ISBN 978-9928-169-54-9
9 789928 169549

Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI DISKRIMINIMI GJINOR NË ÇËSHTJET FAMILJARE E MARTESORE

PROF. DR. ARTA MANDRO-BALILI

DISKRIMINIMI GJINOR

në çështjet familjare e martesore

Tiranë, 2014

Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI

Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore

ROLI I GJYQËSORIT SHQIPTAR NË ELIMINIMIN E TIJ

Prill, 2014

Titulli: Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore
Autore: Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI

© Copyright: Shkolla e Magjistraturës & UNDP

ISBN ?????

Ky studim u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (UNDP) dhe Qeveria e Suedisë. Mendimet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin e UNDP-së apo të Kombeve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje 6
Falënderime 8
Lista e shkurtimeve 9
Struktura e studimit 10
Metodologjia 17
Vështirësitë e studimit 18

Pjesa e parë: Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me barazinë gjinore në jetën familjare e martesore. 21

1. Instrumentet e OKB në aspektin e barazisë gjinore dhe jetës familjare 23
1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut [DUDNJ] 23
1.2. Konventa (Pakti) Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore e vitit 1966 24
1.3. Konventa (Pakti) Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. 1966 24
1.4. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas - CEDAW 25
1.4.1. Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë, të vitit 2010 kundrejt detyrimeve të gjyqësorit shqiptar 27
1.4.2. Rekomandimi i Përgjithshëm 21 i CEDAW mbi "barazinë në martesë dhe në marrëdhëniet familjare" 29
1.4.3. Rekomandimi i Përgjithshëm 29 i CEDAW 29
1.5. Konventa për të Drejtat e Fëmijës [KDF] (1989) 30

2. Instrumentet e Këshillit të Evropës lidhur me barazinë gjinore në jetën familjare e martesore 30
2.1 KEDNJ - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut 31
2.2 Neni 5 i Protokollit Nr. 7 të KEDNj-së - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut 31
2.3 Protokolli Nr. 12 i KEDNj-së [neni 1] 31
2.4 Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje 33
2.5 Jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me diskriminimin në familje e martesë [neni 8 dhe 14 i KEDNj] 34

3. Legjislacioni i Bashkimit Evropian 38

4. Legjislacioni shqiptar 40
4.1. Dispozitat e Kodit të Familjes dhe barazia gjinore 40
4.2. Ligji nr.9970/28.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" 45
4.3. Ligji nr. 221/4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" 45

Pjesa e dytë: Lidhja e martesës dhe parimi i barazisë gjinore 46

1. E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të pasur familje si të drejta themelore të njeriut 46
1.1. E drejta për martesë si e drejtë "e kufizueshme" nga legjislacioni kombëtar. Kufizimet si parim që nuk mund të cenojnë thelbin e së drejtës për martesë 47

2. Pëlqimi i lirë si parim që duhet respektuar për të dy dhe nga të dy bashkëshortët në lidhjen e martesës 48
2.1. Martesa me mblesëri ose ndërmjetësim dhe rreziku i parimit të 'pëlqimit të lirë' 49
2.2. Pëlqimi i lirë sfiduar në rastet e lidhjes së martesës me shtetas të huaj ose me shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit 52
2.3. Shtrëngimi ose detyrimi për martesë

3. Roli i prokurorit në procedurën e lidhjes së martesës pa shpallje 57

4. Mosha për martesë dhe martesat në moshë të mitur 63
4.1. Roli i gjykatës në lejimin e martesës nën moshë 67
4.2. Kufijtë e mundshëm të minimumit ligjor për të lejuar lidhjen e martesës nën moshë 73
4.3. Kujdesi i veçantë ndaj të miturave me gjendje të vështirë ekonomike. Rreziku i martesave fiktive. Premtimeve për martesë me qëllim prostitucionin e trafikimin 77

5. Lidhja e martesës: rëndësia e marrjes së certifikatës në procesin gjyqësor dhe në veprime të tjera që i japin aktit/certifikatës martesore një rëndësi prioritare 78

Pjesa e tretë: Barazia gjinore dhe mos diskriminimi gjatë marrëdhënieve martesore. Ndikimi te fëmijët 80

1. Natyra e dispozitave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesa 81

2. Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet personale

midis bashkëshortëve 83
2.1 Cenime të së drejtës së ushtrimit lirisht të profesionit, arsimimit, etj. të bashkëshortes [neni 63/1 i KF] 84
2.2 Çështje të mbiemrit të bashkëshortëve dhe të fëmijëve [neni 51 dhe 52 i KF] 85
2.3 Çështje të diskriminimit lidhur me funksionin riprodhues dhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet bashkëshortëve 87
2.4 Detyrimi për jetë të përbashkët [neni 55/1 KF] 89
2.5 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi në caktimin e vendbanimit [neni 55/2 KF] 90

3. Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve 91

4. Mjetet juridike që mund të përdoren kundrejt bashkëshortit që shkel detyrimet që burojnë nga martesa 97

Pjesa e katërt: Mbarimi i martesës dhe institute të tjera të së drejtës familjare në fokusin e rreziqeve të diskriminimit gjinor 101

1. Jeta familjare pas mbarimit të martesës. Diversiteti i pasojave në varësi të gjinisë së bashkëshortëve 101

2. Zgjidhja e martesës dhe rëndësia e përcaktimit të vlerës së punës së papaguar kundrejt standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit 102

3. Detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve 111

4. Amësia dhe atësia e fëmijës dhe çështjet e diskriminimit gjinor 114

5. Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës dhe vështirësitë shumëformëshe në gëzimin të drejtave dhe lirive të ish-bashkëshortëve 124

Disa përfundime dhe sugjerime të studimit 136

Bibliografia 142

Hyrje

Në çfarëdo sfere të jetës që të konstatohet apo zhvillohet, publike apo private, diskriminimi gjinor është rrezik për progres. Ndërsa mundësitë e ballafaqimit me fenomenin e diskriminimit në jetën publike janë më evidente, mbetet i padukshëm diskriminimi në familje. Është fjala për atë që ndodh midis bashkëshortëve dhe diskriminimi midis fëmijëve për shkaqe gjinore.

Ky studim është një mundësi për të analizuar gjendjen ligjore dhe faktike të dimensioneve të barazisë në familje nga këndvështrimi gjinor. Pra, si të thuash përmes 'lupës' së vendimeve gjyqësore të shfletohet situata brenda familjes dhe kryesisht respektimi i të drejtave bazë të gruas dhe vajzës brenda familjes duke u përpjekur që të ndikojmë në transparencën e problemit dhe në vëmendjen e sistemit të drejtësisë për të siguruar që vendimet të marrin në konsideratë pasojat e ndryshme që mund të sjellë një vendim për shkak të përkatësisë gjinore.

Barazia gjinore në jetën familjare dhe në atë në çift çon në kultivimin, garantimin dhe respektimin e këtyre standardeve në një prej qelizave bazë më të rëndësishme të shoqërisë siç është familja. Familja është, në këtë mënyrë, baza e sigurt për transmetimin e këtyre parimeve tek fëmijët dhe anëtarët e tjerë të saj duke e shndërruar barazinë gjinore në jetën familjare në një të drejtë dhe detyrim për edukimin e brezave të ardhshëm.

Marrëdhëniet e shëndosha familjare e martesore janë një kontribut në eliminimin e steriotipave gjinore. Gjithçka fillon në familje dhe transmetohet në shoqëri. Për këtë arsye, me të drejtë, nëse duam të dimë sa i respekton parimet e mosdiskriminimit dhe të barazisë gjinore një shoqëri, është shumë efikase që këtë analizë ta fillojmë nga familja.

Ndonëse e drejta familjare dhe marrëdhëniet e prodhuara prej saj i përkasin kryesisht sferës së të drejtës private, ka një interes të fortë publik për "mbrojtjen e veçantë të familjes dhe të martesës" sikurse ka një interes të veçantë e parësor për mbrojtjen e fëmijëve. Sa u përmend është një detyrim Kushtetues, konvencional dhe ligjor.

Familja nuk është një koncept abstrakt, utopik apo i papërcaktuar. Familja janë anëtarët e saj. Në këtë mënyrë kjo mbrojtje e veçantë që garantohet edhe prej legjislacionit, është, në thelb, mbrojtje e të drejtave njerëzore të individëve që e përbëjnë atë, është mbrojtje e parimeve të barazisë gjinore duke nisur që nga çifti, i kompozuar nga bashkimi i një burri me një grua qoftë në martesë qoftë në bashkëjetesë e duke u shtrirë mandej në fëmijët (vajza e djem) dhe të gjithë anëtarët e familjes në kuptimin e gjerë të fjalës (*communi iure*).

Anëtarët e familjes gjenden kudo të shpërndarë në gjithë sferat e jetës

publike. Ata mund të jenë edhe gjyqtarë të çështjeve familjare. Kështu konceptet familje, shoqëri, shtet janë hallka të të njëjtit zinxhir e si të tilla, transmetojnë tek njëra-tjetra presionin e tyre, duke e bërë kështu problemin e diskriminimit brenda familjes një problem mbarë shoqëror dhe shtetëror.

Sipas DUDNJ dhe të gjithë instrumenteve ndërkombëtare që e pasojnë atë, kur flitet për barazinë midis bashkëshortëve, instrumentet ndajnë tri momente të rëndësishme:

1. barazi dhe mos diskriminimim midis burrit dhe gruas kundrejt martesës si akt, pra në gjithë procedurën dhe çastin e lidhjes së martesës;
2. barazi dhe mosdiskriminimim midis burrit dhe gruas si bashkëshortë dhe si prindër të fëmijëve të tyre gjatë martesës, qoftë në aspektet personale dhe ato pasurore;
3. barazi dhe mos diskriminimim midis bashkëshortëve në procesin dhe pasojat e mbarimit të martesës.

Pikërisht, këto janë edhe linjat kryesore të këtij studimi.

Falënderime

Të ndërtosh një strukturë për një studim të tillë duket e lehtë por kur nis të hulumtosh praktikën gjyqësore verifikon vështirësitë që has teksa kërkon 'të hysh në strofkullën' e diskriminimit në familje dhe mënyrën se si përcillet në gjykatë. E them këtë sepse diskriminimi është kaq 'i fshehtë e tinëzar' saqë, ndonjë herë, për të realizuar këtë studim më është dashur t'u rikthehem një grupi vendimesh e t'i ri-analizoj ato nga një këndvështrim i ri: jo thjesht për nga mënyra si janë formuluar, apo për nga filozofia që përcjellin, por edhe për nga pasojat që mund të sjellin. Në këtë mënyrë, mund të themi se çdo studiues ndjen rritjen dhe aftësinë hulumtuese brenda vetes në konceptimin e fenomenit që mund të shfaqet si neutral dhe si zgjidhja më e duhur në rreshtat e një vendimi, por që sjell efekte të pabarabarta gjinore në praktikë.

Nga ana tjetër më duhet të pranoj se koha e përgatitjes kaloi shumë shpejt dhe kur pjesët u lidhën e dhanë gjithë panoramën e jetës familjare e martesore, në fragmentet më tipike të saj, doli edhe më në pah fytyra 'shqiptare' e diskriminimit brenda familjes që, ndërsa ka një kolorit të vetin, nuk ndryshon shumë nga ato që evidentohen edhe nga studime të vendeve të tjera.

Falënderoj UNDP-në dhe Shkollën e Magjistraturës që më besoi këtë studim.

Nuk është e gjitha merita ime: Nurjeta Tafa, Enkelejda Kapedani, Ersida Bajgora, Olta Goxhaj, janë studente të shkollës së Magjistraturës që gjetën kohë të punonin për detyra të ngarkuara.

Më duhet të nënvizoj se realizimi i këtij studimi është kontribut i shumë kolegëve kryesisht gjyqtarë që, në kushtet e një sistemi të dhënash shumë të vështirë për t'u aksesuar, kanë dërguar vendime tipike. Kështu, gjejmë rastin të falënderojmë: gjyqtarët *Fjoralba Qinami; Adelina Zarka, Rexhina Merlika, Admir Belishta, Sonjela Voskopi, Rezarta Mataj, Brunilda Kasmi, Brunilda Kadi, Brikena Lubonja,* të cilët e pasuruan studimin me rastet e paraqitura në sistemin e drejtësisë shqiptare dhe tipologjinë e këtyre rasteve si dhe qëndrimeve të palëve në procese. Kështu studimi u bë realist dhe i mbështetur në fakte konkrete të cilat tregojnë se ndonëse ligji duket i plotë dhe i barabartë për të gjithë, efektet e tij në zbatim japin rezultate të ndryshme.

Një falënderim i veçantë u shkon aktorëve të shoqërisë civile dhe veçanërisht Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim. Falënderojmë veçanërisht *Aurela Anastasi, Mirela Arqimandriti, Besa Saraçi, Iris Aliaj, Artili Mandro.*

Falënderojmë Kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterisë *Znj. Mimoza Sadushi* e cila përgatiti një informacion mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga zyrat noteriale lidhur me problemet që hasin noterët në veprimtarinë e tyre;

Së fundi, aspak për nga rëndësia, një falënderim e mirënjohje e veçantë shkon për Entela Lakon, Emira Shkurtin dhe Elona Dinin, si pjesë e stafit të UNDP.

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa e OKB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DUDNj	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterisë
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
GJEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GjL	Gjykata e Lartë
GjRrGj	Gjykata e Rrethit Gjyqësor
HUDOC	Faqja web e dokumentacionit të të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës
KC	Kodi Civil
KDF	Konventa e OKB për të Drejtat e Fëmijës
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut
KF	Kodi i Familjes
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
LBGJ	Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" i vitit 2008
LGJC	Ligji "Për Gjendjen Civile", 2009, i ndryshuar
LMDF	Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", 2010
MSA	Marrëveshja e Stabilizim- Asocimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
UM/UMM	Urdhër mbrojtjeje/Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNWomen	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Struktura e studimit

Ky punim është i pari në llojin e vet, bërë pas thuajse një dekade nga hyrja në fuqi dhe zbatimi i Kodit të Familjes së R.Sh. [2003]. Çështjet e barazisë gjinore dhe të mos diskriminimit gjatë këtij dhjetëvjeçari kanë marrë jetë dhe kuptim të ri dhe kanë adoptuar skema e stile të reja shfaqjeje e kamuflimi. Ndërkohë, kur KF u hartua, ende nuk kishim një ligj të mbrojtjes nga diskriminimi dhe të barazisë gjinore në shoqëri. Dalja e tyre sensibilizoi dhe ndërgjegjësoi aktorë të ndryshëm të cilët janë anëtarë të familjeve, gjithashtu. Kështu, le të themi në mënyrë indirekte, filloi puna me njohjen e koncepteve dhe të përçuarit e tyre përmes sferës publike në atë që quhet jetë private e jetë familjare.

Çështje që dikur konsideroheshin si të drejta vetëm për bashkëshortin, sot kanë një qasje krejt të barabartë për të dy bashkëshortët, të paktën në kontekstin ligjor. Kështu, ishte edhe situata e dhunës në familje. Dikur një e drejtë e burrit në çdo plan qoftë si baba, vëlla, bashkëshort, sot jemi dëshmitarë të denoncimit në rritje të dhunës në familje duke bërë kështu të mundur reduktimin e saj edhe prej forcës edukuese të ligjit, edhe prej masave mbrojtëse civile, por edhe prej ndëshkimeve penale.

Kjo periudhë dhjetëvjeçare e hyrjes në fuqi të KF është shoqëruar me tranzicione e vështirësi edhe në aspekte të barazisë dhe diskriminimit në jetën publike, në sferën e marrëdhënieve të punës dhe të shërbimeve, aksesit në arsim e në të drejta pronësore, aksesit në gjykatë, etj. Si të tilla, këto aspekte kanë sjellë impaktin e tyre në jetën familjare dhe martesore.

Duke hulumtuar praktikën gjyqësore mundëm të evidentonim standardet e barazisë dhe reciprocitetit sipas dispozitave të Kodit të Familjes në disa drejtime: sa i njohin e respektojnë ato bashkëshortët; çfarë mbrojtjeje gëzojnë këta në proceset gjyqësore e në vendimet gjyqësore, dhe në këtë mënyrë sa efektiv është ligji dhe cili është qëndrimi i gjykatës kundrejt qasjes së standardeve ligjore me realitetin që sjell rasti konkret. Nuk pretendojmë që në këtë studim të kemi parë gjithçka ka ndodhur në këta 10 vjet dhe të kemi analizuar tërë gamën e neneve të KF e të praktikës gjyqësore parë nga këndvështrimi i zbatimit të drejtë ose diskriminues të tyre.

Gjithsesi, dhe me kaq sa është hulumtuar, mendojmë se ky studim ka një profil të fortë drejt praktikës gjyqësore. Kujdesi ndaj rasteve të praktikës gjyqësore, vjen natyrshëm nisur nga fakti se, ndërsa legjislacioni lidhur me gëzimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve në aspekte personale dhe pasurore të marrëdhënieve bashkëshortore, në përgjithësi, është i plotë dhe neutral, rezultatet dhe zbatimi në praktikë i këtij legjislacioni, sjellin vështirësi më së shumti për gratë. Në cenimet që iu bëhen parimeve të barazisë në familje e në martesë ka rolin e vet dhe sjell kontribute tradita, zakonet dhe mentalitetet mbizotëruese, mënyra se si zbatohet

ligji, niveli i ndërgjegjësimit edhe të vetë grave, si nëna e bashkëshorte dhe si anëtare me të drejta të plota e të barabarta në familje. Këtu një rol të veçantë ka bashkëshorti ose le të themi një mashkull në familje. Sa me respekt e dinjitet e sheh ai rolin e gruas si nënë e bashkëshorte në familje? Çfarë raportesh barazie ndërtohen me fëmijët vajza e djem në shtëpi? Në disa raste në këtë bilanc jo pozitiv ka vendin e vet edhe gjykata përmes vendimeve të veta në të cilat mungon një analizë adekuate e rezultateve për të ardhmen dhe për cilësitë e jetës së anëtarëve të saj, të balancuar me përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre.

Ndërmarrja e masave konkrete për përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave si dhe ndërmarrja e politikave anti diskriminuese mbetet një prioritet kyç edhe në kuadrin e BE-së, edhe në kontekstin e respektimit të CEDAW si detyrime për Shqipërinë dhe këtu sfera publike dhe sfera private nuk kanë asnjë dallim në dedikim.

Studimi është i ndarë në katër [4] pjesë kryesore dhe përmbyllet me disa sugjerime që kemi vlerësuar e shkëputur si me rëndësi për t'u konsideruar nga aktorë të ndryshëm

Në pjesën e parë, renditen gjithë instrumentet ndërkombëtare e kombëtare që trajtojnë aspekte të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore.

Ndërsa lista e instrumenteve ndërkombëtare është e plotë, mbetet si detyrë njohja me to, me qëllim zbatimin. Praktika gjyqësore e monitoruar edhe në kuadrin e këtij studimi por edhe nga aktorë të tjerë, tregon se referimi tek këto instrumente është tepër i kufizuar.

Instrumentet ndërkombëtare i referohen parimit të mos diskriminimit dhe të barazisë në familje si një prej parimeve themelore për një jetë cilësore. Kur flasim për barazinë gjinore e shohim këtë në dy dimensione: barazi formale dhe barazi substanciale [në përmbajtje]. Në kuptimin formal kërkohet që ligjet të jenë neutrale nga këndvështrimi gjinor. Në kuptimin substancial kërkohet që edhe rezultatet të jenë të tilla dhe asnjë skutë e ligjit 'neutral' të mos jetë vetëm sa për sy e faqe por të prodhojë vërtet këtë barazi. Kështu duhet parë edhe dhënia e drejtësisë në çështjet familjare. Gjyqtari në çdo vendimmarrje vlen të shohë përtej paraqitjes unike të një rregulli duke e përkthyer vendimin e vet në pasojat që do të vijnë për rastin konkret. Studimi tërheq vëmendjen se kjo analizë e impaktit të vendimit do bërë sa kohë vendimi ende nuk është marrë përfundimisht dhe kjo është detyrë kryesisht e gjykatës, por edhe e aktorëve që kontribuojnë në këtë proces.

Është shumë e rëndësishme që gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë të njohin kuadrin ligjor dhe standardet lidhur me parimin e barazisë gjinore në jetën private, familjare e martesore. Duke i njohur ato, kanë gjithë mundësitë për t'i përdorur dhe pasqyruar në vendimet konkrete. Është po kaq e rëndësishme njohja me përvojat pozitive, me qëllim adoptimin e tyre në të mirë të parimeve të mosdiskriminimit. Këtë

e realizojmë në studim edhe përmes praktikës së gjykatës së Lartë ose jurisprudencës së GjEDNj duke vënë në dispozicion të lexuesit profesionist burime prej nga mund të azhurnohet në çështje të caktuara.

Seleksionimi i pasazheve të konventave dhe ligjit shqiptar, është bërë me qëllim që prej tyre të filtrohen dispozitat që ndikojnë mbi parimet e barazisë gjinore në jetën familjare e martesore për t'u përdorur me efikasitet në mbrojtjen nga diskriminimi. Pa dyshim që në këtë proces një rol të veçantë kanë avokatët dhe palët, por gjykata ka rolin e saj për nxitjen e barazisë dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore. Gjykata është përgjegjëse që në vendimet e saj të kujdeset që pasojat të mos sjellin pabarazi dhe diskriminim kundrejt të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, qoftë në aspektet personale ashtu edhe ato pasurore. Duke analizuar legjislacionin shqiptar, dhe praktikën gjyqësore, kemi mundësi tu paraqesim aktorëve të ndryshëm karakterin thjesht teorik të disa neneve që duket sikur janë vendosur në ligj për të ligjësuar një të drejtë, por që, nëse nuk zbatohen', bën që të drejtat e parashikuara në to të mbeten të pa garantuara, fiktive. Kjo edhe me qëllim për të nxitur veprime pozitive, qoftë edhe përmes vendimeve, kërkesë padive apo ndryshimeve ligjore.

Punimi është ndalur në prurjet e vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë dhe shqetësimet e këtij Komiteti me qëllim përmirësimin e situatës në vend. Ende njohja dhe zbatimi i këtyre standardeve kërkon më shumë vëmendje përderisa rastet e referimit të CEDAW gati - gati numërohen me gishta. Po kaq e vakët është edhe njohja me jurisprudencën e GjEDNj lidhur me aspekte të nenit 8 dhe 14 të KEDNj. Ndodh që këto vendime të përdoren për të treguar thjesht se njihen dhe dihen, dhe jo për të mbështetur standarde të jetës familjare e martesore përmes një analize konkrete të rastit të paraqitur dhe raportit me jurisprudencën e GjEDNj.

Në këtë pjesë të parë, instrumentet janë klasifikuar dhe renditur në disa drejtime për nga fakti nëse: i përkasin një organizate globale apo rajonale; janë norma të detyrueshme apo rekomanduese, norma ndërkombëtare apo kombëtare lidhur me barazinë gjinore dhe mos diskriminimin në jetën familjare e martesore.

Fokus i veçantë, por jo në mënyrë ekskluzive vetëm në këtë pjesë i është kushtuar jurisprudencës së GJEDNJ në lidhje me diskriminimin në familje e martesë [neni 8 dhe 14 i KEDNj] duke sjellë rastet që në mënyrë dinamike dhe tepër parimore vënë në lëvizje këtë gjykatë. Studimi synon të japë në dorë të gjyqtarëve mjete praktike se si të hulumtojnë në këtë jurisprudencë, siç është faqja dokumentacionit të të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës e njohur me HUDOC, etj.

Pjesa e dytë trajton parimet e barazisë që duhen mbajtur në vëmendje gjatë lidhjes së martesës si një hap me rëndësi në konstituimin e saj, si një martesë me ose pa të meta. Shumë e rëndësishme që martesa dhe familja të ndërtohen mbi baza të shëndosha, pra të ketë themele të forta e cilësore që

në fillesat e veta. E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të pasur familje hyn tek të drejtat themelore të njeriut. Për shkak të kushteve esenciale që i lihen në diskrecion çdo shteti, duket se ka disa kufizime ligjore lidhur me realizimin e kësaj të drejte.

Pëlqimi i lirë dhe mosha për martesë

Studimi ndalet në rëndësinë që ka mosha për martesë dhe pëlqimi i lirë kundrejt rolit të gjykatës, e cila, nisur nga interesi publik që qëndron në institutin e martesës si një e drejtë private, në disa raste, sipas përcaktimeve ligjore, bëhet protagonistja dhe garantja kryesore e martesës. Ndërkohë që legjislacioni shqiptar, Kodi i Familjes [2003] parashikon të njëjtat kushte dhe pengesa martesore pa diskriminuar as burrin e as gruan, si bashkëshortë të ardhshëm, praktika gjyqësore dhe realiteti raporton se ende zakonet dhe traditat shfaqen dhe përpiqen të luajnë rol protagonist. Kështu, studimi sjell, përmes shembujve nga vendimet gjyqësore, raste që tregojnë rrezik ndaj cenimit të standardeve të Kodit të Familjes dhe të konventës CEDAW.

E drejta e një gruaje për të zgjedhur një bashkëshort dhe për të hyrë lirisht në një martesë është me rëndësi qendrore për jetën, dinjitetin dhe barazinë e saj si qenie njerëzore. Teorikisht, e njëjta vlen edhe për burrin ndonëse në asnjë rast nga praktika e analizuar, nuk kemi hasur rastin e një burri që kërkon lidhjen e martesës nën moshë. Këtu jemi ndalur në garancinë që jep parimi/kushti i "pëlqimit të lirë" sipas nenit 8 të KF. Mungesa e pëlqimit të lirë, apo një pëlqim i vesuar, e bën martesën të pavlefshme juridikisht. Një martesë e pavlefshme nuk sjell pasoja juridike për bashkëshortët dhe si rregull goditet për pavlefshmëri.

Martesa me 'mblesëri a shkuesi'

Në studim trajtohet se sa evidente është martesa me mblesëri ose ndërmjetësim dhe çfarë rreziqesh shfaq kjo lloj martesë në parimin e 'pëlqimit të lirë'. Në një sërë vendimesh gjyqësore të analizuara kemi gjetur të përmendet se 'rezulton e provuar se çifti është fejuar me ndërmjetësi ose me mblesëri', çka do të thotë se në lidhjen e martesës ende aplikohen rregullat e së drejtës zakonore mbi shkesin apo mblesin. Mendojmë se sikurse palët që e parashtrojnë këtë fakt gjatë procesit gjyqësor, edhe gjykata që gjen rastin dhe vendin e duhur ta citojë këtë në vendim, duket sikur duan të na tërheqin vëmendjen mbi masat që duhen marrë për edukimin e qasjeve të lira dhe pa vese lidhur me lidhjen e martesës. Fjala e dhënë nga shkesi apo mblesi në disa zona të caktuara të vendit, për shkak të rëndësisë që ende banorët e tyre i veshin së drejtës zakonore, e kthen dhënien e pëlqimit në një detyrim për çiftin. Ky detyrimi vë në rrezik pëlqimin e lirë dhe për rrjedhojë e bën martesën të mundshme për t'u goditur për pavlefshmëri.

Ndikimi i së drejtës zakonore edhe në aspekte të tjera

Në disa zona të vendit, zakonet dhe traditat e së shkuarës ende kanë një ndikim edhe më të madh. Praktika evidenton raste ku mungesa e pëlqimit të lirë haset jo vetëm në rastin e lidhjes së martesës por edhe

të krijimit të marrëdhënieve të faktit përmes institutit të bashkëjetesës. Ajo çka bie në sy, veç faktit të mblesërisë është 'përdorimi' në tekstet e vendimeve gjyqësore i institutit të fejesës. Ndërkohë, nuk ka asnjë dispozitë të KF të bëjë rregullime për këtë institut.

Roli i prokurorit në çështjet lidhjes së martesës

Studimi ndalet në një çështje me rëndësi dhe devijimet në praktikë lidhur me rolin e prokurorit në procedurën e lidhjes së martesës pa shpallje, duke tërhequr vëmendjen se praktika të tilla mund të çojnë në cenimin e parimeve të barazisë dhe në rrezikun e diskriminimit. Gjithashtu studimi tërheq vëmendjen e gjykatës ndaj rreziqeve që mund ti shfaqen pëlqimit të lirë në rastet e lidhjes së martesës me shtetas të huaj ose me shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë, vetëm për dokumentacion apo për përfitime ekonomike si dhe rastet ekstreme të shtrëngimit apo detyrimit për martesë, përfshi këtu edhe rreziqet e trafikimit.

Problematika e martesës në moshë të mitur

Mosha për martesë dhe martesat në moshë të mitur janë një tjetër aspekt i kushteve për martesë të analizuara me kujdes në praktikën gjyqësore dhe sidomos për të parë vëmendjen e treguar nga gjykata në disponimet për lidhjen e martesës nën moshë. Martesa e fëmijëve është një çështje që pozicionohet ndërmjet standardeve të barazisë gjinore dhe të drejtave të fëmijëve. Për këtë arsye, KF parashikon që "Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe". Fenomeni i martesave të të miturve, është ndër çështjet e trajtuara më shpesh nga komitetet e KDF dhe CEDAW në vërejtjet përfundimtare në dialogun e tyre me shtetet palë të këtyre instrumenteve. Të dy komitetet përmes jurisprudencës së tyre lidhur me martesën e fëmijëve theksojnë tiparet plotësuese dhe reciprokisht përforcuese të të dy Konventave sa i përket moshës së martesës. Ndërsa KDF nuk ndalon posaçërisht martesën e fëmijëve, por në mënyrë të qartë përcakton moshën madhore si atë 18 vjeç, CEDAW kategorikisht e konsideron martesën e fëmijëve të pavlefshme *ab initio*. Martesat në moshë të mitur efektojnë negativisht në realizimin e të drejtave të tjera të kësaj grupmoshe siç është e drejta për arsimim dhe kualifikim, etj.

Nuk mungojnë vendime ku dalin në pah të dyja rreziqet ndaj të pëlqimit të lirë: edhe mosha e mitur, edhe bërja fakt e lidhjes në çift nga ana e familjarëve. Sa më e vogël mosha, aq më e kufizuar autonomia për të vendosur dhe aq më i mundshëm imponimi apo detyrimi për martesë. Në rolin e vet gjykata kontrollon dhe të mbron martesën si institut, por edhe të drejtat e fëmijës që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Sipas Kushtetutës së RSH dhe dispozitave të KF, edhe martesa, edhe fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti**.** Gjykata që lejon martesën nën moshë ndërsa "ndërhyn" në realizimin e aktit të martesës, nuk mund të jetë aq sipërfaqësore sa të mos shohë përtej aktit. Garantimi i martesës si

institut është detyrë e rëndësishme që ligji në këtë situatë ia ka deleguar gjykatës, e cila jep lejen mbi bazën e një analize tërësore të shkaqeve me rëndësi. Studimi sjell një listë kontrolli, tentative, për gjykatën në rastet e kërkesës për lejimin e martesës nën moshë.

Pjesa e tretë përqendrohet në atë që ndodh në jetën familjare e martesore midis bashkëshortëve gjatë martesës. Jeta e bashkëshortëve ka një orientim të ri dhe dinamikë të re kundrejt jetës së mëparshme dhe përpjekjet e tyre synojnë që të qaset jeta individuale, interesat e tyre personale, me funksionet e familjes së re të sapokrijuar. Në disa çifte, menaxhimi i jetës së re, edhe kur ka vështirësi, bëhet me sukses. Në disa të tjerë, shfaqen shenjat e para e mandej sjelljet e përsëritura të diskriminimit e pabarazisë deri në dhunën në familje si situatë ekstreme. Martesa është si një organizëm i gjallë e ndodh që qëndrimet ndaj funksioneve të saj dhe të drejtave dhe detyrimeve ndaj familjes dhe martesës, pavarësisht diversitetit që ka në çift, të përkthehen herë në sjellje e veprime jo diskriminuese dhe herë në të tilla. Këto të fundit herë shfaqen në mënyrë të dukshme e herë më të kamufluara.

Qëllimi i kësaj pjese është 'të hyjmë' në marrëdhëniet e bashkëshortëve dhe të shohim se sa barazi ka në gamën e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, gjatë martesës. Çfarë roli dhe peshe kanë bashkëshortët në vendimmarrje të ndryshme, që nga ato me rëndësi radikale për cilësinë e jetës e deri në ato më të zakonshmet për mbarëvajtjen e përditshme. Kjo pjesë e jetës së bashkëshortëve, është më pak e zbuluar apo më pak evidente. Vetëm bashkëshortët e dinë se çfarë ndodh në shtëpinë e tyre!

Në këtë pjesë jemi ndalur në një analizë të natyrës së dispozitave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimeve që burojnë nga martesa duke tërhequr vëmendjen në faktin se detyrimet që burojnë nga martesa kanë përparësi dhe të drejtat që burojnë nga martesa janë të pashmangshme. Analiza ndalet në çështje të barazisë dhe mosdiskriminimit në marrëdhëniet personale midis bashkëshortëve duke veçuar këtu cenimet e së drejtës së ushtrimit lirisht të profesionit, ndjekjes së arsimit, etj. të bashkëshortes [neni 63/1 i KF]; në çështjen sensitive të mbiemrit të bashkëshortëve dhe të fëmijëve [neni 51 dhe 52 i KF]; në çështje të diskriminimit lidhur me funksionin riprodhues dhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet bashkëshortëve; detyrimin për jetë të përbashkët [neni 55/1 KF]; Mjetet juridike që mund të përdoren kundrejt bashkëshortit që shkel detyrimet që burojnë nga martesa; Parimi i barazisë dhe mos diskriminimi në caktimin e vendbanimit [neni 55/2 KF]; etj.

Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve gjatë martesës sjell në fokus kryesisht çështje që kanë të bëjnë me regjimin me kontratë. Kontrata paramartesore dhe rreziqet e diskriminimit gjinor trajtohen me qëllim që të sillen në vëmendje të gjykatës lidhur me vlefshmërinë ose jo të kësaj kontrate kur bëhet vlerësimi prej saj në vendimin gjyqësor. Pra, çfarë duhet të vlerësohet

kur përpilohet kontrata martesore ose paramartesore me qëllim që kundrejt parimeve të barazisë midis bashkëshortëve të mos goditet me pavlefshmëri në një proces gjyqësor.

Pjesa e katërt ndalet në disa aspekte të ndryshme të jetës familjare, të tilla si diversiteti i pasojave personale e pasurore të zgjidhjes së martesës në varësi të gjinisë së bashkëshortëve. Praktika ka treguar se pasojat që lë mbarimi i martesës tek bashkëshortët varen shumë nga gjinia e bashkëshortit/es. Këtu është fjala si për aspektet personale, ashtu edhe ato pasurore, lidhur kjo edhe me detyrimet personale e financiare që ata kanë kundrejt njëri-tjetrit ose aftësive të ndryshme që ka njëri bashkëshort kundrejt detyrimeve për personat e tjerë që mbeten në ngarkim të tij/saj.

Në këtë pjesë, studimi ndalet në kuptimin dhe rëndësinë e përcaktimit të vlerës së punës së papaguar kundrejt standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit duke u mbështetur për këtë trajtesë në tekstin "Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi". Gjithashtu synohet të jepen disa alternativa që mundet të konsiderohen nga ekspertët e marrë nga gjykata në vlerësimin e punës së papaguar.

Çështje të tjera të analizuara në këtë pjesë janë: detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve, duke evidentuar edhe disa instrumente përllogaritës në ndihmë të gjykatës lidhur me detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve; Çështje të institutit të amësisë dhe atësisë kundrejt rreziqeve të diskriminimit gjinor; Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës dhe vështirësitë shumëformëshe në gëzimin të drejtave dhe lirive të ishbashkëshortëve, etj.

Pjesa e fundit e studimit. Studimit nuk mund t'i mungojnë një seri rekomandimesh të cilat, në fakt, zënë vend edhe në faqet e tij por që paraqiten në mënyrë të përmbledhur në pjesën përmbyllëse. Këto rekomandime i drejtohen të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë, e në mënyrë të veçantë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve, me synimin që të përçohen, përmes rolit të tyre, standardet e barazisë dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore, si një nga aspektet e jetës që përfshin të gjithë pa përjashtim. Këto rekomandime duhet të mbahen në vëmendje nga studentët e Shkollës së Magjistraturës si brezi që merr stafetën në çështjet e drejtësisë dhe duhet të vlerësojnë se nuk ka drejtësi në përgjithësi, qoftë edhe në një vendim të vetëm, të dhënë qoftë edhe në një gjykatë të rrethit gjyqësor më të 'vogël' në vend, nëse nuk respektohen parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit. **Pra, siç vihet re, më shumë se sa një pjesë më vete, është një përmbledhje me qëllim reflektimi.**

Metodologjia shkurt

Ky studim kaloi përmes këtyre fazave kryesore:

❒ një rishikim i seleksionuar i legjislacionit në fuqi dhe një analizë cilësore e impaktit të dispozitave ligjore në lidhur me parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore;

❒ një rishikim i seleksionuar i standardeve ndërkombëtare lidhur me parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore;

❒ hulumtim në jurisprudencën e disa gjykatave si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Tiranë, Vlorë, Fier, Durrës, dhe në disa prej vendimeve Unifikuese dhe të kolegjeve

Civile e Penale të Gjykatës së Lartë [analizuar rreth 77 vendime të periudhës 2010-2013të Gjykatës së Lartë] me objekt çështje të Kodit të Familjes.

❒ Një vështrim mbi jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

Për realizimin e studimit u zbatua metoda cilësore, e kombinuar me atë sasiore për të zbuluar anët e shumta e komplekse të të drejtave të grave.

Vështirësitë e studimit:

Kryesisht këto janë të lidhura me vështirësi që vijnë nga pamundësia e aksesimit të vendimeve gjyqësore me përjashtim të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Lartë faqet në web të të cilave janë lehtësisht të përdorshme.

Të gjitha gjykatat e tjera të rretheve gjyqësore, gjithsej 22, [pa përfshirë Gjykatën e Krimeve të Rënda] ndërsa kanë faqe elektronike, vendimet gjyqësore që gjenden në to janë plotësisht të paaksesueshme. Kjo situatë na krijoi shumë vështirësi dhe humbje kohe të pallogaritshme. Veç kësaj, nuk mundëm të evidentojmë përmes një kampioni të balancuar ndër gjykatat kryesore në vend, tipologjinë dhe gamën e problemeve gjinore të shoqërisë shqiptare. Po kështu, kjo na vështirësoi në matjen e tendencës së çështjeve që paraqiten përpara gjykatës si dhe qëndrimin e gjykatës dhe profesionistëve të ligjit kundrejt tyre. Për të kuptuar këtë vështirësi, mjafton të shkosh në faqen e Ministrisë së Drejtësisë [http://www.drejtesia.gov.al/] dhe të gjesh aty portalin e emërtuar 'Portali kombëtar i Sistemit Gjyqësor Shqiptar'. Si të hapësh këtë portal në programet e kërkuara, sipas instruksioneve që jepen në të, duke marrë si model një nga gjykatat e rretheve gjyqësore, kupton lehtësisht se përmes filtrave në dispozicion nuk është e mundur të gjesh çështjet objekt i këtij studimi. Filtri i bazës ligjore është jo funksional dhe filtrat e tjerë që lidhen me të dhëna të palëve në proces, emrin e gjyqtarit, etj, mund të përbëjnë lehtësi për palët e përfshira drejtpërdrejt në një proces, por nuk kanë vlerë përdorimi për një studiues. Për të kompensuar këtë informacion, një ndihmesë të mirë na dhanë disa gjyqtarë, të cilët janë falënderuar në mënyrë të veçantë.

Krejt tjetër është gjendja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Të paktën në këtë portal, filtrat e vendosur janë të përshtatshëm dhe funksionalë. Megjithatë, edhe këtu ekziston mundësia e përmirësimit dhe e ndarjes së portalit në dy nivele: një nivel për publikun dhe një nivel për profesionistët, me qëllim që të mund të studiohen vendimet gjyqësore dhe të dalin konkluzione të rëndësishme e rekomandime për reformime pozitive të normave ligjore, organizimit të sistemit të drejtësisë, etj.

Po kështu, në këtë kontekst, mendojmë se mbrojtja e të dhënave personale që paraqiten në dokumentet e vendimeve gjyqësore duhet të adresohet më mirë dhe profesionalisht nga autoritetet kompetente. Nëse marrim një shembull nga portali i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, p.sh., rastin e një vendimi birësimi, që nënkupton një situatë shumë sensitive dhe ku mbrohet konfidencialiteti në mënyrë të veçantë, vëmë re se aty dalin të gjitha të dhënat, si të fëmijës që birësohet, ashtu edhe të prindërve birësues. Morëm si shembull

birësimin por, në çdo vendim të dhënat e palëve janë publike. Rasti i vendimit nr.3724/06.05.2011 nuk është i vetmi por është seleksionuar për të kuptuar gjendjen e të dhënave të mbrojtura me ligj dhe nevojën e ndërhyrjeve në sisteme të tilla të aksesueshme për të gjithë.

Përdorimi i pseudonimeve lidhur me të dhënat, në raste kur ato nuk mund të hiqen plotësisht nga teksti i një dokumenti, është një nga mjetet më kryesore në mbrojtjen e të dhënave personale në nivelin e duhur[1].

[1] Për më shumë lidhur me mënyrat e mbrojtjes së të dhënave personale shih: 'Handbook on European data protection law' në: http://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_data_protection_ENG.pdf

PJESA E PARË: KUADRI LIGJOR KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR LIDHUR ME BARAZINË GJINORE NË JETËN FAMILJARE E MARTESORE

Instrumentet ndërkombëtare i referohen parimit të mosdiskriminimit dhe të barazisë në familje si një prej parimeve themelore për një jetë cilësore. Kur flasim për barazinë gjinore e shohim këtë në dy dimensione: barazi formale dhe barazi substanciale [në përmbajtje]. Në kuptimin formal kërkohet që ligjet të jenë neutrale nga këndvështrimi gjinor. Në kuptimin substancial kërkohet që edhe rezultatet të jenë të tilla dhe asnjë skutë e ligjit 'neutral' të mos jetë vetëm sa për sy e faqe por të prodhojë vërtet këtë barazi.

Kështu duhen parë dhe analizuar edhe vendimet gjyqësore. Mund të duken neutrale por kundrejt veçorive që kanë bashkëshortët në një situatë konkrete, rezultati që vjen nga zbatimi i këtij vendimi mund të jetë diskriminues. Kjo analizë e impaktit të vendimit do bërë sa kohë ende nuk është marrë vendimi dhe kjo është detyrë kryesisht e gjykatës, por edhe e aktorëve që kontribuojnë në këtë proces.

Është shumë e rëndësishme që gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë të njohin kuadrin ligjor dhe standardet lidhur me parimin e barazisë gjinore në jetën private, familjare e martesore. Duke i njohur, ata kanë gjithë mundësitë për t'i përdorur e pasqyruar, ose siç përdoret nga gjyqtarët shprehja 'për t'i zbardhur' në vendimet konkrete. Është po kaq e rëndësishme njohja me përvojat pozitive, me qëllim adoptimin e tyre në të mirë të parimeve të mosdiskriminimit. Këtë e realizojmë përmes praktikës së gjykatës së Lartë ose jurisprudencës së GjEDNj[2].

Nga publikimet dhe studimet, vëmë re se kujdesi për të mbrojtur individët nga diskriminimi në jetën publike ka një vëmendje më të gjerë dhe më të thellë. Kjo vihet re edhe nga pikëpamja institucionale. Ndërkohë diskriminimi në familje ka fituar një status 'të infiltruar', e kështu identiteti dhe pasojat qëndrojnë shpesh të fshehura. Pra, ndodh që harrojmë se çfarë ndodh në familje. Kujtojmë se episodet e diskriminimit në familje duket sikur janë sporadike dhe të izoluara, por në fakt kanë një përhapje tejet të gjerë për shkak të ndërveprimit midis shoqërisë dhe familjes. Midis tyre ndodh shkëmbimi dhe komunikimi, qoftë i fenomeneve pozitive, qoftë edhe i atyre negative. Sikurse ajo çka fillon në familje dhe transmetohet në shoqëri, ndodh

[2] Një përmbledhje akteve në fushën e të drejtës familjare dhe mbrojtjes së fëmijëve në kuadrin e Këshillit të Europës mund të aksesoret në: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/family/Achievements%2008_08.pdf

edhe anasjelltas. Kështu, shoqëria ndikon në atë që ne 'çojmë' në familje sikurse familja mund të ngulitë episodet e diskriminimit në një nivel më gjithëpërfshirës nëse arrin t'i përçojë këto në shoqëri. Për këtë arsye, tentuam të kuptojmë familjen dhe anëtarët e saj.

Seleksionimi i pasazheve të konventave dhe ligjit shqiptar, është bërë me qëllim që prej tyre të filtrohen dispozitat që ndikojnë mbi parimet e barazisë gjinore në jetën familjare e martesore për t'u përdorur me efikasitet në mbrojtjen nga diskriminimi. Pa dyshim që në këtë proces një rol të veçantë kanë avokatët dhe palët, por gjykata ka rolin e saj pasivo-aktiv me qëllim nxitjen e barazisë dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore. Gjykata është përgjegjëse që në vendimet e saj të kujdeset që pasojat të mos sjellin pabarazi dhe diskriminim kundrejt të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, qoftë në aspektet personale ashtu edhe ato pasurore. Duke analizuar legjislacionin shqiptar, dhe praktikën gjyqësore, kemi mundësi të arrijmë në konkluzione mbi karakterin thjesht teorik të disa neneve që duket sikur janë vendosur në ligj për të ligjësuar një të drejtë, por që, nëse nuk zbatohen, bën që të drejtat e parashikuara në to të mbeten të pa-garantuara, fiktive.

Në vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë, nënvizohet se "Komiteti mbetet i shqetësuar që dispozitat e Konventës nuk janë përmendur në procese gjyqësore, gjë që tregon se ka njohuri të pamjaftueshme në shoqëri në përgjithësi dhe në vetë gratë, tek të gjitha degët e qeverisjes, duke përfshirë gjyqësorin, për të drejtat e grave sipas Konventës dhe Protokollit të saj Opsional, konceptin e barazisë lëndore (de facto) të grave dhe burrave dhe rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit"[3].

Duket se ky shqetësim ende nuk është adresuar siç duhet. Pikërisht këtë tregojnë edhe të dhënat e monitorimi të vendimeve gjyqësore, përkatësisht të gjykatave të rretheve gjyqësore Tiranë, Vlorë, Durrës e Shkodër realizuar nga QNLQ[4]. Ndër aspektet e monitoruara për periudhën janar 2011-maj 2013 është edhe referimi i standardeve ndërkombëtare, përfshi këtu CEDAW, etj. Ende njohja dhe zbatimi i këtyre standardeve kërkon më shumë vëmendje përderisa rastet e referimit të CEDAW gati - gati numërohen me gishta. Po kaq e vakët është edhe njohja me jurisprudencën e GjEDNj lidhur me aspekte të neni 8 dhe 14 të KEDNj. Ndodh që këto vendime përdoren për të treguar thjesht se njihen dhe dihen, dhe jo për të mbështetur standarde

[3] Shih paragrafi 16 i CEDAW/C/ALB/CO/3 në:
http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N10/485/20/PDF/N1048520.pdf?OpenElement [aksesuar më qershor 2013]

[4] Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Shih raportin e hartuar në kuadrin e zbatimit të projektit: "*Përgatitja e kërkesë padive strategjike me qëllim forcimin e të drejtave të grave dhe rritjen e aksesit të tyre në mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë". Projekti është zbatuar nga QNL, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2011-1 qershor 2012. mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD).*

të jetës familjare e martesore përmes një analize konkrete të rastit të paraqitur dhe raportit të tij me jurisprudencën e GjEDNj.

Kjo është arsyeja që në këtë pjesë të këtij studimi kemi vlerësuar paraqitjen e përmbledhur të këtyre instrumenteve. Nevoja e njohjes me këto standarde është instrument që mundëson që standardet e barazisë të bëhen realitet.

1. Instrumentet e OKB në aspektin e barazisë gjinore dhe jetës familjare

1.1. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut [DUDNJ]

Ndonëse DUDNJ[5] është një dokument i renditur si "*soft law*", përmban në brendinë e vet vlera kolosale dhe është bërë kështu, burim frymëzimi për formulimin e konventave ndërkombëtare dhe zbatimin e tyre. Ky efekt i saj nxit ende sot hartimin e ligjeve të çdo shteti, frymëzon politika të domosdoshme efektive, udhëheq veprimet e autoriteteve dhe individëve si edhe vendimet e gjykatave.

Ekziston një korpus i madh i normave të së drejtës ndërkombëtare, por DUDNJ përbën zemrën e korpusit juridik ndërkombëtar dhe të normave të çdo vendi demokratik lidhur me të drejtat e njeriut. Si e tillë, DUDNJ ka një vend nderi. Si një dokument i "së shkuarës" dhe aktualitetit, DUDNj është programuar dhe ka kaluar provën për t'i shërbyer edhe së ardhmes.

Të gjithë të drejtat dhe liritë e njeriut të renditura në DUDNJ janë njohur gjerësisht nga komuniteti ndërkombëtar. Dispozitat dërrmuese të DUDNJ si pjesë e së drejtës ndërkombëtare, janë bërë të detyrueshme. Për shumë shtete, përfshi edhe Shqipërinë, nenet e kësaj Deklarate zbatohen sikur të ishin ligj. Shqipëria i ka integruar të drejtat e njeriut të përmendura në DUDNJ në dispozitat kushtetuese si edhe në të gjithë legjislacionin në fuqi, duke garantuar kështu të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në ditët e sotme, standardet e së drejtës ndërkombëtare dhe asaj kombëtare ndalojnë qartë në parimet e garantuara nga DUDNJ[6] ku, për efekt të asaj se çfarë do të trajtohet në vijim po ndalemi kryesisht në parime – standarde (1) të një dimensioni të përgjithshëm dhe (2) të një karakteri më specifik lidhur me fushën familjare e martesore. Në nivelin e parë rendisim të tilla si:

- Barazia në dinjitet dhe në të drejta e të gjithë njerëzve të cilët lindin të lirë dhe të barabartë (neni 1);
- Gëzimi i të drejtave dhe lirive pa kurrfarë kufizimi përfshi edhe ato gjinore (neni 2);
- E drejta për barazi përpara ligjit dhe mbrojtja ndaj çdo diskriminimi (neni 7);
- E drejta për sigurime shoqërore dhe për realizimit të të drejtave

[5] http://mfa.gov.al/web/pub/deklarata_20universale_20e_20te_20drejtave_20te_20njeriut2870.pdf (aksesuar më 20 Maj 2009).

[6] http://www.unhchr.ch/udhr/lang/aln.htm (aksesuar më 20 Maj 2009).

ekonomike, sociale, kulturore (neni 22);

- Nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme (neni 25/2
- E drejta për arsimim (neni 26).

Në nenin 16 të DUDNj gjenden standarde të dedikuara më ngushtësisht kësaj fushe që po analizojmë. Për ta bërë më evidente për lexuesin, përmbajtjen e këtij neni e kemi vendosur në kutizë.

1.2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore i vitit 1966

Çfarë gjejmë në DUDNJ?

Neni 16

Burrat dhe gratë në moshë madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe formojnë familje, pa kurrfarë kufizimi për sa i përket racës, shtetësisë ose besimit. Ata kanë të drejta të barabarta si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi.

2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin plotësisht të lirë të personave që do të martohen.

3. Familja është bërthama e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Është ratifikuar nga Shqipëria në 04.09.1991 dhe përmban veç të tjerash në nenin 10 disa të drejta bazike lidhur me jetën familjare, pëlqimin e lirë për martesë të bashkëshortëve të ardhshëm; mbrojtje e veçantë duhet t'u jepet nënave gjatë një periudhe të arsyeshme kohore para dhe pas lindjes së fëmijëve si dhe sigurimet sociale të garantuara; mbrojtjen e veçantë të fëmijëve pa kurrfarë diskriminimi.

Sipas nenit 3, Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhetëgruaspërt'igëzuartëgjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të përmendura në këtë Pakt[7].

1.3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. (1966)

Ky instrument elaboron parimet e vendosura në DUDNJ. Është ratifikuar nga Shqipëria në 04.09.1991. Lidhur me jetën familjare martesore, një vend të veçantë ka neni 23.

Neni 23

1. Familja është njësi e natyrshme dhe themelore e shoqërisë dhe ka të drejtë të ketë mbrojtjen e shoqërisë dhe të shtetit.

2. E drejta e burrit dhe gruas për t'u martuar dhe për të formuar familje duhet të njihet duke filluar nga mosha e pjekurisë.

3. Asnjë martesë nuk duhet të lidhet pa pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.

[7] Shih Komentin e Përgjithshëm nr. 16 (2005) të Komitetit të OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore lidhur me nenin 3 mbi të drejtat e barabarta të burrit dhe gruas dhe lidhjen me nenin 10 dhe 16 të Konventës.

Në nene të tjera Pakti përfshin:

❒ Parimin e mosdiskriminimit (neni 2/1)

❒ Barazinë në të drejta ndërmjet burrit dhe gruas me qëllim përfitimin e të gjitha të drejtave civile e politike të përmendura në këtë Pakt (neni 3)

❒ Barazinë përpara ligjit. Ligji ndalon çdo lloj diskriminimi dhe garanton për shtetasit mbrojtje të barabartë dhe efektive pa asnjë diskriminim të bazuar në racë, ngjyrë, **seks,** gjuhë, përkatësi rajonale, politike, kombëtare, origjinë sociale, pasuri apo status lindjeje (neni 26).

1.4. Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas - CEDAW

Pa dyshim që kjo është një konventë shumë e rëndësishme e OKB. Sikurse bëhet evidente në vetë titullin e saj, Konventa vendos në fokusin e vet gratë dhe ka si objektiv eliminimin e diskriminimit ndaj tyre në të gjitha fushat. Shqipëria ka aderuar në këtë Konventë që prej vitit 1993[8].

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas sjell në vëmendje të drejtat e patjetërsueshme të gruas që janë tashmë të mishëruara thuajse tërësisht edhe në legjislacionin shqiptar. Kjo Konventë shkon më tej, duke njohur rëndësinë e kulturës dhe traditës në formësimin e të menduarit dhe sjelljes së gruas dhe burrit si dhe rolin e rëndësishëm që ato luajnë në kufizimin e ushtrimit të të drejtave bazë nga gruaja.

Ka tri nene të kësaj Konvente që kanë domethënie të posaçme për statusin e gruas në familje. Këto janë neni 9, neni 15 dhe neni 16 i CEDAW[9]. Duke i cituar këto nene të karakterit substancial, nënvizojmë që ato duhet të shihen në lidhje të ngushtë me nenet 1-5 të Konventës të cilat njihen si nenet 'kuadër' të saj.

Neni 9 i CEDAW lidhet me të drejtën grave për të marrë, ndryshuar, apo mbajtur nënshtetësinë e tyre njësoj si edhe burrat. Për këtë konventa CEDAW kërkon që të sigurohen sidomos që as martesa me një të huaj dhe as ndryshimi i nënshtetësisë nga burri gjatë martesës të mos ndryshojë nënshtetësinë e bashkëshortes, të mos e lërë atë pa nënshtetësi e të mos i imponojë nënshtetësinë e bashkëshortit. Në pikën 2 të nenit 9 të CEDAW theksohet se Shtetet palë duhet t'u akordojnë grave të drejta të barabarta me burrat në lidhje me nënshtetësinë e fëmijëve të tyre.

Pa statusin e shtetësisë, grave u mohohet e drejta për të votuar apo për të kandiduar për poste publike dhe mund t'u mohohet dhe aksesi ndaj përfitimeve publike si dhe zgjedhja e vendbanimit. a Një grua në moshë

[8] Ligji nr, 7767/9.11.1993. për aderimin e RSh në Konventën "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave" CEDAW.

[9] Shqipëria ka miratuar Raportin e parë dhe të dytë periodik dhe të tretë periodik në kuadër të CEDAW (Raporti i Shqipërisë mban datën 23 Maj 2002 dhe konsiderohet si raport i kombinuar i atij fillestar dhe raportit te dytë – nr. CEDAW/C/ALB/1-2 dhe është shqyrtuar nga Komiteti i CEDAW në sesionin e tij të 28-të në Janar 2003) si dhe ka miratuar Raportin e III kombëtar, periodik në kuadër të CEDAW (VKM 1082/23.7.2008)

madhore duhet të ketë të drejtën të ndryshojë me vullnet të lirë nënshtetësinë e saj; ajo nuk i duhet hequr arbitrarisht për shkak të martesës apo mbarimit të martesës, apo sepse i shoqi apo i ati ndryshon nënshtetësinë e vet.

Neni 15 i CEDAW trajton çështje të barazisë së grave me burrat përpara ligjit. Gjithashtu këtu përfshihet zotësia e barabartë juridike dhe për të vepruar, barazia kontraktore, barazia në administrimin e pronave, barazia procedurale në proceset gjyqësore. Në këtë nen, nënvizohet rëndësia që ka që shtetet t'u akordojnë burrave dhe grave të njëjtat të drejta për sa i përket ligjit në lidhje me lëvizjen e personave dhe lirinë për të zgjedhur vendbanimin.

Kur një grua nuk mund të hyjë fare në një kontratë, apo të ketë akses ndaj kredive financiare, apo mund ta bëjë këtë vetëm me pëlqimin a garancinë e bashkëshortit a një të afërmi mashkull, asaj i mohohet autonomia ligjore. Çdo kufizim i tillë e pengon atë të mbajë pronë si pronare e vetme dhe e përjashton nga menaxhimi ligjor i biznesit të saj apo nga mundësia për të arritur ndonjë formë tjetër kontrate. Kufizime të tilla kufizojnë seriozisht aftësinë e grave për të siguruar të ardhura për veten dhe personat e varur prej saj. Gratë migruese që jetojnë dhe punojnë përkohësisht në një vend tjetër duhet të lejohen të kenë të njëjtat të drejta si burrat që bashkëshortët, partnerët dhe fëmijët të bashkohen me to. Në një studim, ende në proces botimi, të UNWomen, mbi të drejtat pronësore të grave në Shqipëri, realizuar nga Arta Mandro, gjenden shembuj të cenimit të të drejtave. Të drejtat ligjore mohohen dhe, në ndonjë rast, edhe vetë gratë, me padijeninë e tyre apo për shkak të ndikimit të zakonit ndikojnë në mohimin e një sërë të drejtash. Ky studim i përmendur është i pasur me referenca në vendime gjyqësore dhe opinione të juristëve e ekspertëve të fushës, të cilët nënvizojnë se gratë në fushën kontraktore ballafaqohen me manipulime e vështirësi, të cilat vijnë kryesisht nga bashkëshortët apo vëllezërit e tyre dhe që favorizohen nga niveli i ulët i ndërgjegjësimit të grave, por edhe nga veprimet e papërgjegjshme të institucioneve.

Neni 16 i CEDAW i referohet rëndësisë që ka eliminimi i diskriminimit në martesë dhe marrëdhëniet familjare. Këtu përfshihen a) e drejta e njëjtë për të lidhur martesë; b) e drejta e njëjtë për të zgjedhur lirisht bashkëshortin dhe për të lidhur martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë; c) e drejta dhe përgjegjësia e njëjtë gjatë martesës dhe në prishjen e saj; d) e drejta dhe përgjegjësia e njëjtë si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. (Në të gjitha rastet interesi i fëmijëve duhet të jetë kryesor); e) e drejta e njëjtë për të vendosur lirisht dhe me përgjegjësi për numrin dhe kohën e lindjeve dhe për të marrë informacion, arsimim dhe mjete të nevojshme që bëjnë të mundur ushtrimin e këtyre të drejtave; f) Të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta për çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen, kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve, apo me institucionet e ngjashme, ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar. (Në të gjitha rastet,

interesi i fëmijëve duhet të jetë kryesor); g) Të drejtat e njëjta personale të burrit dhe gruas, duke përfshirë edhe të drejtën për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe llojin e punës; h) Të drejtat e njëjta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, fitimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë. Në pikën 2 të nenit 16 nënvizohet se "Fejesat dhe martesat e fëmijëve të mitur nuk kanë asnjë efekt juridik, prandaj do të merren të gjitha masat e nevojshme, duke përfshirë legjislacionin, me qëllim që të caktohet një moshë minimale për martesë dhe të bëhet i detyrueshëm regjistrimi i martesës në një regjistër zyrtar".

1.4.1. Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë [2010]

Po sjellim në këtë pjesë ato që mund të quhen si detyra të shtruara për sistemin e drejtësisë shqiptare nga Komiteti CEDAW. Është fjala për vërejtjet përmbyllëse të Komitetit që i referohen analizës së raportit të fundit të Shqipërisë, korrik 2010.

Pra, kanë kaluar rreth 4 vjet dhe po sjellim në vëmendje çfarë detyrimesh janë lënë nga Komiteti. Në prag riraportimi, vlen të bëjmë bilancin e atyre që ende janë detyra të parealizuara, për shkak të sistemit të drejtësisë.

Vlerësuam të sjellim në këtë punim, ekstrakte, sepse, është kërkesë e Komitetit që këto vërejtje përmbyllëse të vihen në dispozicion të të gjitha ministrive përkatëse, Kuvendit dhe gjyqësorit, për të siguruar zbatimin e tyre të plotë [shih për këtë paragrafin 10].

Në paragrafin 13 të Vërejtjeve Përmbyllëse, Komiteti përsërit rekomandimet e tij me qëllim që të sqarohet se cilat dispozita të Konventës janë drejtpërdrejt të zbatueshme brenda rendit juridik të brendshëm të Shqipërisë dhe nëse është Ekzekutivi, Parlamenti apo gjykatat që vendosin për zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë. Ai kërkon në mënyrë të veçantë që në raportin periodik të radhës [2014] Shqipëria të japë informacion në lidhje me çështjet gjyqësore ku Konventa, ose dispozitat e saj, janë kualifikuar si të vetë-zbatueshme, dhe në këtë mënyrë janë zbatuar drejtpërdrejt. Në paragrafin 16, Komiteti mbetet i shqetësuar që dispozitat e Konventës nuk janë përmendur në procese gjyqësore, gjë që tregon se ka njohuri të pamjaftueshme në shoqëri në përgjithësi dhe në vetë gratë, tek të gjitha degët e qeverisjes, duke përfshirë gjyqësorin, për të drejtat e grave. Në një raport të vitit 2014 të QNLQ mbi '*gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së 1-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë*', vëmë re se nga çështjet e monitoruara, nuk ka rezultuar në asnjë rast referimi i Konventës CEDAW apo vendimeve të Komitetit CEDAW[10].

Në paragrafin 15, po aty, Komiteti ndalet në çështjet e aksesit në drejtësi dhe kujdesin për të mënjanuar pengesat që hasen nga gratë për mundësimin e drejtësisë, ndihmën ligjore, rëndësinë e ndërgjegjësimit të grave në lidhje me përdorimin e mjeteve ligjore kundër diskriminimit gjinor, në mënyrë që

[10] Shih faqen 24 të raportit në shqip në: http://www.qag-al.org/WEB/publikime/raporti_shqip.pdf

të rritet kapaciteti i grave për të përdorur mekanizmat ekzistues të ankimit dhe kërkojë kompensim për diskriminimin në sistemin ligjor shqiptar, si dhe të monitorojë rezultatet e këtyre përpjekjeve. Komiteti nxit Shtetin palë të shqyrtojë heqjen e barrës së provës në rastin e diskriminimit të pretenduar për shkak të seksit dhe gjinisë, veçanërisht në rastin e ngacmimit seksual, në legjislacionin e tij për anti-diskriminimin dhe Kodin e Punës. Duket se këto shqetësime ende nuk janë adresuar në mënyrën e duhur.

Nga analiza e praktikës gjyqësore në vijim, kuptojmë se sa me vend janë shqetësimet e Komitetit CEDAW [paragrafi 24], në lidhje me mbizotërimin e stereotipave gjinore të rrënjosura në familje. Duket se masat e marra në këtë periudhë, për të sfiduar traditat e dëmshme të martesës që shkelin të drejtat e grave dhe vajzave në bazë të Konventës, duke përfshirë martesat e fëmijëve, praktikën e ndërhyrjes së familjes në zgjedhjen e burrit, dhe pagesën e një çmimi për nusen që mbetet mbizotëruese në zonat rurale dhe të largëta të vendit dhe ndërmjet komuniteteve minoritare janë të pamjaftueshme. Komiteti mbetet seriozisht i shqetësuar në lidhje me ri-daljen e koncepteve tradicionale të drejtësisë (kanuni) dhe kodeve të sjelljes në disa zona veriore të vendit që tolerojnë të ashtu-quajturat vrasje për nder. Një episod i fundit, mars 2014, tregon mënyrën e reagimit të dy familjeve lidhur me institutin e martesës dhe kuptimin e nderit. Vetëm pas 2-3 javë martesë, nusja kthehet në shtëpinë e prindërve. Babai i vajzës 'së kthyer' është shprehur se 'nuk do të lejoj askënd të tallet me nderin e vajzës dhe të familjes'. Këtë deklaratë ai e ka bërë pas vrasjes se krushkut dhe plagosjes së rëndë të ish-dhëndrit[11].

Në paragrafin 30, Komiteti shpreh shqetësime që kanë të bëjnë me numrin e madh të largimeve nga shkolla, veçanërisht në nivelin e mesëm, edhe për shkak të martesave të parakohshme, stereotipave tradicionale në lidhje me seksin, çka tërheq vëmendjen e gjyqësorit shqiptar për rastet kur kërkohet lidhja e martesës nën moshë e cila ka impakt negativ në arsimimin e vajzave.

Paragrafi 33 Komiteti CEDAW nënvizon aspekte të punësimit dhe të fuqizimit të masave të efektshme që lejojnë kombinimin e përgjegjësive familjare dhe profesionale, veçanërisht në zonat rurale dhe që të nxitet ndarja e përgjegjësive familjare dhe ekonomisë shtëpiake ndërmjet burrave dhe grave. Kjo çështje vlen të jetë në radarët e sistemit të drejtësisë në rastet e zgjidhjes së martesës dhe llogaritjes së punës përkujdesëse në familje në proceset e pjesëtimit të pasurisë me këtë rast.

Në paragrafin 37 Komiteti kërkon që në raportin periodik të radhës, të jepet informacion i detajuar në lidhje me zbatimin e Kodit të Familjes mbi pronësinë gjatë martesës dhe pas zgjidhjes së saj. Në këtë mënyrë, ky studim, sikurse studimi i cituar mbi të drejtat pronësore të grave, mund t'i shërbejë aktorëve të interesuar në marrjen e masave përkatëse si dhe në gjetjen e informacionit të kërkuar.

[11] Shih në: http://www.panorama.com.al/2014/03/16/vret-krushkun-se-i-ktheu-vajzen-2-jave-pas-martese/

1.4.2. Rekomandimi i Përgjithshëm 21 i CEDAW mbi "barazinë në martesë dhe në marrëdhëniet familjare12"

Në tërësinë e këtij Rekomandimi të Përgjithshëm gjejmë komente mbi kuptimin dhe interpretimin e neneve 9, 15 dhe 16 të CEDAW. Në nenin 16 të CEDAW nënvizohet se e drejta e një gruaje për të zgjedhur një bashkëshort dhe për të hyrë lirisht në një martesë është me rëndësi qendrore për jetën, dinjitetin dhe barazinë e saj si qenie njerëzore.

Komiteti CEDAW, nga shqyrtimi i raporteve të Shteteve palë ka vënë re se ekzistojnë vende të tilla, të cilat, mbi bazën e zakoneve, besimeve fetare apo origjinës etnike të grupeve të caktuara të njerëzve, lejojnë martesat ose rimartesat e detyruara. Vende të tjera lejojnë që martesa e një gruaje të arrihet për pagesë dhe në të tjera, varfëria i detyron gratë të martohen me shtetas të huaj për siguri financiare. Duke iu nënshtruar kufizimeve të arsyeshme bazuar, për shembull mbi moshën e re apo lidhjen e gjakut me partnerin, e drejta e një gruaje për të zgjedhur se kur, nëse, dhe me kë martohet duhet ruajtur dhe vënë në zbatim nga ligji. E sjellim këtë shqetësim të Komitetit sepse në pjesët në vijim të këtij studimi, do të shohim gjendjen e të drejtave të grave në Shqipëri pikërisht në këto aspekte, dhe në këtë mënyrë do të mund të ballafaqojmë sa qëndron kjo problematikë në rastin e vendit tonë. Për këtë do të bazohemi në vendimet e analizuara dhe mendimet e ekspertëve të fushës familjare dhe të barazisë gjinore. Në këtë mënyrë, kuptojmë se disa aspekte të diskriminimit në jetën familjare e martesore kanë ngjashmëri me vendet e tjera e për këtë arsye është rasti që veprimet pozitive dhe me rezultate të disa vendeve në drejtim të eliminimit të diskriminimit në aspekte të tilla, të mund të adoptohen në vendin tonë.

Në Shqipëri, veç nëpunësit të gjendjes civile, një rol të veçantë ka gjykata në rastet e kërkesës së paraqitur për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë.

1.4.3. Rekomandimi i Përgjithshëm 29 i CEDAW13

Ky Rekomandim ndalet në interpretimin e zgjeruar të nenit 16 të Konventës CEDAW lidhur me pasojat ekonomike të martesës, të marrëdhënieve familjare dhe të mbarimit apo zgjidhjes së tyre.

Neni 16 i Konventës CEDAW trajton eliminimin e diskriminimit ndaj grave në lidhjen e martesës, gjatë martesës si dhe në mbarimin e saj, qoftë përmes zgjidhjes apo për shkak të vdekjes së bashkëshortit/es. Gjithashtu, Rekomandimi 29 ndalet në kuptimin e përkufizimit dhënë për diskriminimin sipas nenit 1 të Konventës[14] me qëllim që të jetë sa më i

[12] Tekstin në shqip të këtij rekomandimi e gjeni në: http://www.mpcs.gov.al/dpshb/images/stories/files/instrumentat_e_okb/3.2.1.4.Rekomandimet%20e%20CEDAW/Rekomandim_i_Pergjithshem_21.pdf

[13] Teksti anglisht i Rekomandimit të Përgjithshëm 29 gjendet në: http://www2.ohchr.org/english/bodies/CEDAW/docs/comments/CEDAW-C-52-WP-1_en.pdf

[14] **Neni 1 i CEDAW:** Në këtë Konventë shprehja "diskriminimi i gruas" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë

qartë. Gjithashtu, Komiteti u bën thirrje shteteve palë për të ndërmarrë masa ligjore dhe politika siç kërkohet në neni 2 të Konventës dhe Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 28 përmes të cilit jepet interpretimi i duhur për nenin 2 të Konventës CEDAW[15].

Ky rekomandim i përgjithshëm shërben si një udhëzues për shtetet palë në arritjen e një regjimi të barabartë de jure dhe de facto, sipas të cilëve përfitimet ekonomike dhe kostot e marrëdhënieve familjare dhe pasojat e këtyre marrëdhënieve pas zgjidhjes apo mbarimit të martesës për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort, të jenë të njëjta si për burrat dhe gratë. Ky Rekomandim krijon një normë për vlerësimin e zbatimit nga shtetet palë të Konventës në lidhje me barazinë ekonomike në familje.

1.5. Konventa për të drejta e fëmijës [KDF] (1989)

Në lidhje me fushën familjare, nënvizojmë përkatësisht nenet 9, 10, 20, 21, 22 të kësaj konvente. Neni 9 parashikon çështje që kanë të bëjnë me ndarjen e fëmijëve nga prindërit duke nënvizuar se fëmija nuk duhet të ndahet nga prindërit kundër dëshirës me përjashtim kur kjo vlerësohet se është në interesin më të lartë të fëmijës. Ndarja mund të jetë e nevojshme kur prindërit keqtrajtojnë ose nuk kujdesen për fëmijën, ose kur ata jetojnë të ndarë dhe kur duhet vendosur se ku duhet të banojë fëmija. Në rastet e ndarjes, fëmija ka të drejtë të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me prindërit, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 10 dhe neni 22 trajtojnë çështje të ribashkimit familjar parë edhe nga pozita e fëmijës refugjat duke nxitur që këto kërkesa për ribashkim të familjes, të trajtohen në një frymë pozitive, të njerëzishme dhe me shpejtësi.

Neni 20 dhe neni 21 trajtojnë masat që duhen marrë ndaj fëmijëve që u mungon kujdesi familjar përmes instituteve të kujdestarisë dhe birësimit.

2. Instrumentet e Këshillit të Evropës lidhur me barazinë gjinore në jetën familjare e martesore

Parimi i barazisë gjinore është një nga parimet themelore të Këshillit të Europës. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vazhdimisht është shprehur se "barazia e sekseve është një nga qëllimet madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës", dhe e ka deklaruar barazinë gjinore si një nga parimet themelore, thelbësore të Konventës **Evropiane të të Drejtave të Njeriut[16].**

---

së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.

[15] Shih përmbajtjen e Rekomandimit në: http://www.refworld.org/docid/4d467ea72.html

[16] Ivana Radacic Critical Review of Jurisprudence: An Occasional Series 'Gender Equality Jurisprudence of the European Court of Human Rights'. Në : The European Journal of International Law Vol. 19 no. 4 © EJIL 2008, 841 – 857. Për më shumë shih Strategjinë e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore (2014-2017) dhe Objektivin Strategjik nr 3 të saj lidhur me garantimin e aksesit të barabartë në

2.1. KEDNJ

Neni 14 i KEDNj-së është dispozita bazë kundër diskriminimit. Në të përcaktohet se:

"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër".

Ky nen duket se ka karakter plotësues dhe si i tillë, synon kryesisht të garantojë ushtrimin e efektshëm të të drejtave dhe lirive të mbrojtura nga Konventa. Si rrjedhojë e karakterit plotësues të dispozitave, ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të Nenit 14, përpara daljes së Protokollit 12, ishin të pranueshme vetëm në rast se tregohej një lidhje e mjaftueshme midis diskriminimit të pohuar dhe një prej të drejtave apo lirive të mbrojtura nga një dispozitë substantive e Konventës, me qëllim që të përdoret me sukses ndalimi i diskriminimit. Ndaj, ankesat për shkelje të Nenit 14, përpara daljes së Protokollit 12, pothuaj nuk kanë qenë të suksesshme.

Një pasojë problematike e karakterit plotësues është fakti se ai e ndalonte Gjykatën të shqyrtonte një gamë të gjerë pretendimesh për diskriminim. Gjykata ishte veçanërisht e kufizuar në shqyrtimin e dallimeve, që shkelin të drejtat sociale apo ekonomike, me qenë se Gjykata rrallë konstatonte se këto të drejta hynin në gamën e Konventës. Si rrjedhojë, ankesa për trajtim të pabarabartë në lidhje me çështje të tilla si, qasje në punësim, trajnim profesional apo siguri sociale, shpesh deklaroheshin të papranueshme, edhe kur dallimi pretendohej se mbështetej në shkaqe të dyshuara, të tilla si, raca, kombësia ose seksi.

Me Protokollin 12, këto kufizime u eliminuan.

2.2. Neni 5 i Protokollit Nr. 7 të KEDNj-së[17]

Ky dokument normativ, përmend shprehimisht barazinë midis bashkëshortëve. Në nenin 5 nënvizohet parimi i barazisë midis bashkëshortëve: "Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësish të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, *në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj*. Ky nen nuk do t'i ndalojë Shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve[18]".

2.3. Protokolli Nr. 12 i KEDNj-së [neni 1]

Mbrojtja nga diskriminimi sipas Nenit 14, u plotësua me Nenin 1 të Protokollit 12 të KEDNj-së. Protokolli 12 e zgjeron gamën e zbatimit të

drejtësi. http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/02_GenderEqualityProgramme/Council%20of%20Europe%20Gender%20Equality%20Strategy%202014-2017.pdf

[17] Hyrja në fuqi në Shqipëri: 1 janar 1997.

[18] Shih vendimin e GJEDNJ në çështjen Chepelev kundër Rusisë dhe pretendimet për shkelje të nenit 5 Protokollit 7 të KEDNJ dhe arsyetimin e gjykatës. http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-81910

Nenit 14, duke parashikuar një zbatim krejtësisht të pavarur të parimit të mos-diskriminimit "për çdo të drejtë të përcaktuar me ligj". Ky protokoll veçanërisht zgjeron gamën e mbrojtjes nga mos-diskriminimi për të përfshirë detyrimin negativ të palëve kontraktuese si edhe një detyrim pozitiv (për të marrë masa për mbrojtje nga diskriminimi, edhe kur diskriminimi ndodh midis palëve private). Ai qëndron pranë Nenit 14, pa e ndryshuar apo shfuqizuar atë. Megjithatë, sikurse Neni 14, ai nuk garanton mos-diskriminim në terma absolute. Përkundrazi, ai ndjek përqasjen e miratuar nga GjEDNj-ja në juridiksionin e saj.

Protokolli 12 i KEDNj -së garanton një të drejtë që **qëndron më vete** (për barazinë). Ai shprehet:

Neni 1 – Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i një të drejte të parashikuar me ligj do të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak të tillë si, seksi, raca, ngjyra, feja, mendimi politik apo ndonjë mendim tjetër, origjina kombëtare apo shoqërore, lidhja me një pakicë kombëtare, pronë, lindje apo ndonjë status tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga ndonjë autoritet publik për shkaqe të tilla si ato që përmenden në paragrafin 1.

Protokolli 12 është hartuar për të çuar përpara mbrojtjen e barazisë që ofron KEDNj-ja përtej garancisë relativisht të kufizuar të Nenit 14, i cili garanton të drejtën e mos-diskriminimit vetëm në gëzimin e të drejtave të tjera sipas Konventës. Me qëllim që të zbatohet Neni 14, pra, duhet të përcaktohet se diferenca në trajtim hyn në gamën e një prej të drejtave të tjera të Konventës. Protokolli 12 hyri në fuqi për ato shtete që e kanë ratifikuar, ndër të tjerë, Shqipëria, e cila e ka ratifikuar atë më 1 prill 2005.

Raporti shpjegue[19] për dispozitat e Protokollit 12 shprehimisht thekson se, ndërsa "parimi i barazisë nuk del shprehimisht as në tekstin e Nenit 14 të Konventës, as në Nenin 1 të këtij Protokolli, duhet pasur parasysh se parimi i mos-diskriminimit dhe i barazisë janë ngushtësisht të lidhura. Për shembull, parimi i barazisë kërkon që gjendje të barabarta të trajtohen njëlloj, ndërsa gjendje të pabarabarta, ndryshe. Mosveprimi në këtë mënyrë do të përbëjë diskriminim, në rast se nuk ekziston një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm.

"Nocioni i diskriminimit është interpretuar në mënyrë konsistente nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj ligjore, që ka të bëjë me Nenin 14 të Konventës. Në veçanti, këto çështje e kanë bërë të qartë se jo çdo dallim apo ndryshim në trajtim përbën diskriminim. Sikundër ka konstatuar Gjykata, "një ndryshim në trajtim është diskriminues në rast se 'ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm', që do të thotë, në rast se ai nuk ndjek një 'qëllim të ligjshëm' apo kur nuk ka 'një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet'". Kuptimi i termit

[19] Shih tekstin e raportit shpjegues lidhur me Protokollin 12 të KEDNj në: http://conventions.coe.int/Treaty/en/Reports/Html/177.htm

"diskriminim" në Nenin 1 ka për qëllim të jetë identik me atë të Nenit 14 të Konventës. Lista e shkaqeve të mos-diskriminimit në Nenin 1 të Protokollit 12 është e njëjtë me atë të Nenit 14 të Konventës.

Neni 1 i Protokollit 12 parashikon një klauzolë mos-diskriminimi dhe si pasojë ofron një gamë mbrojtjeje e cila shtrihet përtej "gëzimit të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ". Në veçanti, gama shtesë e mbrojtjes, sipas Nenit 1 të Protokollit 12, ka të bëjë me raste kur një person diskriminohet:

i. në gëzimin e çdo të drejte të dhënë posaçërisht një individi sipas ligjit të vendit;

ii. në gëzimin e një të drejte e cila mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit të vendit, që do të thotë, kur një autoritet publik e ka për detyrë sipas ligjit të vendit të sillet në një mënyrë të caktuar;

iii. nga një autoritet publik gjatë ushtrimit të së drejtës diskrecionale (për shembull, duke dhënë subvencione të caktuara);

iv. nga çdo akt tjetër apo mosveprim i një autoriteti publik (për shembull, sjellja e oficerëve të zbatimit të ligjit gjatë mbajtjes nën kontroll të njëtrazire).

2.4. Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" [Ligji Nr. 104/2012]

Shqipëria ka ratifikuar një instrument shumë të rëndësishëm të Këshillit të Evropës, siç është Konventa "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", e njohur ndryshe edhe si konventa e Stambollit. Duke e konsideruar dhunën në familje çështje të diskriminimit gjinor, Konventa në nenin 3/b nënvizon se me "dhunë në familje" nënkuptohen të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve apo ish-partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Në nenin 32, Konventa parashikon pasojat ligjore të martesave me detyrim dhe siguron që martesa të tilla mund të "bëhen të pavlefshme, të anulohen ose të zgjidhen". Për qëllimet e kësaj dispozite, një martesë relativisht e vlefshme" është një martesë e konsideruar si e vlefshme, por që mund të kthehet në martesë të pavlefshme, nëse kundërshtohet nga njëra prej palëve; një martesë "e anuluar" është një martesë e zhveshur nga pasojat e saj ligjore, pavarësisht nëse kundërshtohet ose jo nga një palë; një martese "e zgjidhur", si në rastin e divorcit, është e zhveshur nga pasojat ligjore vetëm duke filluar nga data e zgjidhjes së saj.

Kuptimi i martesës me detyrim jepet në nenin 37 të konventës. Hartuesit e kanë parë të rëndësishme të përfshijnë në këtë dispozitë dy lloje sjelljesh: detyrimin e një personi të hyjë në një martesë dhe joshja e një personi për

jashtë vendit me qëllim detyrimin e këtij personi që të martohet.

Neni 48 i Konventës ndalon proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit. Për këtë kërkohet që të merren masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2.5. Jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me diskriminimin në familje e martesë [neni 8 dhe 14 i KEDNj]

Gjithnjë e më shumë vihet re një jurisprudencë dinamike dhe e pasur me raste që pasqyrojnë çështje të barazisë në jetën familjare dhe përpjekjet për mosdikriminimin ndërmjet bashkëshortëve.

Në vijim, po rendisim disa prej këtyre vendimeve të GjEDNJ të cituara në mënyrë të përmbledhur. Kështu, gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë, mund të ndalen në detaje të rasteve, një pjesë e të cilave janë edhe të përkthyera në gjuhën shqipe.

Si të gjejmë vendimin e duhur të GjEDNJ?

Portali i Gjykatë Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNj) është një sistem informativ zyrtar shumë i fuqishëm, modern dhe i lehtë në përdorim.

Për këtë shkojmë tek HUDOC në faqen: http://hudoc.echr.coe.int

Baza e të dhënave HUDOC ofron qasje në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Këto tekste të vendimeve mund të konsultohen nëpërmjet një ekrani në dukje të sofistikuar, por në fakt shumë të lehtë për t'u përdorur e për të kërkuar.

Portali është përditësuar rregullisht.

Në anën e majtë të portalit gjenden disa filtra të cilat e ndihmojnë përdoruesin të ngushtojë kërkimin në vendimin për të cilin ka interes. Ndër këto filtra është edhe ai i gjuhës.

Ka rreth 329 vendime të përkthyera në gjuhën shqipe[20]. Këto përkthime pasurohen në vazhdimësi. Veç filtrave të gjuhës kemi atë të neneve të KEDNJ, fjalëve kyç, rëndësisë së vendimit, shkeljes ose jo të të drejtës, shtetit, etj.

Vendimet e kësaj gjykate veç se janë të detyrueshme, sjellin mundësinë që gjyqtari shqiptar të frymëzohet nga standardet e të drejtave dhe lirive themelore e të ketë mundësi të qasë vendimin me drejtësinë.

Kështu, në jurisprudencën e GjEDNJ gjejmë probleme të ndryshme të cenimit të së drejtës për jetë private dhe jetë familjare [neni 8] të pleksura me nene të tjera.

Në çështjen, *Airey kundër Irlandës*[21], gjykim i 9 Tetor 1979, GjEDNj

[20] Deri më 7 Janar 2014.

[21] *Airey kundër Irlandës, GjEDNJ* [6289/73] 09/10/1979. http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/

ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ lidhur me procedurat e gjata të veçimit bashkëshortor dhe nga ana tjetër nuk ka konsideruar të nevojshme të shqyrtohet neni 14 i Konventës në lidhje me Nenin 6. Për shkak të mungesës së ndihmës juridike, kërkuesja, Johanna Airey, nuk mundi të gëzojë një të drejtë efektive për akses në Gjykatën e Lartë me qëllim që të kërkonte një vendim lidhur me veçimin bashkëshortor. Kërkuesja nuk ishte në gjendje ekonomike që të paguante një avokat për të realizuar veçimin e saj nga bashkëshorti i cili e dhunonte atë dhe katër fëmijët e tyre. Zonja Airey, ndonëse mund të shkonte në gjykatën e lartë e pa përfaqësuar nga avokat, sepse avokati nuk ishte detyrim, për të personalisht ishte plotësisht e pamundur kjo procedurë, e cila ishte e ndërlikuar dhe si e tillë, kërkonte përfaqësim nga juristë. Mund të thuash se ligji dukej korrekt, por zbatimi i tij ishte i pamundur. Ky rast paraqet ende rëndësi sepse në vendin tonë, ndonëse ka një ligj për ndihmën ligjore, nuk janë të pakta apo nuk mungojnë rastet kur gratë e kanë të cunguar aksesin në sistemin e drejtësisë për shkak të pamundësisë për të patur një ndihmë juridike për shkak të kostove të larta të proceseve gjyqësore, etj.

GjEDNJ në rastin *Cechova kundër Sllovakisë*[22], ka gjetur shkelje të nenit 6 të Konventës. Ish-bashkëshorti i ankueses depozitoi një padi kundër saj për pjesëtimin e pasurisë martesore. Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procedurave të Gjykatës Kushtetuese ka shkelur nenin 6 të KEDNJ. Rasti sillet për të tërhequr vëmendjen e gjyqësorit shqiptar ndaj kohëzgjatjes së procedimeve në fushën e të drejtës familjare ku afatet e tepruara dhe vonesat në gjykim sjellin implikime të nenit 6 dhe 8 të Konventës. Nga monitorimi i praktikës gjyqësore, sidomos në çështjet pronësore, me objekt nenin 207 të Kodit Civil mbi pjesëtimin e pasurisë në bashkëpronësi, rezulton që një vendim të shkojë edhe deri në 10 vjet[23]. Ndërgjegjësimi i palëve me të drejtat e tyre dhe i avokatëve për mbrojtjen më të mirë të interesave të klientëve, mund të sjellë në një të afërme jo të largët adresimin e çështjeve familjare deri në GjEDNj për cenim të procesit të rregullt sipas nenit 6. Problemet e vonesave në gjykime duhet të jenë në radarët e gjyqësorit shqiptar sidomos për shkak se jeta familjare ka një dinamikë specifike dhe si e tillë kërkon mbrojtje të veçantë.

Nga jurisprudenca e GJEDNj vëmë re konsekuencën e qëndrimeve të kësaj gjykate në kohë të ndryshme sa i përket parimeve që garantojnë jetën private e familjare kundrejt diversitetit të çështjeve të paraqitura edhe për shkak të gjinisë. Me të drejtë, çështjet familjare dhe raporti i tyre me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga KEDNJ, kanë

---

pages/search.aspx?i=001-57420

[22] ĚCHOVÁ v. SLOVAKIA (Application no. 33378/06), 05/10/2010. http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-100885

[23] Shih Vendimin nr. 10051/2013 [çështja është regjistruar në nëntor 2003 dhe përfunduar më korrik 2013]; Vendimin nr. 8373/2013 [korrik 2008-korrik 2013]; Vendimin 1147/2013 [janar 2008-nëntor 2013] etj të GjRrGj Tiranë, etj. http://gjykatatirana.gov.al/

vënë shpesh herë në vështirësi gjykatat e vendeve anëtare të Këshillit të Europës. Kështu, duke u ndalur pikërisht në çështje të afateve të ndryshme të parashkrimit të së drejtës lidhur me kundërshtimin e atësisë në varësi të subjektit kundërshtues [nëna ose ati i fëmijës], në çështjen *Rasmussen kundër. Danimarkës*, gjykim i 28 Nëntor 1984, problemi sillet nga aplikuesi nën këndvështrimin e diskriminimit gjinor. Aplikuesi, si at i prezumuar, u ankua pikërisht për kufizimet ligjore lidhur me kundërshtimin e atësisë së fëmijës të cilat ishin të ndryshme kundrejt nënës së fëmijës. Gjykata në këtë rast, nënvizoi se kjo çështje, ndonëse përbën një trajtim të diferencuar për shkak të gjinisë, duhet trajtuar si një diferencim i justifikuar. Qëllimi i justifikimit ka të bëjë me faktin se fëmijës i duhet dhënë siguri dhe qartësi lidhur me statusin, duke i penguar kështu baballarët të abuzojnë me kundërshtimin e atësisë gjatë gjithë jetës. Pra, justifikimi qëndron tek interesi më i lartë i fëmijës dhe siguria juridike që duhet ti jepet lidhur me atësinë. Duke qenë se nuk ka uniformitet në këto rregullime ligjore në shtete të ndryshme anëtare të Këshillit të Europës, përfshi këtu edhe Shqipërinë, Gjykata u njeh shteteve anëtare një hapësirë diskrecionale ose hapësirë vetëvlerësimi, duke e konsideruar këtë trajtim apo rregullim të ndryshëm, si të justifikuar por gjithnjë që këto norma materiale e procedurale të jenë në harmoni me standardet dhe synimet e nenit 8 të KEDNj. Po nën këtë frymë, në çështjen *Rasmussen kundër Danimarkës*, GjEDNJ nuk ka gjetur shkelje të nenit 14 [neni antidiskriminim i KEDNJ] në lidhje me nenin 8 të Konventës. E drejta e ankuesit për të kundërshtuar atësinë e një fëmije të lindur gjatë martesës ishte subjekt i afateve të përcaktuara nga ligji, ndërsa ish-gruaja e tij kishte të drejtë të fillonte procedurat e atësisë në çdo kohë. Po kështu edhe në çështjen *Mizzi kundër Maltës*, gjykim i 12 janarit 2006, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6, 8 dhe 14 të Konventës lidhur me afatin prej gjashtë muajsh nga dita e lindjes së fëmijës për të filluar procedurat e kundërshtimit të atësisë së një fëmije të lindur nga martesa [rast prezumimi].

Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykim i 28 majit 1985, është një rast ku GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ. Kjo, sepse, sipas rregullave të emigracionit ishte më e lehtë për një burrë të vendosur në Mbretërinë e Bashkuar sesa për një grua, për të marrë leje për bashkëshortin jo-shtetas të tij/saj për të hyrë apo për të qëndruar në atë vend.

Diskriminimi i fëmijëve të lindur jashtë martese në çështjet personale e pasurore [trashëgimore kryesisht] ka gjetur pasqyrim në disa vendime të GJEDNJ. Në çështjen *Inze kundër Austrisë*, gjykim i 28 tetorit 1987, aplikuesi është një fëmijë i lindur jashtë martese. Rasti paraqet vështirësitë dhe kufizimet në të drejtat e tij trashëgimore për shkak të këtij statusi. Dispozitat neutrale të Kodit Civil, për shkak të interpretimit të tyre, në kushtet e familjes bujqësore [fermë], me disa dispozita të tjera, sillnin si pasojë diskriminimin e fëmijës së lindur jashtë martese. Kështu,

GjEDNj gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës [e drejta e pronës]. Diskriminimin e fëmijës së lindur jashtë martese lidhur me trashëgiminë e gjejmë të pasqyruar edhe në çështjen *Vermeire kundër Belgjikës*, gjykim i 29 nëntorit 1991. Edhe në këtë rast, GjEDNj konstatoi shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës. Aplikanti ishte përjashtuar nga të drejtat e trashëgimisë duke qenë një "fëmijë i paligjshëm". Për gjyqtarët shqiptarë është i mirënjohur edhe rasti *Markxs kundër Belgjikës*[24].

Diskriminimi për shkaqe që lidhen me përgjegjësitë prindërore dhe balancimin e tyre me marrëdhëniet e punës është sjellë në çështjen *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës*, gjykim i 24 qershorit 1993. GjEDNj gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 6-1 të Konventës në rastin e ndërprerjes së pensionit të invaliditetit të aplikantes, bazuar në kontributin e detyrueshëm nga paga e saj, pasi ajo kishte lindur një fëmijë. Vendimi i gjykatës vendase është bazuar në supozimin se gratë e lënë punën kur lindin fëmijë. Ndonjëherë gjykatat vendase [pra të shteteve anëtare të Këshillit të Europës, duket se nuk bëjnë dot shkëputjen nga stereotipat e krijuara të cilat nuk i përgjigjen realitetit. Kjo duhet të jetë në vëmendje të gjyqësorit shqiptar gjithashtu. Siç do të shohim në vendimet që do të analizojmë në vijim të këtij studimi, herë pas here në to shfaqen influenca të zakoneve dhe traditës dhe të stereotipave që ende qëndrojnë fort në shoqëri dhe familjen shqiptare.

Në një çështje të kohëve të fundit, *Konstaktin Markin kundër Rusisë* [2010], GjEDNj gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ. Gjykata u shpreh se refuzimi i shtetit anëtar [Rusisë] për t'i dhënë ushtarakut lejen prindërore, ndryshe nga ushtaraket femra, është diskriminues. Ndërsa Neni 8 nuk përfshin të drejtën për lejen prindërore, Gjykata theksoi se në qoftë se një shtet vendos për të krijuar një skemë të lejes prindërore, ky shtet duhet ta bëjë këtë në një mënyrë jo-diskriminuese. Gjykata konstatoi se avancimi i barazisë mes burrave dhe grave është sot një objektiv i madh i vendeve anëtare të Këshillit të Europës dhe se duhet te paraqiten arsye shumë të forta përpara se një dallim në trajtim midis sekseve të mund të konsiderohet në përputhje me Konventën.

Status maritalis dhe efektet e tij mbi 'pensionin' dhe diferencimet [reduktimet] ndërmjet burrave dhe grave të martuara gjenden edhe në çështjen *Wessels-Bergervoet kundër Holandës*, gjykim i 4 qershorit 2002. Në këtë rast, GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Reduktimi i pensionit ishte rezultat i një trajtimi diskriminues. Po kështu, edhe në çështjen *Zeman kundër Austrisë*, u gjetën shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës për shkak të dallimit në trajtim midis burrave dhe grave për sa i përket të drejtës së pensionit familjar në lidhje me bashkëshortët. Këto dallime nuk bazoheshin në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Diskriminimi në marrëdhëniet personale jo pasurore haset edhe në

[24] Shih gjithashtu GjEDNj çështjen Biondic v Kroacia,

çështje të tilla si: *Burghartz kundër Zvicrës*, gjykim i 22 shkurtit 1994. Kështu, GJEDNJ konsideron si shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës refuzimin që i është bërë aplikuesit për të lejuar të përdorë mbiemrin e gruas si mbiemrin e familjes së tyre. Po kështu, në çështjen *Ünal Tekeli kundër Turqisë*, gjykim i 16 nëntorit 2004, gjykata vlerësoi se kemi shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës për shkak të refuzimit prej autoriteteve për të lejuar aplikanten të mbajë vetëm mbiemrin e saj të vajzërisë pas martesës[25]. Në *Keegan kundër Irlandës*, gjykim i 26 majit 1994, u gjet shkelje e nenit 8 të Konventës sepse legjislacioni i brendshëm nuk i njihte të drejtën një babai natyral për t'u emëruar si kujdestari i fëmijës së tij. Për këtë ai vetëm mund të aplikonte.

Në çështjen *Opuz kundër Turqisë*, nënvizohet rëndësia që ka mbrojtja e veçantë e familjes dhe e martesës. GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 2, 3 dhe 14 të Konventës dhe vuri re se Turqia kishte dështuar në krijimin dhe zbatimin në mënyrë efektive të një sistemi në të cilin të gjitha format e dhunës në familje ndëshkohen dhe të vihen masa mbrojtëse të mjaftueshme për të mbrojtur viktimat. Gjykata arriti në përfundimin se dhuna në familje prek kryesisht gratë dhe se pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues gjyqësor i shfaqur nga autoritetet kombëtare ishte i bazuar në gjini. Po kështu, në çështjen *Branko Tomasic dhe të tjerë kundër Kroacisë*, GjEDNJ gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës sepse shteti kishte dështuar në ndërmarrjen e të gjitha hapave të arsyeshme/e nevojshme për të mbrojtur viktimën e dhunës në familje ose familjen e saj nga një bashkëshort i cili më parë ishte shpallur fajtor për kërcënimin se do ta vriste.

1. Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Mbrojtja e shtatzënisë, amësisë dhe prindërimit është një prej qëllimeve të legjislacionit të BE[26].

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ka dhënë kontributin e vet në zhvillimet në këtë fushë. Në këtë mënyrë jurisprudenca ka ndikuar në sqarimin e mëtejshëm të parimeve që gjenden në legjislacionin kryesor e dytësor të BE si dhe në interpretimin adekuat të diskriminimit direkt ose indirekt duke zgjeruar kuptimin e barazisë.

Direktiva e Punëtoreve Shtatzëna 92/85/e KEE-së [27]: përcakton nivelet

[25] Shih gjithashtu rastin e GjEDNj Cusan and Fazzo v. Italy të 07.01.2014 në të cilin nënvizohet se dhënia fëmijës e mbiemrit të atit drejtpërdrejt nga nëpunësi i gjendjes civile dhe analiza e bërë nga gjykata në rastin e ankesës së prindërve, tregon se kemi të bëjmë me diskriminim që lidhet me gjininë. Judgment Cusan and Fazzo v. Italy.

[26] Për më shumë shih: http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/your_rights/discrimination__pregnancy_maternity_parenthood_final_en.pdf si dhe Çështjet e Barazisë Gjinore në standardet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndërkombëtare'. Udhëzues. Botuar nga Shkolla e Magjistraturës në: http://www.magjistratura.edu.al/media/users/4/UNIFEM_permbajtja.pdf

[27] Direktiva e Këshillit 92/85/e KEE-së e 19 tetorit 1992, për futjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve që kanë pak kohë që kanë lindur, apo që kanë fëmijë në gji (Direktiva e dhjetë e veçantë, sipas kuptimit të Nenit 16

minimale të të drejtave të lindjes, duke përfshirë lejen dhe pagën, të cilat Shtetet Anëtare duhet t'i sigurojnë për punëtoret shtatzëna dhe punëtoret që kanë pak kohë që kanë lindur apo që kanë fëmijë në gji. Qëllimi kryesor i saj është të zbatojë masa për të nxitur përmirësime në sigurinë dhe shëndetin në punë të këtyre personave.

Direktiva e Lejes Prindërore 96/34/e KE-së [28]: Pajtimi i jetës familjare/private është, sipas GjED-së, "rrjedhojë e natyrshme e barazisë gjinore" dhe një mjet për arritjen e barazisë gjinore jo vetëm me ligj por edhe në realitetin e jetës së përditshme.[29] Si pasojë, ndonëse nuk është miratuar si një direktivë e posaçme e barazisë gjinore, Direktiva e Lejes Prindërore 96/34/e KE-së luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e barazisë gjinore.

Kështu, në çështjen e GjED C-588/12 (Lyreco kundër Rogiers), të datës 11.3.2014 një punëmarrës me një kontratë pune me kohë të plotë mori leje prindërore me kohë të pjesshme. Gjatë kësaj periudhe punëdhënësi përfundoi marrëdhënien e punës pa dhënë arsye apo justifikime të mjaftueshme lidhur me këtë. Sipas legjislacionit belg, punëdhënësi është i detyruar të paguajë punëmarrësin me një shumë fikse si paradhënie që lidhet me kompensimin mbrojtës të barabartë me pagën e 6 muajve. Për shkak të apelimit të çështjes, Gjykata e Lartë e Punës në Antwerp, i parashtroi një pyetje GjED nëse në një situatë të tillë, shuma fikse do të përcaktohej/përllogaritej mbi bazën e pagës së punës part-time për shkak të lejes prindërore apo pagës së plotë bazuar në kontratën e punës me kohë të plotë? Në këtë rast GjED vendosi se nëse një punëmarrës në mënyrë të padrejtë përjashtohet nga puna gjatë lejes prindërore me kohë të pjesshme, shuma fikse e parashikuar si shpërblim mbrojtës, do të përllogaritet mbi bazën e pagës së punës me kohë të plotë. Nëse kjo përllogaritje do të bëhej mbi bazën e pagës së lejes prindërore, kjo do të vinte në kundërshtim me Direktivën e Këshillit 96/34/EC të 3 Qershorit 1996.

Direktiva e Riformuluar 2006/54/e KE-së [30]: Qëllimi i kësaj Direktive është të sqarojë dhe bashkojë në një tekst të vetëm dispozitat për punësimin, duke përfshirë ngritjen në detyrë dhe trajnimin profesional, si edhe kushtet e punës, dhe duke përfshirë pagën dhe skemat profesionale të sigurimeve shoqërore. Ajo shfuqizon kështu Direktivat 75/117/të KEE-së, 76/207/të KEE-së, 86/378/të KEE-së dhe 97/80/të KE-së. Pothuaj të gjitha nenet e Direktivës së Riformuluar u korrespondojnë neneve ekzistues në njërën apo më shumë prej direktivave të sipërpërmendura.

---

(1) të Direktivës 89/391/të KEE-së), OJ L 348, 28.11.1992, f. 1–8.

[28] Direktiva e Këshillit 96/34/e KE-së e 3 qershorit 1996, për marrëveshjen kuadër për lejen prindërore të përfunduar nga UNICEF, CEEP dhe ETUC, OJ L 145, 19.6.1996, f. 4–9.

[29] GjED, 17 qershor 1998, Çështja-243/95, Hill dhe Stapleton v. Komisionerëve të të Ardhurave dhe Departamentit të Financës [1998] ECR I-3739 (Hill).

[30] Direktiva e 2006/54/e KE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 korrikut, për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në çështje të punësimit dhe profesionit (e ribërë), Official Journal L 204, 26/07/2006 P. 0023 – 0036.

4. Legjislacioni shqiptar

4.1. Dispozitat e Kodit të Familjes dhe barazia gjinore

Kodi i familjes përfshin parimet dhe rregullimet kryesore të jetës familjare martesore. I konceptuar në tri pjesë (parime të përgjithshme, bashkëshortët, fëmijët), ky ligji-kod nënvizon parimet e barazisë (përfshi edhe atë gjinore) dhe të reciprocitetit në marrëdhëniet familjare e martesore në disa drejtime të tilla si:

❒ Barazia midis bashkëshortëve: marrëdhëniet personale e pasurore të tyre në të tri etapat: lidhjen e martesës, marrëdhëniet personale e pasurore gjatë martesës, dhe në mbarimin e martesës;

❒ Barazia e prindërve kundrejt të drejtave dhe detyrimeve ndaj fëmijëve. Për këtë nuk ka rëndësi nëse prindërit janë të martuar ose jo.

❒ Barazia e fëmijëve pavarësisht statusit të prindërve dhe pavarësisht nëse janë fëmijë natyrorë apo të birësuar.

Ajo që evidentohet lehtësisht është që në të gjitha etapat që kalon çifti i bashkëshortëve, që nga lidhje e martesës e deri në mbarimin e saj, duket se kodi priret nga parimet e barazisë gjinore.

Në nenin 1 i Kodit të Familjes *nënvizon parimet e barazisë morale e juridike mbi të cilat duhet të ndërtohet dhe të jetojë martesa si një institut shumë i rëndësishëm i së drejtës familjare*. Në të nënvizohet: "martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet *në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve*, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit ne familje".

Pjesa e dytë (nenet 7-164) përmban rregullime lidhur me: kushtet thelbësore për lidhjen e martesës; formën e martesës, institutin e pavlefshmërisë së martesës, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, regjimet pasurore martesore, mbarimin e martesës dhe pasojat. Në këtë pjesë ka edhe rregullime në vetëm 2 nene për institutin e bashkëjetesës, si një alternativë tjetër të jetës familjare. Nga pikëpamja formalo juridike nuk ka asnjë vend për trajtimin e diferencuar në varësi të të qenit burrë apo grua në tërësinë e neneve të kësaj pjese. Nënvizohet pëlqimi i lirë si kusht thelbësor për lidhjen e martesës. Mosha minimale për lidhjen e martesës është e unifikuar edhe për burrin edhe për gruan. Ndalesat për martesë nuk kanë diferencime gjinore. Martesa është një bashkim monogam e ndaj poligamia dhe poliandria ndalohet[31]. Kjo është e shprehur në disa nene të

[31] Lidhur me monogaminë duhet të nënvizojmë se është një parim jo vetëm i martesës por edhe bashkëjetesës. Me respektim të monogamisë kuptojmë edhe rastin e kombinimeve të martesës dhe bashkëjetesës. Pra, nuk mund të kemi njëkohësisht edhe njërën, edhe tjetrën. Gjithsesi, për sa kohë, bashkëjetesa është një lidhje faktike e cila nuk verifikohet dhe nuk regjistrohet, praktika tregon se ka raste që ndonëse bashkëshortët janë ende të lidhur në martesë juridikisht, njëri prej tyre ka një lidhje faktike sipas karakteristikave të dhëna në nenin 163 të KF lidhur me bashkëjetesën. Në një rast të tillë, detyrimi për jetë të përbashkët respektohet vetëm në bashkëjetesë. Kështu, p.sh., në vendimin nr.1836/25.02.2013 të GjRrGj Tiranë, kemi: "gjatë gjykimit rezultoi se rreth pesë vite më parë, paditësi është larguar nga jeta bashkëshortore pasi ka njohur një shtetase po nga e njëjta

KF jo në mënyrë të drejtpërdrejtë me termat monogami por gjithsesi në një mënyrë plotësisht të qartë.

Sa u përket të drejtave dhe detyrimeve të bashkëshortëve gjatë martesës, KF *s*anksionon shprehimisht të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të njëjta (reciproke) për të dy bashkëshortët në raport me njëri-tjetrin, familjen dhe fëmijët. KF nxit parimin e respektimit vullnetarisht të të drejtave dhe detyrimeve por edhe parashikon mbrojtje nga bashkëshorti/ja abuzues në respektim të të drejtave e detyrimeve përmes: masave urgjente, masave ndaj dhunës, dhënies së autorizimit nga gjykata, sekuestrimit të të mirave, largimit nga banesa, etj.

Një ndalesë tek kuptimi dhe zbatimi i masave urgjente:

Neni 61 i KF: **Masat urgjente**

Në qoftë se njëri nga bashkëshortët nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit tjetër, mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me ta.

Zgjatja e masave të parashikuara në këtë nen duhet të jetë e përcaktuar dhe në asnjë rast të mos i kalojë 3 vjet.

Fjalët kyç të këtij neni janë: masë urgjente, mosplotësim i dukshëm i detyrimeve, vënie në rrezik e interesave të familjes, afat maksimal 3 vjeçar,

Pra, masa urgjente karakterizohet si një masë e përkohshme që duhet marrë me shpejtësi, që ka karakter aktual, sepse mosmarrja e tyre mund të sjellë rreziqe që vijnë qoftë në aspektet personale, ashtu edhe ato pasurore. Këto rreziqe mund të vijnë si për bashkëshortët, ashtu edhe për fëmijët e tyre. Për nga natyra e tyre këto masa mund të krahasohen edhe me natyrën e masave të parashikuara nga Ligji "Për masa ndah dhunës në marrëdhëniet familjare" [2006], por që kanë si shkak jo dhunën, por mosplotësimin e detyrimeve që burojnë nga martesa dhe që lidhen me familjen, fëmijët, bashkëshortët në aspekte pasurore dhe personale.

Nga pikëpamja procedurale duket se për të vendosur lidhur me një masë urgjente, kërkohet bërja e një kërkese nga ana e njërit bashkëshort.

Ndërsa në këtë nen nënvizohet se gjykata mund të përcaktojë të gjitha masat urgjente që lidhen me bashkëshortin që nuk ka plotësuar detyrimet dhe vënë në rrezik familjen, nga ana tjetër, nuk është renditur asnjë masë orientuese, qoftë edhe si model, duke ia lënë kështu, këtë detyrë, totalisht në diskrecion gjykatës.

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, përmes Rekomandimit Nr. R (91) 9 "Mbi masat emergjente në çështjet familjare" i cilëson ato si masa që duhen marrë me shpejtësi me qëllim që të parandalohet ardhja

komunë ku ai jetonte me të paditurën dhe aktualisht jeton në Tiranë e nga bashkëjetesa ka edhe një fëmijë. Bashkëshortët nuk bashkëjetojnë me njëri – tjetrin dhe në këto kushte martesa ka mbetur formale. Gjatë gjykimit rezultoi se pala paditëse ka bërë vazhdimisht përpjekje për të normalizuar marrëdhëniet bashkëshortore, por i padituri ka qenë i vendosur në vendimmarrjen e tij."

e pasojave negative dhe të pakthyeshme. Shpesh herë gjykata, për arsye të ndryshme që lidhen me ngarkesën, procedurën, veprimet e palëve, e të tjera pengesa, duke se vepron jo aq me shpejtësi dhe për rrjedhojë nuk jep zgjidhje të shpejta në rastet kur interesi i fëmijës dhe interesi i individëve të tjerë në nevojë është në rrezik serioz.

Duke mos qenë të qarta sipas legjislacionit dhe praktikës shqiptare, masat urgjente as kërkohen nga bashkëshortët dhe as aplikohen nga gjykata. Kjo mund të paraqesë rrezikshmëri, për shembull, në rastet kur fëmija është hequr në mënyrë të paligjshme nga mjedisi ku jeton ose kur mirëqenia e tyre është vënë në rrezik serioz. Po ka aspekte ekonomike të cilat mund të vënë në rrezik familjen duke i hequr asaj mundësitë bazike për të jetuar normalisht. Nga ana tjetër, në rastin e vendit tonë, masat urgjente në çështjet familjare nuk mbështeten me burime të mjaftueshme për të mbrojtur interesat e familjes. Pra, nga ana e shtetit dhe institucioneve nuk ka mjete adekuate në dispozicion për të mbështetur jetën e familjes së vënë në rrezik.

Gjykatat duhet të ketë mundësi ligjore për të marrë një masë urgjente të duhur si dhe burime për të mbrojtur fëmijët dhe personat e tjerë në nevojë. Mbrojtje e veçantë i duhet kushtuar një fëmije, mirëqenia e të cilit është në rrezik serioz, për shkak të neglizhencës apo për shkak të keqtrajtimit fizik ose mendor ose që ka qenë ose mund të hiqet në mënyrë të parregullt nga një person i cili ka kujdestarinë mbi të. Vetë gjykata mund të konstatojë rreziqet që i shfaqen një fëmije edhe kur personat e legjitimuar nuk aplikojnë përmes urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

Gjykata duhet të tregojë gatishmëri për të vepruar në çdo kohë. Psh, siç do të shohim një rast edhe në vijim, nëse asaj i paraqitet një rast i zgjidhjes së martesës dhe çifti rezulton se ka fëmijë ndër të cilët disa janë të regjistruar dhe të tjerë të paregjistruar në gjendjen civile, atëherë, si masë emergjente është adresimi i problemit të regjistrimit të fëmijës/ve dhe pezullimi i procedurës së zgjidhjes së martesës deri sa të bëhet regjistrimi i fëmijëve. Duhet të pranojmë se për fëmijët është një rrezik i madh nëse ata figurojnë të paregjistruar. Një mungesë përgjegjësie e tillë nga ana e prindërve nuk mund të neglizhohet nga ana e gjykatës. Për këtë, gjykata i drejtohet autoriteteve kompetente që kanë kompetencë regjistrimin e fëmijëve. Mendojmë se nuk ka emergjencë të zgjidhjes së martesës dhe nuk ka asnjë shkak që vonesat në zgjidhjen e martesës të konsiderohen si pretendim për cenimin e jetës private në raste të tilla. Zgjidhja e martesës nuk është qëllim në vetvete nëse nuk rregullohen pasojat e saj, ndër to kryesore janë ato që lidhen me fëmijët.

Me këtë duam të themi që, në disa raste, marrja e një mase të caktuar, nuk duhet të presë bërjen e një kërkese. Vetë legjislacioni e parashikon këtë mundësi dhe gjykata nuk mund të qëndrojë e ngurtësuar nën shprehjen e 'rolit pasiv' të saj. Fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti, ndaj në këtë rast gjykata është shteti. Do të ishte më efektive që dispozita lidhur me masat urgjente të parashikonte më shumë diskrecion të gjykatës për

vetëveprim, sepse kështu urgjenca do të kishte adresimin e duhur.

Sipas parimit 3 të Rekomandimit të sipërcituar të Këshillit të Europës nënvizohet se:

1. Një procedurë e thjeshtë dhe e shpejtë duhet të jetë në dispozicion për të siguruar dhënien e vendimeve pa humbur kohë. Për këtë qëllim, masat e mëposhtme mund të përdoren:

❒ Bërja e kërkesës përmes një aplikimi sa më të thjeshtë;

❒ Mundësisht të parashikohen raste se kur mund të lejohet gjykata për të vepruar me iniciativën e vet;

❒ Masat e përkohshme të merren edhe me bindjen e brendshme të gjykatës;

❒ Duke përdorur të gjitha mjetet e teknologjisë moderne të komunikimit për të lehtësuar çdo procedurë njoftimi, transmetimin e kërkesave dhe shkëmbimin e informacionit midis gjykatave dhe autoriteteve të tjera dhe palëve të ndryshme në proces;

❒ Duke i lejuar gjykatës një rol aktiv në rastin konkret dhe në marrjen e provave;

❒ Parandalimin e ndonjë pale që synon të keqpërdorë masat emergjente dhe të bëhet pengesë në proces përmes vonesave/shtyrjeve, etj.

2. Autoritetet kombëtare duhet të sigurojnë që informacioni mbi masat urgjente të jetë bërë sa më publik. Kjo përfshin edhe rastet e subjekteve të cilëve një person në nevojë mund t'u drejtohet për ndihmë.

3. Ndihma ligjore dhe këshillimi duhet të jepet sa më shpejt nëse një gjë e tillë kërkohet.

4. Gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente duhet të ketë fuqinë për të dhënë vendime të cilat janë menjëherë të zbatueshme [të ngjashme me ekzekutimin e UM/UMM];

5. Vendimet e gjykatës duhet të zbatohen me shpejtësi duke bërë të qarta sanksionet në rast moszbatimi .

Bashkëshortët kanë të drejta të barabarta për t'u ankimuar në gjykatë për shkeljen e detyrimeve familjare martesore.

Çështja e mbiemrit:

Bashkëshortët kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Askujt nuk i imponohet mbiemri. Mbiemri i fëmijëve është mbiemri i përbashkët i prindërve (nëse ky është i tillë); ose mbiemri i njërit prind i vendosur me marrëveshje; ose mbiemri i atit në rast mosmarrëveshjeje të prindërve. Në këtë mënyrë KF ende ka ndonjë dispozitë diskriminuese ndërkohë që çështja e mbiemrit është një çështje sensitive[32].

Çështja e kontributeve gjatë martesës:

Kontributi për martesën vetë-rregullohet nga bashkëshortët në marrëveshjen mbi regjimin; në mungesë të rregullimeve në kontratën e

[32] Lidhur me çështjen e mbiemrit në kuadrin e Këshillit të Europës shih Rekomandimin nr. 1362 (1998) Mbi diskriminimin ndërmjet femrave dhe meshkujve në caktimin e mbiemrin dhe kalimin e mbiemrit të prindërve tek fëmijët.

regjimit, sipas mundësive dhe kushteve çka do të thotë që në rast abuzimi me kuptimin individual dhe subjektiv mbi kushtet e aftësitë, njëri bashkëshort mund të abuzojë e të vegjetojë në 'kurriz' të tjetrit. Kultura e mos aplikimit të masave urgjente e bën edhe më të mundshme këtë përfitim të padrejtë.

Masat ndaj dhunës në dispozitat e KF:

Neni 62 mbi masa ndaj dhunës mbron njësoj burrin e gruan si bashkëshortë ndaj veprimeve të dhunshme të bashkëshortit tjetër. Në fakt kjo dispozitë qëndron më shumë si normë që reklamon standardin anti-dhunë të legjislacionit familjar, sepse aplikimi i saj realizohet përmes ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare [2006].

*Marrëdhëniet pasurore dhe personale gjatë martesës duket se mbështeten mbi norma neutrale. A*snjë prej bashkëshortëve nuk mund t'i imponojë tjetrit zgjedhjen e një regjimi për pasurinë. Vendosja për këtë është e drejtë e barabartë e të dy bashkëshortëve. Duhet të pranojnë se varësisht neutralitetit në ligj qëndron një pabarazi në praktikë, ndaj edhe qëllimi nuk është thjesht të sjellim në vëmendje normën si të tillë, por kujdesin që duhet të tregojnë autoritetet e ligjit dhe kryesisht gjyqtarët, noterët, etj. kur e zbatojnë këtë. Çdo regjim ka avantazhet dhe rreziqet e veta. Çdo martesë ka të priturat dhe të papriturat e veta. Ndaj KF siguron mbrojtje të veçantë për familjen dhe martesën e mbi të gjitha, për fëmijët.

Ndonëse mbarimi i martesës, nga pikëpamja formalo-juridike, sjell të njëjtat pasoja si për burrin, edhe për gruan, zhvillimi i jetës tregon se kjo është shumë relative dhe përgjegjësitë për gruan janë më të mëdha. Kështu, ndonëse një nga mënyrat e zgjidhjes së martesës është ajo "me pëlqimin reciprok të të dy bashkëshortëve", kjo mënyrë, duhet të dëshmojë një shkallë të lartë përgjegjshmërie dhe përgjegjësie të bashkëshortëve. Procesi shndërrohet edhe në një proces edukues për palët dhe është çasti që këta të japin prova dhe të demonstrojnë që janë të vendosur në respektimin e ligjit dhe të njëri-tjetrit si ish-bashkëshortë që kanë konsumuar vite jetë së bashku. Nga disa detyrime nuk mund të hiqet dorë, sikurse ka disa pjesë të detyrueshme që duhet të jenë në marrëveshje.

Pjesa e tretë e KF (nenet 165-313) mban titullin "Fëmijët". Do të ndalemi në analizë në diskriminimin në rastet e aplikimit të dispozitave të institutit të amësisë dhe të atësisë; detyrimin për ushqim, përgjegjësinë prindërore, kujdestarisë, etj.

4.2 Ligji nr.9970/28.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri"

Nga vetë objekti i tij duket se ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Duke qenë se jeta publike ka një impakt të drejtpërdrejtë në jetën familjare, si p.sh., mosdiskriminimi në marrëdhëniet e punës,

mosdiskriminimi në arsim apo formim profesional, respektimi i këtyre parimeve në rekrutim etj. sjell avantazhe ekonomike për gratë dhe automatikisht rritjen e të ardhurave të tyre dhe të autonomisë së administrimit të tyre sipas interesit të familjes dhe atij vetjak.

Një nen i rëndësishëm që bën qasje me vlerë të përgjegjësive familjare si kontribut, është neni 23, lidhur me 'Vlerësimin e punës së papaguar'.

1. Puna e papaguar e femrave dhe e meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo:

a) kujdeset për mirëqenien e familjes;
b) kujdeset për fëmijët;
c) kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes;
ç) punon në bujqësi dhe ekonomi familjare.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi.

4.3 Ligji nr. 221/4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

Nuk mungojnë rastet kur diskriminimi është i lidhur me statusin martesor. Askush nuk mund të diskriminohet në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Sipas nenit 7 nën titullin 'Mbrojtja nga diskriminimi', përbën diskriminim, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

PJESA E DYTË: LIDHJA E MARTESËS DHE PARIMI I BARAZISË GJINORE

1. E drejta për t'u martuar dhe e drejta për të pasur familje si të drejta themelore të njeriut.

E drejta për martesë renditet ndër të drejtat themelore të njeriut. Kjo e drejtë hyn në kategorinë e të drejtave sociale. Si e tillë, ajo disiplinohet nga po ato parime të përgjithshme që qëndrojnë në themel të kësaj kategorie të drejtash[33].

Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje (neni 53/1 i Kushtetutës). Përdorimi i përemrit "kushdo", do të thotë që nuk ka asnjë lloj diskriminimi lidhur me të.

E drejta për t'u martuar e për të krijuar familje rregullohet nga neni 12 i KEDNJ, nen i cili është i lidhur ngushtë me nenin 8 të kësaj Konvente që parashikon të drejtën e jetës private dhe familjare. Sipas nenit 12 të KEDNJ *"duke filluar nga mosha e lejuar për martesë, burri dhe gruaja kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje* ***sipas ligjeve kombëtare*** *që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte"*. KEDNj e lë në diskrecion të shteteve anëtare përcaktimin e moshës së lejuar për martesë. *GjEDNj ka një jurisprudencë të elaboruar sa i përket të drejtës për martesë*[34].

Kushtetuta jonë ia delegon këtë ligjit: *"Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj" (neni 53/3).* Pra është ligji, në rastin tonë Kodi i Familjes, që do të rregullojë me detaje të drejtën për martesë.

Thelbi i së drejtës për martesë është *formimi i raporteve juridike të detyrueshme midis një burri e një gruaje*. U takon atyre që të vendosin nëse dëshirojnë ose jo të vendosin këto raporte në rastin *kur nuk mund të jetojnë së bashku*, si në rastin e personave të dënuar me heqje lirie[35]. Personat e ndaluar apo të burgosur nuk pushojnë së qeni qenie njerëzore, pavarësisht krimit apo dënimit të tyre. Atyre u është

[33] Shih Kushtetutën e R.Sh Pjesa II, Kreu I, nenet 15-20.

[34] GjEDNj çështja V.K kundër Kroacisë [*Application no. 38380/08] ku tejzgjatja e procedurave të zgjidhjes së martesës ekzistuese konsiderohet si shkelje e së drejtës për martesë; në çështjen Lashin kundër Rusisë, GJEDNJ trajton të drejtën për martesë të personave të paaftë mendërisht [Application no. 33117/02]; në çështjen H kundër Finlandës GjEDNJ [Application no. 37359/09]* trajton dimensionin e së drejtës për martesë në rastin e homoseksualëve; në çështjen O'DONOGHUE dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar trajtohet e drejta për martesë kundrejt avantazheve që krijohen ndaj emigrantëve çka mund ta vendosë martesën në një lidhje fiktive, sa për sy e faqe [*Application no. 34848/07]. Për më shumë shih:* http://hudoc.echr.coe.int .

[35] Shih në jurisprudencën e GJEDNJ (Strasburg) rastin: Draper kundër Mbretërisë së Bashkuar (Draper V.United Kingdom). Report 10.7.80.; Hamer kundër Mbretërisë së Bashkuar (Hamer v.United Kingdom). Report 13.12.79.

hequr liria por ata vazhdojnë të jenë qenie njerëzore e për rrjedhojë iu garantohen të drejtat themelore, me përjashtim të atyre që u janë kufizuar apo hequr si pasojë e heqjes së lirisë[36]. Kjo është arsyeja që kësaj kategorie nuk mund t'i mohohet e drejta për të lidhur martesë[37]. Legjislacioni shqiptar ka parashikuar edhe lehtësira përsa i përket lidhjes së martesës së të dënuarve me heqje lirie. Kështu, neni 31 KF parashikon mundësinë që nëpunësi i gjendjes civile të shkojë në vendin ku ndodhet bashkëshorti i sëmurë ose që ka pengesë për të shkuar në zyrën e gjendjes civile dhe lidh martesën. Kjo pamundësi shëndetësore apo pengesë tjetër duhet të jetë e justifikuar përpara nëpunësit të gjendjes civile. Rregullorja e përgjithshme e burgjeve parashikon mundësinë e "lejeve të veçanta" në rastet e lidhjes së martesës apo të takimeve me nëpunësin e gjendjes civile[38].

1.1. E drejta për martesë si e drejtë "e kufizueshme" nga legjislacioni kombëtar. Kufizimet nuk mund të cenojnë thelbin e së drejtës për martesë.

Një prej kufizimeve të lidhjes së martesës është kushti i moshës. Të tjera kufizime lidhen me të ashtuquajturat pengesa apo ndalesa për martesë.

"Martesa është një institut, në mirëmbajtjen e pastërtisë së të cilit ka një interes të fortë publik, sepse martesa është themeli i familjes dhe i shoqërisë, pa të cilën nuk do të kishte as civilizim dhe as progres"[39].

Si një e drejtë e kujtdo, e drejta për martesë është një e drejtë e garantuar. Për të garantuar pastërtinë e institutit dhe mbrojtjen e veçantë të martesës si një nga format e jetës familjare, veç të tjerave, në çdo legjislacion familjar, vendin e parë e zënë rregullat lidhur me zotësinë për martesë. Këto rregulla janë të qarta dhe me karakter detyrues dhe në mënyrë të prerë evidentojnë interesin publik në mbrojtjen e institutit të martesës por pa cenuar aspak karakterin dhe interesin privat në të. Ndër këto rregulla të zotësisë për martesë merr rëndësi të veçantë lidhja e martesës me pëlqimin e lirë dhe pa vese[40] nga ana e të dy bashkëshortëve; kushti i moshës; mungesa e pengesave/ndalesave të parashikuara nga KF dhe respektimi i formës.

---

[36] Shih ligjin Nr.8328/16.04.1998 (ndryshim i vitit 2008, etj) "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" sipas nenit 64 (ndryshuar) "Drejtoria e institucionit i evidenton, në një regjistër të veçantë, faktet e lindjeve, martesave apo vdekjeve të ndodhura në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si dhe informon autoritetet përgjegjëse, për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin e posaçëm të gjendjes civile, në të cilin nuk pasqyrohet statusi i personit si i burgosur".

[37] LGJC [2009] parashikon në nenin 47/5 martesën e shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi kur njëri ose të dy bashkëshortët e ardhshëm janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose në vendin e tyre nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

[38] Rregulloren e përgjithshme të burgjeve VKM Nr. 303/ 25.3.2009, nenet 65, 70, etj.

[39] Kështu nënvizohet në një Vendim të Gjykatës së Lartë në Shtetet e Bashkuara qysh më 1888. shih: Harry.D Krause. Family Law "In a nutshell". Botimi i tretë. West Publishing CO. 1995. fq.88.

[40] Fjala për vese që lidhen me vullnetin.

2. Pëlqimi i lirë - parim që duhet respektuar për të dy dhe nga të dy bashkëshortët në lidhjen e martesës

Ndërkohë që legjislacioni shqiptar, Kodi i Familjes[41] [2003] parashikon të njëjtat kushte dhe pengesa martesore pa diskriminuar as burrin e as gruan, si bashkëshortë të ardhshëm, praktika gjyqësore dhe realiteti raporton se ende zakonet dhe traditat shfaqen dhe përpiqen të luajnë rol protagonist. Kështu, themi se kemi raste që tregojnë për dështim në zbatimin e standardeve të Kodit të Familjes dhe të konventës CEDAW.

E drejta e një gruaje për të zgjedhur një bashkëshort dhe për të hyrë lirisht në një martesë është me rëndësi qendrore për jetën, dinjitetin dhe barazinë e saj si qenie njerëzore. E njëjta vlen edhe për burrin. Kjo është garancia e parimit/kushtit të "pëlqimit të lirë" sipas nenit 8 të KF[42]. Mungesa e pëlqimit të lirë, apo një pëlqim i vesuar, e bën martesën të pavlefshme juridikisht. Një martesë e pavlefshme nuk sjell pasoja juridike për bashkëshortët[43] dhe si rregull goditet për pavlefshmëri[44].

Komiteti CEDAW, në vërejtjet përmbyllëse për Shqipërinë [korrik 2010], nënvizon se "mbetet i shqetësuar në lidhje me masat e kufizuara që shteti ka marrë për të sfiduar traditat e dëmshme të martesës që shkelin të drejtat e grave dhe vajzave në bazë të Konventës, duke përfshirë martesat e fëmijëve, praktikën e rolit vendimtar të familjes në zgjedhjen e burrit, dhe pagesën e një çmimi për nusen që mbetet mbizotëruese në zonat rurale dhe të largëta të vendit dhe ndërmjet komuniteteve të minoritetit. Komiteti mbetet seriozisht i shqetësuar në lidhje me ri-daljen e koncepteve tradicionale të drejtësisë (kanuni) dhe kodeve të sjelljes në disa zona veriore të vendit që tolerojnë të ashtu-quajturat vrasje për nder[45]".

Nga një shqyrtim i disa vendimeve të gjykatave shqiptare, qoftë edhe përmes pasazheve të marra nga çështje penale, vëmë re se në vendin tonë ka ende praktika mbi bazën e zakoneve e traditave diskriminuese e patriarkale në lidhjen e martesës ku nuk ka vend për 'pëlqim të lirë' të bashkëshortëve ose së paku të bashkëshortes në lidhjen e martesës. Kemi raste të martesave dhe rimartesave të detyruara. Ka raste që mund të dyshohet për martesa me pagesë. Sikurse ka raste të konsiderueshme të martesave nën moshë. Intervistimi i disa gjyqtarëve në kuadrin e këtij studimi, vuri në pah se, ndonëse problemet e ndikimit të së drejtës zakonore ndihen gjatë gjykimit

---

[41] Shih nenet 7-14 të KF lidhur me kushtet thelbësore për lidhjen e martesës.

[42] Neni 8 i KF: *"Pëlqimi i bashkëshortëve":* Martesa lidhet para nëpunësit të gjendjes civile, me pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm.

[43] Me përjashtim të rasteve të mirëbesimit të parashikuara nga neni 49 i KF, pra të bashkëshortit që nuk ka ditur shkakun e pavlefshmërisë së martesës. Në këtë rast pasojat fillojnë nga koha që vendimi ka marrë formë të prerë.

[44] Lidhur me trajtimin e institutit të pavlefshmërisë shih: Arta Mandro, E Drejta Familjare, SHB Emal, Tiranë, 2009, Kreu IV.

[45] Shih paragrafi 24 i Vërejtjeve Përmbyllëse për Shqipërinë, korrik 2010. Në: http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N10/485/20/PDF/N1048520.pdf?OpenElement

të çështjeve familjare, palët në proces janë të kujdesshëm që jo në çdo rast t'i pasqyrojnë ato edhe me fjalë. Diskriminimi bëhet më shumë evident kur paraqesin situata, episode të jetës familjare dhe kryesisht të veprimeve të kryera nga pjesëtarët meshkuj të familjes kundrejt imponimit apo detyrimit për të vepruar në një mënyrë apo tjetrën.

2.1 Martesa me mblesëri ose ndërmjetësim dhe rreziku i parimit të 'pëlqimit të lirë'

Ende ekzistojnë martesat me shkesi a mblesëri të njohura dhe praktikuara sipas normave të së drejtës zakonore.

Praktika e gjykatave të shkallës së parë na sjell përmes rasteve të zgjidhjes së martesës fakte nga koha e lidhjes së martesës ku del në pah mblesëria, shkuesia apo ndërmjetësimi i personave të tjerë[46].

Nga një monitorim i shpejtë që iu bëmë vendimeve me objekt zgjidhje martese të GjRrGj Shkodër, konstatuam se në një numër të konsiderueshëm, martesa ishte lidhur me shkuesi a mblesëri ose të paktën kështu është shënuar në tekstin e vendimit. Të pyetur nga gjykata mbi mënyrën e njohjes, çiftet përgjigjen se kjo është bërë përmes shkuesisë ose mblesërisë. Kështu, në vendimin nr.2/5.01.2010 të GjRrGj Shkodër nënvizohet se "Palët ndërgjyqëse janë njohur me shkuesi me njëri tjetrin, më pas janë *fejuar* [? pikëpyetja jonë lidhur me institutin e fejesës si pjesë e shumë vendimeve gjyqësore]. Ata kanë ndenjur rreth 5 muaj të fejuar dhe kanë lidhur martesë ligjore pranë Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër më datë 19.08.1999".

Vendimi i cituar nuk është i vetmi që ka këtë informacion lidhur me lidhjen e martesës. Gjyqtarë të intervistuar, pohuan se, në praktikën e tyre, ka shumë raste të tilla ku përgjigja mbi njohjen dhe lidhjen e martesës i referohet një instituti të së drejtës zakonore shqiptare.

Gjithashtu, edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në disa vendime, që, si të themi, mbërrijnë deri në këtë gjykatë, ka bërë evident fakte të tilla, duke cituar pjesë nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të rretheve gjyqësore[47]. Kështu në përmbajtjen e vendimit nr.68/14.2.2012 të këtij Kolegji gjejmë: "Nga aktet e administruara në dosje rezulton e provuar se palët ndërgjyqëse, paditësja M. K. dhe i padituri F. K., kanë qenë lidhur në martesë ligjore. Nga palët ndërgjyqëse <u>*rezulton e provuar*</u> [nënvizimi ynë]

[46] Sipas vendimit nr. 421/17.02.2010 të GjRrGj Shkodër kemi: "Fejesa mes palëve ndërgjyqëse është bërë me mblesëri, në vitin 1996. Martesën në gjendjen civile e kanë celebruar në vitin 1998, pasi u ka lindur fëmija i tyre i parë. Më vonë u kanë lindur edhe dy fëmijë të tjerë. Marrëdhëniet mes tyre kanë qenë jo të mira që në fejesë për shkak të xhelozisë së tepruar të të padituri. Paditësja deklaroi se në shumë raste ka qenë viktimë e dhunës fizike e psikike që i padituri ka ushtruar ndaj saj, madje ka pasur raste që këtë dhunë i padituri e ka ushtruar edhe në prani të personave të tjerë, duke e fyer në dinjitetin e moralin e paditëses, ku paditësja është akuzuar nga i padituri për lidhje jashtëmartesore me persona të tjerë. Të gjitha këto kanë sjellë grindje të vazhdueshme, të cilat janë përshkallëzuar në konflikte të thella mes tyre. Në vendimin nr.67/14.01.2011 paditësi pohon se: Jam njohur me Lulën me shkuesi në vitin 1992. Pas pesë muajsh kemi bërë martesën.

[47] Vendimi KCGJL, **Nr.21001-00864-00-2008 i Regj. Themeltar**
Nr.00-2012-448 i Vendimit (68).

se janë *fejuar me ndërmjetësi*, dhe kanë qëndruar të fejuar rreth 18 muaj dhe në datën 18.07.1994 kanë lidhur martesën ligjore. Nga konsumimi i kësaj martese ndërgjyqësit kanë lindur tre fëmijë. Paditësja M. K. pretendon se i padituri F. K. vazhdimisht ndaj saj ka përdorur dhunë fizike dhe psikologjike, gjë e cila ka detyruar paditësen M. K. në janar të vitit 2007 të largohet nga shtëpia e saj dhe të banojë me prindërit".

Të citosh në tekstin e një vendimi se 'rezulton e provuar se janë fejuar me ndërmjetësi' do të thotë se në lidhjen e martesës aplikohen rregullat e së drejtës zakonore mbi shkesin apo mblesin dhe kjo është e provuar nga gjykata [?!] dhe shkuarja tek nëpunësi i gjendjes civile është një akt që bëhet si detyrim për shkak se kjo është forma e njohur nga ligji për lidhjen e martesës. Por a merret gjykata me prova të tilla? A i interesojnë procesit këto prova? Çfarë e bën gjykatën të dalë në konkluzionin se martesa me mblesëri 'rezulton e provuar'? A provojnë palët që instituti i ndërmjetësimit funksionon sipas së drejtës zakonore me të gjitha të drejtat dhe detyrimet respektive apo më shumë kur thonë 'me mblesëri' duan të thonë se njohja e tyre nuk ka qenë e drejtpërdrejtë por përmes personave të tjerë, duke e bërë kështu ndërmjetësin apo mblesin një shprehje që nuk ka atë kuptim që i jep këtij instituti e drejta zakonore shqiptare por që shprehja e përdorur është një rudiment i kësaj të drejte.

Pra, siç e përmendëm, në rastin e martesave të tilla, duket se ndërkohë që është finalizuar gjithçka sipas të drejtës zakonore, mbetet që shkuarja tek nëpunësi i gjendjes civile, është një rutinë për të zyrtarizuar atë sipas të drejtës pozitive. Në martesën me mblesëri apo shkuesi, janë familjet respektive, miqtë apo të afërmit ata që marrin rolin drejtues në zgjedhjen e partnerit/es dhe mandej në njohjen dhe lidhjen e çiftit me njëri-tjetrin. Prezumohet që në një rast të tillë, lidhja në martesë të marrë pëlqimin e çiftit. Por ndërkohë fjala e dhënë nga shkesi apo mblesi në disa zona të caktuara e kthen dhënien e pëlqimit në një detyrim për çiftin. Detyrimi vë në rrezik pëlqimin e lirë dhe për rrjedhojë martesën të mundshme për t'u goditur për pavlefshmëri. Këtu lind pyetja: A është provuar kjo nga gjykata, pra a është provuar mungesa e pëlqimit të lirë? Sepse nëse diçka e tillë do të provohej, sipas nenit 33 të KF atëherë martesa do të ishte e pavlefshme[48] dhe, nëse nuk ka kaluar ende 3 vjet nga lidhja e martesës kjo e drejtë nuk është parashkruar [neni 44 paragrafi 3 i KF][49] çka do të thotë që gjykata mund të mos pranojë padinë për zgjidhjen e martesës sepse shkaku nuk ka të bëjë me marrëdhënien martesore por me lidhjen e martesës.

Në disa zona të vendit, zakonet dhe traditat e së shkuarës ende kanë një ndikim edhe më të madh. Duke shkëputur një pasazh nga vendimin nr. 143/11.02.2008 të GjRrGj Lezhë, i cili nuk është i vetmi në aspektet e

[48] "Martesa që është lidhur pa pëlqimin e lirë dhe me vese të të dy bashkëshortëve ose të njërit prej tyre është e pavlefshme".

[49] Neni 43&3 i KF: E drejta e padisë parashkruhet, në qoftë se nga data që ka pushuar kanosja, që është zbuluar lajthimi ose bashkëshorti ka fituar lirinë e plotë në rast të martesës pa pëlqim të lirë, kanë kaluar 6 muaj, por në çdo rast jo më tepër se 3 vjet nga lidhja e martesës.

jetës reale që duket se sjell në fokus, vëmë re që mungesa e pëlqimit të lirë haset jo vetëm në rastin e lidhjes së martesës por edhe të krijimit të marrëdhënieve të faktit përmes institutit të bashkëjetesës.

Kështu, në këtë çështje, çifti, siç del nga vendimi, ka lidhur një 'akt marrëveshje' për bashkëjetesën. Deri këtu duket se ky veprim është në përputhje me nenin 164 të Kodit të Familjes[50]. Ndërkohë duhet të paraqesim si parantezë se marrëveshje të tilla të lidhura përpara noterit, sipas komunikimeve të bëra për këtë studim me Kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterisë, janë të pakta në numër. Në këtë vendim bëhet e ditur se nga dëshmitarët në proces dhe vetë palët mësohet se, "familja e E.Gj dhe ajo e A.N kanë origjinë nga rrethi i Mirditës dhe në kurorëzimin e martesës ata *përgjithësisht* ruajnë traditën dhe zakonet e zonës së tyre. Lidhja e çiftit është kryer pa patur një njohje reciproke paraprake, por thjesht *me miratimin e familjeve të të dyja palëve*. Sipas deklarimeve të dëshmitarëve rezulton se shkak për bashkëjetesën mes palëve ka qenë ndërmjetësimi".

Në këtë fragment është cituar, brenda thonjëzave, një pjesës, ashtu siç gjendet në vendim. Kështu që, në këtë panoramë ka diçka kontradiktore. Duket se bashkëjetesa, me shumë se ajo çka rregullon neni 164, është bërë me qëllim që, nga njëra anë, të shmanget lidhja e martesës sipas të drejtës pozitive dhe nga ana tjetër të garantohen familjet për këtë bashkim fakti. Kjo lloj bashkëjetese duket se ngjan më shumë si një lloj 'martese me provë ose pa kurorë' të njohur nga e drejta zakonore shqiptare[51] dhe duket se është situata tipike e veshjes së instituteve të së drejtës zakonore me petkun e normave të së drejtës pozitive. Veç kësaj, këtë na i përforcon fakti se, lidhja midis çiftit është kaq e brishtë saqë bashkëjetesa e tyre merr fund për shkak të grindjeve "për motive të parëndësishme mes babait të paditëses E.Gj dhe babait të të padituri A.N" [citim nga vendimi]. Ky acarim është përcjellë edhe në vetë marrëdhëniet mes paditëses dhe të padituri dhe ka çuar në moslejimin e kontakteve të paditëses me familjen e saj. Po kështu në tekstin e vendimit kemi: "E.Gj rezulton të ketë qëndruar në familjen e të padituri A.N deri më datë 17.01.2006. Në këtë datë duke qenë se marrëdhëniet e saj me të padituri ishin përkeqësuar, *sipas bisedimeve me ndërmjetës,* mes dy familjeve është rënë dakord që ajo të largohej në familjen e saj. *Po sipas ndërmjetësve* babai i E.Gj kishte kërkuar që vajza e tij të kthehej në shtëpinë e tij duke lënë fëmijën e saj në familjen e të padituri". Pra, në këtë vendim nuk është fjala për ndërmjetësin si rekomandues i thjeshtë apo si personat e tretë të cilët bëhen shkak që çifti të njihet, por roli i tyre është tipik sipas kanunit. Po kështu, vëmë re se, sipas normave të zakonit, fëmija i përket familjes së burrit ndaj urdhërohet që nëna të largohet e të mos e marrë fëmijën. Kështu thotë edhe zakoni. Fragmentet e shkëputura nga vendimet më shumë se me aktualitetin duket se shkojnë për shtat me

[50] Neni 164 i KF: "Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës."
[51] Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit & 40 "Nuse pa shkuesi, sbahet".

periudhën e mesjetës dhe të kulmit të zbatimit të normave zakonore.

Në raste të martesës me mblesëri, 'presioni' emocional ka ndikimin e vet për të lidhur një martesë të përshpejtuar ku liria e pëlqimit nuk është e pastër. Ndoshta këto nuk janë martesa të lidhura nën kërcënim a ushtrim dhune por kanë ngarkesën e tyre çka, sidomos në zona të caktuara, ku ende kanuni luan rol evident, cedojnë në pastërtinë e pëlqimit të lirë. Pëlqimi i lirë nuk është kusht vetëm i lidhjes së çiftit në martesë por edhe në bashkëjetesë.

'Martesa me mblesëri', jo plotësisht në formatin e së drejtës zakonore, është ringjallur apo është e rëndomtë edhe për shkak të emigracionit ekonomik. Dëshira e të afërmve për të martuar djalin apo vajzën e tyre ka çuar shpesh në martesa të përshpejtuara pa njohjen e duhur që shumë shpejt përfundojnë në zgjidhje. Kështu, sipas vendimit nr.284/10.02.2010 të GjRrGj Vlorë, "nga shpjegimet e palëve ndërgjyqëse, të dhëna që në seancat e zhvilluara për pajtimin e palëve, si dhe nga provat shkresore, rezultoi se bashkëshortët kanë lidhur martesë me ndërmjetësinë e të afërmve të tyre, njohje e cila është realizuar në vitin 2005. Paditësi rezulton të ketë qenë emigrant ekonomik në Itali dhe në përpjekje të krijimit të familjes është njohur me të paditurën, me të cilën ka rënë dakord që të lidhin martese".

Ajo çka bie në sy, veç faktit të mblesërisë është 'përdorimi' në tekstet e vendimeve gjyqësore i institutit të fejesës. Nuk ka asnjë dispozitë të KF të bëjë rregullime për këtë institut. Ka kohë që fejesa nuk njihet juridikisht në të drejtën pozitive shqiptare. Ndërkohë, me sa duket, është i ngulitur në memorien dhe praktikat paramartesore si një akt me rëndësi që e konsideron lidhjen e martesës ngjarje të sigurt gjë që buron nga rregullat e së drejtës zakonore. Nga leximi i vendimeve gjyqësore duket se fejesa është diçka e pranuar, e mirëqenë [?!] edhe nga bashkëshortët, edhe nga gjykata. Nuk është profesionale që në vendime të tilla të nënvizohet fejesa për sa kohë nuk ka një interpretim të efekteve të fejesës. Nëse në vendime do të gjenim një analizë të tillë, atëherë kjo do të përbënte një shkak për të rikonsideruar kuptimin dhe pasojat juridike të fejesës, siç ka qenë e rregulluar në historikun e hershëm të normave të së drejtës familjare shqiptare.

2.2 Pëlqimi i lirë i sfiduar në rastet e lidhjes së martesës me shtetas të huaj ose me shtetas shqiptarë që jetojnë jashtë.

Nëse nuk ka pëlqim të lirë, mundet që varfëria, pra nevoja e madhe të jetë shkaku vendimtar që i detyron gratë të martohen me shtetas të huaj ose shqiptarë që jetojnë jashtë. Më së shumti, këto janë martesa të rregulluara për siguri financiare dhe jo për shkak të dashurisë dhe pëlqimit të lirë.

Në lidhjen e martesës në mënyrë të përsëritur i kthehemi institutit të 'pëlqimit të lirë' për shkak të rëndësisë së veçantë që ka kundrejt diskriminimit.

Në raste të tejskajshme, martesa të tilla për të siguruar një jetë më të mirë, pra këto martesa fiktive nga ana e bashkëshortëve, i kanë çuar këto

gra e vajza drejt trafikimit dhe ushtrimit me detyrim të prostitucionit[52]. Nga praktika gjyqësore kemi vënë re se pothuaj në të gjitha rastet e trafikimit e prostitucionit është manipuluar me martesë serioze dhe premtime për përmirësim të kushteve ekonomike, etj[53].

Shtetasja A.Ç në tetor të vitit 2001 ka humbur vëllain e saj Ar.Ç. Shtetasi P.R, i cili kish pasur lidhje shoqërore me të ndjerin, ka vajtur në fund viti 2001 për ngushëllim. Pas vdekjes së të atit dhe të vëllait, e dëmtuara A. Ç jetonte me të ëmën dhe të motrën. Në kushtet kur e dëmtuara shkonte për të ndjekur një kurs rrobaqepësie në qytetin e Peshkopisë, i gjykuari P.R, duke <u>përfituar nga situata ekonomike dhe shpirtërore</u> [marrë nga vendimi dhe nënvizuar nga autorja] e të dëmtuarës ka krijuar një lidhje me të, duke u paraqitur si serioze dhe që <u>ka përfunduar me kurorëzimin e saj</u> [shprehje e marrë nga vendimi], <u>*pas kërkesës së nënës së të dëmtuarës për respektimin e ceremonive zakonore*</u> [shprehje e marrë nga vendimi dhe nënvizimi ynë], midis dy familjeve. I gjykuari ka refuzuar martesën [duket sipas legjislacionit në fuqi- komenti ynë] duke parashtruar si arsye të pamundësisë fatkeqësitë e ndodhura në familjet respektive. Në këto kushte nëna e së dëmtuarës e ka konsideruar të mjaftueshme *kërkesën e dorës së vajzës* A. Ç nga ana e të pandehurit në shtëpi, duke përfunduar kjo situatë me *fejesën e tyre* [?? fejesa nuk është institut juridik i njohur nga kodi i familjes – komenti ynë]. Dy muaj pas krijimit të kësaj lidhjeje mes tyre, i pandehuri i ka propozuar të dëmtuarës të shkonin në Itali së bashku *për një jetë më të mirë*. Në kushtet e mirëbesimit, i gjykuari, duke përfituar nga gjendja e vështirë ekonomike dhe familjare e të dëmtuarës, është nisur së bashku me të për në Itali, me gomone nga qyteti i Vlorës, në mars të vitit 2002. .... Gjatë kësaj periudhe të qëndrimit të tyre në shtetin italian, e dëmtuara A.Ç është detyruar nga i pandehuri P.R të ushtronte prostitucion. ... Me qëllim lehtësimin e qëndrimit të tyre në Itali, i pandehuri me anë të një marrëveshjeje prej 4000 euro, ka siguruar një martesë formale për të dëmtuarën me shtetasin italian S.A. Në harkun kohor të viteve 2002-2004 e dëmtuara ka ardhur dy herë në Shqipëri duke u kontrolluar nga i gjykuari, i cili asnjëherë nuk e ka prezantuar atë me familjen e tij. Jeta e së dëmtuarës dhe telefonatat e saj me familjen kontrolloheshin nga i gjykuari, duke mos pasur asnjëherë mundësi të tregonte në familjen e saj jetën që ishte e detyruar të bënte"[54].

Duke sjellë këto raste, mbetet që në vëmendje të gjykatës të jetë kujdesi i verifikimit të pëlqimit të lirë në rastet e lejes së lidhjes së martesës

---

[52] Shih çështjen e GJEDNJ M. and others v. Italy and Bulgaria [40020/03], 31/07/2012.

[53] Shih Vendimin nr. 51/22.02.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: Më datë 25.03.2004, shtetasja Gj.P, nëna e të dëmtuarës M.P ka bërë një kallëzim penal ndaj shtetasve A.P dhe Gj.Gj pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësore Lezhë. Në kallëzim ajo ka denoncuar që personat e mësipërm kanë marrë vajzën e saj për ta kthyer si prostitutë në Itali. Këtë gjë kjo e ka mësuar me anë të letrave që e bija i ka dërguar nga shteti i Italisë. Sipas këtij kallëzimi ka rezultuar që A.P i ka premtuar të dëmtuarës në rastin konkret për martesë dhe së bashku janë nisur për në Itali.

[54] Shih Vendimin e Kolegjit Penal të GJL nr.99/10.02.2010.
Nr.52804-00870-00-2008 i Regj.Themeltar; Nr.00-2010-194 i Vendimi (99).

nën moshë. Është detyrë e saj që të zbulojë pas shkakut me rëndësi të pretenduar, shkakun e vërtetë me rëndësi që e detyron një vajzë të re të kërkojë lidhjen e martesës nën moshë.

Veç kësaj, në pasazhet e marra nga ky vendim, kemi mundësi të shohim mentalitetin e vërtetë ku, ndonëse ka një kohë kaq të gjatë që "sundon", të themi, e drejta pozitive lidhur me familjen e martesën, ende citohet zakoni dhe institute të së drejtës zakonore. Për efekte studimi, do të rekomandohej të monitorohej shpeshtësia e përdorimit të instituteve të së drejtës zakonore për të ndërmarrë aksionet e duhura pozitive për edukimin dhe çrrënjosjen e tyre edhe nga shoqëria edhe nga përfaqësuesit e institucioneve.

2.3 Shtrëngimi/detyrimi për martesë

Një martesë e lidhur me mblesëri nuk është e njëjtë me një martesë të lidhur me detyrim apo me atë që Kodi Penal e rendit si veprën penale të shtrëngimit për martesë. Në disa raste janë familjet ato që e detyrojnë vajzën të lidhë një martesë. Martesa me detyrim apo shtrëngim është një martesë e lidhur pa pëlqimin e lirë dhe për këtë përdoret presion, dhunë e abuzim me pushtetin. Mjetet e dhunës dhe të presionit janë si përmes asaj fizike apo kërcënimit për dhunë fizike ose presionit emocional. Përvoja ka treguar se ka patur raste që vajzat e reja janë çuar jashtë shtetit dhe kur kanë mbërritur aty u janë marrë mjetet e identifikimit për ti ndaluar të kthehen në shtëpi e kështu duke i detyruar të martohen.

Shtrëngimi për martesë si vepër penale parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal[55] përfaqësohet nga raste të pakta në praktikën gjyqësore. Sipas Vjetarit Statistikor të M.D për vitin 2009 ka 4 [katër] vendime ndërsa për vitin 2010 ka vetëm 1 [një] vendim lidhur me shtrëngimin për martesë. Duhet të pranojmë se vepra të tilla denoncohen kur shoqërohen me pasoja të tjera të rënda, si vrasje apo plagosje, apo dhunë e ashpër ndaj gruas apo familjarëve të saj. Kjo do të thotë se rastet e denoncuara mund të mos përputhen me realitetin. Viktimat ose i nënshtrohen fatit nga frika, ose arrijnë të kërkojnë zgjidhjen e martesës duke e paraqitur si martesë me mblesëri e pa e denoncuar si shtrëngim për martesë.

Nga vendimi nr.42/23.02.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë[56] mësojmë se nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton e provuar se në vitin 1993, i gjykuari Y.L i ka propozuar për martesë

[55] Neni 130 i K.Penal parashikon: "Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë (Ndryshuar neni me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013, neni 32): Shtrëngimi apo pengimi për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën, ose shtrëngimi për të lidhur apo zgjidhur martesën, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Kërkesa e qëllimshme ndaj një të rrituri ose fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin e tij për të lidhur martesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj"

[56] Vendimi i Kolegjit Penal të GJL. Nr.52102-01216-00-2010 i Regj. Themeltar Nr.00-2011-216 i Vendimit (42).

shtetases R.Gj. Pas refuzimit të saj, ai e ka kërcënuar me dinamit në dorë. Për shkak të këtij fakti, shtetasja R.Gj ka braktisur shkollën dhe është mbyllur në shtëpi. Në maj të vitit 1993 i gjykuari është thirrur për të kryer shërbimin ushtarak dhe nuk e ka kryer këtë detyrim. Më datë 01.12.1993 ai ka marrë çiften e babait të tij dhe ka shkuar për në lagjen Ndrelalaj, ku shtetasi P.Gj, babai i vajzës, po kulloste bagëtinë. Kur është afruar në një distancë prej 3-4 m, i gjykuari e ka goditur me çifte dhe si pasojë shtetasi P.Gj ka humbur jetën.

Në një rast tjetër, i pandehuri G.I banor i qytetit të Tiranës, ka bashkëjetuar me shtetasen E.T, me të cilën ka dhe një fëmijë rreth 2 vjeç. Për shkak të problemeve të ndryshme, bashkëjetesa mes tyre është shoqëruar me debate të shumta, të cilat kanë sjellë si pasojë largimin disa herë nga banesa të së dëmtuarës. I pandehuri në mënyrë të vazhdueshme e ka shtrënguar të dëmtuarën për të vazhduar bashkëjetesën me veprime konkrete. Konkretisht ai ka dërguar 'sms' në telefonin e vëllait të dëmtuarës, ka kontaktuar me babanë e saj duke i bërë presion dhe duke i thënë se në rast se ajo nuk shkonte të bashkëjetonte me të ai do t'i vriste. E dëmtuara i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka lëshuar një urdhër mbrojtje me nr.7041 akti, datë 17.03.2010 me afat kohor nga data 17.03.2010 deri në datë 08.04.2010. Ky shtetas ka vazhduar t'i bëjë presion të dëmtuarës, së cilës i ka dalë përpara në rrugë , duke e kapur për dore dhe duke i thënë se nuk do të largohej, përndryshe do t'ia mbushte kokën me plumba. Nga procesverbali i këqyrjes së aparatit celular në përdorim të shtetasit L.T (vëllai i të dëmtuarës), rezulton se i pandehuri ka dërguar disa sms në këtë celular. Konkretisht në njërin prej tyre është shkruar: "po ju drejtohem të gjithëve si familje e veçanërisht 'E': kthehu në shtëpi mos më shkatërro më shumë se çdo ditë dhe po më detyron të bëhem i keq me ju megjithatë dy fjalë ti dini dhe mos thoni ah ca ndodhi pse nuk u pajtuam sepse kurr skam për të lën gruan time ta gzoj njeri [vini re shprehjet e përdorura: gruaja si send dhe burri si pronar i sendit që ka tagrin e gëzimit] ."[57]

Shtrëngimi për martesë është një nga format e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave apo abuzimit me fëmijët. Në thelb është shkelje e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe duhet trajtuar si e tillë nga ana e gjyqësorit[58].

Në një studim të vitit 2005, bërë në kuadrin e Këshillit të Europës lidhur me detyrimin për martesë në vendet anëtare të Këshillit të Europës bëhet dallimi midis shtrëngimit për martesë dhe lidhjes së martesës pa qëllim për të jetuar si bashkëshortë[59].

[57] Vendimi nr.1169/16.09.2010 i GjRrGj Tiranë. Teksti marrë sipas vendimit duke përdorur drejtshkrimin sipas citimit bërë në të.

[58] Shih, Këshilli i Europës, Asambleja Parlamentare, Rezoluta 1468 (2005) Mbi martesat me detyrim dhe martesat e fëmijëve [anglisht: Forced Marriages and Child Marriages], 5 Tetor 2005, 1468 (2005). Në: http://www.refworld.org/docid/43f5d5184.html [aksesuar më tetor 2013].

[59] Shih "Forced marriages in Council of Europe member states. A comparative study of legislation

Studimi ndalet në kuptimin e *'forced marriage'* dhe kuptimin e ndryshëm që ka në vende të ndryshme duke përzjerë këtu edhe rastet e mungesës së pëlqimit të lirë, rastet e martesës 'sa për sy e faqe' ose martesave pa qëllim për jetë të përbashkët, edhe rastet e kanosjes apo lajthitjes, si edhe ato raste ekstreme që kanë të bëjnë me ushtrimin e shtrëngimit apo të dhunës me qëllim lidhjen e martesës.

Me sa duket, nuk është gjithnjë e lehtë dhe e thjeshtë që të bëhet kualifikimi ligjor i duhur si dhe ndarja qartë e disa prej situatave të sipërpërmendura. Pra, nuk është e lehtë për të konstatuar 'gjendjen mendore' prapa përmbajtjes eksplicite të lidhjes së martesës. Fakti ka të bëjë me qëllimin që shprehet nga bashkëshortët kur lidhet martesa. Ky qëllim është shumë më i komplikuar se sa fjalët e pranimit që shprehen e artikulohen. Ky vullnet i shprehur varet shumë nga rrethana të krijuara jashtë zyrës së nëpunësit të gjendjes civile ku 'de jure' shprehet vullneti. Ankthi dhe frika mposhtin fuqinë për t'i bërë rezistencë një martese të tillë dhe, për rrjedhojë, nuk ka aspak pëlqim të lirë.

Nga ana tjetër, nuk është e lehtë që të paraqiten prova të karakterit të tronditjes emocionale, të kërcënimit emocional, të frikës e tmerrit që përjeton një person që shtrëngohet të lidhë këtë martesë përpara gjykatës[60]. Pra, ky individ vulnerabël ndodhet në një pozitë që duket sikur e çon vetë veten drejt një martese skllavëruese. Sipas këtij studimi, del se praktika gjyqësore e vendeve të marra në analizë tregon se edhe martesat e realizuara për efekt të përfitimeve nga rregullat/procedurat e emigracionit, pra, lidhja e martesës pa qëllim për martesë, mund të përbëjë në vetvete një martesë të lidhur me detyrim ose forcë.

Studimi bën një analizë të faktorëve që çojnë në martesat e detyruara. Këta faktorë ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin në varësi të faktit nëse monitorojmë vendet ku praktika të tilla zbatohen në zonat rurale ose të familjeve të varfra, ose në vende të Bashkimit Europian ku përfshihen familjet për shkak të rregullave të imigrimit[61].

---

and political initiatives". Përgatitur nga Edwige Rude-Antoine Doctor of Law, Research Officer CERSES/CNRS. Directorate General of Human Rights Strasbourg, 2005. Studimi mund të aksesohet në: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/equality/03themes/violence-against-ëomen/CDEG(2005)1_en.pdf

[60] Nga ana e gjykatës, kërkohet marrja e mendimit të ekspertit të fushës sepse ka raste që në detyrimin për martesë ndodhemi nën efektet e stresit post traumatik.

[61] Shih GjEDNj A.A. and Others v. Sweden (no. 14499/09) 28/06/2012. Sipas fakteve, aplikuesja dhe 5 fëmijët e saj janë nga Jemeni dhe jetojnë në Suedi. Ata po presin vendimin lidhur me deportimin në vendin e tyre. Bazuar në nenin 2 dhe 3 të KEDNJ aplikuesja pretendon se nëse do të deportohet në Jemen, ata do të ndodhen përpara një rreziku të madhe sepse do të akuzohen për krime që lidhen me nderin sepse nuk I janë bindur atit apo bashkëshortit e janë larguar pa lejen e tij nga vendi. Përpara autoriteteve të migracionit aplikuesja është ankuar se ajo ka vuajtur për vite me radhë dhunë në familje por arsyeja kryesore e largimit lidhet me mbrojtjen e vajzave të mitura të cilat kërcënohen me martesë të detyruar.

3. Roli i prokurorit në procedurën e lidhjes së martesës pa shpallje

Mendojmë se është me vend që në këtë studim të trajtojmë rolin e prokurorit në çështjet martesore dhe bashkëveprimin e këtij institucioni me gjykatën. Kështu, në vijim po ndalemi në tri aspekte të veprimeve që lidhen me fazën e lidhjes së martesës dhe analiza do të fokusohet në interpretimin e dispozitave ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Roli i prokurorit lidhur me institutin e kundërshtimit të lidhjes së martesës

Kështu, nën titullin "kundërshtimet e lidhjes së martesës", neni 20 legjitimon prokurorin si një nga subjektet që mund të kundërshtojë lidhjen e martesës për çdo shkak që vjen në kundërshtim me kushtet e parashikuara në KF për lidhjen e martesës dhe për të cilat prokurori mund të kërkojë pavlefshmërinë e saj [martesës][62]. Duke përcaktuar një rreth të gjerë subjektesh të legjitimuar për të kundërshtuar lidhjen e martesës, qëllimi i legjislatorit është që të parandalohet, përpara lidhjes, pavlefshmëria e martesës në të ardhmen, pra të mbrohet martesa nga rastet e pavlefshmërisë.

Subjektet, përfshi prokurorin, që kanë të drejtën e kundërshtimit të martesës, e paraqesin aktin e kundërshtimit *përpara nëpunësit të gjendjes civile* të vendit ku do të lidhet martesa. Kjo sipas nenit 21 të KF. Në këtë akt, sipas nenit 22 të KF, prokurori duhet të shënojë:

- ❒ Cilësinë, që i jep atij të drejtën të bëjë kundërshtimin;
- ❒ Vendin ku martesa do të lidhet;
- ❒ Shkaqet e kundërshtimit;
- ❒ Dispozitën ligjore përkatëse ku gjendet ky shkak.

Me të marrë kundërshtimin, çështja është në diskrecion të nëpunësit të gjendjes civile, i cili sipas rastit mund të vendosë nëse kundërshtimi qëndron në përputhje me ligjin ose jo. Në varësi të vendimit të nëpunësit, kjo mund të kundërshtohet ose jo në gjykatë, sipas interesit të subjekteve që bëjnë kundërshtimin dhe bashkëshortëve të ardhshëm.

Nuk na rezulton që të ketë ndonjë rast, së paku nga praktika gjyqësore lidhur me kundërshtimin e bërë nga ana e prokurorit.

Roli i prokurorit lidhur me shpalljen e martesës

Referuar nenit 29 të KF kemi: "Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur".

Pra, në disa raste të parashikuara nga ligji, prokurori shfaqet përpara gjykatës si përfaqësues i interesave të palëve. I tillë është edhe rasti i lidhjes së martesës pa u shpallur. Gjykata mund të aksesohet vetëm përmes prokurorit. KF nuk parashikon të drejtën e bashkëshortëve ku ata vet ti drejtohen drejtpërdrejt gjykatës, por këtë e bëjnë vetëm përmes prokurorit. Nga ana e vet, prokurori, që të vërë në lëvizje gjykatën për lidhjen e martesës pa shpallje, duhet marrë dijeni e ti bëhet kërkesë nga

[62] Këto janë rastet e pavlefshmërisë absolute të martesës.

bashkëshortët e ardhshëm[63]. Me këtë duam të themi se prokurori nuk ka një detyrim ligjor *apriori* sepse veprimi i tij duhet të sigurojë paraprakisht pëlqimin e lirë si dhe kushtet esenciale të lidhjes së martesës[64].

Çdo martesë paraprihet nga shpallja. Vetëm për shkaqe me rëndësi, *me kërkesën e prokurorit*, gjykata mund të vendosë shkeljen e kësaj rregulle të përgjithshme, për të lidhur martesë pa shpallje paraprake. Shkaqet me rëndësi vlerësohen si të tilla vetëm nga gjykata. Kërkesa për lidhjen e martesës pa shpallje i drejtohet gjykatës nga prokurori i vendit ku do të lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm. Në këtë kërkesë prokurori, vë në dijeni gjykatën edhe për shkakun (shkaqet) e këtij përjashtimi nga rregulli. Sipas doktrinës, nisur nga roli i prokurorit sipas legjislacionit në fuqi[65], ndër rastet e konsideruara me rëndësi për shmangien e shpalljes së martesës, janë renditur: rastet e martesave të dëshmitarëve të drejtësisë; të martesave të bashkëpunëtorëve të drejtësisë; personave të afërm me ta për shkak të lidhjeve familjare, gjinisë a krushqisë, personave që banojnë ose bashkëjetojnë me ta në mënyrë të qëndrueshme; personave të lidhur me ta për shkak të marrëdhënieve konkrete; rastet e vlerësuara si në rrezik nëse do të realizohej shpallja publike e lidhjes së martesës.

Qëllimi i prokurorit është që ndërsa ushtron ndjekjen penale dhe mbledh fakte në rrugë ligjore të sigurojë e të garantojë mbrojtjen e posaçme të disa subjekteve në kushtet e rrezikut aktual, konkret e serioz në rrethanat kur ky proces komprometohet nga pamundësia e mbrojtjes së identitetit përmes shpalljes së martesës. Prokurori ushtron ndjekje penale dhe është përfaqësues i shtetit në një proces gjyqësor dhe është detyrë e shtetit mbrojtja dhe siguria e palëve në një proces. Në këtë mënyrë, prokurori bëhet garant edhe i realizimit të të drejtës themelore për të lidhur martesë edhe të detyrimit për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së individëve[66]. Ndër parimet e kodit etik të prokurorit është të respektojë dinjitetin e profesionit[67].

---

[63] Me këtë duam të themi që nëse nuk ka një kërkesë të qartë nga ana e bashkëshortëve për të lidhur martesën me pëlqimin e lirë pa shpallje, nuk ka arsye që prokurori të veprojë në mënyrë të njëanshme vetëm për shkak të faktit që për shkaqe dhe fakte që lidhen me detyrën e tij ai/ajo merr dijeni për dëshirën dhe qëllimi e një subjekti që duhet mbrojtur për lidhjen e martesës. Shih GjEDNJ çështjen *Ferreira Alves v. Portugal (no. 3)*, no. 25053/05, 21 Qershor 2007.

[64] Shih psh, GjEDNJ çështjen *Moldovan and Others v. Romania* (dec.), no. 8229/04 dhe aplikime të tjera, §§ 153-155, 15 Shkurt 2011.

[65] Sipas nenit 148/1 të Kushtetutës së RSH: **"**1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj."; Ligji nr.8737, datë 12.2.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" *(Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003) (Ndryshuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008), neni 2/1 me të njëjtën përmbajtje si kushtetuta.*

[66] Ligji nr.10173/22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë". (Ndryshuar me ligjin nr. Nr.10 461, datë 13.9.2011)

[67] Neni 7 i Kodit Etik të Prokurorit nënvizon "Marrëdhëniet me të Dëmtuarit dhe Dëshmitarët" dhe ndalet në detyrimin për të ruajtur konfidencialitetin dhe për të mos bërë të ditur asnjë informacion që mund të rrezikojë sigurinë e tyre; të marrë masat e nevojshme ligjore për të siguruar dëshmitarët dhe familjet e tyre; të kujdesen që të dëmtuarit të mos pësojnë dëmtime të mëtejshme dhe të trajtohen me dinjitet; do t'u sigurojnë *asistencë ligjore* dhe sociale dëshmitarëve, në rastet e parashikuara me ligj.

Çfarë ndodh në praktikë?

Ka raste që, për të lidhur sa më parë martesën, me ngut, njëri nga bashkëshortët apo të dy i drejtohen prokurorit dhe duket se është rasti që ky i fundit të investohet për të kërkuar, nga gjykata, lejimin e martesës pa shpallje. Nga mënyra se si praktika gjyqësore dhe e prokurorisë e ka zhvilluar këtë 'tagër' të prokurorit, vëmë re se, ndryshe nga rregullat e përgjithshme të investimit të tij, në çështjet familjare, ky rol duket se e konsumon figurën e tij/saj pa arsye të përligjur. Prokurori investohet kështu për të mundësuar realizimin e një martese sa më të shpejtë. E themi këtë sepse në praktikë duket se problemi nuk qëndron tek shpallja në vetvete por tek afati minimum që shpallja kërkon. Këto janë përgjithësisht rastet kur emigrantët vijnë me pushime e gjendet një vajzë 'e gatshme' nga familjarët për ta sugjeruar si kandidate për martesë e mandej për të lidhur martesë. Pra, janë përgjithësisht martesa të lidhura me shumë nxitim. Menjëherë pas lidhjes zyrtarisht të martesës, bashkëshorti largohet dhe, si në rastet e qëmotshme të kurbetit, shfaqet e zhduket herë pas here, si me magji, çka e bën marrëdhënien martesore të brishtë dhe bashkëshortët vetëm formalisht të tillë.

Ndër shkaqet e paraqitura nga prokurori dhe pranuar nga gjykata si shkaqe me rëndësi, për lidhjen e martesës pa shpallje, renditen: "shtetasi ka prerë biletën e kthimit për në Itali"; "nuk ka leje nga punëdhënësi italian apo grek për të qëndruar deri në fund të këtij afati", etj., vendime të shumta me këtë natyrë justifikuese që duket e pakuptimtë aq sa të përfshihet prokurori të cilit i kërkohet të trajtojë me dinjitet profesionin e tij. Kështu, duket se bileta e prerë ka më shumë rëndësi se akti i lidhjes së martesës që përfshin procedurën e shpalljes, aq sa për të respektuar periudhën e shpalljes e cila ka efekt jo vetëm për ata që legjitimohen të bëjnë kundërshtimin, por edhe për vet bashkëshortët e ardhshëm si një periudhë reflektimi dhe 'pjekjeje' të pëlqimit të lirë. Pa dyshim që në raste të tilla, edhe pëlqimi ka gjasa të jetë i imponuar dhe sforcuar pa u mbështetur në bindjen dhe njohjen e mjaftueshme.

'Fluksi' i këtyre kërkesave të prokurorit e për rrjedhojë edhe të vendimeve gjyqësore lidhur me lidhjen e martesës pa shpallje rezulton të jetë më së shumti gjatë muajit janar, ose më saktë, në ditët e para të fillim vitit. Këto vendime gati - gati përkojnë me datat e festave të zyrtare të caktuara, pikërisht atëherë kur emigrantët kthehen në atdhe për disa ditë pushime.

Përsërisim përmbajtjen e nenit 29 të KF: "Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur". Nëse lexojmë me kujdes dispozitën vëmë re se kërkohen shkaqe të një rëndësie të veçantë që të mund të shkelet rregulli i shpalljes publike të lidhjes së martesës. Ndërkohë në këtë kontekst vlen të përmendim edhe nenin 17 të KF në të cilin përcaktohet se "Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Në qoftë se shpallja ndërpritet përpara mbarimit të

këtij afati, ky fakt duhet të përmendet në shpalljen e re".

Në një rast të tillë, pra të lidhjes së martesës pa shpallje, përpara se bashkëshortët ti drejtohen nëpunësit të gjendjes civile, ata duhet ti drejtohen prokurorit që të bëjë vlerësimin nëse shkaqet janë të justifikuara me rolin e tij si institucion dhe mandej ky i fundit ti drejtohet [ose jo] gjykatës. Pra, dy filtra të fortë për të vendosur lidhjen e martesës pa shpallje. Kjo do të thotë që rastet duhet te kenë disa kritere që të klasifikohen si të rëndësishme nga ana e autoriteteve

Për këtë, është shumë e rëndësishme që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë në kërkesën paraqitur prokurorit dhe përpara gjykatës se plotësojnë kushtet dhe nuk kanë asnjë nga pengesat e parashikuara nga KF lidhur me lidhjen e martesës. Gjykata duhet të kërkojë detyrimisht një deklarim të tillë nga bashkëshortët e ardhshëm sepse duke lidhur martesën pa shpallje, cenohet e drejta e kundërshtimit të martesës sipas analizës që paraqitëm më sipër. Veç kësaj, duke qenë se prokurori është një nga subjektet që legjitimohet për kundërshtimin, duke bërë kërkesën për lidhjen e martesës pa shpallje, nënkupton, sipas ligjit që ka bindjen e plotë se nuk ka shkaqe kundërshtimi e për rrjedhojë pavlefshmërie për këtë martesë.

Qëllimi i shpalljes është që duke bërë publike lidhjen e martesës, të mundësojë monitorimin e rregullsisë së saj, goditjen e saj nga të tretët, nga ata që legjitimohen si kundërshtues të lidhjes së martesës sipas dispozitave të KF. Është shumë e rëndësishme që, në rastet kur martesa lidhet pa shpallje, dhe nuk ka mundësi për instrumentin e kundërshtimit, në aktin e deklarimit bërë prej bashkëshortëve, duhet të nënvizohen ato shkaqe që e pengojnë martesën duke vërtetuar ata vetë se, në rastin e tyre, pengesa të tilla që e bëjnë një martesë të kundërshtueshme, nuk ekzistojnë.

Nuk rezulton një deklaratë e tillë, depozituar në dosjen gjyqësore në martesat e lejuara që të lidhen pa shpallje, sikurse edhe në dosjet e prokurorisë të analizuara. Nënvizojmë në mënyrë të përsëritur se, në rastin e lidhjes së martesës pa respektuar shpalljen, prokuroria dhe gjykata duhet të bëjë kujdes në marrjen e këtij konfirmimi apo deklarimi solemn nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.

Sipas Vendimit nr.6/06.01.2010 të GjRrGj Shkodër gjejmë këtë arsyetim: "Duke qenë se shtetasi E.K, është me vendqëndrim (për arsye pune) në shtetin italian, ai nuk ka mundësi për të qëndruar në Shqipëri deri në përfundim të afatit 10 ditor të shpalljes së martesës, me qëllim që pas këtij afati ai të lidhë këtë martesë me shtetasen V.A. Për këtë arsye ai në bazë të nenit 29 të K.F ka paraqitur kërkesë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me qëllim që kjo e fundit t'i drejtohet Gjykatës, për të lejuar lidhjen e martesës përpara afatit 10 ditor të shpalljes të përcaktuar në ligj".

Çfarë ka kërkuar prokurori? Të mos shpallet publikisht martesa apo të lidhet përpara 10 ditëve? Siç vihet re nga fragmenti kopjuar sikurse ndodhet në vendim, prokurori kërkon që të shkurtohet afati 10 ditor, dhe nuk ka asnjë

shqetësim për shpalljen si të tillë. Kjo nuk parashikohet në ligj dhe në këtë rast prokuroria dhe gjykata nuk kanë respektuar KF. Dispozita të tilla, derisa gjenden në përmbajtjen e KF, dhe këtu bëjmë parantezën që nuk janë vetëm në KF të RSH por edhe në legjislacione të familjes të vendeve të tjera, kanë një rëndësi të veçantë dhe impakt në kushtet substanciale të lidhjes së martesës ku përfshihet pëlqimi i lirë dhe publiciteti i lidhjes.

Për këtë fragment të vendimit të gjykatës, rezervojmë komentin se, siç parashikohet nga neni 29 i KF, kërkesa paraqitur prokurorit nuk ka të bëjë me shkeljen e afatit 10-ditor, por me lidhjen e martesës pa u shpallur. Shpallja është element i publicitetit të martesës që cenohet vetëm për shkaqe me rëndësi, të vlerësuara si të tilla nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Sa i përket raportit që ekziston midis shpalljes dhe lidhjes së martesës, ndajmë mendimin se ndërsa shpallja duhet të qëndrojë detyrimisht 10 ditë, martesa mund të lidhet nga e nesërmja e 10-ditëshit të shpalljes deri në një vit[68]. Enkas janë parashikuar të tilla afate, të gjera e jo të kufizuara, që sigurojnë mundësinë që individi që dëshiron të martohet, të gjejë kohën më të përshtatshme, të vejë e të vijë disa herë nga jashtë shtetit, por edhe t'u japë kohë përgatitjeve personale për lidhjen e martesës. Kështu që, kur prokurori vlerëson se martesa mund të lidhet pa u shpallur dhe këtë ia kalon gjykatës për ta çmuar, do të thotë se nuk është çështje afati, por çështje e një rëndësie të veçantë që duhet të mbrojë njërin ose të dy bashkëshortët nga bërja publike e lidhjes së martesës. Pra, ka një interes të fortë publik dhe privat, që prevalon mbi efektet e shpalljes së martesës dhe mbi të drejtën e atyre që mund të kundërshtojnë lidhjen e kësaj martese.

Raste të tilla duhet të mos pranohen nga gjykata si shkaqe me rëndësi për lidhjen e martesës pa shpallje, aq më shumë për shkeljen e afatit 10-ditor të shpalljes.

Vazhdojmë me analizën e vendimit nr.6/06.01.2010 të GjRrGj Shkodër[69]: "Organi i Prokurorisë e ka vlerësuar si të drejtë kërkesën në fjalë [pra për të lidhur martesë përpara 10 ditëve –shpjegimi ynë] dhe më pas ka paraqitur në Gjykatë kërkesën për gjykim. Së bashku me të, Prokuroria ka paraqitur si prova shkresore biletën e udhëtimit të shtetasit E.K në shtetin italian (që provon se ai nuk mund të qëndrojë në Shqipëri deri në mbarim të afatit të shpalljes), certifikatat e lindjes së shtetasve E.K dhe V.A, (nga të cilat vërtetohet se ata e kanë mbushur moshën e caktuar me ligj për t'u martuar), *si dhe aktin e shpalljes së afishuar në Zyrën e Gjendjes Civile Bajzë*. Gjykata, pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, krijon bindjen se kërkesa në gjykim duhet pranuar. Kjo pasi, sipas nenit 29 të Kodit të Familjes, "*Gjykata për arsye të veçanta mund të lejojë lidhjen e martesës përpara*

[68] Sipas nenit 18 të KF: Në qoftë se lidhja e martesës nuk është bërë brenda 1 viti nga shpallja, martesa nuk mund të lidhet pa u bërë shpallja e re e parashikuar në dispozitat për shpalljen e martesës

[69] Duhet theksuar se vendime me përmbajtje të tilla janë tipike. Në këtë analizë duke u ndalur tek një vendim synojmë të bëjmë komente për mënyrën më të drejtë të zbatimit të ligjit.

afatit 10-ditor të shpalljes".

Vëmë re se në këtë vendim neni 29 KF jo vetëm është kuptuar gabim por edhe është shkruar në mënyrë të gabuar, nuk është kopjuar sipas dispozitave të KF, por është krijuar nga gjykata [?!]. Citimi nga ana e gjykatës i nenit 29 i KF siç gjendet në përmbajtjen e vendimit, është bërë në mënyrë jo të saktë. Nuk është kjo përmbajtja e këtij neni!

Për qartësim të lexuesit!

Po citojmë edhe një herë nenin 29 të KF siç gjendet në këtë Kod: "*Me kërkesë të prokurorit të vendit ku lidhet martesa e bashkëshortëve të ardhshëm, gjykata, për shkaqe me rëndësi, mund të vendosë që martesa të lidhet edhe pa u shpallur*".

Po citojmë nenin 29 të KF sipas tekstit të vendimit të gjykatës:

"*Gjykata për arsye të veçanta mund të lejojë lidhjen e martesës përpara afatit 10 ditor të shpalljes*".

Mungesa e seriozitetit të institucioneve të drejtësisë dhe e zbatimit të dispozitave ligjore, mund të çojë deri edhe në raste diskriminimi gjinor.

Nga mënyra se si duhet kuptuar dispozita [neni 29 KF] kjo nuk ka të bëjë me lidhjen e martesës përpara afatit, por me mosshpalljen e saj publike. Arsyeja është sepse në shpallje vendosen të dhëna mbi identitetin, vendbanimin e vendqëndrimin, profesionet e palëve dhe këto bëhen publike, ndërkohë që interesi e kërkon, që për shkaqe me rëndësi të mos bëhen të tilla. Veç kësaj, siç del nga përmbajta e këtij vendimi që kemi cituar [vendimit nr.6/06.01.2010 të GjRrGj Shkodër], martesa është shpallur, pra prokurori nuk ka vepruar për të eliminuar procedurën e shpalljes, por për të shkurtuar afatin e saj. Vetë vendimi nënvizon se në dokumentet e paraqitura gjykatës është "*akti i shpalljes së afishuar në Zyrën e Gjendjes Civile Bajzë*". Në këtë mënyrë, siç vihet re nga rasti që përdorëm për ilustrim, investimi i prokurorit është bërë jo për 'shkaqe me rëndësi' siç ligji e kërkon, dhe jo për të shmangur shpalljen e martesës, por vetëm për shpejtësi. Prokurori nuk ka vepruar sipas ligjit dhe gjykata ka arsyetuar në mënyrë të gabuar.

Arsyeja e veçantë [?!]

Vijojmë me pjesën tjetër të vendimit nr.6/06.01.2010 të GjRrGj Shkodër: "*Në rastin në gjykim, Gjykata vlerëson se arsyeja për të cilën shtetasi E.K nuk mund të qëndrojë në Shqipëri deri në mbarimin e afatit të shpalljes, <u>është e veçantë</u>. Kjo pasi sipas tij ai nuk ka leje nga punëdhënësi i tij në shtetin italian për të qëndruar në Shqipëri deri në mbarim të këtij afati. Duke pasur në vëmendje sa më sipër Gjykata e gjen kërkesën në gjykim të bazuar në ligj dhe në prova dhe për rrjedhojë vlerëson se duhet ta pranojë*"[70]. Arsyeja e konsideruar si e veçantë në këtë vendim, por edhe në vendime të tjera të marra në analizë, e ul vlerën e raportit të interesit publik dhe përligjjes së arsyeshme që duhet të vërë në lëvizje prokurorin dhe gjykatën në rastin e mos shpalljes së martesës duke ulur deri në ekstrem qëllimin e ligjit kur përdor shprehjen 'shkaqe me rëndësi'.

[70] Vendimi nr.6/06.01.2010 i GjRrGj Shkodër; vendimi nr.9/06.01.2009.

Edhe një herë, duke dashur të tërheqim vëmendjen e gjykatës, në interes dhe mbrojtje të veçantë të martesës dhe familjes nënvizojmë se afati i shpalljes është 'jo më pak se 10 ditë'. Martesa nuk mund të lidhet për efekt të kësaj shpalljeje nëse ka kaluar 1 vit. Ky afat optimal i legjislatorit, krijon të gjitha mundësitë për të respektuar standardet formale të lidhjes së martesës. E drejta e prokurorit për të shmangur shpalljen duhet të lidhet me një interes të fortë publik që synon mbrojtjen dhe sigurinë e bashkëshortëve në rrethana kur publiciteti i martesës dekonspiron ata dhe vë në rrezik jetën e tyre. Edhe raste të tilla mund të ekzistojnë, por pa dyshim që numri i tyre është i kufizuar dhe për rrjedhojë edhe roli i prokurorit.

Roli i prokurorit lidhur me kërkesën për pavlefshmërinë e martesës

Në aspekte të ndryshme të marrëdhënieve familjare vihet re vendi dhe roli i prokurorit. Jemi përpara situatave të rolit të prokurorit jashtë fushës mirëfilli penale[71].

Sipas nenit 42 të KF, martesa që nuk është lidhur publikisht dhe përpara nëpunësit të gjendjes civile është e pavlefshme. Kërkesa, për këtë situatë mund të bëhet edhe nga prokurori. Të drejtën për të kërkuar pavlefshmërinë absolute të martesës [përkatësisht sipas shkaqeve të neneve 36, 39, 40 dhe 41 të KF] e ka edhe prokurori. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës. Sipas KF, martesa quhet e zgjidhur kur ka një vendim të formës së prerë.

4. Mosha për martesë dhe martesat në moshë të mitur

Martesa e fëmijëve është një çështje që pozicionohet ndërmjet standardeve të barazisë gjinore dhe të drejtave të fëmijëve. Për këtë arsye, KF parashikon që "Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe".

Kështu, nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të lejojë lidhjen e martesës nëse nuk ka një vendim gjyqësor ku arsyetohet mbi shkaqet me rëndësi që e lejojnë këtë martesë.

Fenomeni i martesave të të miturve, është ndër çështjet e trajtuara më shpesh nga komitetet e KDF dhe CEDAW në vërejtjet përfundimtare në dialogun e tyre me shtetet palë të këtyre instrumenteve. Të dy komitetet përmes jurisprudencës së tyre lidhur me martesën e fëmijëve theksojnë tiparet plotësuese dhe reciprokisht përforcuese të të dy Konventave sa i përket moshës së martesës. Ndërsa KDF nuk ndalon posaçërisht martesën e fëmijëve, por në mënyrë të qartë përcakton moshën madhore si atë 18-vjeçare, CEDAW kategorikisht e konsideron martesën e fëmijëve të pavlefshme *ab initio*. Martesat në moshë të mitur efektojnë negativisht

[71] Council of Europe: European Court of Human Rights, *The role of public prosecutor outside the criminal law field in the case-law of the European Court of Human Rights*, March 2011, available at: http://www.refworld.org/docid/4ee1d8361a.html [aksesuar në 10 Dhjetor 2013]

në realizimin e të drejtave të tjera të kësaj grupmoshe, siç është e drejta për arsimim dhe kualifikim, etj.

Ndërsa shtetet kanë rendur drejt anulimit të ligjeve dhe rregullave ekzistuese për të siguruar unifikimin e moshës për martesë për të dy gjinitë, ende mbetet një sfidë hedhja poshtë e zakoneve dhe praktikave që diskriminojnë dhe shkaktojnë dëm ndaj vajzës duke e nxitur lidhjen e martesës nën moshë.

Kur burrat e gratë martohen, ata marrin përsipër përgjegjësi të rëndësishme. Për pasojë, si rregull, martesa nuk duhet lejuar përpara se individi të kenë arritur pjekurinë e plotë dhe zotësinë për të vepruar. Sipas OBSH [Organizatës Botërore të Shëndetësisë] kur të miturit, sidomos vajzat, martohen dhe kanë fëmijë, shëndeti i tyre mund të ndikohet për keq dhe shkollimi i tyre të pengohet. Si rezultat, autonomia e tyre ekonomike kufizohet. Veç kësaj, martesat nën moshë, jo vetëm ndikojnë tek gratë personalisht por edhe kufizojnë zhvillimin e shprehive dhe pavarësisë së tyre si dhe pakësojnë mundësitë për punësim, duke ndikuar kështu për keq në familjet dhe bashkësitë e tyre. Këto konsiderata duhet të jenë në vëmendjen e gjykatës kur gjykata ushtron diskrecionin e saj dhe 'lejon lidhjen e martesës nën moshë' për shkaqe me rëndësi. Shpesh herë në këto vendime kemi gjetur si argument 'fejesën' e vajzës që siç e thamë më lart është gabim të pranohet nga gjykata se nuk është institut ligjor. Në shumicën dërrmuese njohja e çiftit është bërë me mblesë apo me shkesë [??!!]. Pa dyshim që ndërmarrje të tilla janë në kundërshtim me dispozitat e KF lidhur me lirinë e pëlqimit dhe lirinë e zgjedhjes së partnerit si dhe me instrumente të tjerë ndërkombëtarë.

Thuajse në të gjitha rastet e paraqitura në gjykatat shqiptare, janë vajzat ato që kërkojnë lidhjen e martesës nën moshë. Pra barazimi i moshës për martesë për shkak të gjinisë sipas ligjit, e ka gjetur mënyrën e anashkalimit përmes vendimeve gjyqësore.

Përcaktimi aktual i moshës për lidhjen e martesës dhe ndryshimi në kohë të ndryshme lidhur me të në legjislacionin shqiptar, është produkt i studimit të vlerës sociale e juridike të martesës në një plan të gjerë.

Në çdo kohë ka pasur një moshë "kufi" tej minimumit të së cilës lidhja e martesës ka qenë e ndaluar[72]. Kjo ka qenë e ndryshme në kohë dhe vende të ndryshme. Argumentet e përdorura në përcaktimin e një moshe fillimisht bazoheshin në arritjen e pubertetit që nënkupton pjekurinë seksuale të individit. Në një rast të tillë, qëllimi kryesor i martesës është lindja e fëmijëve dhe marrëdhëniet seksuale të

[72] Përgjithësisht faktori dhe kushti "moshë" ka ngjallur shumë interes në rastin e institutit të martesë. Ndër pyetjet më të shpeshta që bëhen sa herë që konkludojmë në një martesë të suksesshme ose jo, janë të tilla si: "në çfarë moshë keni marrë vendimin për të lidhur martesë?"; "Sa diferencë moshe keni me bashkëshortin/en?" ose "Sa vite keni që jeni martuar", "Ç'moshë kishit kur patët fëmijën e parë"? etj. Vërtet rasti rastit nuk i ngjan por mosha është tregues i maturisë që në rastin e martesës kërkon që të jetë sa më e arrirë.

qëndrueshme. Sot mosha e lejuar për martesë nuk është e lidhur me pubertetin. Përcaktimi i moshës minimum reflekton kujdesin ndaj fëmijëve, kujdesin ndaj institutit të familjes dhe martesës dhe pa dyshim mbrojtjen e gruas nga diskriminimi. Kështu, mosha lidhet me pjekurinë psikologjike, emocionale, zotësinë e plotë për të vepruar, për të marrë përsipër përgjegjësitë e jetës familjare dhe të fëmijëve. Pa dyshim që edhe pjekuria seksuale ka rëndësinë e vet.

Ndërsa mosha e lejuar për martesë ka ardhur drejt rritjes, mbijetuan për një periudhë më të gjatë diferencimet në përcaktimin e kësaj moshe të lejueshme midis femrave dhe meshkujve. Përgjithësisht për femrat mosha e lejuar për martesë ka qenë më e ulët se sa për meshkujt. Sot, në këtë drejtim konstatohet se po mbizotërojnë parimet e barazisë gjinore. Unifikimi ose prirja drejt unifikimit të moshës së lejuar për martesë për të dyja gjinitë është fenomen masiv i legjislacioneve në stadin aktual, përfshi këtu edhe vendin tonë nga viti 2003 [KF].

Mosha për martesë është e lidhur me 'daljen nga fëmijëria' dhe për rrjedhojë nga ato që konsiderohen 'të drejta të fëmijës'. Kjo nënkupton se këto të drejta janë realizuar. Ndaj thërritet kontrolli gjyqësor lidhur me lejimin e martesës nën moshë.

Duke qenë një kusht thelbësor për lidhjen e martesës, martesa e lidhur nga persona që nuk kanë mbushur moshën e lejuar, është e pavlefshme *ab initio* duke e renditur moshën ndër shkaqet e pavlefshmërisë absolut të martesës.

Përgjithësisht, paralel me përcaktimin e moshës minimum, ka qenë "klauzola" *e mundësisë* që u jepet bashkëshortëve të ardhshëm që "ta devijojnë" këtë kusht. Vetëm dëshira për të lidhur martesë nën moshë, nuk mjafton për ta realizuar këtë. Vetëm një autoritet i njohur nga ligji siç është gjykata, nëse gjatë procesit të hetimit gjyqësor verifikon se ka "shkaqe me rëndësi" *mund* të lejojë ose autorizojë lidhjen e martesës nën moshë. Në kontekstin e legjislacionit aktual familjar shqiptar, ky autoritet është gjykata e vendit ku lidhet martesa.

Martesa është një akt juridik. Si e tillë, që akti të jetë i vlefshëm kërkohet plotësimi i disa "parametrave/standardeve", arsyeja e qëndrimit të të cilave në legjislacion nuk është spontane apo një kapriçio. Martesa si akt juridik ka karakter tipik dhe solemn. Tipik, sepse për të gjithë ata që duan të martohen kërkohet që të përmbushin disa kushte thelbësore të zotësisë për martesë dhe të formës. Solemn, sepse mund të lidhet vetëm nëse respektohet forma e kërkuar prej ligjit. Martesa është një akt juridik personal (sepse nuk lejon përfaqësim), përmes së cilës një burrë e një grua marrin përsipër detyrime reciproke. Këto jo gjithnjë janë të qarta për ata që kërkojnë të lidhin martesë nën moshë. Normat në lidhje me martesën si akt duket se kanë karakter urdhërues, përndryshe martesa goditet për pavlefshmëri.

Martesa të jep një status dhe ky status ka interes për individin dhe

shoqërinë në tërësi.

Për gjykatën është shumë e rëndësishme që të marrë në konsideratë të gjithë këta elementë duke i qasur me çiftin konkret që kërkon të lidhë martesë nën moshë.

Nuk mungojnë vendime ku dalin në pah dy rreziqe të pëlqimit të lirë: edhe mosha e mitur, edhe bërja fakt e lidhjes në çift nga ana e familjarëve. Sa më e vogël mosha, aq më e kufizuar autonomia për të vendosur dhe aq më i mundshëm imponimi apo detyrimi për martesë.

Kështu, nga Vendimi nr.88/18.01.2011 i GjRrGj Shkodër, marrim dijeni se shtetasja V.B. ka bërë një kërkesë për lejimin e martesës nën moshë me shtetasin Sh.Bi. Siç shkruhet në vendim: "Nga aktet e shqyrtuara në këtë gjykim rezultoi e provuar se VB ka lindur me datë 19.03.1995, në qytetin Shkodër. Që në vitet e para të fëmijërisë së saj prindërit saj kanë zgjidhur martesën, dhe në bazë të vendimit për zgjidhjen e martesës, e mitura i është lënë për rritje dhe edukim nënës së saj, e cila më vonë është rimartuar. Të miturën, me pëlqimin e dy prindërve biologjikë, e kanë rritur gjyshërit nga nëna. Që në moshë shumë të vogël, e mitura së bashku me gjyshërit e saj ka emigruar në shtetin grek, ku dhe janë vendosur për shumë vite me radhë. Si gjyshërit rritës të kësaj të miture, ata, në vitin 2008, kanë dhënë pëlqimin për fejesën e mbesës së tyre, vullnet, i cili u shpreh dhe nga deklarimet e vetë gjyshërve në seancë gjyqësore të pyetur me cilësinë e dëshmitarëve. Ky vullnet i tyre ishte kushtëzuar nga dëshira që ata kishin që *ta martonin vetë ata mbesën e tyre*, duke qenë se i pëlqente familja e cila e kishte kërkuar për nuse të miturën dhe vetë djali, të cilët ishin dhe ata në emigrim, në shtetin grek. Gjithashtu ata donin të ndiqnin traditën e tyre, si anëtarë të komunitetit egjiptian, që fëmijët të martoheshin herët. Kërkuesja është e mitur, ka dhe pak më tepër se dy vite për të mbushur moshën e lejuar nga ligji, Kodi i Familjes, neni 7 i tij. Megjithatë i është drejtuar kësaj gjykate, që të mundësojë lidhjen e martesës civile me shtetasin Sh.B, pasi nga lidhja joformale me të, ajo kishte dhe një fëmijë, i cili ka lindur në shtetin grek në maj të vitit 2008".

Në këtë studim kemi sjellë në vëmendje se çfarë pasojash negative sjell një martesë e lidhur nën moshë, të tilla si: shëndeti i nënës, shëndeti i fëmijës, rreziku i cenimit të të drejtave të nënës lidhur me edukimin dhe arsimimin e saj sepse ende është në moshën e përfitimit të këtyre dijeve; martesa e parakohshme rrezikon të jetë më e brishtë se martesa e lidhur në moshën madhore e për rrjedhojë të çojë në zgjidhjen e martesës më shumë se në raste të tjera; rreziqe për të jetuar më shumë me dhunën e keqtrajtimin, varësia ekonomike, etj.

Është detyrë e gjykatës që të verifikojë në disa drejtime statusin e vajzës që kërkon të lidhë martesë nën moshë dhe të japë një vendim të arsyetuar me kujdes duke e parë mundësinë ligjore për të lidhur martesë

nën moshë kundrejt parimeve të interesit më të lartë të fëmijës që kërkon të lidhë një martesë të tillë.

4.1 Roli i gjykatës në lejimin e martesës nën moshë

Në rolin e vet gjykata duhet të kontrollojë dhe të mbrojë martesën si institut dhe të drejtat e fëmijës që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Sipas Kushtetutës së RSH dhe dispozitave të KF, edhe martesa edhe fëmijët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti.

Gjykata që lejon martesën nën moshë ndërsa "ndërhyn" në realizimin e aktit të martesës, nuk mund të jetë aq sipërfaqësore sa të mos shohë përtej aktit. Garantimi i martesës si institut është detyrë e rëndësishme që ligji në këtë situatë ia ka deleguar gjykatës e cila jep lejen mbi bazën e një analize të tërësore të shkaqeve me rëndësi. Parimi më i rëndësishëm që duhet të mbahet nën kontroll është *autonomia e vullnetit të palëve ose më saktë e të miturit/ës që kërkon leje për lidhjen e martesës nën moshë.*

Martesa si akt lidhet ngushtë me lirinë e vullnetit të bashkëshortëve që shprehet në manifestimin e vullnetit, pra të konsensusit. Edhe nëse ky verifikim i pëlqimit bëhet dhe shprehet përpara nëpunësit të gjendjes civile, në rastin e lejimit të martesës nën moshë duhet të jetë i qartë edhe për gjykatën e cila do të japë "lejen" për ta lidhur këtë martesë nën moshë. Qëllimi i martesës si akt është krijimi i marrëdhënieve martesore e për rrjedhojë realizimi i të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa.

Tabela nr. 1

Listë kontrolli për gjykatën në rastet e kërkesës për lejimin e martesës nën moshë

Çfarë duhet të verifikojë gjykata	**Çfarë kuptojmë me këtë aspekt**
Pjekurinë fiziko-psikike të personit nën moshën 18 vjeç që bën kërkesë për lidhje martese nën moshë. A është fizikisht dhe psiqikisht i aftë personi për të lidhur martesë nën moshë?	Pjekuria psikike përfshin qartësinë e kërkuesit/es lidhur me rëndësinë e martesës në tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin. Pjekuria psikike duhet konstatuar prej veprimeve të subjekteve dhe jo thjesht prej deklarimeve të tyre. Gjykata në këtë vendimmarrje duhet të mbrojë dy institute: miturinë dhe martesën. Duke qenë se nga martesa lindin të drejta, detyrime e përgjegjësi, gjykata duhet të vlerësojë se sa në harmoni është personi me pjekurinë e vet kundrejt këtyre të drejtave dhe detyrimeve që imponon martesa.

	Pyetje të tilla si: A keni ndikime apo presion të familjes/shoqërisë/të afërmve/opinionit në nxitjen e lidhjes së martesës nën moshë? A jeni i/e lirë nga pikëpamja psikike që po kërkoni të lidhni martesë nën moshë? A është e qartë për ju se çfarë do të thotë të lidhësh martesë? Çfarë nguti/nxitimi keni në lidhjen e martesës përpara moshës? Çfarë pasojash pozitive prisni të vijnë nga lidhja e martesës nën moshë? A shikoni ndonjë pasojë negative në lidhjen e martesës nën moshë? Si mund të ndikojë martesa në realizimin e nevojës/dëshirave tuaja për arsimim, kualifikim, etj? Si kuptohen nga ana e juaj përgjegjësitë dhe të drejtat në aspekte të ndryshme të jetës familjare? A jeni të kënaqur nga kjo marrëdhënie dhe sa është kohëzgjatja e saj përpara kërkesës? Mendoni që është një lidhje e konsoliduar, serioze? A është i lumtur partneri për ardhjen e fëmijës? A jeni frikësuar ndonjëherë nga partneri juaj apo të tjerë anëtarë të familjes? A ka qenë ai/ajo ndonjëherë abuziv me ju? A ju ka kërcënuar dikush për të lidhur këtë martesë? A jeni detyruar për të kryer marrëdhënie seksuale? A keni bërë ndonjë përpjekje për ndërprerje shtatzënie? Kuptohet që lista e pyetjeve drejtuar personit mund të jetë e gjatë. Dedikimi në këtë proces është kontribut për mbrojtjen e të miturit dhe të martesës!
Rëndësinë e motivit/shkakut të pretenduar dhe që shoqëron kërkesën për lejimin e lidhjes së martesës nën moshë.	Motivi duhet trajtuar në raport me atë se çfarë i shtyn subjektet të kërkojnë lejen e gjykatës për lidhjen e martesës përpara kohe. Duhet të ketë arsye të mira për të lidhur këtë martesë dhe martesa nuk mund të lidhet me detyrim. Vlerësimi i rëndësisë së shkakut kërkon një analizë edhe të përgjithshme, edhe të përveçme, duke e lidhur këtë shkak të paraqitur si të rëndësishëm për rastin konkret. Arsye të mira mund të jenë ato që lidhen me dashurinë e vërtetë në çift, shtatzëninë ose ardhjen në jetë të fëmijës, bashkëjetesës si një etape që ka treguar marrëdhënie të qëndrueshme etj. Gjithsesi këto janë indikative dhe nuk kanë karakter absolut në çdo rast.

	Kujdes, prindërit që detyrojnë fëmijët të lidhin martesë nën moshë e justifikojnë këtë si mënyrë për të mbrojtur fëmijët e tyre nga rreziqet që shfaqen në një shoqëri liberale ku partnerët mund të ndërrohen pa problem. Gjithashtu, kjo shihet si një mënyrë për të ndërtuar familje të fortë dhe për të mbrojtur traditën kulturore ose të besimit. Në raste të tilla prindërit nuk shohin ndonjë gjë të keqe në veprimet e tyre ndaj gjykata duhet të hulumtojë në këto motive. Disa nga motivet mund të lidhen me: kontrollin mbi sjelljet seksuale të padëshiruara për familjen; kontrollin mbi sjellje të padëshiruara që lidhen me përdorimin e drogës apo alkoolit; të kontrollojnë shoqërimin me individë të padëshiruar; kontrollin mbi shoqërimin dhe marrëdhëniet me individë të racave, etnive e besimeve të tjera; mbrojtja e nderit të familjes; interesin që të forcohen lidhje me familje të caktuara; me qëllime për të përmirësuar gjendjen ekonomike; për të përfituar pasuri e prona e që këto të mbeten brenda familjes; për të patur një krah pune e shërbimesh më shumë në familje. Për të gjitha këto motive, ka një pyetje sqaruese nga ana e gjykatës.
Bazueshmërinë e motivit.	Është ky një motiv fiktiv apo real. Nëse është real sa i bazuar është për të bërë një kërkesë në shkelje të rregullit të përgjithshëm të moshës. Arsyet duhet të jepen qartë. Ato duhet të jenë konkrete e reale. Pas shkaqeve që justifikohen si të rëndësishme mund të qëndrojnë të tjera që mund të sjellin rrezik për të miturin/ën dhe martesën. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në rastet kur martesa mund të jetë mbulesë për të lëvizur e mitura jashtë shtetit, për sigurim dokumentacioni a privilegjesh në një shtet tjetër, etj. Pyetje të tilla mund të ndihmojnë: si shkojnë marrëdhëniet në shtëpi, a ka një klimë të mirëkuptimit me prindërit? Është vërtet shtatzënia shkaku kryesor për lidhjen e martesës? Nëse fëmija ka lindur, a është njohur atësia? Midis dashurisë dhe interesit të fëmijës që po vjen në jetë, si do të vlerësohej raporti kundrejt lidhjes së martesës? Pra lidhet martesa më shumë për t'u mbrojtur nga turpi apo ka të gjitha arsyet për të qenë solide?

	Rast pas rasti gjykata mund të operojë me pyetje të ndryshme të cilat çojnë në zbulimin e fiktivitetit ose jo të motivit.
Marrja e mendimit të psikologut lidhur me anën psikologjike, pëlqimin e lirë dhe situatën sociale	Është një ndihmesë e madhe për gjykatën që të japë një vendim të drejtë dhe të gjykojë mbi rëndësinë e shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre duke e bërë këtë verifikim edhe përmes psikologut. Gjykata edhe në gjykime të tilla duhet të respektojë parimin e nenit 6 të Kodit të Familjes dhe të KDF sipas të cilit: "Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën sociale". Gjykata duhet të monitorojë me kujdes 'pëlqimin e lirë'. Gjykata duhet të orientojë psikologun që të përqendrojë raportin e vet në këto çështje. Gjykata mund të parashikojë seancë dëgjimi veçmas të të miturit, kjo në analogji edhe me nenin 126,134, të KF për rastet e zgjidhjes së martesës. Veç kësaj, të dëgjuarit e fëmijës vetëm, pa praninë e prindërve apo të përfaqësuesve, e sjell komunikimin në një hapësirë me të hapur e demokratike për mbrojtjen e interesit të të miturit.
Interesi më i mirë i kërkuesit/es duhet të pasqyrohet në arsyetimin e vendimit	Gjykata duhet të arsyetojë se dhënia ose mosdhënia e këtij vendimi është në interesin me të mirë të palëve apo të kërkuesit/es që synojnë të lidhin martesë nën moshë. Arsyetimi i vendimit duhet të kalojë në linjën e gjithë analizës mbi shkaqet, motivet, pjekurinë, mendimin e psikologut, etj. të cilat bëhen pjesë e shqyrtimit gjyqësor. A ka i mituri pjekurinë fizike e psikike për të filluar një jetë të re, juridikisht autonome dhe të marrë përsipër përgjegjësitë e jetës në martesë sipas detyrimeve që burojnë nga martesa? A i ka të qarta të drejtat që burojnë nga martesa? A i ka i mituri të gjitha mjetet në dispozicion, fjala vjen mundësitë ekonomike, të strehimit, edukimit etj. për të filluar një jetë të re? Si do të mbështetet familja e re?

Në lidhje me martesën nën moshë, mbi autonominë e bashkëshortëve *ka një tutelë të fortë* e cila bëhet vetëm me qëllim *dhe në dobi të mbrojtjes së institutit të martesës dhe të pastërtisë të lirisë së shprehjes së vullnetit dhe konsensusit* për martesë nga ana e të miturit.

Duke qenë se nga martesa burri dhe gruaja kanë **të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime**, kanë detyrimin reciprok për besnikëri, për ndihme morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës (neni 50 KF), me të drejtë gjykata mund të mos e lejojë lidhjen e martesës nën moshë kur këto nuk janë të qarta për kërkuesit kuptohet, përveç rasteve kur dyshon për një pëlqim jo të lirë.

KF nuk përcakton moshën minimum brenda të cilës gjykata mund të lejojë lidhjen e martesës.

Kujdes! Sipas Kodit Penal, (neni 100): "Marrëdhëniet seksuale me të miturën që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, ose që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohen me burgim....".

Martesa është një akt shumë i rëndësishëm në jetën e njeriut dhe që kërkon detyrimisht një pjekuri fizike dhe intelektuale (psikike) të mjaftueshme për të marrë përsipër detyra, të drejta dhe përgjegjësi, jo vetëm dhe thjesht emocionalisht, por, në thelb, realisht. Në përcaktimin e kësaj moshe ligjvënësi shqiptar ka pasur parasysh: KDF, CEDAW dhe KEDNJ-në[73].

Le të analizojmë kuptimin e "shkaqeve me rëndësi". Kjo është një veprimtari që çmohet rast pas rasti prej gjykatës në bazë bindjes së krijuar prej provave dhe argumenteve të paraqitur prej atyre që e pretendojnë lejen. Një situatë e tillë mund të ishte shtatzënia e gruas, lindja e fëmijës, bashkëjetesa e qëndrueshme. Por mund të ndodhë që edhe këto të mos konsiderohen 'shkaqe me rëndësi', nëse nuk vërtetohen elemente të caktuara që duhet të mbartin subjektet që kërkojnë me "sforco" të lidhin këtë martesë. Edhe në rastin e shtatzënisë së hershme të një të miture e cila kërkon leje për lidhjen e martesës (veprim ky që nëse konkludohet me lejimin e lidhjes së martesës dhe celebrimin e saj e "emancipon" të miturën), është shumë e rëndësishme që gjykata të vendosë në balancë interesat e dy "të miturve", fëmijës-nënë dhe fëmijës-fëmijë në barkun e nënës së mitur ose të sapolindur prej saj.

Kur kjo kërkesë vjen nga një i/e mitur nën moshën 18 vjeç, gjykata, duhet të marrë në konsideratë disa parime të përgjithshme. Një moment i rëndësishëm është arritja e pjekurisë psikiko-fizike. Nuk janë të rralla rastet që nën 18 vjeçarët të kenë arritur ndonjëherë një pjekuri dhe përgjegjshmëri shumë më të madhe se 18 vjeçarët. Kjo varet rast pas rasti. Parime të tjera të rëndësishme janë ai i interesit më të lartë të fëmijës, detyrimin kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e familjes dhe të martesës, respektimin e lirisë së plotë të vullnetit në rastin e një martese që në këtë moshë, në shumicën e rasteve, kërkohet të lidhet jashtë normalitetit për

[73] Rezolutën e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr.(72)29, e cila propozon këtë moshë si kufirin e nisjes së jetës prej të rrituri.

shkak të mosdijes së rëndësisë së saj dhe të pasojave në të ardhmen, turpit të shtatzënisë, frikës, presionit, motiveve të tjera, etj. Kur këto parime janë cenuar ose vënë në rrezik, gjykata nuk mund ta lejojë atë martesë.

Në të vërtetë, rëndësia e motivit dhe bazueshmëria e tij e ndihmojnë gjyqtarin të konkludojë edhe për pjekurinë psikike që është një element thelbësor për vlerësimin e impenjimeve që do të marrë përsipër "i mituri" për shkak të martesës. Këto lloje kërkesash, pra, për të lejuar një martesë në moshë nën 18 vjeç, bëhen me qëllim për të riparuar ose për të "mbuluar" një sjellje të caktuar dhe për këtë arsye gjykata, gjatë hetimit gjyqësor, duke vërejtur këtë, ka më shumë prirje të verifikojë me kujdes e në mënyrë profesionale përpara se të lejojë ose mos e lejojë lidhjen e martesës. Kështu sikurse përmendëm më sipër mund të ndodhë që, ndonëse shtatzënia është një motiv i rëndësishëm dhe i bazueshëm, jo gjithnjë ajo është edhe e mjaftueshme për të lejuar lidhjen e martesës. Kjo sepse nuk shoqërohet me një aftësi të kuptimit të martesës si një detyrë për jetë të përbashkët me përgjegjësi dhe ndërgjegjësim, për ta zhvilluar atë në mënyrë të pavarur prej prindërve, sikur mund të mos shoqërohet me pëlqimin e lirë për martesë, por vetëm sa për të mbuluar problemin. Në këtë rast një leje e dhënë nga gjykata e barazon moshën për martesë vetëm me pjekurinë seksuale dhe jo si një faktor shumë kompleks i pjekurisë dhe zhvillimit të gjithanshëm të individit.

Pjesëza "mund" e përdorur pas "shkaqeve me rëndësi", pra, "gjykata e vendit ku lidhet martesa, për shkaqe me rëndësi, **mund** të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe" nuk është aspak paradoksale. Kjo shenjtëron rolin dhe përgjegjësinë e gjykatës. Ndërkohë mosha ecën sikurse koha. Dhe në një rast të tillë koha do të punojë në garantimin e plotë të autonomisë së palëve që maturohet (formohet psikologjikisht dhe fizikisht) bashkë me rritjen e tyre në moshë.

Në ç'mënyrë do të lejojë gjykata lidhjen e martesës përpara kësaj moshe? Si do të investohet gjykata dhe prej kujt, për të "lejuar shkeljen" e paragrafit 1 të nenit 7?

Kur një vajzë dhe një djalë duan të lidhin martesë ata i drejtohen me dokumentet përkatës nëpunësit të gjendjes civile. Është e kuptueshme që, në një situatë të tillë, e para pengesë që u shfaqet bashkëshortëve të ardhshëm është vetë nëpunësi i gjendjes civile, i cili, gjatë verifikimit të këtyre dokumenteve[74], pra të certifikatave të lindjes, mund të vërejë fare lehtë që gruaja (ose burri) nuk e ka arritur moshën e kërkuar nga ligji për martesë. Në këtë rast, me të drejtë, nëpunësi i gjendjes civile, edhe nëse kjo nuk është kundërshtuar nga të tjerë që ligji u njeh të drejtën e kundërshtimit ose kur këta kanë hequr dorë nga kundërshtimi, e refuzon lidhjen e martesës[75]. Është një shkak më se i përligjur. Ka raste që

[74] Shih formën e lidhjes së martesës, në nenin 19 të Kodit të Familjes: "personi që kërkon shpalljen e martesës, duhet t'i paraqesë nëpunësit të gjendjes civile certifikatat e lindjes së dy bashkëshortëve, si edhe çdo dokument tjetër që është i nevojshëm dhe provon se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës".

[75] Sipas nenit 32 të Kodit të Familjes, "Nëpunësi i gjendjes civile mund të refuzojë lidhjen e martesës vetëm për shkaqe të parashikuara në këtë Kod. Në këtë rast ai mund të lëshojë një akt ku

bashkëshortët e ardhshëm e dinë që do të hasin pengesa tek nëpunësi i gjendjes civile ndaj i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës.

Investimi i gjykatës në një situatë të tillë bëhet prej vetë të interesuarve, pra bashkëshortëve të ardhshëm, atij/asaj që kërkon të lidhë martesë nën moshë. Duke e trajtuar në mënyrë përjashtimore rastin e bashkëshortëve të ardhshëm nën moshë, nga situata e përgjithshme e moshës madhore, për t'u ligjësuar aktivisht, sipas Kodit të Procedurës Civile, ky qëndrim i ligjit dhe i praktikës gjyqësore është plotësisht i justifikuar nisur nga fakti që gjykata po disponon një situatë singulare (të veçantë, përjashtimore), ku bëhet fjalë për martesë, e cila duhet të ketë në thelbin e vet pëlqimin e lirë, i cili në këtë rast duhet që të verifikohet (sikur shumë elemente të tjera) prej gjykatës, e mandej edhe prej nëpunësit të gjendjes civile.

Qëllimi i këtij rregullimi shfaqet shumë koherent me konceptimin e martesës si *akt personal*[76], përmes së cilit bashkëshortët synojnë të krijojnë një bashkësi materiale e shpirtërore për gjithë jetën e tyre. Kjo është arsyeja që, nëse vëmë re me vëmendje filozofinë e Kodit të Familjes (shih p.sh. nenin 23), këtyre të miturve që ende nuk kanë zotësinë e plotë për të vepruar, u atribuohet e drejta e bërjes së kërkesës, duke përjashtuar prej këtij akti prindin ose kujdestarin, të cilët mund të dëgjohen prej gjyqtarit, ashtu sikurse duhet të dëgjohet edhe prokurori. Prindi që ka të drejtën e kundërshtimit të martesës, në këto kushte nuk mund të jetë ai që vepron dhe nuk mund të kërkojë leje për martesën e fëmijës me cilësinë e ushtruesit të përgjegjësisë prindërore.

4.2 Kufijtë e mundshëm të minimumit ligjor për të lejuar lidhjen e martesës në moshë

Mosha ligjore për martesë është një kusht i rëndësishëm me karakter të përgjithshëm dhe absolut për të pasur zotësi për martesë. Por, ndërsa Kodi vendos një kufi moshe për lidhjen e martesës (18 vjeç) dhe i njeh diskrecionin gjykatës që, për shkaqe me rëndësi, të lejojë lidhjen e martesës përpara kësaj moshe, nuk përcakton se deri ku do të shtrihet kjo tolerancë moshore "për shkaqe me rëndësi".

Martesat në moshë të hershme janë një problem global[77]. UNFPA në një raport mbi martesat në moshë shumë të re dhe dhënien fund këtyre, nënvizon se, nëse nuk merren masa për ndryshimin e gjendjes, vendet

---

të tregohen shkaqet e refuzimit.
Kundër aktit të refuzimit mund të bëhet ankim në gjykatë".

[76] Kjo është evidente në lidhjen e martesës si një akt ku duhet të jenë të pranishëm të dy bashkëshortët. Sipas nenit 47 të LGJC [2009, ndryshuar]: Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar: "1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt. 2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve…."

[77] UNFPA: "Marrying too young: end child marriage": https://www.unfpa.org/webdav/site/global/shared/documents/publications/2012/MarryingTooYoung.pdf

në zhvillim do të jenë dëshmitarë të një rritjeje të martesave në moshë të mitur. Priten rreth 142 milion martesa të të miturve për periudhën 2011-2020 dhe 151 milion në dekadën pasardhëse. Ndërsa numri i vajzave të mitura që lidhin martesë do të rritet, numri i fëmijëve që lindin fëmijë do të rritet dhe po kështu edhe vdekshmëria e vajzave.

Me të drejtë shtrohet pyetja: deri në çfarë moshe nën 18 vjeç gjykata mund të lejojë lidhjen e martesës? A është e lirë gjykata që, rast pas rasti, të lejojë martesë edhe në moshën 14-vjeçare a më shumë (por gjithnjë nën 18 vjeç)[78], me argumentin se nuk ka kufi të poshtëm që të kufizojë diskrecionin e gjykatës? "Liria" në këtë rast duhet të ketë një kufi. Kodi i Familjes nuk shprehet lidhur me minimumin e tolerueshëm për dhënien e lejes nga ana e gjykatës. Kjo, në praktikën gjyqësore mund të ketë çuar në ndonjë tepri të gjyqësorit.

Diskrecioni që ligji i njeh gjykatës në dhënien e lejes për lidhjen e martesës nën moshë, dhe mungesa në ligj e kufirit minimal të tolerueshëm, nuk duhen interpretuar deri në pasojat e tyre të skajshme aq sa të cenohen të drejtat e fëmijës sipas KDF dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. Kjo është shumë e rëndësishme që të mbahet parasysh sa herë disponohet me vendim për situata të tilla. Kjo do të thotë që ka një legjislacion tjetër i cili nuk lejon që të abuzohet pa masë lidhur me "boshllëkun" e krijuar nga KF. Në këtë rast një i tillë është legjislacioni penal. Kështu, ndonëse kriteri i moshës minimum brenda të cilat gjykata mund të disponojë me lejim, nuk është përvijuar nga legjislacioni familjar, kurrë nuk mund të jepet një vendim për lejim lidhje martesë të personit nën 14 vjeç. Edhe sikur të bëhet fjalë për një shkak "të super rëndësishëm" ose "të rëndësisë ekstreme". Sipas Kodit Penal, (neni 100): "Marrëdhëniet seksuale me të miturën që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç, ose që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohen me burgim....". Martesa nënkupton marrëdhëniet seksuale dhe jo të ashtuquajturën "martesë të bardhë" derisa gruaja të mbushë moshën. Në këtë rast dispozita e Kodit Penal, ndonëse nuk e përmend pëlqimin e së miturës, nënkupton se edhe kur kjo marrëdhënie ka ndodhur me pëlqimin e saj, vepra penale është e konsumuar. Ndërkohë është shumë e rëndësishme që të verifikohet pjekuria seksuale edhe në rastin e personave mbi 14 vjeç, sepse nëse kjo nuk është arritur dhe kërkohet lidhja e martesës përsëri jemi përpara një vepre penale.

Martesa të tilla që dukej se ishin "të rralla", kohët e fundit nuk janë më të tilla. Kjo do të thotë se gjykata duhet të bëjë shumë kujdes para se të lejojë lidhjen e martesës nën moshën 16-vjeçare. Mendimi ynë do të ishte që gjykata të konsideronte të paktën këtë moshë (16 vjeç) si kufirin minimum të tolerueshëm në raste përjashtimore dhe kuptohet, për shkaqe me rëndësi. Studiuesit socialë nënvizojnë se sa më e parakohshme të jetë mosha e martesës së djalit apo vajzës, aq më e theksuar është prirja për ta zgjidhur atë[79].

[78] Shih Kodi Penal i R.SH seksionin VI "Krimet seksuale", nenet 100 e në vijim.

[79] Hamit Beqja & Lekë Sokoli: "Divorci. Vrojtime e refleksione". ShB "Dudaj" & "Rinia 2000". Fq 105.

OBSH në një raport për vitin 2012[80] nënvizon se çështjet e vdekshmërisë së nënës adoleshente dhe të sëmundjeve të tyre konsiderohen çështje të shëndetit publik dhe janë një problem global. Adoleshentet që janë 15-19 vjeç janë dy herë më shumë të rrezikuar nga vdekshmëria gjatë shtatzënisë ose lindjes në krahasim me femrat mbi 20 vjeç; adoleshentet nën 15 vjeç janë pesë herë më shumë të rrezikuara nga vdekshmëria gjatë shtatzënisë ose lindjes së fëmijës. Po kështu, rreziqet shëndetësore të fëmijëve të lindur nga nëna adoleshente dhe vdekshmëria foshnjore është edhe më e lartë mes fëmijëve të lindur nga nënat adoleshente.

OBSH ka publikuar udhëzime lidhur me parandalimin e shtatzënisë së hershme në vendet me nivel ekonomik të ulët dhe mesatar. Ky udhëzues i përgatitur në bashkëpunim me Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), është bazuar në një rishikim sistematik të hulumtimeve ekzistuese, si dhe konsultimeve me hartuesit e politikave, drejtuesit e programeve dhe ekspertët e fushës së shëndetësisë. Këto udhëzime përmbajnë rekomandime të bazuara në veprimet që vendet mund të ndërmarrin, duke synuar gjashtë objektiva kryesore të tilla si: reduktimi i martesave nën moshën 18 vjeç; të mundësohet të kuptuarit drejt dhe sigurimit të mbështetjes së politikave me qëllim reduktimin e shtatzënive nën 20 vjeç; rritjen e përdorimit të kontraceptivëve për adoleshentët në risk për shtatzëni të padëshiruar; reduktimin e seksit të detyruar ndër adoleshentët; reduktimi i abortit të pasigurtë të adoleshenteve; rritja e kujdesit para, gjatë dhe pas lindjes[81].

Është detyrë e gjykatës që, kur jep një leje të tillë për lidhjen e martesës nën moshë, të sigurohet për pjekurinë psiko-fizike të të miturit dhe argumentimin e fortë të arsyes së dhënies së lejes si dhe garantimin e të drejtave themelore që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

Leja për të lidhur martesë përpara moshës së kërkuar nga ligji nuk është gjenerike. Kjo do të thotë që kërkuesi i lejes e lidh marrjen e saj me qëllim lidhjen e martesës me një person të caktuar. Pra, në këtë rast kjo nuk shërben si "mandat" (ose licencë) i përgjithshëm për të kërkuar nga organi kompetent (nëpunësi i gjendjes civile) lidhjen e martesës, në çdo raport që dëshirohet të shndërrohet në martesë, përpara moshës 18 vjeç. Kjo do të thotë që kërkuesi nuk mund të shkojë me këtë leje e të lidhë martesë më këdo qoftë, por me një individ konkret për të cilin gjykata ka dhënë vendimin. Kjo do të thotë që nëse kjo martesë nuk lidhet, për çfarëdo shkaku, individi nën moshë nuk fiton zotësinë e plotë për të vepruar. Për të lidhur një martesë tjetër nën moshë ai/ajo duhet t'i drejtohet përsëri gjykatës për leje. Por nëse e ka lidhur martesën e parë nën moshë dhe kjo ka mbaruar (për shkaqe të njohura nga legjislacioni) përpara arritjes së moshës madhore, ky person ka të drejtë të lidhë martesë të re dhe nëse është përsëri nën moshë nuk ka nevojë të marrë

[80] Shih: "WHO Guidelines on Preventing Early Pregnancy and Poor Reproductive Outcomes Among Adolescents in Developing Countries", në: http://whqlibdoc.who.int/publications/2011/9789241502214_eng.pdf?ua=1

[81] Shih, po aty.

leje nga gjykata sepse konsiderohet që ka fituar për shkak të martesës së parë zotësinë e plotë për të vepruar.

Është e pavlefshme martesa e lidhur nga persona që janë *nën moshën e përcaktuar nga Kodi i Familjes për lidhjen e martesës* (neni 39) dhe që nuk kanë marrë lejen (autorizimin) prej gjykatës për të lidhur martesë nën këtë moshë. Pra mosha është një kusht i rëndësishëm, absolut dhe që shkakton pavlefshmëri absolute të martesës. Por, nisur nga fakti që mosha "rend" sikurse edhe koha që ecën, Kodi i Familjes "kursen", cilësimin e "pavlefshme" të martesës së lidhur nën moshë, kur vërehet se:

i. personi e ka arritur moshën e kërkuar,

ii. gruaja ka lindur fëmijë,

iii. gruaja ka mbetur shtatzënë,

Kjo ndodh atëherë kur kërkesën për pavlefshmëri nuk e ka paraqitur ndonjë prej bashkëshortëve.

Martesa është një e drejtë personale e subjektit që kërkon të lidhë martesë. Nëse prindërit e pëlqejnë apo jo këtë martesë kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e saj por gjykata e ka për detyrë që të analizojë qëndrimin e prindërve në këtë nismë për të parë nëse jemi përpara një martese të detyruar nga ana e tyre.

Sipas nenit 20 të KF prindërit kanë të drejtën e kundërshtimit të lidhjes së martesës përpara nëpunësit të gjendjes civile. Ky kundërshtim duhet të jetë gjithnjë i përligjur me shkeljen e kushteve për martesë, të njohura nga Kodi[82]. Ligji shqiptar nuk e lidh pëlqimin e prindërve, as me formën, as me fitimin e zotësisë për martesë nga ana e fëmijëve madhorë ose nën 18 vjeç

Me qëllim që lejimi i martesës nën moshë të mos bëjë rregullin e lidhjes së martesës por një rast përjashtimor, është shumë e rekomandueshme që të tilla martesa, qoftë edhe për shkak "të zakonit" të mos nxiten ose të inkurajohen. Për këtë duhet që prindërit dhe të rinjtë të marrin pjesë në programe edukuese ku të jepen informacione shkencore mbi problemet shëndetësore dhe social- ekonomike të shkaktuara nga martesat në moshë të re. Një vend të veçantë merr edukimi i vajzave. Kjo sepse statistikat e marra nga gjykatat në vendin tonë, tregojnë që përgjithësisht gjinia femërore është ajo që "kërkon" lidhjen e martesës nën moshë. Sikurse, u nënvizua më sipër, ilustruar edhe përmes statistikave të OBSH, UNICEF dhe UNFPA, problem shqetësues për politikat e shëndetit publik ka qenë dhe, me sa duket, ende do të jetë fakti që ka një lidhje të fortë midis mëmësisë dhe sëmundjeve e patologjive infantile dhe shtatzënisë në moshë të re. Nënat adoleshente janë në një risk të madh të vdekshmërisë dhe të sëmundjeve. Nuk është plotësuar zhvillimi fizik dhe psikologjik i fëmijëve që ndërkohë bëhen prindër. Fëmijët e tyre shpesh

[82] Pra, prindi nuk mund të kundërshtojë lidhjen e martesës për shkak të besimit fetar të ndryshëm ose të përkatësive të ndryshme racore a gjendjes materiale (pasurore), por vetëm për ato që ligji i familjes i konsideron si kushte për lidhjen e një martese të vlefshme. Nëse kundërshtimi i prindërve nuk pranohet nga gjykata, ata përjashtohen nga dëmshpërblimi (shih nenin 27 të KF).

lindin prematurë. Janë fëmijë të lindur nga prindër jo të maturuar si në kuptimin psikologjik ashtu edhe në atë fizik. Vdekshmëria foshnjore në këto raste është më e lartë dhe kjo nuk është e lidhur vetëm me moshën e re të nënës por edhe me faktorë social ekonomikë si ushqimi, mënyra e jetesës, kujdesi për të miturit, etj. Kështu në vëmendje të gjykatës duhet të jetë fakti që martesat e hershme kërkojnë përkujdesje të veçantë, si për çiftin, ashtu edhe për fëmijën. Martesa të tilla në të vërtetë ngarkojnë mbi bashkëshortët përgjegjësi të cilat ata i mbajnë me shumë vështirësi ose i shkarkojnë tek të tjerët. Në të dyja rastet kemi dalë nga normaliteti.

4.3 Gjykata duhet të mbajë në vëmendje se të miturat me gjendje të vështirë ekonomike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të martesave fiktive apo premtimeve për martesë që përfundojnë në shfrytëzim për prostitucion e trafikim

Nga Vendimi nr.538/ 26.05.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë[83] i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.38/17.06.2008 të gjykatës së Apelit për Krime të Rënda "Për veprën penale të "Trafikimit të të miturve" kundrejt shtetasit Xh.G, mësojmë fakte rrëqethëse.

I gjykuari XH.G, duke shfrytëzuar padijeninë dhe moshën e miturisë, nivelin e ulët intelektual të së dëmtuarës, ka arritur ta bindë atë që të largohet nga shtëpia e saj. Këtë ai e ka realizuar lehtë nëpërmjet bisedave telefonike, duke i premtuar asaj që do fejohet me të, e do largohet nga shtëpia e saj, për një jetë më të mirë. Pasi është bindur, e dëmtuara i ka premtuar se në rastin më të parë, kur të mos ishin prindërit e saj në shtëpi, ajo do të shkojë me të. Rezulton e provuar se e dëmtuara, kur ka ndodhur ngjarja ka qenë e mitur, 14 vjeçe. Ajo, pasi është rekrutuar me anë të mashtrimit nga i gjykuari, është transportuar prej tij nga fshati i saj Usojë për në qytetin e Vlorës, ku është mbajtur e fshehur në një apartament, në të cilin i gjykuari jo vetëm e ka detyruar atë që të shikonte video pornografike dhe ka kryer veprime të turpshme me të, por edhe i ka thënë se do ta çonte jashtë shtetit duke e shitur për 5.000 euro dhe ajo do të punonte për të fituar lekë për një jetë më të mirë, duke pasur kështu si qëllim shfrytëzimin e saj për prostitucion.

Ndonëse në vendimin e cituar, nuk paraqitet rasti i lejimit të lidhjes së martesës nën moshë për viktimën, shembulli i marrë synon të ndikojë dhe rrisë pozitivisht vigjilencën e gjykatës në rastet e kërkesës së lidhjes së martesës nën moshë, e cila mund të maskojë mjeshtërisht një rast trafikimi apo prostitucioni.

Liria në dhënien e pëlqimit për martesë duhet të jetë maksimale, në kuptimin që, ajo çka i afron bashkëshortët e ardhshëm drejt ushtrimit të së drejtës për martesë, nuk ka të bëjë thjesht me plotësimin e dëshirave të të tjerëve ose sugjerimeve të të tjerëve, ose riparimin e një veprimi të nxituar

[83] Vendimi i KPGJL: Nr.52907-00592-00-2008 i Regj.Themeltar

Nr.00-2010-795 i Vendimit (538).

apo të papjekur, por të së drejtës së tyre. Pra, pëlqimi i lirë është standard, i cili, ndonëse shpallet si kusht i rëndësishëm, është i pakontrollueshëm prej asnjë organi tjetër administrativ ose gjyqësor, publik ose privat, përveç vetë bashkëshortëve. Në kërkimin e lejes për të lidhur martesë nën moshë duhet që të kemi një provë më shumë dhe verifikim më të kujdesshëm të kësaj lirie pëlqimi. Gjithsesi çasti simbolik i deklarimit të pëlqimit të lirë realizohet përpara nëpunësit të gjendjes civile, në prani të dy dëshmitarëve dhe të të gjithë atij mjedisi procedural që ligji parashikon për një solemnitet të tillë, siç është martesa. Por gjykata, gjithashtu, në rastin kur lejon lidhjen e martesës nën moshë duhet të bëjë verifikimet e veta lidhur me këtë pëlqim për të parandaluar martesat e detyruara.

Në rastin kur gjykata lejon martesën nën moshë mendojmë që, prej saj duhet bërë kujdes dhe duhet parë përtej moshës duke e bërë gjykatën alerte dhe vigjilente ndaj rreziqeve ekstreme[84].

5. Lidhja e martesës: rëndësia e marrjes së certifikatës në procesin gjyqësor dhe në veprime të tjera që i japin aktit/certifikatës martesore një rëndësi prioritare

Martesa u jep bashkëshortëve një status. Data e lidhjes së martesës ka një rëndësi të veçantë në aspektet personale dhe pasurore, në marrëdhëniet e bashkëshortëve me njëri tjetrin dhe atyre me të tretët. Nëse në procedurën e zgjidhjes së martesës, gjykata shprehet se 'në një ditë të pacaktuar çifti ka lidhur martesën' kjo vë pikëpyetje mbi vlefshmërinë e martesës dhe mbi pasojat e martesës përfshi këtu ato pasurore, të cilat janë të lidhura me datën që mban certifikata martesore. Certifikata martesore është një dokument që mund të paraqitet në çdo fazë apo shkallë të gjykimit dhe duke qenë se nga kjo datë nis konceptimi dhe zhvillimi i shumë të drejtave dhe detyrimeve lidhur me martesën, mossigurimi i saj nuk mund të bëhet shkak për tejzgjatje të proceseve të pajustifikuara.

Kështu, për të ilustruar këtë, po shkëputim një ekstrakt nga Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë datë 09.02.2012: "Sipas arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke qenë se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar se kur është lidhur martesa midis palëve, në cilën kohë është vënë pasuria bashkëshortore dhe gjithashtu duhet të saktësohet edhe adresa e vendbanimit të të paditurit, pasi nuk rezulton të jetë dokumentuar në mënyrë të saktë pasja dijeni e tij për zhvillimin e seancave gjyqësore, çështja duhet të kthehej për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. ... Veç sa më sipër, prova që Gjykata e Apelit

[84] Sipas Asylum Aid, Women's Asylum News: Issue No. 120, November/December 2013, December 2013, Issue 120, në : http://www.refworld.org/docid/529c6d5a4.html [akesuar ne Dhjetor 2013], Rumania, Nigeria, Hungaria dhe Shqipëria kanë përqindjen më të lartë të viktimave të trafikuara në Mbretërinë e Bashkuar për qëllime shfrytëzimi seksual.

Tiranë ka arsyetuar se duhet të ishte marrë gjatë gjykimit të çështjes në shkallën e parë dhe se nuk mund të merret prej vetë gjykatës së apelit, nuk është prej atyre që "marrja e së cilës është e vështirë të merret në shkallën e dytë", siç parashikon pika "f" e nenit 467 të K.Pr.Civile. Duke përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, Gjykata e Apelit Tiranë mund të administronte certifikatën e martesës dhe vendimin e zgjidhjes së martesës ndërmjet palëve ndërgjyqëse për të sqaruar çka ajo ka kërkuar të sqarohen gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë".

Martesa lidhet dhe regjistrohet konform dispozitave të KF dhe ligjit "Për gjendjen civile"[85]. Kjo bën të mundur vlefshmërinë e martesës, ndalimin e bigamisë dhe poligamisë si dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Data e lidhjes së martesës ndan shkaqet për pavlefshmëri martese, nga shkaqet për zgjidhje martese. Kështu, një e metë që ekziston para lidhjes së martesës përbën shkak për pavlefshmëri, ndërsa kur kjo lind gjatë martesës mund të shkaktojë krizë në marrëdhëniet në çift dhe të çojë në zgjidhjen e martesës. Po kështu edhe për çështje që lidhen me regjimet pasurore. Çdo gjë e fituar para martesës në regjimin bashkësisë ligjore është pasuri vetjake. Të tjera rregulla vlejnë pas martesës.

[85] Sipas nenit 50 të LGJC [2009, ndryshuar] kemi "Veprimet me aktin e martesës": "Akti i martesës pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëpunësi i gjendjes civile, që mban aktin e martesës, bën përditësimin e të dhënave për bashkëshortët e ardhshëm, në faqen përkatëse."

PJESA E TRETË: BARAZIA GJINORE DHE MOS DISKRIMINIMI GJATË MARRËDHËNIEVE MARTESORE. NDIKIMI TE FËMIJËT

Pas lidhjes së martesës, nis një jetë e re. Kjo mënyrë e re jetese mund të jetë 'eksploruar' përmes bashkëjetesës së çiftit dhe kështu, bashkëshortët ta kenë më të lehtë përshtatjen me jetën e re, me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë. Por mundet që bashkëjetesa në çift të përkojë në kohë me lidhjen e martesës.

Tashmë të martuar, burri dhe gruaja marrin statusin e bashkëshortëve dhe kanë një sërë të drejtash dhe detyrimesh që burojnë për ta nga martesa. Jeta e bashkëshortëve ka një orientim të ri dhe dinamikë të re, kundrejt jetës së mëparshme dhe përpjekjet e tyre synojnë që të qaset jeta e tyre individuale, interesat e tyre personale, me funksionet e familjes së re të sapokrijuar. Në disa çifte, menaxhimi i jetës së re, edhe kur ka vështirësi, bëhet me sukses. Në disa të tjerë, shfaqen shenjat e para e mandej sjelljet e përsëritura të diskriminimit e pabarazisë, deri në dhunën në familje si situatë ekstreme.

Pra, duke qenë se martesa është si një organizëm i gjallë, ndodh që qëndrimet ndaj funksioneve të saj e të drejtave dhe detyrimeve ndaj familjes dhe martesës, pavarësisht diversitetit që ka në çift, të përkthehen herë në sjellje e veprime jo diskriminuese dhe herë në të tilla. Këto të fundit, herë shfaqen në mënyrë të dukshme e herë më të kamufluara.

Duke qenë se familja ka disa funksione e ndër të tjera, ka funksione dhe rol edukues, ndodh që të gjendet apo edukohet ekuilibri midis lirive dhe të drejtave të çdo individi dhe detyrimeve për familjen e martesën. Por ka raste që ekuilibri nuk gjendet dhe pesha e barra e durimit, dhunës dhe përgjegjësive familjare bie vetëm mbi njërin prej bashkëshortëve ose kryesisht mbi njërin prej tyre.

Qëllimi i kësaj pjese është 'të hyjmë' në marrëdhëniet e bashkëshortëve dhe të shohim se sa barazi ka në gamën e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, gjatë martesës. Çfarë roli dhe peshe kanë bashkëshortët në vendimmarrje të ndryshme që nga ato me rëndësi radikale për cilësinë e jetës e deri në të zakonshme për mbarëvajtjen e përditshme.

Kjo pjesë e jetës së bashkëshortëve, është më pak e zbuluar apo më pak evidente. Vetëm bashkëshortët e dinë se çfarë ndodh në shtëpinë e tyre! Nuk ka këtë karakter kaq 'të mbyllur', çasti i lidhjes së martesës dhe i mbarimit të saj. Për vetë natyrën e tyre, këto marrëdhënie gjatë martesës, kanë tendencën të qëndrojnë private dhe problemet e vërteta kuptohen më shumë e dalin në pah kur martesa zgjidhet. Duket se ky është momenti që pabarazia dhe diskriminimi bëhet 'publik' në gjykatë. Ndaj, edhe në analizën e marrëdhënieve midis bashkëshortëve gjatë martesës, më së shumti kemi qenë të detyruar të analizojmë shkaqet e zgjidhjes

së martesës. Këto vendime na kanë çuar tek tipologjia e marrëdhënieve martesore midis bashkëshortëve me qëllim për të analizuar situatat diskriminuese në këto marrëdhënie dhe sjelljen e tyre në vëmendje të gjykatës dhe aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë.

1. Natyra e dispozitave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesa

Titulli II i pjesës së dytë të KF [nenet 50-65], përfshin rregullime mbi të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve.

Rezulton se kjo është një nga pjesët më pak të evidentuara në praktikën gjyqësore. Në shumë pak raste këto nene të KF paraqiten si pjesë e bazës ligjore të pretendimeve të parashtruara në gjykatë. Po kështu, duhet pranuar se këto nene të KF janë më pak të shtjelluara edhe në doktrinë. Ndërkohë dispozitat e kësaj pjese kanë një rëndësi shumë të madhe. Duke qenë se këto nene përfshijnë gjithë gamën e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, rezulton se, në disa aspekte, të drejtat e detyrimet e përfshira në këtë pjesë kanë prioritet.

Për nga natyra, dispozitat e këtij kreu, sipas doktrinës, klasifikohen në dy grupe, nisur nga parimi i diskrecionit dhe autonomisë së bashkëshortëve. Ka disa norma ku duket qartë se 'ligji vendos' dhe nuk lë mundësi tjetër, sikurse ka norma të tjera ku ka qëndrim të qartë se për këtë aspekt janë bashkëshortët që vendosin. Ka edhe norma që paraqiten në gjendjen '*quasi*'. Kështu, nëse, diskrecioni për të vendosur për një situatë të caktuar lidhur me të drejtat e detyrimet që burojnë nga martesa, u është lënë bashkëshortëve dhe këta nuk merren vesh, në varësi të interesit të mbrojtur, aplikohet zgjidhja e mosmarrëveshjes përmes rrugës gjyqësore.

Dispozitat që kanë kufizuar autonominë e bashkëshortëve janë pikërisht ato që kanë rëndësi prioritare për mbrojtjen e familjes dhe të martesës.

Për të na treguar këtë rëndësi që kanë dispozitat e titullit të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga martesa, legjislatori, në nenin e fundit të kësaj pjese [neni 65 KF], nënvizon karakterin përparësor që kanë *detyrimet* që rrjedhin nga martesa, pra, ato çka janë cituar në këtë pjesë dhe që, si të tilla, qëndrojnë pavarësisht regjimit pasuror martesor që ka apo që mund të zgjedhë çifti. Legjislatori, duke dashur të përforcojë pikërisht karakterin e pashmangshëm të *të drejtave* që burojnë nga martesa, të cilat janë të pacenueshme, të pashmangshme e të pa-manipulueshme nga çfarëdo marrëveshjeje, pothuaj të njëjtën gjë, por në një dimension të ri, na përsërit edhe në nenin 67 të KF. Ky nen është pozicionuar nën titullin e 'Regjimeve pasurore martesore'.

Duke përdorur gjuhën e legjislatorit, konkludojmë se detyrimet që burojnë nga martesa kanë përparësi dhe të drejtat që burojnë nga martesa janë të pashmangshme! Asnjë 'allishverish' midis bashkëshortëve nuk mund të parashikojë shmangie apo devijime nga përmbajta e këtyre dy

neneve. Çdo lloj marrëveshjeje e tillë do të ishte absolutisht e pavlefshme. Kjo vlen të jetë si në vëmendjen e noterëve, sa i përket kontratave mbi regjimet pasurore ashtu edhe avokatëve e mandej gjykatës, kur kjo duhet të shprehet përmes vendimit për pavlefshmërinë absolute të këtyre marrëveshjeve apo për shkelje të të drejtave e detyrimeve gjatë martesës.

Në formën e një tabele, po i vendosim të dy nenet e sipërcituara për të parë unitetin dhe diversitetin e përmbajtjes së tyre me qëllim mbulim të plotë të interesave që lidhen me martesën dhe familjen e krijuar nga martesa.

Neni 65: Përparësia e detyrimeve që rrjedhin nga martesa.	Neni 67: Të drejta të pashmangshme
"Zbatimi i dispozitave të këtij kreu rrjedh nga martesa dhe zbatohet pavarësisht nga regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve."	"Bashkëshortët nuk mund t'i shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin për ta nga martesa, si dhe përgjegjësisë prindërore dhe rregullave të administrimit ligjor dhe të kujdestarisë."

Me martesë, burri dhe gruaja, përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime si në planin personal ashtu edhe pasuror. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës [neni 50 KF]. Thënë në këtë mënyrë duket shumë e qartë dhe kaq neutrale. Rezultatet në praktikë duket se nuk janë të tilla.

Një klasifikim tjetër i dispozitave të këtij kreu mund të behet nisur nga karakteri personal apo pasuror i të drejtave dhe detyrimeve që ato përmbajnë. Tabela në vijim bën paraqiten e këtij klasifikimi:

Marrëdhëniet personale	Marrëdhëniet pasurore
• Jetën e përbashkët (55/1) • Ushtrimin lirisht të profesionit (63/1) • Veprimet juridike që kanë të bëjnë me mbrojtjen e familjes (60) • Edukimin e fëmijëve • Mbiemrin e bashkëshortëve (n.52) • Mbiemrin e fëmijëve (n.52) • Vendbanimin e bashkëshortëve (55/2) • Detyrimi dhe e drejta për besnikëri • Detyrimi dhe e drejta për ndihmë morale • Përfaqësimi	• Disponimin lirisht të të ardhurave • Administrimi dhe tjetërsimin lirisht të sendeve vetjake (64) • Detyrimet për ndihmë materiale • Disponimi i banesës dhe i pajisjeve • Detyrimet ndaj fëmijëve • Kontributi i bashkëshortëve lidhur me detyrimet që lindin nga martesa - Masa e kontributit mund të përcaktohet nga kontrata nëse ka një të tillë, ose - Masa e kontributit varet nga kushtet dhe aftësitë e bashkëshortëve

Si rregull detyrimet që burojnë nga martesa duhet të zbatohen vullnetarisht dhe me mirëkuptim ndërmjet bashkëshortëve. Por ka

edhe raste të shkeljes dhe abuzimit. Në këtë mënyrë Kodi i Familjes ka parashikuar (nenet 58 – 64) ndërhyrjet e autoritetit publik (gjykatës) kur njëri bashkëshort nuk dëshiron të plotësojë detyrimet vullnetarisht. Gjykata vihet në lëvizje me kërkesën e bashkëshortit tjetër.

2. Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet personale midis bashkëshortëve

Kur flasim për të drejta dhe detyrime midis bashkëshortëve, i shohim këto në planin personal, pasuror, moral dhe në atë ligjor. Ligji bën fjalë për barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve dhe ndihma morale është një nga detyrimet që buron nga martesa.

Mbivlera e moralit është ajo që e mban të fortë dhe në këmbë një martesë. Kur ky moral vdes, atëherë kërkohet ndihma e ligjit dhe martesa si e tillë ka marrë fund; pritet vetëm zgjidhja ligjore e saj ose zvarritja e kotë e saj pa asnjë impakt në të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesa.

Martesa mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje [neni 1 KF]. Barazia morale, respekti, dashuria, dhembshuria, mirëkuptimi, besnikëria, etj, janë kategori morale. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës [neni 50 KF].

Bashkëshortët nuk janë si në raportet e krijuara ndër ortakët e një shoqërie tregtare. Në marrëdhënien e tyre ka rëndësi të madhe harmonia dhe mirëkuptimi, ndjenja e dashurisë. Në këtë raport, kontrolli juridik, ia lë vendin parimeve morale, të cilat e ushqejnë martesën cilësisht dhe e bëjnë martesën ende një institut 'të kërkuar'[86]. Përndryshe martesa do të ishte një barrë dhe vuajtje. Reciprociteti ka vlerë gjithashtu. Ky reciprocitet nuk ka 'peshore farmacie', por qeveriset nga toleranca dhe mirëkuptimi aq sa nuk cenohet thelbi i barazisë.

Kontrolli juridik i barazisë del në pah dhe merr rëndësi atëherë kur ka rreziqe për pabarazi, mungesë reciprociteti, diskriminim e dhunë në familje. Atëherë del nevoja të kthejmë vështrimin nga leximi i asaj që ligji përmban me qëllim që të mbrohemi. Sa kohë duket se morali e paraprin ligjin, familja e krijuar nga martesa rezulton të ketë një jetë të shëndetshme.

Nëse respektohen të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga martesa dhe kuptohen drejt, martesa ka gjasa të vazhdojë 'deri në vdekje'. Në praktikën gjyqësore shqiptare, vihet re se gratë gjithnjë e më shumë kuptojnë rëndësinë që ka respekti reciprok si baza e unitetit në familje e martesë. Mungesa e respektit sjell tronditje të marrëdhënieve. Hasur në disa vendime gjyqësore, nënvizimi nga ana e gjykatës i 'respektit të munguar në marrëdhëniet midis bashkëshortëve', nga ana e këtij studimi,

[86] Ndaj thuhet se jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj [nenin 132 KF].

është një konkluzion që ka impakt në dy drejtime:

❒ kujdesin e gjyqësorit për fiksuar në një vendim vlerat morale dhe të respektit në një marrëdhënie të tillë, siç është ajo e krijuar nga martesa dhe nga ana tjetër,

❒ emancipimin në rritje të grave për të sjellë deri në procesin e gjykimit një qasje kaq me rëndësi, që ndonëse duket si diçka e rrallë dhe elitare në kontekstin e jetës familjare e marrëdhënieve martesore shqiptare, në fakt ekziston dhe e bën një martesë jo të lumtur të ndjekë rrugën e zgjidhjes[87].

Në gamën e marrëdhënieve personale ndërmjet bashkëshortëve do të trajtojmë disa aspekte të cilat mund të çojnë në pabarazi dhe diskriminim e, si të tilla, duhet të jenë në vëmendjen e gjyqtarëve.

2.1. Cenime të së drejtës së ushtrimit lirisht të profesionit, arsimimit, etj. të bashkëshortes [neni 63/1 i KF]

Një familje e qëndrueshme është një familje që bazohet mbi parimet e barazisë së shanseve, drejtësisë dhe plotësimit individual të secilit anëtar. Secili partner i lidhur në martesë, duhet të ketë të drejtën të zgjedhë një profesion a vend pune që i përshtatet më mirë aftësive, kualifikimeve, dhe aspiratave të tij apo të saj [neni 11 (a dhe c) CEDAW].

Ende në shumë familje shqiptare duket se grave u imponohet një barrë punësh dhe detyrimesh e pabarabartë në familje. Përgjegjësitë që bien mbi gratë për të mbajtur dhe rritur fëmijët, për t'u kujdesur për të moshuarit, punët e shtëpisë, etj. etj. ndikojnë të drejtën e tyre për aksesin ndaj arsimit, trajnimit, punësimit dhe veprimtarive të tjera lidhur me zhvillimin e tyre profesional dhe personal. Kur gruaja i njeh mirë të drejtat e saj, ajo përdor mekanizmat për realizimin e tyre, deri në ekstremin e zgjidhjes së martesës kur nuk ka alternativë tjetër. Por duhet të pranojmë që ka edhe raste që gratë 'i nënshtrohen fatit' dhe mbyllen brenda mureve duke lënë në harresë dëshirat dhe ambiciet e tyre për ecje përpara e, në rast të zgjidhjes së martesës nga bashkëshorti, hasin vështirësi të konsiderueshme me problemet e punësimit, kualifikimit, etj.

Nga vendimi nr. 6042/30.05.2013 të GjRrGj Tiranë, me objekt zgjidhje martese me pëlqim reciprok, mësojmë se kërkuesit[88] janë njohur në rrethin e tyre shoqëror dhe pas një periudhe të shkurtër kanë vendosur të martohen. Martesa është lidhur në datën 21.01.2013 dhe duket se ka zgjatur *vetëm 4*

[87] Fragmenti në vijim është marrë nga teksti i vendimit nr.39/15.01.2013 të GjRrGj Tiranë me objekt zgjidhje martese. Në këtë vendim, pala e paditur [bashkëshortja], nënvizon se mungesa e respektit është shkaku determinant në zgjidhjen e martesës. Pala e paditur pohon se paditësi [bashkëshorti i saj] manifestonte mungese te respektit ndaj te padituresë. Po kështu, në vendimin nr. 2189/04.03.2013, nënvizohet se "Pala paditëse [në këtë rast bashkëshortja] pretendoi se i padituri nuk e pyeste fare atë në lidhje me marrjen e vendimeve të rëndësishme që kishin të bënin me mbarëvajtjen e familjes . Ne rrethanat sa më sipër paditësja është ndjerë e parespektuar dhe e pavlerësuar nga ana e të padituri në rolin e saj si bashkëshorte dhe si nënë."

[88] Bashkëshortët i janë drejtuar gjykatës me kërkesë sipas nenit 125 të KF.

muaj. Kërkuesit, pas martesës së tyre, kanë jetuar në banesën e kërkueses N.B [bashkëshortes], e cila ka shërbyer edhe si banesë bashkëshortore. Martesa që në fillimet e saj duket se paraqitet relativisht e vështirë. Nga vendimi del se çifti ka mosmarrëveshje në lidhje me të konceptuarit e jetës. Palët kërkuese kishin interesa të ndryshme, dhe kërkuesja N.B kërkonte më shumë hapësirë për t'ju përkushtuar arsimimit dhe profesionit të saj. Kjo dëshirë nuk ka gjetur mbështetjen e bashkëshortit F.B[89].

Kur martesa lidhet, ka shumë rëndësi që çifti të ketë kuptuar rëndësinë që ka respektimi i të drejtave të bashkëshortit/es, qoftë në realizimin e tij/saj në jetën publike, qoftë në atë private. Ky rast i përzgjedhur ndër vendimet gjyqësore, është vërtet interesant sepse, bashkëshorti është gati të qëndrojë në shtëpinë e gruas, është gati edhe të marrë mbiemrin e saj, por ajo që imponohet prej tij dhe që duket prish gjithë mundin për të arritur deri në martesë, është që bashkëshortja duhet të qëndrojë brenda mureve të shtëpisë dhe të privohet nga e drejta e ushtrimit të profesionit dhe arsimimit.

Me profesionin janë të lidhura ngushtë të ardhurat. Sipas nenit 63 KF secili nga bashkëshortët mund të ushtrojë lirisht një profesion, të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa.

2.2. Çështje të mbiemrit të bashkëshortëve dhe të fëmijëve [neni 51 dhe 52 i KF]

Mbiemri përbën një çështje shumë sensitive. Aq sa rastet lidhur me diskriminimin për shkak të mbiemrit janë paraqitur deri në GjEDNj.

Secili bashkëshort duhet të ketë të drejtën të zgjedhë mbiemrin e vet, duke ruajtur kështu individualitetin dhe identitetin në bashkësi dhe duke e dalluar atë person nga anëtarë të tjerë të shoqërisë. Askush nuk mund të detyrojë një grua të ndryshojë mbiemrin e saj pas martesës nëse ajo nuk e dëshiron këtë. Pas zgjidhjes së martesës, bashkëshorti që ka ndërruar mbiemrin me lidhjen e saj, ka të drejtë të mbajë mbiemrin e ndryshuar nëse kjo justifikohet përpara gjykatës me impaktin që ka në interesin e fëmijëve apo të vet bashkëshortit/es. Në këtë mënyrë, është e drejtë e bashkëshortëve që, kur lidhin martesën, të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Ky mbiemër i zgjedhur regjistrohet në regjistrin e martesave.

Çështja e mbiemrit të fëmijëve[90] mund të jetë objekt mosmarrëveshjesh midis prindërve. Sipas KF, duket se nëse prindërit nuk bien dakord,

[89] Nga ky vendim rezulton se bashkëshorti F ka marrë mbiemrin e gruas [bashkëshortes] dhe në marrëveshja çifti ka rënë dakord që F të mbajë këtë mbiemër edhe pas zgjidhjes së martesës. Gjykata e ka pranuar këtë pa bërë ndonjë vlerësim të interesit të bashkëshortit për të mbajtur këtë mbiemër sipas kërkesave të nenit 146 KF. "Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës."

[90] Shih vendimin e GjEDNj në çështjen Cusan and Fazzo v. Italy të 07.01.2014 lidhur me mbiemrin e fëmijëve dhe diskriminimin gjinor.

problemi duket se zgjidhet duke vendosur mbiemrin e atit dhe duke rezervuar të drejtën e fëmijës kur bëhet madhor për të ndryshuar këtë nëse është rasti[91] [shih neni 52 i KF].

Duke marrë shkas nga vendimi i sipërcituar, vendimi nr. 6042/30.05.2013 të GjRrGj Tiranë, mendojmë të rikthehemi në çështjen e mbiemrit të ndryshuar gjatë martesës dhe kujdesit që duhet të tregohet përmes disponimit të gjykatës lidhur me të pas zgjidhjes së martesës[92]. Nga ky vendim rezulton se bashkëshorti F ka marrë mbiemrin e gruas [bashkëshortes], situatë kjo që nuk është tipike në realitetin shqiptar, dhe, në marrëveshjen e paraqitur përpara gjykatës për zgjidhjen e martesës me pëlqimin reciprok, çifti ka rënë dakord që F të mbajë këtë mbiemër edhe pas zgjidhjes së martesës. Gjykata, siç del nga vendimi, e ka pranuar këtë pa bërë ndonjë vlerësim të interesit të bashkëshortit për të mbajtur këtë mbiemër sipas kërkesave të nenit 146 KF, ndërkohë që, përsërisim, është fjala për një çift që nuk ka fëmijë dhe martesa ka zgjatur vetëm katër muaj. "Gjykata, me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës."

Lidhur me çështjen e mbiemrit vlen të rikthehemi tek ky vendim e të ndalemi në mënyrë të veçantë sepse çifti duket sikur ka lidhur martesë sa për të ndryshuar mbiemrin e bashkëshortit. Nga faktet e paraqitura, martesa zgjat vetëm 4 muaj. Çifti nuk ka fëmijë. Bashkëshorti del se ka patur konceptime të ndryshme për jetën dhe të drejtat e bashkëshortes, ai është larguar gati menjëherë pas martese për në Austri, por në marrëveshjen e paraqitur, ai kërkon të mbajë mbiemrin e bashkëshortes dhe kjo e fundit nuk ka kundërshtime. Asnjë analizë nga gjykata lidhur me interesin që ka bashkëshorti për të mbajtur këtë mbiemër. Duke cituar pjesën e vendimit lidhur me mbiemrin kemi: "Në respektim të nenin 146 të Kodit të Familjes, në të cilin parashikohet se: "*Bashkëshorti që me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes së martesës merr mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës. Gjykata me kërkesën e bashkëshortit dhe kur është në interes të tij ose të fëmijëve, mund të lejojë që ai të mbajë mbiemrin që ka marrë me lidhjen e martesës"* nisur edhe nga parashikimi në Projekt-marrëveshje në mënyrë të shprehur të vullnetit të kërkuesve, ashtu edhe gjatë gjykimit, ku kërkuesja N.B, mbiemri i së cilës ishte vendosur si mbiemër i përbashkët, ka dhënë pëlqimin e saj dhe ka qenë dakord që kërkuesi F.B pas zgjidhjes

[91] Ky i fundit është komenti ynë bazuar në dispozitat e Ligjit për Gjendjen Civile [2009, ndryshuar]. Kryesisht ligji Nr. 130/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ndryshuar" në të cilin parashikohen rregullime tepër të komplikuara lidhur me ndryshimin e emrit dhe mbiemrit [nenet 57/1, 57/2, 57/3, 57/4, 57/5, 57/6, 57/7, 57/8, 57/9 dhe 57/10]. Sipas nenit 57/1 nën titullin "Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar" parashikohet se çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/ shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

[92] Vendimi nr. 6042/30.05.2013 të GjRrGj Tiranë.

së martesës, të mbajë mbiemrin e marrë pas lidhjes së martesës, ***"B"***, Gjykata çmon se kjo kërkesë është e mbështetur në ligj [?].

Nëse lexojmë dispozitat e LGJC 2009 [ndryshuar] lidhur me ndryshimin e emrit dhe mbiemrit mund të konkludojmë që është shumë më e thjeshtë që të lidhësh e zgjidhesh një martesë e të marrësh mbiemër të ri se sa të bësh procedurën e ndryshimit të tyre. Kjo mundet të shndërrohet në abuzivitet për të fshehur të dhëna që lidhen me identitetin. Për këtë na vjen ndër mend edhe Çështja Bajrami kundër Shqipërisë, ku nëna arrit të 'modifikojë' plotësisht identitetin e fëmijës me qëllim që të mos pengohej nga autoritetet kufitare sa herë hynte e dilte.

2.3. Çështje të diskriminimit lidhur me funksionin riprodhues dhe marrëdhëniet seksuale ndërmjet bashkëshortëve

Një nga funksionet e martesës është realizimi i të drejtave riprodhuese dhe plotësimi i nevojave për jetë seksuale.

Vendimet për të pasur apo jo fëmijë janë vendime që duhen marrë bashkërisht. Me qëllim që të merret një vendim i informuar për masat e sigurta dhe të besueshme, bashkëshortët duhet të kenë informacion mbi masat kontraceptive dhe përdorimin e tyre, si dhe akses të garantuar ndaj edukimit seksual dhe shërbimeve për planifikimin familjar.

Ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2013, përfshinë në kuadrin e nenin 102 me titull *"Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura"*[93], si figurë të veçantë vepre penale, atë të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre. Vepra dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Në këtë mënyrë Shqipëria plotësoi edhe një detyrim tjetër ndaj kërkesave të Komitetit CEDAW.

Ka një seksion të veçantë në përmbajtjen e Kodit Penal lidhur me veprat penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose mosdhënia e ndihmës. Në nenin 93 të KP bëhet fjalë për ndërprerjen e shtatzënisë pa pëlqim të gruas dhe neni 94 lidhur me ndërprerjen e shtatzënisë në vende dhe nga persona të paautorizuar[94]. Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010 nuk paraqet asnjë rast të këtyre veprave ndërkohë që kemi rezerva lidhur me realitetin mbështetur në të dhëna të marra nga studime të tjera.

Statistikat janë kokëforte dhe shprehen krejt ndryshe. Shqipëria ka një raport të disekuilibruar sa i përket sekseve në lindje. Ka më shumë lindje të

---

[93] Ndryshuar paragrafi i nenin 102 me ligjin 144/2013, datë 2.5.2013

[94] Neni 93 i KP: "Ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqim të gruas, veç rastit kur ndërprerja diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet."; neni 94 i KP: "Ndërprerja e shtatzënisë e kryer jo në ambiente spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, ose nga një person që nuk është mjek ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Kur nga vepra është shkaktuar rrezikimi i jetës ose vdekja, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet."

fëmijëve meshkuj se femra. Shqipëria duket se është një vend problematik sa i përket ndërprerjes së shtatzënisë për shkak të përzgjedhjes së seksit të fëmijës[95]. Shpesh herë presioni dhe dhuna e ushtruar i detyrojnë gratë të bëjnë aborte të padëshiruara sepse fëmija rezulton e seksit femër. Shpesh herë gratë vënë në rrezik jetën e tyre duke bërë aborte në kushte të papërshtatshme.

Dëshira për të patur të paktën një pasardhës mashkull në familje është shkaku kryesor i aborteve të qëllimshme të foshnjave vajza. Në pellgun e Ballkanit, një nga zonat më problematike ndërkombëtarisht, Shqipëria zë vendin e parë për këtë tregues, ndjekur nga Maqedonia Veriperëndimore[96].

Dëshira për të patur fëmijë në rastet pamundësisë së një shtatzënie natyrore mund të realizohet edhe përmes teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar[97]. Sipas nenit 6 "Çdo grua, e lirë dhe e përjashtuar nga çdo formë diskriminimi, detyrimi dhe dhune, ka të drejtë për t'u kontrolluar e për të vendosur lirisht për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin e saj dhe shëndetin seksual e riprodhues."

Respektimi reciprok i marrëdhënieve të barabarta nga ana e grave dhe burrave gjatë lidhjeve seksuale dhe riprodhimit nënkupton respektin, mos-cenimin e integritetit të secilit, mirëkuptimin dhe ndarjen e përgjegjësive për sjelljet seksuale dhe pasojat e tyre. Në çështjet lidhur me dhunën në familje, në konfidencë me avokatët, viktimat e dhunës bëjnë me dije për dhunën seksuale të ushtruar nga bashkëshortët dhe partnerët e tyre. Ky studim nuk ka shtrirje në monitorimin e vendimeve gjyqësore në kuptimin sasior të tyre por në aspektet cilësore që lidhen me diskriminimin në jetën familjare e martesore. Sipas Studimit Demografik e Shëndetësor në Shqipëri për vitin 2008-2009, trembëdhjetë përqind e meshkujve bien dakord që një mashkull është i justifikuar ta godasë apo të rrahë bashkëshorten e tij nëse ajo nuk pranon të kryejë marrëdhënie seksuale me të[98]. Po sipas këtij studimi, shtatëdhjetë e shtatë përqind e femrave thonë se një femër mund të refuzojë të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e saj nëse e di që ai ka një sëmundje seksualisht të transmetueshme [STD]; 83 përqind pohojnë se ajo mund të refuzojë nëse e di që bashkëshorti po kryen marrëdhënie seksuale me një femër tjetër; dhe 78 përqind pohojnë se ajo mund të refuzojë nëse nuk ka dëshirë apo është

[95] Shih HIGH SEX RATIO AT BIRTH IN SOUTHEAST EUROPE. A research note prepared by CZ Guilmoto, October 2010 në:
http://www.demographie.net/guilmoto/pdf/research%20note%20on%20BM%20in%20SE%20Europe4.pdf; shih gjithashtu Christophe Z. Guilmoto "Sex Imbalances at Birth. Current trends, consequences and policy implications." 2012, botuar nga UNFPA Asia and Pacific Regional Office.

[96] Ndër disa nga përfundimet e studimit "Raporti i paekuilibruar midis sekseve ne lindje në Shqipëri", i prezantuar nga Ministria e Shëndetësisë, me mbështetjen e organizatave UNFPA dhe World Vision. Studimi u prezantua më 19 dhjetor 2012, në Tiranë. Sipas studimit, në Shqipëri, raporti i lindjes së meshkujve shënon një mesatare prej 111.7 për 100 lindje vajzash, për periudhën 2008 – 2010. Ndërkaq, norma botërore është 105 lindje djemsh për 100 lindje vajzash dhe studimi vërteton se ky ekuilibër në Shqipëri është prishur pikërisht për shkak të shtimit të rasteve të abortit selektiv.

[97] Shih ligjin nr. 8876/4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues".

[98] Ky studim mund të aksesohet në: http://www.instat.gov.al/media/169821/adhs_al.pdf

e lodhur. Vetëm 8 përqind e femrave nuk janë dakord që bashkëshortja justifikohet të refuzojë marrëdhëniet seksuale me bashkëshortin e saj për ndonjë prej arsyeve të specifikuara.

Abuzimi seksual mund të përfshijë: një xhelozi të tepruar nga ana e partnerit; të thirrurit me emra poshtërues seksualë; kritika për seksualitetin; kryerja e marrëdhënieve seksuale me detyrim; detyrimi për t'u zhveshur ose zhveshja me forcë; akte seksuale sadiste; kryerja e marrëdhënieve seksuale pas dhunës fizike; detyrimi për seks kur gruaja është në pamundësi ose e sëmurë etj.

Aborti i foshnjës për shkak të seksit të saj (apo detyrimi i nënës për të abortuar kur fetusi është vajzë) përbën një tjetër cenim të lirisë riprodhuese. Duke iu referuar studimit të UNFPA[99] mbi "Sex imbalaces at birth in Albania" gjejmë fakte mbi presionin e bërë prej bashkëshortëve dhe familjarëve në rastet kur fëmija ishte vajzë dhe kërkohej aborti nga ana e tyre. Kështu, një grua nga Dibra raporton se "kunata e saj kishte dy vajza dhe ishte shtatzëne për herë të tretë. Ajo abortoi në muajin e katërt për shkak të presionit të bashkëshortit, i cili i thoshte se nëse ajo nuk lindte djalë, ai do ta çonte në shtëpinë e prindërve".

2.4. Detyrimi për jetë të përbashkët [neni 55/1 KF]

Bashkëshortët kanë detyrimin e jetesës së përbashkët. Mos respektimi i këtij detyrimi nga njëri prej bashkëshortëve mund të shkaktojë krizë në marrëdhëniet martesore[100]. Nga ky detyrim mund të devijohet në rastet kur si rezultat i dhunës në familje, gjykata cakton si masë atë të largimin të bashkëshortit dhunues nga vendbanimi.

Jeta familjare e martesore sjell edhe disa situata kur për arsye ekonomike, pune, shëndetësore, emigracioni, etj. ndodh që njëri bashkëshort është i detyruar të largohet përkohësisht. Në raste të tilla, për aq kohë sa të mos jetuarit bashkërisht:

(a) ka karakter të përkohshëm,

(b) bëhet për një arsye madhore, për të mirë të martesës dhe familjes dhe

(c) ka mirëkuptimin e të dy bashkëshortëve dhe

(d) nuk sjell asnjë luhatje apo pasiguri në dashurinë e tyre,

atëherë, thelbi i jetës së përbashkët konsiderohet i pacenuar.

Përkundrazi, nëse kjo mënyrë jetese sjell krizë në marrëdhëniet bashkëshortore, atëherë flasim për cenim të detyrimit për jetesë të përbashkët.

Jetesa e përbashkët kupton aspektin material dhe subjektiv/shpirtëror të

[99] https://www.unfpa.org/gender/docs/UNFPA_report_Albania2012.pdf

[100] Kështu, në vendimin nr. 2060/28.02.2013 të GjRrGj Tiranë, "paditësja pretendoi se marrëdhëniet bashkëshortore kanë vazhduar të funksionojnë normalisht deri në vitin 2009 , por më pas ato nuk kanë qenë më të qëndrueshme . Kjo sepse kur i padituri kthehej nga Greqia ai largohej nga banesa me dite te tera pa e vene fare ne dijeni paditësen se ku ndodhej. Ne këto rrethana midis bashkëshortëve po konstatohej një mungese e respektit dhe e komunikimit. Sipas palës paditëse i padituri filloi te mos përmbushte rregullisht detyrimet e tij si bashkëshort dhe si prind. Ai nuk kontribuonte ne ekonominë e përbashkët familjare ."

saj. Nisur pikërisht nga rëndësia që ka jeta e përbashkët, në dispozitat e KF, neni 129, parashikon si një nga mënyrat/mundësitë e zgjidhjes së martesës atë të shkaktuar nga ndërprerja e jetës së përbashkët për një periudhë 3-vjeçare.

Jeta e përbashkët si detyrim i jetës në çift mbrohet standardi i së drejtës për jetë familjare sipas nenit 8 të KEDNJ. Zbatimi i nenit 8 ka një rëndësi të veçantë sidomos në rastet e emigracionit. Pra, pikërisht në rastet kur familja dhe çifti jeton në vende të ndryshme. E përballur me një numër të konsiderueshëm të rasteve në lidhje me statusin e rezidentëve të huaj afatgjatë, GjEDNj ka njohur në mënyrë progresive implikimet e të drejtave të njeriut në situata të tilla, kundrejt zbatimit të nenit 8. Kjo ka pasur një ndikim të dukshëm në gjendjen e emigrantëve të ligjshëm dhe të paligjshëm që jetojnë në vendet e Këshillit të Evropës.

Duke patur parasysh se shumë vende evropiane, këto kohët e fundit, janë përpjekur të kufizojnë jo vetëm të drejtën për akses, por edhe më e rëndësishmja, të drejtën për rregullimin juridik të pozitës së një personi në një vend të huaj, vendimet e kësaj gjykate marrin një rëndësi të madhe në garantimin e jetës familjare. Në këto vendime kemi parë se si ka evoluar qëndrimi drejt përmirësimi të bashkimit familjar pikërisht si detyrim pozitiv i shtetit për të garantuar të drejtën e jetës së përbashkët në të njëjtin vendbanim, si një detyrim që buron edhe nga martesa si një nga format e jetës familjare[101].

Në listën joshteruese të atyre që konsiderohen ndërhyrje në gëzimin e të drejtave të rrezikuara në kontekstin e jetesës familjare sipas GjEDNJ përfshihet edhe moszbatimi i urdhrave gjyqësore siç janë UM/UMM të dhëna për mbrojtjen ndaj personit të dhunshëm[102] duke përfshirë ndër masat mbrojtëse edhe ato lidhur me largimin e dhunuesit nga vendbanimi i përbashkët familjar.

2.5 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi në caktimin e vendbanimit [neni 55/2 KF]

Vendbanimi i familjes është vendi që bashkëshortët zgjedhin me marrëveshje të përbashkët. Në rast mosmarrëveshjeje, secili nga bashkëshortët mund t'i drejtohet gjykatës, e cila, pasi dëgjon mendimet e të dy bashkëshortëve dhe, nëse është rasti, edhe mendimin e fëmijës që ka mbushur moshën katërmbëdhjetë vjeç, mundohet të arrijë një zgjidhje me mirëkuptim. Kur kjo nuk është e mundur, gjykata vendos zgjidhjen që e quan më të përshtatshme për kërkesat e familjes.

Komiteti CEDAW duke nënvizuar influencën e së drejtës zakonore, nënvizon se shqyrtimi i raporteve të Shteteve palë demonstron që një gruaje nuk i lejohet gjithmonë të zgjedhë vendbanimin e vet. Komiteti vë në pah se vendbanimi, si edhe nënshtetësia, duhet të ketë mundësi të ndërrohet sipas

[101] Protecting the right to respect for private and family life under the European Convention on Human Rights. Council of Europe human rights handbook.
shttp://www.coe.int/t/dghl/cooperation/capacitybuilding/Source/documentation/hb11_privatelife_en.pdf

[102] shih GjEDNJ në vendimin: A kundër Kroacisë, në: http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-101152

dëshirës së gruas në moshë madhore pavarësisht nga statusi i saj martesor. Çfarëdo kufizimi mbi të drejtën e një gruaje për të zgjedhur vendbanimin, mbi të njëjtat baza si një burrë, mund të kufizojë aksesin e saj ndaj gjykatave në vendin ku ajo banon apo ta ndalojë të hyjë dhe të dalë nga një vend lirisht.

Vendimi nr 2843/19.03.2013 i GjRrGj Tiranë, paraqet situatën se si mosmarrëveshjet lidhur me vendbanimin e imponuar nga njëri bashkëshort, bëhen shkak deri në zgjidhjen e martesës. Në këtë proces gjyqësor, paditësja shpjegoi se disa kohë pas lidhjes së martesës, i padituri është larguar në Kanada. Duke qenë se paditësja kishte detyrime të tjera familjare për një fëmijë nga një bashkëjetesë e mëparshme ajo nuk mund të shkonte dot në Kanada. Në këto kushte, paditësja i ka kërkuar të paditurit që të kthehej e të jetonin së bashku, por nga i padituri iu vu kusht se martesa do të vazhdonte nëse ajo do të shkonte në Kanada, në të kundërt martesa quhej e përfunduar.

3. Barazia dhe mosdiskriminimi në marrëdhëniet pasurore midis bashkëshortëve

Përcaktimi i regjimit pasuror martesor: çfarë duhet vlerësuar në rastin e përcaktimit të regjimit. Kontrata paramartesore dhe rreziqet e diskriminimit gjinor

Regjimi pasuror është diçka që duhet të qartësohet përpara lidhjes së martesës. Regjim me ligj a me kontratë? Bashkësi apo regjim i pasurive të ndara? Ende ka një kulturë të varfër lidhur me regjimet pasurore. Regjimi pasuror është i ndryshueshëm sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në KF.

Nëse bashkëshortët e ardhshëm, përpara lidhjes së martesës, zgjedhin si regjim pasuror martesor atë me kontratë, janë ata që përcaktojnë rregullat mbi regjimin pasuror. Marrëveshja e tillë, kalon në filtrin e respektimit të rregullave të përcaktuara sipas Kodit të Familjes dhe që duhet të respektohen nga noteri dhe bashkëshortët e ardhshëm në çdo negociatë lidhur me regjimin pasuror.

Përtej sa përmban ligji, është shumë e rëndësishme që në marrëveshje të tilla, pra në kontratën paramartesore, të ruhet balanca e mosdiskriminimit gjinor të bashkëshortëve, parë në tri drejtime kryesore: të drejtat pasurore të bashkëshortëve gjatë martesës; detyrimet e tyre pasurore dhe tagrat apo thënë ndryshe pushtetet.

Rregullat e regjimit pasuror martesor do të luajnë rolin e tyre gjatë martesës dhe në mbarim të martesës ose më saktë në mbarim të atij regjimi që jo domosdoshmërisht mund të jetë mbarimi i martesës. Kështu që statusi ligjor i regjimit të zgjedhur duhet të kuptohet drejt duke e matur efektin e regjimit në episodet e sipërpërmendura të jetës martesore. Në çfarë mase regjimi do të përcaktojë rregullat në martesë, pra sa martesa do të ndikohet nga rregullat e regjimit pasuror? Sa parashikues duhet të jetë

regjimi? Cilat janë rreziqet e diskriminimit dhe të pabarazisë që mund të shfaqen në regjimet pasurore martesore.

Çfarë duhet të vlerësohet kur përpilohet kontrata martesore ose paramartesore me qëllim që, kundrejt parimeve të barazisë midis bashkëshortëve, të mos goditet me pavlefshmëri?

Veç elementëve të formës për këtë kërkohet një balancë e fortë midis:

- ❒ Të drejtave dhe 'interesit të familjes dhe martesës';
- ❒ Të drejtave dhe "interesave të bashkëshortëve".

Të tria, përfshirë edhe formën, duhet të shihen si komplementare dhe në unitet dhe jo si forca divergjente me njëra tjetrën. Gjithsesi, në vlerësimin e interesave, kanë prioritet ato që lidhen ngushtësisht me familjen dhe martesën sepse qëllimi i regjimit nuk është që të devijojë nga detyrimet për këto institute.

Ndonëse kontrata paramartesore apo martesore përcakton një regjim pasuror dhe qëllimi është që çifti të përcaktojë vetë rregullat që qeverisin marrëdhëniet e tyre pasurore, gjithsesi ata nuk mund të parashikojnë shmangien nga juridiksioni i gjykatës, prandaj, kur ka mosmarrëveshje, është kjo e fundit që në çdo rast, me vendimin e saj përfundimtar, do të vendosë për vlerën e kësaj kontrate.

Cila është vlera e kësaj kontrate kur çështja paraqitet në gjykatë?

Kur çështja e regjimit me marrëveshje paraqitet në gjykatë, kjo e fundit duhet të vendosë, sipas pretendimeve të palëve, nëse, kësaj kontrate do t'i japë vlerë deçizive, do e ulë pjesërisht vlerën e saj apo nuk do e marrë fare në konsideratë.

Për këtë gjykata duhet të ketë parasysh dhe të vlerësojë këta elementë, të dhënë në mënyrë jo shteruese, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerën e saj. Të tillë janë:

- ❒ Presioni që ushtrohet nga njëra palë mbi tjetrën;

Nga gjykata duhen mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat arrihet marrëveshja. Duhet të verifikohet nëse ato janë të tilla ku palët kanë shprehur vullnetin e tyre të lirë, apo vullneti i tyre ka qenë i vesuar. Nëse ka qenë i lirë gjykata do t'i japë kontratës para-martesore vlerë të konsiderueshme, por nëse vullneti ka qenë i vesuar gjykata duhet të jetë shumë e kujdesshme në lidhje me fuqinë që do i japë asaj kontrate si dhe të ketë si qëllim dhënien e drejtësisë me vendimin që do të japë.

- ❒ Cilësia e autonomisë dhe lirisë së vullnetit kundrejt moshës dhe pjekurisë së bashkëshortëve

Asnjëri nga bashkëshortët nuk mund të detyrohet apo të detyrojë tjetrin në përcaktimin e një regjimi pasuror. Asnjë jashtë tyre nuk mund të detyrojë ata të zgjedhin një regjim të caktuar. Kur bashkëshortët ose njëri prej tyre janë nën 18 vjeç dhe gjykata ka lejuar lidhjen e martesës midis tyre, për shkaqe me rëndësi, ata nuk mund të vendosin për një regjim me marrëveshje. Në këtë rast duhet të veprojnë rregullat e bashkësisë ligjore. Por, mundet që negociata e regjimeve me marrëveshje të bëhet përpara moshës 18 vjeç dhe martesa të lidhet pas moshës 18 vjeç. Kështu, është shumë e rëndësishme që gjykata të verifikojë këtë. Nëse palët e

kontratës kanë qenë të rritur, kontratës duhet t'i jepet më shumë vlerë, se sa kur ato janë të rinj. Kjo duhet çmuar edhe në lidhje me paaftësitë fizike ose mendore të secilës palë. Pra mosha, pjekuria luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin e vlerës së këtyre kontratave. Prania dhe pëlqimi i njëkohshëm është gjithashtu i detyrueshëm, por jo si një element formal por substancial ku prania duhet të evidentohet aktivisht në negociata dhe pëlqimi të mos jetë sa për sy e faqe.

❒ Pozita ekonomike dhe sociale që njëra palë ka kundrejt tjetrës dhe ndarja e kontributeve për detyrimet që rrjedhin nga martesa, nëse këto janë parashikuar në regjimin me kontratë, kundrejt kësaj pozite;

Sipas nenit 54 të KF, "në qoftë se kontributi i bashkëshortëve për detyrimet që rrjedhin nga martesa nuk është rregulluar me kontratën martesore, ata do të kontribuojnë për nevojat e familjes në përputhje me kushtet dhe aftësitë e tyre"[103]. Kontributi për nevojat e familjes duket se është një institut kyç në cilësinë e jetës familjare. Kujdesi për të realizuar/ përmbushur këtë kontribut shfaqet në dispozita të ndryshme të KF. Kështu kontributi, në kuptimin e masës, duhet parë në raport me të ardhurat dhe burimet që kanë bashkëshortët duke ruajtur balancën: në kuptimin që kush ka më pak burime e të ardhura nuk mund të kontribuojë më shumë. Nuk mund të lihet mënjanë në listën e kontributeve ato që vijnë si kontribut nga puna e papaguar në shërbim dhe përkujdesje për familjen. Nisur nga rëndësia që ka kontributi për detyrimet që burojnë nga martesa, në nenin 65 ka kufizime lidhur me disponimin e të ardhurave të çdo natyre qofshin ato. Ky nen parashikon se, secili nga bashkëshortët mund të disponojë të ardhurat nga puna dhe të ardhurat e tjera, sipas regjimit pasuror martesor përkatës, pasi të ketë kontribuar në detyrimet që rrjedhin nga martesa.

❒ Njohuritë e pamjaftueshme të njërës palë lidhur me kontratën paramartesore;

Duhet që palët jo vetëm të nënshkruajnë këtë marrëveshje por edhe të kenë si qëllim atë që ato kanë nënshkruar. A janë të ndriçuar mjaftueshëm bashkëshortët e ardhshëm dhe a i kuptojnë në mënyrë të njëjtë klauzolat kontraktore? Kjo vlerësohet në raport me negociatat që palët kanë bërë para lidhjes së kontratës lidhur me regjimin pasuror martesor. Për të kuptuar këtë duhet ditur se cili ka qenë edukimi apo kualifikimi i secilës, për të parë nëse ato kanë qenë në gjendje të vlerësojnë drejt kushtet e kontratës që kanë nënshkruar si dhe a kanë patur ato mundësi për të parashikuar të ardhmen në mënyrë të tillë që të kenë qenë të bindura për pasojat që dëshironin. Pra, duhet të shikohet nëse nënshkrimi i kësaj kontrate dhe i kushteve të parashikuara në të, ka qenë ajo që palët kanë dëshiruar në të vërtetë.

❒ Mundësia për të patur ose jo kështillim ligjor cilësor.

Në rastet kur palët kanë lidhur një kontratë të tillë para-martesore me kështillën e avokatëve të tyre, gjykata duhet t'i japë vlerë këtij fakti,

[103] Gati një qëndrim të përsëritur mban edhe neni 116 i KF. "Bashkëshortët kontribuojnë në detyrimet që rrjedhin nga martesa, sipas përcaktimit të kushteve në kontratën e martesës. Në rast se kontrata e martesës nuk përmban asgjë lidhur me detyrimet që rrjedhin nga martesa, bashkëshortët kontribuojnë sipas nenit 54 të këtij Kodi."

përveç rastit kur gjykata arrin në konkluzionin se marrja në konsideratë e marrëveshjes do të çojë në padrejtësi në lidhje me palët. Shkaqet se përse mund të ndodhë kjo mund të jenë të ndryshme.

❒ Një ndryshim thelbësor i rrethanave kur gjykohet çështja kundrejt rrethanave kur është lidhur kontrata

Jeta familjare ka dinamikën e vet. Disa faktorë, ndonëse sjellin ndryshim, nuk do të thotë se kanë sjellë modifikim të plotë të gjendjes nga ajo që palët kanë konsideruar në marrëveshje. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme që të merren në analizë dhe në konsideratë ndryshimet e kushteve dhe rrethanave në momentin e zgjidhjes së martesës ose mbarimit të regjimit me atë kontratë. Është e pamundur të bësh një parashikim të mirë të së ardhmes në momentin e lidhjes së kontratës. Mund të ndodhë që kushtet të kenë pësuar një ndryshim aq drastik, saqë situata të jetë totalisht në kundërshtim me situatën në të cilën palët nënshkruan kontratën. Mundet që palët me kalimin e kohës të jenë pasuruar apo të kenë falimentuar, të jenë sëmurë apo të jenë bërë të paaftë. Nëse ky ndryshim i kushteve arrin të provohet para gjykatës, ajo do t'i shmanget zbatimit të saj, në të kundërt ajo do të zbatohet. Prandaj gjykata ka për detyrë të kontrollojë në mënyrë të pavarur marrëveshjet e bëra midis palëve dhe t'i vlerësojë ato nën dritën e rrethanave të rastit, duke vlerësuar interesat e familjes dhe të martesës si prioritare, kundrejt atyre pasurore të bashkëshortëve.

❒ Pamundësia për të bërë një parashikim të mirë dhe të plotë të së ardhmes në momentin e lidhjes së kontratës.

Është shumë e rëndësishme që gjykata të vlerësojë edhe këta faktorë të tjerë, si: A ka fëmijë çifti në kohën e lidhjes së marrëveshjes paramartesore ose ndryshimit të regjimit pasuror? Sa janë marrë në konsideratë interesat e fëmijëve dhe nevojat për mbështetje të tyre?

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje, pra kontratës së regjimit pasuror martesor, duhet të sjellë drejtësi. Parimi i përparësisë së të drejtave e detyrimeve që burojnë nga martesa duhet të jetë orientimi kryesor në vlerën e këtij akti. Do të ishte absolutisht e pavlefshme një regjim me kontratë në të cilin cenohen elementët thelbësore të martesës dhe familjes.

Regjimi me kontratë 'është një kontratë'. Pra, kujdesi ndaj respektimit të parimeve të së drejtës kontraktore kërkon vëmendje më shumë, e cila duhet të jetë e fokusuar ndaj interesit të familjes, martesës e bashkëshortëve. Pa dyshim që një rol të veçantë pritet të luajë noteri. Nëse regjimi me kontratë nuk është zgjedhur para-martese, atëherë çifti ka të drejtë që të kërkojë një regjim të tillë pas 2 vjetësh nga lidhja e martesës duke argumentuar se çfarë e motivon këtë ndryshim radikal, çfarë ka ndryshuar në ekonomi apo çfarë problemi ka krijuar regjimi i parë në funksion të interesit të familjes.

Në çdo rast, kalimi nga një regjim pasuror në tjetrin, bëhet me pëlqimin e të dy bashkëshortëve sipas rregullave të KF (shih trajtimin më sipër). Gjithashtu, kalimi në një regjim pasuror me kontratë mund të ndodhë kur bëhet pjesëtimi i detyrueshëm i pasurisë në rastin e regjimit të bashkësisë ligjore. Në këtë mënyrë i hapet rrugë regjimit të pasurive të ndara.

Kodi i familjes rendit ndër regjimet me kontratë atë të: bashkësisë me kontratë [e rregulluar në disa forma e mënyra[104]] dhe atë të regjimit të pasurive të ndara.

Ka disa rregulla që bëjnë klasifikimet e regjimeve me kontratë në bashkësi apo pasuri të ndara. Këto rregulla kanë të bëjnë me:

- ❒ përmbajtjen e pasurive, përmbajtjen e pjesëve dhe ndarjen e tyre;
- ❒ rregullimet në skemën e kredive (të ardhura dhe përfitime);
- ❒ rregullimet në skemën e detyrimeve.

Kështu, p.sh.: bashkësia me kontratë sjell pasoja në përbërjen e pjesëve duke vendosur rregullime të reja lidhur me pjesët dhe ndarjen e tyre, ndryshe nga bashkësia ligjore që nënkupton barazinë e pjesëve. Në këtë mënyrë, bashkëshortët bien dakord që të kenë në bashkësi pjesë jo të barabarta (neni 112-113 KF). Kjo ndarje jo e barabartë duhet të reflektohet edhe në përgjegjësinë ndaj detyrimeve. Çka do të thotë që detyrimet janë në përpjesëtim të drejtë me pjesën që i takon secilit bashkëshort në bashkësinë me kontratë. Çdo rregullim në kundërshtim me parimin e reciprocitetit është i pavlefshëm. Çdo klauzolë e kontratës është e pavlefshme nëse detyron bashkëshortin me pjesë të kufizuar ose trashëgimtarët e tij të përballojnë një detyrim më të madh se pjesa e tyre në bashkësi ose të përjashtohen nga përballimi i detyrimit të tyre në raport me këtë pjesë. Kjo vlen edhe për trashëgimtarët e bashkëshortëve, të cilët i përballojnë detyrimet në raport me pasurinë që kanë trashëguar nga bashkësia.

- ❒ Rregullimet lidhur me administrimin dhe përfaqësimin

Kujdes! Kontrata martesore nuk duhet parë si një mjet ku njëri bashkëshort vendos si prioritare interesat e veta. Në një kontratë martesore duhet të ketë drejtësi, reciprocitet dhe mundësi të barabarta për të dy bashkëshortët. Regjimi me kontratë siguron një lloj sigurie në kuptimin që "të mbron" nga detyrimet vetjake të bashkëshortit dhe skemat e këtij regjimi kanë karakter elastik për të siguruar avantazhe reciproke ndërmjet bashkëshortëve në aspektet pasurore. Kjo nuk nënkupton se efekte të tilla janë të munguara në regjimin e bashkësisë ligjore.

Duke e analizuar regjimin me kontratë, kuptojmë se nëse përmes tij synohet të shmangen detyrimet që burojnë nga martesa, ky regjim është nul. Kështu, nëse bashkëshortët kanë zgjedhur regjimin e pasurive të ndara, dhe njëri prej tyre gjendet përpara një nevoje ekstreme shëndetësore që nuk mund të realizohet me pasurinë e vet të ndarë, sipas regjimit të pasurive të ndara, kjo nuk do të thotë që tjetri "të mbrohet" nga pretekstet e regjimit të zgjedhur e të mos kontribuojë. Kjo cenon thelbin e martesës pa të cilën çdo regjim është një kështjellë në rërë.

Për të dhënë drejtësi, në rastet ku gjykohet lidhur me pasojat e një regjimi, gjykata duhet të fokusohet në tri elemente kryesorë: nevojës; kompensimit; pjesëtimit/ndarjes. Gjykata duhet të ketë parasysh se sa janë të

[104] Bashkësi të thjeshtë apo të 'zakonshme' me kontratë, në bashkësi të pjesëve jo të barabarta ose në bashkësi universale.

ardhurat, aftësia fituese, pasuritë e secilës palë. Cilat janë nevojat financiare, detyrimet dhe përgjegjësitë që ka dhe do ketë secila palë pas zgjidhjes së martesës. Cili ka qenë standardi i jetesës para zgjidhjes së martesës. Cila ka qenë mosha e secilës palë dhe kohëzgjatja e martesës së tyre.

Element tjetër shumë i rëndësishëm për gjykatën është edhe kontributi i secilit prej tyre në krijimin dhe shtimin e pasurisë bashkëshortore, duke përfshirë këtu edhe kujdesin ndaj familjes, shtëpisë dhe fëmijëve. Secili nga llojet e kontributeve do të vlerësohet sepse martesa, për shkak të jetesës së përbashkët midis burrit dhe gruas, sjell edhe detyrueshmërinë e kontributit të secilit prej tyre në pasurinë bashkëshortore.

A është standardi i jetesës pas zgjidhjes së martesës i krahasueshëm, i ngjashëm, i përafërt me standardin e jetesës gjatë martesës? Pra, një analizë cilësore mund të çojë në vlerësimin e pasojave pasurore të tilla që çojnë ose jo në detyrimin për kontribut kompensues. Ky quhet gjykim i drejtë mbi pasojat e zgjidhjes së martesës. Ndërsa praktika gjyqësore nuk adreson problematikën e kontributit kompensues, si institut i së drejtës familjare, duket se mbetet sfidë e çifteve që zgjidhin martesë për të bërë një kërkesë të tillë. Nga ana tjetër ky institut do të kërkojë që gjykata të bëjë analizën e duhur mbi atë që është e moralshme dhe e virtytshme me qëllim që kontributi kompensues të mos jetë një qëllim në vetvete e të sjellë pasoja të pakontrolluara sociale dhe ekonomike por diçka plotësisht e merituar. Për këtë nuk ka formula dhe përgjigja e gjykatës do të variojë sipas kontekstit që rasti konkret sjell. Ajo çka duhet ngritur nga teoria në praktikë është aplikimi i standardeve të Michael Jang, sociolog britanik ky, i cili në vitin 1958 përdori për herë të parë termin "meritokracia" duke nënvizuar meritën si diçka të përcaktuar si "aftësi plus përpjekje".

Çështja e kontributit kompensues ka vështirësitë e veta. Kjo paraqitet e tillë edhe në sistemin common law të së drejtës ku për këtë çështje nënvizohet se lidhur me masën nuk ka një ligj apo një precedent sepse kjo varet nga faktet e sjella rast pas rasti[105]. Duke i lënë vendin në këtë gjykim vlerësimit rast pas rasti të gjykatës konsiderohet se guidat udhëzuese në këtë drejtim mund të jenë subjektive dhe të pasakta. Kriteret lidhur me 'kërkesa të arsyeshme' apo parimin e ndarjes së barabartë të parave në mënyrë të njëanshme mund të cenojnë vlerën e institutit si të tillë, duke e kthyer këtë në interpretimin e gjerë mbi nevojat që ka bashkëshorti pas zgjidhjes së martesës.

Ndaj, ushtrimi kryesor është standardi i jetesës gjatë martesës dhe mundësitë që ky standard të mund të mbahet edhe pas zgjidhjes së saj duke përllogaritur për këtë të ardhurat e kombinuara të çiftit.

Nga aktivitetet trajnuese të zhvilluara me avokatët dhe asistent-avokatët e Dhomave Rajonale të Durrësit dhe Vlorës, Qendra për Trajnime dhe Studime Juridike, ka konstatuar se këta nuk e kishin të qartë këtë

[105] Shih: "What is the Measure of Maintenance?" How does the court quantify spousal periodical payments? Alexander Chandler, of 1 King's Bench Walk, considers the court's approach to quantum of maintenance post Charman and Miller në: http://www.familylawweek.co.uk/site.aspx?i=ed33597

institut dhe nuk e aplikonin në proceset e zgjidhjes së martesës, edhe kur këto diferenca pasurore ishin evidente[106]. Në këtë kontekst, meqë ndër indikatorët për vlerësimin e këtij kontributi [neni 149 KF] është edhe koha e shpenzuar dhe koha që i duhet prindit të shpenzojë për edukimin e fëmijëve, kualifikimi profesional; predispozita për punë të reja, etj, është shumë e rëndësishme që të përgatiten lista kontrolli efektive për gjykatën dhe avokatët se si të masin e kërkojnë një të drejtë të tillë. Kjo kërkesë është paraqitur prej gjyqtarëve dhe avokatëve njëkohësisht.

4. Mjetet juridike që mund të përdoren kundrejt bashkëshortit që shkel detyrimet që burojnë nga martesa

KF parashikon disa masa urgjente ndaj bashkëshortit që nuk respekton detyrimet dhe të drejtat e bashkëshortit tjetër të tilla si:

- Sekuestrimi i të mirave të bashkëshortit të larguar, në masën e duhur (56\2);
- marrja e autorizimit të gjykatës për të kryer një veprim juridik për të cilin nevojitet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër (58);
- Autorizimi nga gjykata për të përfaqësuar bashkëshortin tjetër në veprime juridike që lidhen me regjimet pasurore martesore (59);
- Largimi nga banesa i bashkëshortit dhunues (62).

Aplikimi i padisë së pavlefshmërisë së martesës:

Martesa e lidhur nga bashkëshortët pa pasur qëllim për jetë të përbashkët si burrë e grua hyn në rastet e pavlefshmërisë absolute [neni 36 KF]. Të drejtën e padisë për pavlefshmëri në rastin e martesës pa qëllimin e jetës së përbashkët e ka secili nga bashkëshortët, prokurori dhe kushdo tjetër që ka një interes të drejtpërdrejtë të ligjshëm. Kjo padi mund të ngrihet edhe pas zgjidhjes së martesës[107]. Pra, nëse jemi përpara një rasti pavlefshmërie, gjykata mund të investohet nën këtë kërkesë padi.

Ndërprerja e ndihmës materiale e morale:

E drejta për ndihmë morale dhe materiale e parashikuar në KF ndërpritet kundrejt bashkëshortit, që është larguar pa shkak nga vendbanimi familjar dhe refuzon të kthehet. Kështu parashikon neni 56 i KF. Ka disa detyrime që ekzistojnë midis bashkëshortëve edhe pas

[106] Intervistë me Arban Tutulani, Drejtor Ekzekutiv i ACLTS.

[107] Pas zgjidhjes së martesës nuk do të thotë që këtu përfshihen edhe rastet e tjera të mbarimit të martesës. Vetë legjislatori në nenin 45 e ka specifikuar vetëm zgjidhjen e martesës. Në praktikën gjyqësore, ka raste që gjykimi i pavlefshmërisë është bërë edhe pas mbarimit të martesës për shkak të vdekjes. Për të mbështetur argumentin tonë, nënvizojmë se kjo përforcohet edhe nga neni 48 i KF. "E drejta e padisë për shpalljen e pavlefshmërisë së martesës nuk u kalon trashëgimtarëve, përveçse kur gjykimi ka filluar përpara vdekjes së bashkëshortit. E drejta e trashëgimtarëve kufizohet vetëm për rastet që prekin rendin publik dhe jo për raste që kanë të bëjnë thjesht me mbrojtjen e të drejtave të bashkëshortëve, si lajthimi e kërcënimi." Pra, ka filluar gjykimi por nuk ka një vendim përfundimtar dhe çështja implikon situatat e pavlefshmërisë absolute. Shih Vendimi nr.277/09.02.2010 i GjRrGj Vlorë.

zgjidhjes së martesës. Psh, detyrimi për ushqim për bashkëshortin nevojtar dhe kontributi kompensues. Jemi të mendimit se, nëse bashkëshorti që është larguar pa shkak nga vendbanimi familjar pretendon këto të drejta, ai/ajo do të konsiderohen të palegjitimuar sepse martesa nuk është vendi i përfitimeve padrejtësisht por i reciprocitetit, aq më tepër që është shkelur detyrimi i jetës së përbashkët. Vetë dispozita e thotë në mënyrë të qartë: ndërpritet ndihma morale e materiale. Nëse kjo ndodh sa kohë çifti është ende i martuar, ca më shumë, për këtë ndihmë, nuk mund të bëjmë fjalë dhe as nuk mund të pretendohet pas zgjidhjes së martesës. Nga ana tjetër duhet nënvizuar se bashkëshorti që largohet pa shkak nga vendbanimi familjar është i detyruar të paguajë detyrimin për ushqim dhe, nëse është rasti, kontributin kompensues.

Sekuestrimi i të mirave:

Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga martesa, gjykata, sipas rrethanave, mund të urdhërojë sekuestrimin e të mirave të bashkëshortit të larguar, në masën e duhur.

Jemi të mendimit se në një rast të tillë, gjykata, me kërkesën e bashkëshortit që ka qëndruar në vendbanimin e përbashkët, mund të lejojë edhe pjesëtimin e pasurisë së bashkësisë ligjore. Kjo do të mundësojë që në rast se fitohet pasuri gjatë kësaj periudhe, kjo të mos llogaritet si pasuri e bashkësisë ligjore por vetjake. Në këtë rast, si dispozitë që mund të përdoret nga ana e bashkëshortit është neni 98 i KF. Sipas këtij neni, pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohet në gjykatë në rast kur njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi. Pa dyshim që një bashkëshort që largohet nga vendbanimi pa marrëveshje me tjetrin dhe jo për punë ose qëllime në interes të familjes, nuk kontribuon për të. Në këtë rast, ndarja e pasurisë mund të kërkohet nga njëri prej bashkëshortëve ose nga përfaqësuesi i tij ligjor. Vendimi i gjykatës për ndarjen ka fuqi që nga data kur është paraqitur kërkesa dhe i vendos bashkëshortët nën regjimin e pasurive martesore të ndara, të parashikuar në këtë Kod.

Përmes masave të tjera:

Bashkëshorti i interesuar mund të kërkojë realizimin e mbrojtjes së të drejtave përmes zbatimit të neneve 58, 59 dhe 60 të Kodit të Familjes

❒ Sipas nenit 58 të KF:

Sigurohet e drejta për marrjen e autorizimit nga gjykata për veprime që lidhen me administrimin e pasurisë. Pra, për të kryer një veprim juridik, për të cilin bashkëpunimi ose pëlqimi i bashkëshortit tjetër do të ishte i nevojshëm, në qoftë se ky i fundit nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose në qoftë se refuzimi i tij vjen në kundërshtim me interesin e familjes.

❒ Sipas nenit 59 të KF:

Sigurohet nga gjykata autorizimi për përfaqësim. Në rast se bashkëshorti nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, bashkëshorti tjetër mund ta përfaqësojë në të gjitha veprimet juridike ose në veprime juridike të caktuara që lidhen me regjimin pasuror martesor. Kushtet dhe

gjerësia e përfaqësimit përcaktohen në autorizimin e dhënë nga gjykata.

- Sipas nenit 60 të KF:

Përmes marrjes së masave emergjente të cilat u trajtuan më sipër edhe nën këndvështrimin e Rekomandimit të Këshillit të Europës.

PJESA E KATËRT: MBARIMI I MARTESËS DHE INSTITUTE TË TJERA TË SË DREJTËS FAMILJARE NË FOKUSIN E RREZIQEVE TË DISKRIMINIMIT GJINOR

1. Jeta familjare pas mbarimit të martesës. Diversiteti i pasojave në varësi të gjinisë së bashkëshortëve

Pas mbarimit të martesës për shkak të vdekjes apo të zgjidhjes së saj nis një jetë e re, qoftë për nga pasojat personale, qoftë për nga ato pasurore. Nuk ka një studim adekuat në Shqipëri që të marrë në analizë këtë aspekt të jetës kundrejt përkatësisë gjinore. Studiues të huaj nënvizojnë diversitetin e pasojave të cilat janë edhe të lidhura me gjininë[108] dhe që mund të analizohen në disa drejtime të tilla si:

- Procesi ligjor i zgjidhjes së martesës dhe pasojat e tij kundrejt gjinisë;
- Pasojat financiare, ekonomike ose që kanë impakt në mirëqenie;
- Pasojat psikologjike dhe emocionale;
- Pasojat lidhur me përgjegjësitë prindërore;
- Pasojat lidhur me marrëdhëniet ndërprindërore.

Pasojat pasurore, si të tilla përfshijnë sferën ekonomike dhe në këtë kategori hyjnë detyrimi për ushqim për ish-bashkëshortin, kontributi kompensues për ish-bashkëshortin; e drejta e trashëgimisë pas mbarimit të martesës për shkak të vdekjes së njërit prej bashkëshortëve.

Sa i përket ndarjes së roleve gjatë martesës, është shumë e rëndësishme që ligji të kuptohet qartë: në rastin e mbarimit të një regjimi pasuror martesor, kur nuk kemi regjimin e pasurive të ndara, secili bashkëshort ka të drejtën e një pjesëmarrjeje të barabartë në përfitimet financiare dhe në pjesëtimin e pasurisë. Me këtë nuk duam të themi që në rastin e regjimeve të pasurive të ndara, bashkëshortët nuk kanë disa detyrime financiare ndaj bashkëshortit tjetër siç mund të jenë kontributi kompensues, detyrimi për ushqim, etj.

Kjo duhet të jetë edhe në vëmendjen e gjykatës.

Praktika ka treguar se pasojat që lë mbarimi i martesës tek bashkëshortët varen shumë nga gjinia e bashkëshortit/es. Jo të gjitha këto kanë të bëjnë me pronën në një kuptim të ngushtë sepse kjo mund të ndahet 'barabar' edhe kur barazia mund të çojë në pabarazi, por shumica kanë të bëjnë me marrëdhëniet

[108] Hoffman, S. D., & Duncan, G. J. (1988). "What are the economic consequences of divorce". Demography, 25(4), 641-645.; Avellar, S., & Smock, P. J. (2005). "The economic consequences of the dissolution of cohabiting unions". Journal of Marriage and the Family, 67(2), 315-327; Sorensen, E., & Hill, A. (2004). "Single mothers and their child-support receipt - how well is child-support enforcement doing?" Journal of Human Resources, 39(1), 135-154. Një listë e botimeve në këtë aspekt gjendet si referencë nw:https://dspace.library.cornell.edu/bitstream/1813/14235/2/KristenReillyFinalThesis1.pdf

financiare midis personave të martuar pas martesës ose detyrimet financiare që ata kanë kundrejt njëri tjetrit ose aftësive të ndryshme që ka njëri bashkëshort kundrejt detyrimeve për personat e tjerë që mbeten në ngarkim të tij/saj. Psh, nisur nga fakti se përgjithësisht nëna është vendosur nga gjykata të jetë ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore mbi fëmijën[109], mbetet që ati i fëmijës të ketë detyrimin për ushqim si një ndër detyrimet e caktuara nga gjykata. Pa i hyrë analizës së masës së detyrimit për ushqim, praktika ka treguar se sa stresuese është për nënën që të kërkojë në mënyrë të përsëritur sa herë kalon koha për përmbushjen e detyrimit për ushqim. Po, kështu, duke qenë se nëna është ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore, i takon asaj që për çdo aspekt që lidhet me jetën e saj private të vërë në dijeni ish-bashkëshortin nëse kjo implikon kontaktet e këtij të fundit me fëmijët. Intervistat e avokateve sjellin fakte mbi pengesat e shumta që u bëhen grave në këtë drejtim duke mos lejuar lëvizjen e fëmijëve. Nga ana tjetër, disa detyrime të parashikuara kundrejt një shume të caktuar, nuk janë të tilla edhe në jetën reale. Çdo prind e ka të qartë se si evoluojnë në rritje kërkesat e fëmijëve dhe nevojat e tyre në grupmosha të ndryshme.

2. Zgjidhja e martesës dhe rëndësia e përcaktimit të vlerës së punës së papaguar kundrejt standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit

Në tekstin "Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi"[110] për studentët e fakultetit të drejtësisë, bashkautorët ndalen në kuptimin e punës së papaguar me qëllim që juristët e rinj, avokatet e gjyqtarët e së nesërmes të kenë koncepte të qarta dhe të mund të kalkulojnë kontributet e përfituara nga familja e martesa falë punës së papaguar dhe të mos e injorojnë këtë.

Në familje ka disa kontribute që janë të dukshme, disa të padukshme ose që anëtarët e familjes i përfitojnë por i injorojnë, madje në ndonjë rast janë edhe vetë ata që kryejnë këto punë. Sipas KF, në rastin e regjimit të bashkësisë ligjore, çdo pasuri e fituar gjatë martesës, qoftë edhe vetëm nga të ardhurat e njërit bashkëshort, konsiderohet si pasuri e përbashkët[111]. Në këtë mënyrë, me plotësisht të drejtë, regjimi i bashkësisë ligjore, përmirëson pozitën e atij bashkëshorti që i dedikohet më shumë veprimtarisë shtëpiake dhe edukative të fëmijëve se sa "biznesit". Në këtë mënyrë KF mbron pozitën e atij bashkëshorti që duke u angazhuar në sferën e punëve të papaguara, lë pas dore përvojën e vet të punës, kualifikimet profesionale, specializimet apo trajnimet.

Nëse njëri nga bashkëshortët i dedikohet më shumë disa shërbimeve në familje, do të thotë që kjo mund të ndikojë negativisht, në të ardhmen, në rast

[109] Raporti i monitorimit të QNLQ i cituar në këtë studim e ka nxjerrë këtë fakt.

[110] Anastasi.A, Mandro.A, Shkurti.E, Bozo.A "Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi"

[111] Kodi i Familjes, neni 76: "Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak."

zgjidhjeje martese, në gjendjen ekonomike të atij bashkëshorti. Kështu, në rast zgjidhjeje të martesës, nëse dikush ka lënë mbrapa karrierën e kualifikimet për interesa të familjes, kjo ndikon negativisht në gjendjen ekonomike e financiare të tij/saj. Ndaj jepet mesazhi i barazisë dhe mosdiskriminimit se: çka është fituar gjatë martesës është kontribut i angazhimeve të përbashkëta. Gruaja, apo kushdo qoftë, nuk e fiton këtë pasuri pa meritë.

Përgjithësisht gruaja është kontributorja kryesore në disa punë që janë të papaguara por që janë të domosdoshme për interesin e familjes [shih nenin 23 të Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri"-2008]. Sipas nenit 103 të KF, "pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivit dhe pasivit të saj". Gjykata, në bazë të nevojave të fëmijëve dhe nga fakti se kujt do t'i besohen ata, (kuptohet në rastet e zgjidhjes së martesës), mund të vendosë në favor të një bashkëshorti kalimin e një pjese të pasurisë së bashkësisë që i takon bashkëshortit tjetër dhe, në këtë mënyrë, të vendosë ndryshe nga situata e zakonshme ku pasuria e bashkësisë ndahet në mënyrë të barabartë. Pra, Kodi nuk e ka lidhur këtë disproporcion me vetë bashkëshortët por me interesin e fëmijëve.

Ligji i Barazisë Gjinore në shoqëri [2008] synon të ridimensionojë vlerësimin e punës së papaguar. Në nenin 23 kjo lloj pune vlerësohet si kontribut për familjen dhe shoqërinë. Të dhënat tregojnë se subjektet më shumë të përfshira në "sektorin" e punës së papaguar janë gratë. Si puna e paguar, ashtu edhe puna e papaguar janë shumë të rëndësishme për ekonominë dhe mirëqenien. Që të dyja kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë që familja të mund të përballojë jetesën. Anketa e Përdorimit të Kohës përgatitur nga INSTAT na jep më shumë informacion lidhur me këtë aspekt[112]. Këtij dokumenti, në vijim, po i referohemi në mënyrë të përsëritur në studim. Sipas INSTAT, nga totali i punës së papaguar të kryer nga popullsia mbi 10 vjeç e lart, meshkujt kryejnë 14 % ndërsa femrat 86_ përqind. Kjo është një shpërndarje shumë e pabarabartë si në terma absolutë, ashtu edhe në terma relativë krahasuar me vende të tjera evropiane.

Përkundër këtij realiteti që vihet në dukje nga statistikat, nuk ka raste (nisur nga mundësitë që patëm në dispozicion të këtij studimi) të vendimeve ku gjykata të ketë marrë në konsideratë kontributin e bashkëshortes si punë e papaguar.

Kuptimi i punës së papaguar

Në nenin 23 të LBGj [2008] jepet vlerësimi i punës së papaguar dhe përmes këtij neni ne mund të nxjerrim lehtësisht edhe kuptimin e "punës së papaguar". Kështu:

1. Puna e papaguar e femrave dhe e meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo:

a) kujdeset për mirëqenien e familjes;

[112] Shih Studimin e INSTAT mbi përdorimin e kohës 2010-11 në: http://www.instat.gov.al/media/169883/anketa_e_studimit_per_perdorimin_e_kohes_2011.pdf. Pjesa për punën e papaguar gjendet në faqet 29-37 të studimit,

b) kujdeset për fëmijët;
c) kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes;
ç) punon në bujqësi dhe ekonomi familjare.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi.

Pra, aktivitete dhe veprimtari të tilla të cilat kontribuojnë në të mirë të familjes dhe të kujdesit ndaj fëmijëve apo edhe anëtarëve të tjerë të familjes, punët e ndryshme në bujqësi dhe ekonominë familjare, por që nuk janë një punë e shpërblyer sipas metodave dhe mjeteve me të cilat shpërblehet puna e paguar në përgjithësi, ku mungon një raport punëdhënës/punëmarrës në kuptimin e zakonshëm të tij, konsiderohen si punë e papaguar. Për nga lloji dhe mjedisi i ushtrimit, këto veprimtari, që pa diskutim janë punë, mund të realizohen në mjedisin familjar dhe jashtë këtij (pazari, shëtitja e fëmijëve, shoqërimi në shkollë, shoqërimi i të moshuarve në shërbime, etj.) por veçoria e tyre është se janë veprimtari në shërbim të drejtpërdrejtë të anëtarëve të familjes dhe të ekonomisë familjare. Këtu hyjnë veprimtari dhe shërbime që janë shumë të rëndësishme për cilësinë e jetës familjare dhe që nëse do të kryheshin nga individë jashtë familjes, do të kërkonin detyrimisht një shpërblim të këtyre të fundit. Veprimtaria e kryer është punë si gjithë punët e tjera por nuk kontraktohet (paguhet, etj) si punët e tjera por kjo është plotësisht e llogaritshme financiarisht. Në raste të tilla, gjykata, në vlerësimin e komponentëve të punës së papaguar mund të marrë në konsideratë paga të krahasueshme të sektorit përkatës si dhe indeksimin mbi pagën minimum. Për këtë, gjykata mund të orientohet në vendimet e Këshillit të Ministrave për pagën minimum [psh, Vendim Nr. 573, datë 3.7.2013]

Baza e mëposhtme ligjore mund të ndihmojë gjykatën rast pas rasti. Duke qenë se legjislacioni pëson ndryshime, mbetet me rëndësi azhurnimi me të rejat në këtë fushë. Gjithsesi informacioni mund të jetë adekuat nëse merret nga Ministria e Financave apo Departamenti i Administratës Publike.

- LIGJ nr. 7583, datë 13.07.1992 për "Kompetencat për caktimin e pagave te punës".
- LIGJ nr. 9584, datë 17.7.2006 për "Pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj".
- LIGJ nr.10 405, datë 24.3.2011 për "Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve".
- VKM Nr. 393 date 03.09.1992 për "Pagat e punonjësve te institucioneve buxhetore".
- VKM Nr.582 date 25.10.1995 për "Rritjen dhe disa ndryshime ne pagat e punonjësve".
- VKM Nr.317, datë 08.07.1999 për "Shpërblimin e punës së punonjësve".

❒ VKM Nr. 74, date 12. 02. 2004 për "Miratimin e rregullave për indeksimin e pagave".

❒ VKM Nr.139, datë 14.3.2007 për "Kufijtë e përcaktimit të pagës në natyrë dhe kriteret e përllogaritjes së shpërblimit, që i shtohet pagës për leje vjetore".

❒ VKM Nr.1619, datë 02.07.2008 për "Klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore".

❒ VKM Nr.717, datë 23.06.2009 për "Pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore".

❒ VKM Nr.527, datë 20.07.2011 për "Përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

❒ VKM Nr.545, datë 11.8.2011 për "Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit".

❒ Udhëzim nr. 1, datë 24.12.2002 për "Llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni".

❒ Udhëzim Nr .2, datë 5.10.2005 për "Llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar e të pagës neto për efekt pensioni"

Të punosh dhe të mos paguhesh nuk do të thotë që puna nuk ka vlerë. Nëse kjo punë do të kryhej jashtë shtëpisë dhe jo prej apo për anëtarë të familjes, do të kishte pa dyshim pagën e vet. Në fakt, gratë e burrat që i dedikohen punës së papaguar, mund të jenë ose jo të përfshirë në tregun e punëve të paguara. Ka raste që këta janë në pamundësi për tu përfshirë në tregun e punës së paguar', çka lidhet me deficite në vendet e lira të punës dhe nivelin e papunësisë në vend. Ka raste që këta kanë barrën e disa detyrimeve familjare dhe nuk kanë mundësi të kryejnë një punë tjetër të paguar. Nga bilanci i sasisë dhe cilësisë së punëve e shërbimeve që kryejnë, ndodh që këta të jenë kategoria e "të papunëve" me një ngarkesë të krahasueshme ose edhe më të madhe punësh se të punësuarit e paguar.

Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" [2008] përfshin për herë të parë në përmbajtjen e vet dispozita të tilla, të cilat vlerësojnë kontributin e punës së papaguar. Këto dispozita lehtësojnë gjykatën që, në vlerësimin e kontributeve në të mirë të familjes, të shohë me të njëjtin dimension vlere e kontributi edhe punën e papaguar. Madje e bëjnë këtë (gjykatën) të mbajë në vëmendje se realizimi i kësaj veprimtarie mund të jetë shkak i pabarazisë dhe i pengesave që hasin këta individë në integrimin në tregun

e "punës së paguar". Kjo sepse individët që mund të konkurrojnë për një vend pune, nëse i përkasin atyre që kanë kryer punë të papaguar, ka shumë mundësi që të mos kenë përparuar në kualifikim, të kenë mbetur prapa në disa drejtime të azhurnimit me zhvillimet e reja dhe të mos kenë nivelin e duhur/të kërkuar të njohurive, dhe, për rrjedhojë, të mos preferohen krahasuar me të tjerët. Nisur pikërisht nga vlera që ka puna e papaguar dhe ndikimet mbi jetën e personit që ka bërë këtë punë, në rastin e zgjidhjes së martesës, për të bërë vlerësimin e kontributit kompensues, sipas nenit 149 të Kodit të Familjes, nisur nga raporti nevoja-burime, gjykata merr në konsideratë, veç të tjerave, kohën e shpenzuar dhe atë që i duhet të shpenzojë për edukimin e fëmijëve; kualifikimin profesional; predispozitën e tyre për punë të reja, etj.

Kujdesi është një nga llojet e punës së papaguar. Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" [2008] bën fjalë për *kujdesin*. Në këtë përfshihet kujdesi për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes dhe kujdesi për mirëqenien e familjes.

Në një marrëdhënie pune apo jo, gratë janë ato që shpenzojnë një pjesë të madhe të kohës ditore në punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët e anëtarë të tjerë të familjes. Sipas studimit të INSTAT për përdorimin e kohës, punët kryesore të shtëpisë, larja e rrobave dhe hekurosja janë të lidhura jashtëzakonisht shumë me gjininë. Nga gjithë numri i orëve që popullsia e moshës 15-64 vjeç shpenzon për këto aktivitete, femrat kryejnë 96 përqind të tyre dhe meshkujt 4 përqind. Të pasurit fëmijë të vegjël e bën shpërndarjen edhe më të pabarabartë. Në realitetin shqiptar, me gjithë emancipimin dhe përpjekjet për barazi e reciprocitet, janë të rralla rastet e burrave të përfshirë aq sa gratë në këto veprimtari. Këtu përfshihen veprimtari të tilla, si: pastrimi i shtëpisë, blerjet përditshme dhe punët e tjera në shtëpi, përgatitja e vakteve, kujdesi për fëmijët, etj. Një aktivitet tjetër i grave është kujdesi për prindërit e tyre dhe prindërit e bashkëshortit. Koha që konsumojnë gratë në këto shërbime rezulton e lartë në raport me burrat.

Studimet e bëra, përfshi atë të përdorimit të kohës nga INSTAT, tregojnë se ndërkohë që gruaja merret me pafundësinë e punëve në familje, burrat e shpenzojnë shumicën e kohës duke kërkuar punë [nëse janë të papunë], ose duke dalë me shokët në ndonjë lokal, duke u përfshirë në aktivitete sportive, ose aktivitete të tjera jashtë shtëpisë, etj. Studimi mbi Përdorimin e Kohës i INSTAT, tregon se gratë kanë më pak kohë të lirë krahasuar me burrat, për shkak të angazhimeve të tyre shtëpiake. Meshkujt kanë mesatarisht një orë e gjysmë më shumë kohë të lirë se femrat. Pjesa e mbetur prej gjysmë ore lidhet me vaktet/kafetë, kryesisht në restorante.

Ky është rasti si për gratë e punësuara me pagë ashtu edhe për ato të papuna ose ekonomikisht jo aktive. Gratë shpenzojnë shumë pak kohë për veten e tyre, ose për aktivitete argëtuese. Burrat kalojnë kohën e lirë shumë jashtë shtëpisë, për gratë ajo kufizohet brenda shtëpisë. Studimet me natyrë statistikore kanë vlerë të pazëvendësueshme në çështje delikate dhe ku standardi i një gjykimi të drejtë mund të luhatet në mungesë të

tyre. Në këtë studim i jemi referuar në mënyrë të përsëritur studimit mbi përdorimin e kohës, çka mund të ndihmojë gjykatën në një perceptim të drejtë të realitetit. Nga ana tjetër, kur çështje të tilla paraqiten, mund të ishte me vend thërritja si ekspert e individëve me njohuri të spikatura në këtë drejtim, me qëllim që praktika gjyqësore të ndërtohet duke mbajtur parasysh zhvillimet, të cilat jo në çdo rast mund të maten lehtësisht nga gjykata. Kjo teknikë përdoret edhe nga GJED dhe GjEDNJ të cilat nuk hezitojnë që në kuadrin e një gjykimi të drejtë të marrin në konsideratë statistika e raporte, edhe të OJF-ve, të cilat paraqesin situatën në vend dhe japin tendencën e një fenomeni.

Nga praktika që kemi marrë në shqyrtim, nuk e kemi hasur një konsultim të tillë nga ana e gjykatës vendase.

Kujdesi për mirëqenien e familjes: këtu duhet të kuptojmë lidhjen dhe harmoninë që krijojnë termat "kujdes", "mirëqenie" dhe "familje". Dashuria dhe respekti që ndërtohet në familje përfshin edhe kujdesin që tregohet brenda mjedisit familjar ndërmjet anëtarëve të familjes. Sipas nenit 3 të KF, "Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve". Familjet janë njësi shoqërore shumë funksionale. Familja përbëhet nga anëtarët të cilët kanë shumë detyra dhe të drejta në raport me shoqërinë në tërësi dhe me individin në veçanti. Anëtarët e familjes vendosin lidhje emocionale, afektive, shoqërizimi ndërmjet tyre. Martesa ose bashkëjetesa i jep burrit dhe gruas rol parësor në familjen sa kohë ata duhet të kujdesen edhe për njëri-tjetrin, edhe për fëmijët por edhe për më të moshuarit. Gjatë jetës së tyre këta duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet dhe të kujdesen për të zhvilluar një marrëdhënie të ngrohtë e miqësore jo vetëm midis tyre, por edhe me të gjithë anëtarët. Lidhjet emocionale janë rrjedhojë e ndjenjës së dashurisë që ekziston midis anëtarëve të familjes, bashkëshortëve me njëri-tjetrin dhe si prindër me fëmijët e tyre, të dhembshurisë, përkushtimit e respektit reciprok, të mirëkuptimit, të ndarjes bashkërisht të gëzimit e të hidhërimit, të sakrificave dhe të të mirave materiale e jo materiale. Ndjenja e dashurisë, e respektit dhe e mirëkuptimit reciprok janë baza e unitetit në familje. Kujdesi për mirëqenien e familjes përfshin aspekte të mirëqenies morale e materiale. Mirëqenia kërkon kontributin dhe kujdesin për sigurimin e një standardi të mirë jetese, duke përfshirë këtu ushqimin, pastrimin, veshjen, banesën, trajtimin mjekësor, shërbimet e tjera të nevojshme, etj, etj. Nga martesa lind detyrimi reciprok për ndihme morale **dhe materiale**, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës. Ndërsa kujdesi për mirëqenien e familjes duhet të jetë kontribut i të gjithë anëtarëve të saj, konstatohet se ka disa aspekte të kujdesit ku gratë luajnë një rol më të madh.

Ndonjëherë kujdesi për mirëqenie është i lidhur me disa nevoja plotësisht bazike por që kërkojnë shumë kohë, forcë fizike dhe psikologjike. Këtu renditim furnizimin me ujë të pijshëm që jo gjithnjë e kemi me

bollëk e pa sakrifica, sidomos në zonat rurale[113]. Nëse kalojmë tek energjia elektrike, pa të cilën nuk funksionojnë pajisjet elektro-shtëpiake që mund të lehtësojnë sadopak jetën e gruas, duhet të pranojmë që edhe kjo është një çështje shumë problematike. Të dhënat e INSTAT, referojnë se gjendja e grave në zonat rurale është më e keqe. Anketa e matjes së nivelit të jetesës (2012)[114] evidenton norma më të larta varfërie në zonat rurale, edhe pse evidenton një tendencë në rritje të varfërisë nëpër qytete. Kjo është shoqëruar edhe me nivele të ulëta të blerjeve të pajisjeve të ndryshme më afatgjata[115], si për shembull rrobalarëse, sobe e furrë gatimi, mikrovalë etj., të cilat përkthehen drejpërdrejt në stërmundim dhe orë më të zgjatura pune të papaguar për gruan fshatare: "Grupi i vetëm që shpenzon më shumë orë në punë totale – përfshirë ditët e javës dhe fundjavat – është ai i femrave në zonat rurale"[116].

Në familje anëtarët shoqërizohen dhe edukojnë njëri-tjetrin. Ka një interaktivitet dhe përfitim ose kompensim (jo plotësisht të balancuar ndonjëherë) të përkushtimit midis anëtarëve të familjes dhe brezave të anëtarëve që e formojnë atë. Familja ka edhe funksione "mbrojtëse" dhe të kujdesit bazë. Kjo nuk do të thotë që familja është një repart ushtarak ose një forcë policore, por ajo e ushtron këtë funksion në mënyre dhe mjete shumë paqësore me qëllim mirërritjen, mirë-edukimin dhe mirëqenien morale e materiale të anëtarëve të saj. Familja realizon kërkesat bazë të fëmijëve dhe të anëtarëve të saj (të rinj e të moshuar). Pikërisht, këto kontribute kujdesi që disa anëtarë japin për këtë komoditet të jetës familjare përfshihen në punën e papaguar. Në disa raste ka një ndarje të balancuar të këtyre shërbimeve që sjellin mirëqenien. Por jo gjithnjë ndodh kështu. Shkëmbimi i të mirave dhe i shërbimeve është një funksion që rrit qëndrueshmërinë e familjes, jo vetëm kur fëmijët janë të vegjël e në procesin e rritjes, por edhe kur prindërit të jenë të moshuar dhe fëmijët të rritur. Ka një riciklim të shkëmbimit të të mirave dhe të shërbimeve pambarimisht, për aq kohë sa familja jeton e mandej, kur transformohet, edhe këto kalojnë te familja e re. Për shumë individë, familja është siguruesja kryesore e të mirave materiale dhe e shërbimeve. Aty ushqehesh, pastrohesh, lahesh, edukohesh, ke një shtrat të ngrohtë, një strehë të sigurt dhe përmbush nevojat e jetës së përditshme. Ndërkohë është e pamohueshme ndihmesa, kontributi i gruas si bashkëshorte dhe si nënë në ofrimin e këtyre të mirave e shërbimeve. Këto gra ndërkohë, punojnë edhe jashtë familjes dhe "i sjellin" asaj po aq të ardhura sa edhe bashkëshorti. Qëndrueshmëria cilësore e familjes varet shumë edhe nga mënyra si shkëmbehen anasjelltas këto shërbime. Kështu, sipas Vendimit nr. 1241/12.02.2013 të GjRrGj Tiranë, tronditja e marrëdhënieve në çift ka

[113] Anketa e Buxhetit të Familjes (2006-2007) evidenton se 37.4% e familjeve fshatare nuk furnizoheshin me ujë të pijshëm, INSTAT, http://www.instat.gov.al/al/themes/buxheti-i-familjes.aspx

[114] http://www.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf

[115] Po aty

[116] Anketa e Përdorimit të Kohës, cituar më sipër

ardhur sepse bashkëshorti shpenzonte kohe dhe para në lojëra fati dhe në loto sporti. Ai që nga viti 2009 nuk kontribuonte në familje. Gjatë gjykimit, rezultoi se bashkëshortët, pavarësisht nga përpjekjet që kanë bërë për të normalizuar martesën, nuk kanë mundur të gjejnë mirëkuptimin dhe bashkëjetesa midis tyre është bërë e pamundur. Aktualisht bashkëshortët nuk bashkëjetojnë me njëri–tjetrin prej disa kohësh. Paditësja së bashku me fëmijën jeton në Tiranë, ndërsa i padituri në një rreth tjetër. Në këto kushte martesa ka mbetur formale.

Ndonëse nuk kemi bërë një analizë sasiore të shkaqeve kryesore të zgjidhjeve të martesave, nga shqyrtimi i shumë vendimeve gjyqësore në kuadër të këtij studimi, perceptojmë se shkelja nga ana e bashkëshortit e detyrimeve që burojnë nga martesa renditet ndër shkaqet më të shpeshta.

Kujdesi për fëmijët: sipas koncepteve ligjore, me fëmijë do të kuptojmë personat nga 0-18 vjeç. Një nga përgjegjësitë kryesore në punën dhe kujdesin e papaguar është ajo për fëmijët, sidomos ata në moshë të vogël (0-6 vjeç). Kujdesi për fëmijët është një nga angazhimet kryesore të prindërve duke veçuar përkushtimin e dallueshëm të gruas në përgjithësi. Në Shqipëri, ende gratë konsiderohen si personi kryesor përgjegjës për kujdesin për fëmijët. Sipas INSTAT, Të pasurit fëmijë më të vegjël se 7 vjeç, ndikon shumë tek mënyra se si femrat e përdorin kohën. Ato bëjnë shumë më pak punë të paguar dhe shumë më tepër punë të papaguar, krahasuar me femrat me fëmijë më të rritur. Përveç kujdesit për fëmijët e vegjël 0-6 vjeç, që rezulton të jetë një nga shkaqet për mospjesëmarrjen në tregun e punës, mund të shtojmë edhe kujdesin për fëmijët që frekuentojnë shkollën. Gratë kujdesen më shumë për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë. Ato vetë i shoqërojnë fëmijët në shkollë, marrin pjesë në takimet mësues–prindër në shkollë, ndjekin progresin e fëmijëve dhe rezultatet e tyre. Kjo natyrisht që ka një impakt në ecurinë e gruas në tregun e punës – informale dhe formale.

Kujdesi për të moshuarit: ka anëtarë të familjes që kujdesen më shumë për të moshuarit. Të moshuarit hyjnë tek grupet në nevojë[117]. Sipas përkufizimit të shërbimit social, të moshuarit janë ndër përfituesit parësorë të shërbimeve sociale shtetërore. Shërbimet sociale janë adresuar te personat e moshuar të vetmuar, në qendra ose në shtëpi dhe jo për ata që jetojnë me familje, duke mos ndikuar aspak në punën e papaguar dhe kujdesin e treguar në këtë kuadër. Kjo do të thotë që, ndërsa shërbimet sociale për të moshuarit janë adresuar tek personat e moshuar të vetmuar, i bie që për të moshuarit e tjerë përgjegjësia për kujdes shkon te familjet, që si në shumë raste të tjera, zëvendësojnë rrjetet e mbrojtjes sociale që duhet të sigurohen nga shteti. Por, brenda familjes përgjegjësia dhe pesha e kujdesit për anëtarët e tjerë dhe për punët rëndon ekskluzivisht te gratë që e vuajnë më shumë mangësinë e mbështetjen e dobët shtetërore.

Puna në bujqësi dhe ekonominë familjare.

Sipas ligjit të BGj, puna në bujqësi dhe ekonominë familjare mund

[117] Shih "Strategjia e Shërbimeve Sociale" dhe "Strategjia e Sektorit të Mbrojtjes Sociale"

të jetë një nga llojet e punës së papaguar. Ekzistenca e një shkalle të lartë papunësie, kryerja e shumë punëve në bujqësi, mungesa e mundësive kualifikuese, por dhe niveli arsimor i ulët, i bën gratë fshatare shumë më të prekshme nga papunësia dhe varfëria. Për më tepër, emigracioni i burrave jashtë shtetit, apo aktiviteti tregtar i burrave, i lë gratë të përballojnë vetë pjesën më të madhe të punëve bujqësore[118]. Kontributi i gruas në ekonominë e familjes bujqësore është i rëndësishëm, por as ky fakt nuk e favorizon atë për të pasur një vend kryesor në drejtimin e saj. Ligjërisht gruaja fshatare është anëtare e familjes bujqësore dhe ka të drejtën e bashkëpronësisë me anëtarë të tjerë të familjes, por rrallë herë ajo ka rolin e kryetares së familjes. Gruaja përgjithësisht, mban rolin e kryefamiljarit vetëm në rastet kur është e ve, kur ka zgjidhur martesën, ose kur burri është larguar në emigracion afatgjatë.

Puna e papaguar dhe efektet në arsimim, kualifikim e trajnim: barra e punës së papaguar dhe mos shpërndarja e drejtë e përgjegjësive në familje çon në zhvillimin e tregut informal ose në punët e pakualifikuara si: pjatalarëse, sanitare, bariste, kameriere, etj. Mundësitë për punësim në institucione shtetërore bëhen më të kufizuara.

Puna e papaguar dhe efektet në përfshirjen në tregun e punës së paguar. Si rregull, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat se për meshkujt, ndonëse Instituti i Statistikave tregon se në tremujorin e tretë të vitit 2013, niveli i papunësisë në vend u rrit, si për burrat, dhe për gratë, duke arritur në 16.9%. Ndërsa shkalla e papunësisë afatgjatë, që nënkupton njerëzit që kanë vite pa punë vlerësohet në 12%. INSTAT-i konstaton se në të gjithë vendin janë rreth 190 mijë persona të papunë. Por në realitet ky numër mund të jetë edhe më i madh, pasi jo të gjithë të papunët regjistrohen në zyrat e punësimit, aty prej nga ku merren edhe të dhënat zyrtare. Shkalla e papunësisë vlerësohet të jetë më e lartë për meshkujt sesa për femrat, përkatësisht 19,3 % dhe 13,7 %. Ndërkaq, problematike situata paraqitet te të rinjtë. Për moshat nga 15 deri në 29 vjeç shkalla e papunësisë vlerësohet në 26,9 % ndërsa për popullsinë nga 30-64 vjeç është 14 %.

Gratë që kryejnë punë të papaguar kanë më shumë vështirësi për të hyrë në tregun e punës dhe diskriminohen më shumë për shkak të moshës, statusit martesor, fëmijëve, mungesës së kualifikimit të duhur, etj. Nga ana tjetër, gratë dhe vajzat janë të përfshira më shumë në tregun informal të punës dhe të pambrojtura nga skemat e sigurimeve dhe mbrojtjes sociale. Për të kuptuar gjendjen reale, veç statistikave dhe raporteve periodike të përgatitura në kuadrin e raportimit për Komitetin CEDAW, gjykata mund të konsultohet edhe me raportet e OJF-ve

Kjo bën që mjaft prej grave të jenë të dekurajuara për të rihyrë në tregun e punës. Jo vetëm kaq, por nisur nga niveli i pagës që mund të

[118] Për më shumë shih: "Migration, remittances and gender-responsive local development", një studim i UNDP dhe UN INSTRAW (2010), në: http://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Migration,%20Remittances%20and%20Gender-Responsive%20Local%20Development%20-%20english.pdf

përfitojnë, vlerësohet se shpenzimet për kryerjen e "punëve të papaguara" mund të kapërcejnë nivelin e shpërblimit të tyre dhe në këtë mënyrë është më mirë për to të qëndrojnë në shtëpi që të kujdesen për fëmijët e për familjen. Mbingarkesa në punët e shtëpisë dhe me kujdesin për anëtarët e familjes bën që gratë të kryejnë dhe preferojnë më shumë punë me kohë të pjesshme, sa më pranë shtëpisë, ose në kushtet e shtëpisë.

Si mund të llogaritet?

❒ Duke vlerësuar vlerën në treg të punëve të ndryshme që kryejnë në familje gratë ose duke llogaritur koston oportune për kohën e shpenzuar në kryerjen e punëve që nuk paguhen.

Pra, për këtë është e rëndësishme që të përgatitet një listë e punëve që gratë kryejnë në shërbim të familjes dhe të bëhet lidhja e çdo pune me koston e saj në rast se për këtë do të paguhej dikush tjetër që merrej nga jashtë.

❒ Nga një këndvështrim tjetër mundet që puna e papaguar të analizohej kundrejt faktit që çfarë do të kishte përfituar një grua nëse nuk do të angazhohej kaq shumë në këtë lloj pune dhe kohën do ta shpenzonte duke u marrë me një punë që paguhej.

Të dy mënyrat kanë një sërë vështirësish teknike. Ka raste që gruaja në të njëjtën kohë bën dy ose tri punë njëkohësisht. Psh. edhe kujdeset për fëmijët edhe për përgatitjen e ushqimit. Dita e aktivitetit në kuadrin e punës së papaguar për familjen është shumë e gjatë.

Mbetet që çështja e vlerësimit dhe përllogaritjeve lidhur me punën e papaguar, si një çështje e re edhe për jurisprudencën ndërkombëtare të trajtohet në studime më vete. Në këtë kuadër, vlen të ndalemi edhe në rëndësinë që ka ratifikimi i Konventës 189 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës lidhur me 'Punëtorët e shtëpisë' ose punën në shtëpi.

3. Detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve

Detyrimi për ushqim midis bashkëshortëve në të cilin do të ndalemi në këtë pjesë të studimit, është një nga detyrimet që thuajse nuk kërkohet fare në rastet e zgjidhjes së martesës, duke e bërë këtë pjesë të dispozitave të KF plotësisht të papërdorshme në praktikë. Kështu, Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, në raportin me titull "Njohja dhe zbatimi i standardeve të barazisë gjinore në procesin gjyqësor"[119] mbi gjetjet kryesore nga monitorimi i vendimeve të Gjykatave të shkallës së 1-rë, të Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Shkodër e Vlorë, duke analizuar praktikën gjyqësore lidhur me çështjet e detyrimit për ushqim ndërmjet bashkëshortëve nënvizon se për vitin 2011 neni 192/a dhe 199 të Kodit të Familjes për detyrimin ushqimor të bashkëshortit ndaj bashkëshortit tjetër janë hasur vetëm 1 herë, ndër gjithë vendimet e monitoruara prej tyre. Madje edhe ky rast është rrëzuar nga

[119] Raporti mund të gjendet në: http://www.qag-al.org/WEB/publikime/raporti_shqip.pdf

gjykata[120]. Ndërkaq, për vitin 2012 Qendra ka arritur të evidentojë vetëm 1 rast, edhe ky i rrëzuar nga gjykata si i pambështetur në ligj[121].

Gjithashtu, për vitin 2012 në GjRrGj Tiranë, nga 23 vendime lidhur me detyrimin për ushqim, konstatojmë se të gjitha janë kërkesë padi me qëllim dhënien e këtij detyrimi ndaj fëmijës. Në asnjë rast ky detyrim nuk është kërkuar, e për rrjedhojë, dhënë në favor të bashkëshortit ose bashkëshortes. Në 18 raste paditëse është nëna e fëmijës. Nga këto kërkesë padi, 10 janë pushuar. Shkaqet e pushimit lidhen kryesisht me mosparaqitjen e palës paditëse në gjykim, shkaqe këto të parashikuara kryesisht në nenet 127, 179/1; 299/c të K.Pr.C. Ndër çështjet e pushuara, 7 janë padi të ngritura nga nënat e fëmijëve të mitur dhe 3 nga ati i fëmijës. Në rreth 77 vendime të Gjykatës së Lartë lidhur me çështjet familjare, për periudhën 2010-2013 që janë seleksionuar dhe studiuar, në asnjë prej tyre nuk ka çështje që lidhen me detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve.

Nuk do të ndalemi në interpretimet e dispozitave të KF lidhur me detyrimin për ushqim sepse doktrina në fushën e së drejtës familjare dhe praktika gjyqësore e ka realizuar këtë. Qëllimi ynë është që të evidentojnë disa instrumente përllogaritës në ndihmë të gjykatës lidhur me detyrimin për ushqim ndërmjet bashkëshortëve.

Sipas KF, nëse njëri nga bashkëshortët, pas zgjidhjes së martesës është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar, ka të drejtë të kërkojë detyrimin për ushqim. Detyrimi për ushqim ka për qëllim të plotësojë nevojat jetësore të personit që, nëse pretendon detyrimin për ushqim, duhet të plotësojë dy kushte: të jetë i paaftë për punë dhe të mos ketë mjete të mjaftueshme jetese [neni 198 KF]. Detyrimi për ushqim nënkupton plotësimin e nevojave materiale më të domosdoshme të jetesës dhe, si i tillë, nuk duhet ngatërruar me kontributin kompensues, qëllimi i të cilit është të mbajë atë standard jetese që ishte siguruar gjatë martesës edhe pas zgjidhjes së saj.

Pas zgjidhjes së martesës, ndodh më së shumti që gratë të jenë ato që gjenden në pamundësi ose vështirësi të mëdha për të përballuar shpenzimet e jetës së përditshme, duke filluar me ushqimin, kujdesin shëndetësor, veshmbathjen, mundësitë për një strehim adekuat, furnizimin me ujë dhe energji elektrike, ngrohjen, pagimin e taksave të ndryshme dhe çdo gjë tjetër të domosdoshme për jetën.

Sipas nenit 201/2 të KF, detyrimi për ushqim duhet të caktohet në raport me nevojat e atij që e kërkon dhe mundësitë ekonomike të atij që detyrohet. Në rastin e bashkëshortëve si nevojtarë dhe persona të detyruar kërkohet një analizë objektive e aspekteve që kanë të bëjnë me paaftësinë dhe mungesën e mjeteve të pretenduesit, kundrejt mundësive dhe mjeteve të të detyruarit.

Në formën e një liste kontrolli e cila mund të përdoret prej gjykatës në

[120] Vendim nr. 4684/2011
[121] Vendim nr. 158/2012

vlerësimin e burimeve dhe të nevojave kundrejt përcaktimit të detyrimit për ushqim, po përpiqemi që në vijim të japim disa indikatorë mbi të cilët mund të mbështetet gjykata në këtë vlerësim. Si për bashkëshortin debitor ashtu edhe për kreditorin, në përcaktimin e gjendjes ekonomike merren parasysh dhe llogariten jo vetëm të ardhurat, por edhe shpenzimet e tij për përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore që ai ka ndaj anëtarëve të tjerë të familjes.

Vlerësimi i gjendjes ekonomike të personit të detyruar dhe përfitues, me qëllim përcaktimin e detyrimit për ushqim, duhet bërë duke mbajtur në vëmendje edhe moshën dhe kohëzgjatjen e martesës.

Lidhur me burimet:

❒ Identifikimi i burimeve të të ardhurave, të tilla si: paga, shpërblime, të ardhura të tjera me natyrë të përhershme;

❒ Identifikimi i aseteve të bashkëshortëve, duke përfshirë këtu edhe pasurinë vetjake dhe atë të përfituar pas pjesëtimit;

❒ Konsideratat lidhur me faktin se kujt i është lënë banesa familjare dhe pajisjet e saj për përdorim [pavarësisht titullit të pronësisë];

❒ Analiza e aftësive konkrete për të siguruar të ardhura nga burime të mundshme;

❒ Aftësitë e veçanta që ka bashkëshorti kundrejt mundësive që ofron për të tregu i punës dhe që lidhen me këto aftësi;

❒ Nëse bashkëshorti/ja nuk është i punësuar, çfarë trajnimesh ose kualifikimesh mund t'i duhen për t'u punësuar;

❒ Nëse do të punësohet në nivelin e kualifikimit që ka, çfarë të ardhurash mund të priten;

❒ Detyrimet që ka bashkëshorti/ja ndaj anëtarëve të tjerë të familjes ose që mund të ketë;

○ Fakte të tjera me rëndësi që sjellin bashkëshortët, si bashkëjetesa; me te trete???

○ ndryshimet e shpejta të pritshme të statusit ekonomik drejt përkeqësimit;

○ raporte mjekësore lidhur me gjendjen shëndetësore;

○ ristrukturime në vendin e punës, ndryshimet e papritura në vendin e punës, etj.

Lidhur me shpenzimet:

❒ Identifikimi i shpenzimeve të domosdoshme për jetesën normale në rastin konkret. Të merret në konsideratë mundësia që ka secili bashkëshort për të mbajtur standardin e jetës që kishin vendosur gjatë martesës

○ Cilat janë nevojat 'e arsyeshme' të bashkëshortit/es

▪ Të tilla janë shpenzimet për të mbajtur një standard normal jetese dhe jo ato që konsiderohen si çështje të luksit apo të abuzimit. Këtu vlen të ndalemi në ndryshimin midis atyre që janë nevoja dhe atyre që janë dëshira.

○ Sa është masa e shpenzimeve të domosdoshme/nevojshme e të

mjaftueshme për të përballuar koston e jetesës për bashkëshortin/en

❒ Cilat janë detyrimet e bashkëshortit kundrejt pasurisë vetjake të bashkëshortit tjetër, të bashkësisë ose të tretëve [kreditorëve];

❒ Cila është gjendja shëndetësore e bashkëshortëve dhe shpenzimet lidhur me të;

❒ Aftësitë e veçanta të bashkëshortit kundrejt shpenzimeve që duhen bërë për t'i qasur këto me trendin e marrëdhënieve të punës dhe mundësitë e tregut të punës;

o Koha dhe shpenzimet që mund t'i duhen bashkëshortit për të marrë edukimin apo trajnimin e duhur për të zhvilluar aftësi adekuate me tregun e punës

o Nevojat e mundshme për kualifikim me qëllim që të bëhet i kërkueshëm apo të ketë shanse më të mira në tregun punës

❒ Kujt i është lënë fëmija/ët dhe nevojat e arsyeshme të tyre sipas grupmoshës dhe të personalizuara rast pas rasti;

o Këtu kemi parasysh që fëmijët si grup kanë disa nevoja që janë të përgjithshme, të cilat janë dinamike me ndryshimin e moshës. Rritja e fëmijës është kaq e shpejtë në fazën e parë të jetës, saqë shumë artikuj dalin nga përdorimi dhe duhen zëvendësuar me të tjerë. Ky ritëm thuajse nuk ndal deri në moshën 18-vjeçare. Por ndërkohë ndërsa një fëmijë njëvjeçar dhe një 15-vjeçar janë fëmijë, nevojat e tyre janë krejt të ndryshme e për rrjedhojë edhe kostot e shpenzimeve

o Nga ana tjetër çdo fëmijë ka nevojat e veta të veçanta: këto lidhen si me aspekte pozitive siç janë talenti dhe prirjet e fëmijës që duhen kultivuar, ashtu edhe ato që lidhen me shërbime të veçanta që një fëmijë kërkon. P.sh., nëse përdor syze, nëse ka nevojë për terapi që lidhen me shëndetin fizik apo mendor, etj., këto nënkuptojnë shpenzime ekstra rasteve të zakonshme.

❒ Sa janë taksat mbi të ardhurat dhe detyrimet që duhet të paguajë secili nga bashkëshortët me të ardhurat e veta;

❒ gjoba penale dhe shpërblime të tjera të dëmeve të shkaktuara

❒ Çdo faktor tjetër që konsiderohet si i rëndësishëm dhe i drejtë për t'u vlerësuar nga ana e gjykatës

4. Amësia dhe atësia e fëmijës dhe çështjet e diskriminimit gjinor

Amësia dhe atësia janë përbërës të rëndësishëm të identitetit të çdo individi. Lidhjet e gjakut kanë pasur dhe kanë një rëndësi të veçantë në përcaktimin e të drejtave dhe përgjegjësive ligjore ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.

Në Kodin e Familjes[122], nisur nga situatat e mundshme (faktike) të fëmijës, atësia apo amësia e të cilit prezumohet, njihet, vërtetohet gjyqësisht apo kundërshtohet, përcaktohen një tërësi rregullash. Këto rregulla variojnë në varësi të faktit nëse: a) fëmija ka lindur nga martesa; b) fëmija ka lindur

[122] Shih Kodi i Familjes Ligji nr.9062/5.8.2003, nenet 180-191 KF.

jashtë martese; c) fëmija ka lindur nga prindër të panjohur.

Një vend të rëndësishëm në dispozitat lidhur me institutin e atësisë e amësisë zënë parimet e interesit më të lartë të fëmijës; parimi i barazisë së fëmijëve të lindur nga martesa me fëmijët e lindur jashtë martese, parimet e barazisë së prindërve, si nëna e ati biologjik i fëmijës.

Gjatë kryerjes së këtij studimi dhe hulumtimit në praktikën gjyqësore, kemi hasur një vendim, i cili mund të duket se nuk ka lidhje me objektin e studimit, por që dëshirojmë ta përcjellim me qëllim që kur të flitet për interesin e fëmijëve, kjo të mos mbetet një retorikë, por diçka të cilën më mirë se çdo autoritet duhet ta zgjidhë gjykata. Kështu, sipas fakteve të paraqitura në Vendimin nr. 861/04.02.2013 të GjRrGj Tiranë, konstatohet se çifti që po zgjidh martesën ka, nga martesa gjashtë fëmijë. Dy fëmijë janë madhorë dhe katër të mitur. Prej fëmijëve të mitur, nga faktet e paraqitura, 2 prej tyre janë të regjistruar në gjendjen civile dhe dy të tjerë nuk janë të regjistruar. Gjykata shprehet për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore vetëm të dy fëmijëve. Fragmenti në vijim është marrë nga vendimi: "Nga kjo martesë kanë lindur fëmijët M.A. e datëlindjes 08.02.1993, V.A. e lindur më 03.06.1994, Sh.A. e lindur më 06.04.1996 dhe L.A. e lindur më 09.02.1998, provuar me certifikatën familjare me Nr. 001369103 datë 07.10.2011, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia "K" si dhe nga certifikatat përkatëse të lindjes së fëmijëve të administruara në dosje. Gjithashtu, gjatë gjykimit rezultoi se palët nga martesa kanë edhe dy fëmijë të tjerë, vajzën B.A. dhe djalin D.A., përkatësisht të moshës tetë dhe pesë vjeç, të cilët nuk figurojnë të regjistruar në certifikatën e përbërjes familjare të administruar në dosje. Për këtë arsye, gjykata nuk mund të shprehet në lidhje me caktimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore për ta." Kështu, edhe në pjesët e tjera arsyetuese të vendimit, edhe në atë të dispozitivit të vendimit përmenden vetëm dy fëmijët e regjistruar dhe dy fëmijët e mitur të tjerë duket sikur nuk ekzistojnë fare. Sipas mendimit tonë, fëmija në këto kushte ka statusin e "Fëmijës në rrezik" si një fëmijë i paregjistruar dhe, si i tillë, jo subjekt i së drejtës. I tillë është fëmija, të cilit i mohohen ose i cenohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në ligjin "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"[123] dhe në legjislacionin në fuqi.

Përmes dispozitave të KF që i referohen institutit të atësisë [dhe amësisë] synohet e drejta e fëmijës për të njohur të vërtetën lidhur me prindërit e vet biologjikë, si edhe e drejta e atit dhe nënës së fëmijës, për t'u

[123] Shih Konventën për të Drejtat e Fëmijës, neni 7; Ligji Nr.10 347/4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës". Neni 5/1 i këtij ligji parashikon ndër parimet e përgjithshme se "Mbrojtja e të drejtave bëhet duke garantuar: 1. Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjislative." Sipas nenit 7/1. "Fëmija, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë: a) të regjistrohet menjëherë me lindjen e tij". Shih, Artikullin A.Mandro "Pa certifikatë lindjeje. Probleme praktike dhe ligjore që lidhen me regjistrimin e lindjeve të fëmijëve. Botuar në revistën juridike "Justitia" Nr.1, botim i Fakulteti jopublik Justicia. ShB Toena. Prill 2008. (Faqe 29-40).

njohur si prindi biologjik i fëmijës. Gjithashtu, instituti synon mbrojtjen e fëmijëve të lindur në mënyrë "anonime" ose me "prindër të panjohur", por edhe mbrojtjen nga prezumimet ligjore dhe situatat e njohjes që nuk përkojnë me të vërtetën biologjike. KF u ka dhënë personave të interesuar dhe që kanë një interes të ligjshëm të drejtë që të luajnë një rol aktiv në këtë proces dhe të përdorin të gjitha instrumentet ligjore me qëllim që të respektohen të drejtat themelore të fëmijës, pjesë e të cilave është edhe amësia e atësia si përbërës me rëndësi të identitetit të fëmijës.

Instituti i amësisë dhe atësisë përshkohet nga të gjitha ato parime që gjenden në instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuara nga vendi ynë, siç është Konventa për të Drejtat e Fëmijës (neni 7 etj). Çdo njeri, vjen në jetë nga bashkimi i gametave femërore e mashkullore që i përkasin një individi që biologjikisht është nëna dhe ati i fëmijës, por jo detyrimisht edhe juridikisht. Edhe në rastin e inseminimit artificial, materiali gjenetik është ai i *një* burri dhe i *një* gruaje dhe nuk ka asnjëherë disa syresh. Prej këtej vjen një parim i rëndësishëm, siç është ai se 'njohje atësie apo amësie mbi njohje' të mëparshme nuk ka. Që të kemi një njohje të re duhet të kundërshtohet e para. Nuk mund të hiqet dorë nga njohja e amësisë dhe atësisë së fëmijëve të lindur jashtë martese. Çdo lloj marrëveshjeje e tillë do të ishte nul.

Gratë që lindin fëmijë jashtë martese dhe fëmijët e lindur jashtë martese, historikisht, kanë qenë subjekte diskriminimi social dhe ligjor [gratë të përdala e të përçmuara e fëmijët pjellë e mëkatit]. Ndërsa legjislacioni aktual nuk përmban asnjë klauzolë diskriminuese, praktika ende tregon rezistencën e paragjykimeve. Çështjet që lidhen me këto institute, duke u përcjellë deri në GjEDNj tregojnë ndjeshmërinë e lartë sociale që i shoqëron, çka duhet reflektuar në standarde adekuate ligjore dhe kujdes të veçantë të gjyqësorit kur një konflikt familjar precipiton në gjykatë dhe njohja gjyqësisht apo kundërshtimi lidhet me interesat e një fëmije.

Kjo është arsyeja që, ndonëse në gamën e çështjeve familjare shqiptare, paditë lidhur me njohjen e kundërshtimin e atësisë zënë vetëm 1% të totalit të tyre, mbeten me rëndësi të veçantë konsideratat juridike dhe impakti social kryesisht në funksion të interesit të fëmijës dhe të cilësisë që jeta familjare duhet të garantojë[124].

Në vëmendje të këtij studimi po sjellim një rast nga praktika gjyqësore lidhur me institutin e amësisë. Vendimi nr.2301/21.11.2012 i GjRrGj Fier është ndër të paktët vendime, në dy dekada mund të themi se është i vetmi, që na sjell në vëmendje një rast që ka të bëjë me kundërshtimin e amësisë së fëmijës. Në këtë vendim shfaqet hapur mentaliteti, diskriminimi dhe poshtërimi që i bëhet gruas si nënë deri në manipulime të tilla që sjellin mohimin e së drejtës së gruas që e lind fëmijën, ta regjistrojë atë si të vetin

[124] Shih Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010, në: http://www.justice.gov.al/spaw2/uploads/files/File/Vjetari_Statistikor2010.pdf. Sipas të dhënave të këtij dokumenti, për vitin 2010, nga 7675 çështje familjare në total të gjykuara në shkallë vendi, 19 janë padi për kundërshtim atësie dhe 64 padi njohje atësie.

duke dhënë një emër nëne e ati të rremë. Rasti tregon se cfarë kuptimi ka për familjen morali si dhe kuptimi i 'funksionit mbrojtës' deri në paligjshmëri që anëtarët e saj marrin përsipër. Gati gati, këto janë njëlloj me konceptimet që ekzistonin në të drejtën zakonore ku fëmija i lindur jashtë martese është "pjellë e mallkuar" dhe me statusin përcmues që merrte gruaja që lindte këtë fëmijë.

Vendimi që kemi zgjedhur për ilustrim, sjell në vëmëndje një diskriminim të shumëfishtë: diskriminimi i gruas si nënë e cila lind një fëmijë jashtë martese; diskriminimi i fëmijës së lindur jashtë martese'[125] dhe diskriminimi që i bëhet një gruaje tjetër që nuk është nëna e fëmijës, e që ndërsa nuk është në gjendje të lindë fëmijën e vet [mentaliteti i turpit të 'barktharës'], për shkak të mentalitetit dhe presionit të opinionit publik e etiketuar si 'shterpë' kërkon ta mbulojë këtë 'të metë' dhe është gati të zgjidhë një martesë ekzistuese e të pranojë manipulimet e dokumenteve lidhur me amësinë e fëmijës, duke lidhur një martesë të re.

Sipas fakteve të marra nga vendimi, MB është e bija e JB. MB ka paraqitur një padi me objekt kundërshtimin e amësisë së fëmijës XhB. Fëmija XhB figuron e regjistruar në certifikatën e lindjes si fëmijë me atësi të JB [pra ky edhe babai i MB] dhe me amësi atë të VB [përkatësisht njerka e MB]. Për rrjedhojë XhB, sipas dokumentacionit figuron se është motra me babë e paditëses. MB si paditëse ka ngritur padi kundër babait dhe njerkës së saj. Të dy këta të fundit janë të regjistruar si prindërit e fëmijës XhB. JB, ka ndërruar jetë dhe për rrjedhojë në emër të tij hyjnë në proces me zëvendësim trashëgimtarët e tij [neni 199 KPrC[126]] që do të thotë motrat e vëllezërit e MB. Nisur nga faktet që pasqyrohen në vendim na tërheq vëmendjen se të dhënat lidhur me 11 fëmijët nga martesa e mëparshme e JB, dy rezultojnë me të njëjtën datë lindjeje, dhe katër me të njëjtën datë lindjeje [?!][127].

Sipas certifikatës së asistencës në lindje rezulton e shënuar data dhe ora e lindjes së fëmijës së seksit femër dhe në të thuhet se fëmija XhB është lindur nga VB e cila është e martuar me JB. Sipas dispozitave mbi prezumimin e atësisë së fëmijës së lindur nga martesa, në certifikatën e lindjes konfirmohet fakti i lindjes së fëmijës XHB me atësi shtetasin

---

[125] Nisur nga parimi më i rëndësishëm i përcaktuar në nenin 2 të Kodit të Familjes është interesi më i lartë i fëmijës, nevoja për një identitet të plotë e të menjëhershëm pas regjistrimit për t'i dhënë një zgjidhje të tillë, por sigurisht për të mos mohuar as atin e të ëmën biologjike të fëmijës e ata të prezumuar në rastin konkret të kundërshtojë këtë amësi. Kjo e drejtë mund të kundërshtohet vetëm në rrugë gjyqësore.

Lindja e një fëmije nënkupton origjinën e tij si prej një nëne dhe prej një ati, si në këndvështrim ligjor dhe atë praktik. Në rastin konkret, për fëmijën e lindur nga martesa përcaktimi i amësisë dhe atësisë janë të lidhura si me faktin juridik te lindjes ashtu dhe me prezumimin ligjor që e kanë bazën në lidhjen martesore të prindërve të fëmijës.

[126] Neni 199 KPrC: Kalimi procedural. "Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj".

[127] Vini re të dhënat e marra sipas vendimit: MB dhe AB si_bija të JB dhe ish gruas së tij ShB rezultojnë se kanë lindur më 25.02.1965; DhB, PB, VB, MB janë fëmijët e JB me ish gruan e tij ShB dhe kanë datëlindjen 14.12.1972.

''JB'' dhe me amësi shtetasen "VB". Sipas nenit 165 të KF "Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesa provohet nga akti i lindjes i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile".

Paditësja MB pretendon se është ajo vetë nëna e fëmijës dhe pretendon se të dhënat e paraqitura në aktin e lindjes për fëmijën XhB nuk korrespondojnë me realitetin. Ato janë të rreme. Sipas nenit 178 të KF, veç subjekteve të tjerë, gruaja që kërkon të njihet si nënë e fëmijës ka të drejtë të kundërshtojë amësinë e treguar në aktin e lindjes dhe kjo padi nuk parashkruhet. Kështu që paditësja legjitimohet në pretendimet e saj.

Gruaja që e lind fëmijën, është nëna e fëmijës. Në këtë rast themi se amësia provohet përmes aktit të lindjes, çka e bën amësinë një çështje lehtësisht të provueshme sepse "*mater semper certa*". Kjo vlen si për fëmijët e lindur nga martesa ashtu edhe për fëmijët e lindur jashtë martese. Rasti që po analizojmë tregon se në realitetin bashkëkohor, jo gjithnjë nëna që e lind fëmijën është ajo që regjistrohet si e tillë. Ndaj në raste të tilla, dhe të tjera, e vërteta realizohet përmes institutit të kundërshtimit të amësisë.

Sipas paraqitjes së fakteve bërë nga paditësja, nga fundi i vitit 2001, me *ndërhyrjen dhe insistimin e babait* të saj ajo ka njohur shtetasin me inicialet XX. Ajo është shoqëruar me të disa muaj. Marrëdhënia e tyre konkludoi në intimitet. Pas disa muajve lidhja përfundoi sepse shtetasi XX e braktisi paditësen. Si rezultat i kësaj lidhjeje, MB mbetet shtatzënë. Duke qenë se në këtë kohë MB ishte një grua e pamartuar, fakti i shtatzënisë nuk mund të perceptohej nga i ati i saj. Ai vazhdimisht *e kërcënonte se do ta vriste nëse ajo nuk abortonte fëmijën apo që do të vriste foshnjën në momentin e lindjes* [citim nga vendimi]. Gjatë kësaj kohe i ati i MB ishte i ve, pasi bashkëshortja e tij ishte ndarë nga jeta. E gjendur vazhdimisht e frustruar nga i ati i saj, MB iu nënshtrua propozimit të tij, që në momentin e lindjes së fëmijës ajo të deklaronte identitet të rremë të vetin, duke u paraqitur me emrin e VB, përkatësisht njerkës së saj, dhe jo si MB, e si ati i fëmijës të deklarohej babai i saj meqë sipas ligjit VB ishte martuar me JB dhe në këtë mënyrë ishte brenda kushteve të prezumimit të atësisë.

MB pretendon se e pranoi propozimin. Në procesin gjyqësor ajo pohon se pranimi i propozimit nuk ka të bëjë me mungesën e dhembshurisë ndaj fëmijës së lindur prej saj jashtë martese, por për një sërë konceptesh dhe paragjykimesh që veprojnë në shoqëri, të cilat i etiketojnë gratë, që kanë lindur fëmijë jashtë martese, si të pamoralshme.

MB u detyrua të bënte deklarimin e rremë të identitetit të saj. E paditura VB, e cila ishte fqinjë me të paditurin JB, ishte e martuar me një tjetër shtetas, por nga martesa e tyre nuk kishin pasur fëmijë. VB kishte marrëdhënie intime me të paditurin JB dhe në kohën e ardhjes në jetë të fëmijës XhB, duke qenë se dëshira e saj për të patur një fëmijë ishte e madhe, ajo ra dakord me propozimin e bërë nga komshiu i saj JB, duke dhënë në këtë mënyrë miratimin e saj që si nënë e fëmijës që po pritej të

vinte në jetë nga MB, të deklarohej emri i saj, VB. Para ardhjes në jetë të fëmijës XhB, VB zgjidh martesën e saj dhe lidh martesë me JB.

Për të mbështetur pretendimin e vet, paditësja MB, kërkon bërjen e testit të ADN. Në këtë proces, një nga palët e paditura, përkatësisht motra e MB, pranon pretendimet e paditëses dhe pohon se fëmija është i motrës së saj.

Episodet e fakteve të këtij vendimi më shumë të ngjajnë me ndonjë telenovelë ose film nga e kaluara dhe jo me fakte të jetës familjare shqiptare aktuale. Kur ndërkohë, praktika botërore flet për vajza nëna dhe të drejtën e tyre për të realizuar të drejtën riprodhuese.

Testi i ADN

Për të provuar pretendimet e saj, paditësja MB, kërkon bërjen e testit të ADN. Ky pretendim pranohet nga gjykata. Për të përcaktuar nëse paditësja është apo jo nëna e fëmijës me qellim realizimin e testit të ADN-së gjykata iu drejtua me kërkesë Qendrës së Diagnostikës Molekulare dhe kërkimeve Gjenetike pranë Spitalit Universitar Obstretik-Gjinekologjik "Mbreteresha Geraldinë", si i vetmi institut që realizon kryerjen e analizave të ADN-së duke thirrur për këtë edhe ekspertin gjenetist. Rezultatet e testit tregojnë se fëmija XhB është fëmija biologjik i MB. Sipas aktit të ekspertimit është arritur në konkluzion se nga krahasimi i profileve gjenetike të MB dhe fëmijës XhB, MB është nëna biologjike e XhB, pasi karakteristikat gjenetike të tyre përputhen në të 15 markerët gjenetikë dhe saktësia e analizës është e nivelit 99.9999 %.

Shtatzënia e MB ka qenë një fakt i njohur botërisht. Të gjithë të afërmit e MB, në një familje numerike me 10 motra e vëllezër, janë në dijeni të faktit e të kërcënimeve të vazhdueshme që i janë bërë në atë kohë nga babai i saj. Asnjë prej tyre, sa kohë ishte gjallë babai, nuk pati kurajën e guximin të mos e pranonin këtë regjistrim të rremë. Si duket, jo autoriteti i babait, por edhe se 'turpi' do të zinte edhe ata. Asnjë nuk e përkrahu shtatzëninë e një gruaje që po lindte një fëmijë jashtë martese. Nga ana tjetër, ky rast nxjerr në pah rolin e veçantë që ka babai në familje, pushtetin e tij edhe tek fëmijët që e kanë kaluar miturinë. Edhe tek fëmijët që në fakt janë bërë prindër dhe instinkti prindëror duhet t'i nxiste drejt të vërtetës. Forca e opinionit publik diskriminues është ende e fortë dhe kështu në të tërësi, të gjithë së bashku, cenojnë të drejtën për të gëzuar jetë familjare si një të drejtë të njohur nga KEDNj [neni 8] dhe jurisprudenca e GjEDNj.

Një çështje tjetër me efekte në diskriminim.

Çdo analizë laboratorike e cila bëhet me qëllim që të merret informacion për aspekte të veçanta të statusit gjenetik të individit, konsiderohet si analizë gjenetike.

Vini re: edhe për qëllime shëndetësore e mjekësore, analiza gjenetike tek të miturit gjithmonë është trajtuar me shumë kujdes. Zakonisht, fëmijët dhe adoleshentët do të analizohen gjenetikisht vetëm nëse nga rezultati i analizës varen masat urgjente parandaluese ose mjekuese. Në rast se analiza nuk është urgjente (p.sh. sëmundja/çrregullimi fillon vetëm në moshë të rritur dhe nuk mund të fillohet mjekim përpara kësaj kohe)

analiza zakonisht shtyhet derisa i mituri të ketë arritur moshën e duhur për të bërë vetë zgjedhjen përkatëse pasi, të jetë informuar paraprakisht[128].

Në praktikë, hapja e klinikave që ofrojnë testin e ADN-së, duket se ka 'nxitur' interesin e atit të fëmijës së lindur nga martesa që të 'certifikojë' përmes kësaj prove atë që njihet si 'prezumim ligjor' i atësisë. E paraqesim këtë çështje në këtë punim sepse jo vetëm që është një situatë shqetësuese dhe e rrezikshme, por edhe diskriminuese në disa drejtime: kundrejt nënës së fëmijës dhe kundrejt gruas si bashkëshorte.

Pyetja që duam të shtrojmë është: A ka të drejtë ati i fëmijës, të lindur nga martesa, që, pa dijeninë e nënës së fëmijës, njëkohësisht edhe bashkëshortja e tij, t'i drejtohet një klinike, dhe të kërkojë bërjen e provës së ADN-së lidhur me përputhshmërinë e tij me fëmijën. A vihet në rrezik siguria e jetës familjare të realizuar përmes martesës dhe interesi më i lartë i fëmijës? Cili është kuptimi i prezumimit?

A ka të drejtë që në çdo rast, bashkëshorti të sigurohet dhe t'i japë përgjigje pyetjeve: A është fëmija i lindur nga martesa fëmija im? A më ka tradhtuar bashkëshortja?

Ndërsa amësia provohet përmes aktit të lindjes, ndonëse rasti më sipër tregon se edhe kjo nuk është gjithnjë e vërtetë, atësia e fëmijës së lindur në martesë, prezumohet pikërisht duke u bazuar në aktin e lindjes. Edhe në këtë rast, akti i lindjes që pasqyron faktin juridik të lindjes ka rëndësi të veçantë. Pra, fëmija i lindur, nga një nënë që sipas aktit të lindjes është e martuar, prezumohet që ka për at bashkëshortin e nënës. Ky parim me rëndësi dhe me vlerë buron qysh nga e drejta romake: "*pater est quem nupciae demonstrant*". Prezumimi i atësisë që padyshim ndikon në statusin e fëmijës, buron nga statusi i prindërve të fëmijës nëse janë ose jo të lidhur në martesë. Një martesë ekzistuese, një martesë e mbaruar, një martesë e pavlefshme ose një martesë e re e nënës së fëmijës i jep edhe dimensionin e caktuar një personi të prezumuar si atë apo ia jep këtë një personi tjetër. Pa dyshim që qëllimi i prezumimit nuk është që të ndërlikojë, por të stabilizojë marrëdhëniet familjare duke u nisur nga logjika e fakteve dhe e ligjit.

Nëse analizojmë me kujdes dispozitat e KF, konstatojmë këto prezumime. (1) Fëmija prezumohet se ka për at bashkëshortin aktual të nënës, pra atë me të cilin nëna figuron të jetë e martuar në çastin e lindjes së fëmijës. Këtë parim e vëmë re edhe në nenin 180 KF, sipas të cilit, kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit te martesës së dytë të nënës, prezumohet se ka për at bashkëshortin e nënës me martesë të dytë, edhe sikur fëmija të ketë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj (përfshijmë këtu edhe mbarimin me

[128] Rezultatet e analizës gjenetike janë të dhëna personale të ndjeshme në lidhje me "intimitetin biologjik". Rrjedhimisht, duhet të konsiderohen si informacione me natyrë konfidenciale. Për më tepër, individët të cilët kanë kryer analizën gjenetike duhet të kërkojnë mbështetje (këshillim gjenetik) për t'u siguruar se i kanë kuptuar si duhet qëllimin dhe pasojat përkatëse. Shih "Analiza gjenetike për qëllime mjekësore", përgatitur nga Këshilli i Europës. Në: http://www.coe.int/t/dg3/healthbioethic/activities/07_human_genetics_en/brochure/al_geneticTests_bd.pdf

vdekje). (2) fëmija prezumohet se ka për at ish-bashkëshortin e nënës nëse nëna nuk ka lidhur martesë të re dhe fëmija lind brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës ose nga shpallja e pavlefshmërisë së martesës.

Detyrimi reciprok për besnikëri dhe prezumimi, në potencë, i ekskluzivitetit që kanë bashkëshortët në marrëdhëniet seksuale i jep të drejtë legjislatorit të bëjë prezumimet e mësipërme. Marrëdhëniet seksuale janë një nga funksionet e martesës. Prezumimet lidhur me atësinë e fëmijës i japin vlerën e duhur sociale institutit të martesës nisur nga ky funksion i martesës. Fakti që legjislatori përmend pavlefshmërinë e martesës, nënkupton që një martesë e pavlefshme juridikisht nuk ndikon në statusin e fëmijës si të lindur brenda martesës dhe për rrjedhojë edhe në prezumimin e atësisë. Meqë jemi përpara situatave të prezumuara, ndodh që aktet e gjendjes civile të mos përputhen me faktet dhe në këtë rast duhet të kundërshtohen. Atësia e prezumuar mund të kundërshtohet vetëm në rrugë gjyqësore.

Kur ati në mënyrë të njëanshme i drejtohet një klinike për të vërtetuar atë që prezumohet sipas ligjit, mendojmë se shkel disa të drejta të cilat mbrohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni shqiptar dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara dhe zhvleftëson institutin e perzumimit të atësisë.

Së pari, bëhet fjalë për parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Prezumimi është ngushtësisht i lidhur me këtë interes. Një nënë e babë e ka sjellë fëmijën në jetë. Kur ata janë të martuar, ka një arsye të fortë juridike e natyrore që fëmija të jetë biologjikisht i tyre. Është e drejta dhe interesi i fëmijës që të njohë prindërit e tij/saj.

Ka një tërësi instrumentesh me të cilat duhet të konsultohen juristët dhe gjyqtarët në një rast të tillë. Këto janë: KDF, KF dhe LMDF [Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, 2010], etj. Sipas nenit 7 të LMDF fëmija, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që është përkatësisht Ligji për Gjendjen Civile [2009 ndryshuar] ka të drejtë: (a) të regjistrohet menjëherë me lindjen e tij; (b) të ketë një emër; ... (ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur. Gjithashtu, paragrafi i dytë i nenit 7 nënvizon se fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme. A është kjo përpjekje e atit një ndërhyrje e paligjshme? Për mendimin tonë po, sepse rregullimet e atësisë së fëmijës së lindur nga martesa janë bërë nga KF. Në rast kundërshtie, kërkohet respektimi i procedurës së njohur që është vetëm ajo përmes rrugës gjyqësore. Marrëdhëniet familjare kanë nevojë për stabilitet dhe siguri. Çfarë sigurie do të kishim nëse, çështjet e atësisë do të ndiqnin të njëjtën rrugë si në rastet e njohjes apo kundërshtimit të fëmijëve të lindur jashtë martese? Nëse praktika të tilla do të konsideroheshin të drejta, atëherë, duhet të binte instituti i prezumimit.

Në këtë rast, lidhur me përbërësin e atësisë, për fëmijën e lindur nga martesa është shprehur KF përmes institutit të prezumimit [edhe KF edhe LGjC]. Autoritetet administrative, përfshi këtu edhe ato të

shërbimit shëndetësor, nuk mund të dalin mbi ligjin. Personat e interesuar duhet te ndjekin rrugën gjyqësore ne rast se duan ta vënë përmbajtjen e ligjit lidhur me prezumimin e atësisë në provë. Këto kontestime bëhen vetëm në rrugë gjyqësore.

Së dyti, cenohet e drejta e nënës si personi që ka përgjegjësinë prindërore për të vendosur bashkërisht me bashkëshortin që është ligjërisht ati i fëmijës për çdo lloj vendimmarrjeje lidhur me fëmijën, e ca më shumë në një rast të tillë. Asnjë gjë nuk mund të bëhet pa pëlqimin e saj lidhur me fëmijën. Sipas KF të gjitha vendimet lidhur me fëmijën duhet të merren bashkërisht nga të dy prindërit dhe ky është një vendim që do ndikojë mbi fëmijën. Nëna ka përgjegjësinë prindërore e nuk mund të mos merret mendimi i saj. Pëlqimi dhe miratimi i të dy prindërve duhet të garantohet në çdo vendimmarrje lidhur me fëmijën. Injorimi i nënës së fëmijës dhe veprimi në fshehtësi nuk sjell asnjë rezultat, por flet për diskriminim e pabarazi të rrënjosur.

Ndërkohë duhet të nënvizojmë se, edhe sikur bërja e testit të pranohet nga të dy prindërit, përsëri gjykata nuk mund ta marrë këtë si provë sepse për marrjen e provës kërkohet një procedurë e veçantë. Lidhur me çështje të atësisë, ka një jurisprudencë të elaboruar të GjEDNj. Në çështjen *Mizzi kundër Maltës*[129] nëna nuk pranoi kurrë të bëhej ADN e fëmijës dhe bashkëshorti i saj, një pasanik që dyshonte gjithë kohën për këtë, e mori vesh të vërtetën vetëm kur fëmija ishte i rritur dhe vetë fëmija, me dëshirë bëri analizën e ADN. Një nga konkluzionet që nxirret nga GJEDNJ në rasti Mikulić kundër Kroacisë dhe që duhet të mbahet në vëmendje nga autoritetet gjyqësore shqiptare në rastet lidhur me atësinë është vlerësimi [ose mbivlerësimi] i provës së ADN-së. E ndërsa asnjë nuk mund të detyrohet për testin e ADN-së me qëllim që të vendoset atësia në rrugë gjyqësore, interesi i individit që kërkon njohjen e atësisë duhet të garantohet në një mënyrë tjetër.

Provat e mbledhura prej atit në rastin që prezantuam rezultojnë të marra në mënyrë te njëanshme dhe cenojnë aspekte morale, etike të rëndësishme dhe për rrjedhojë që të paraqiten si prova duhet të jenë pjesë e një procedure.

Është e drejta e çdo individi që të marrë dijeni dhe të jetë i qartë për lidhjet familjare. Prej tyre burojnë te drejta dhe detyrime. Pra, ndërsa në parim është një e drejtë e atit, kundrejt interesit të fëmijës, kjo e drejtë e atit paraqitet e dobët. Në çdo çështje që ka të bëjë me fëmijët duhet parë interesi i fëmijës dhe për realizimin e kësaj të drejte ai duhet të veprojë përmes rrugës gjyqësore. Ky interes që po shpreh ati për të pasur të qartë realitetin biologjik duke bërë një analizë mjekësore në fshehtësi, pra nxjerrja e së vërtetës biologjike mbi prezumimin ligjor, duhet të jete e balancuar me parimet dhe vlerat që përmban legjislacioni, të tilla si interesat e pasardhësve, identiteti i bërthamës familjare dhe stabiliteti i shoqërisë. Ndaj shteti ka rregulla të tilla kaq strikte lidhur me atësinë që disave mund t'u duken edhe

[129] Mizzi v. Malta, aplikimi numër 26111/02, 12 Janar 2006.

cenime. Atyre që kanë dyshime nuk u pengohet rruga gjyqësore.

Çdokush që ka "një interes personal të justifikuar dhe të mjaftueshëm" mund të kërkojë kundërshtimin e atësisë". Aplikimi për të bërë analizën e ADN-së nuk është një çështje për të qetësuar një baba kundrejt tradhtisë së prezumuar të bashkëshortes së tij. Kjo nuk mund të qëndrojë si një kërkesë e izoluar që iu paraqitet autoriteteve administrative në mënyrë të njëanshme për të bërë një baba të qetë, sepse kjo do të krijonte precedentë shumë të rrezikshëm. ADN-ja në një rast të tillë duhet të jetë pjesë e një procesi të njohjes apo kundërshtimit të atësisë. Edhe në rastin e procedurave gjyqësore, gjykata nuk urdhëron dot të bëhet ADN-ja. Kjo bëhet vetëm me pëlqimin e palëve në proces. Vetëm kur interesi i lartë i fëmijës e kërkon, gjykata mund të zgjidhë këtë problem në një mënyrë më detyruese. Si të tilla mund të jenë rastet që kanë të bëjnë me shëndetin e fëmijës dhe domosdoshmërinë e bërjes së analizave gjenetike për qëllime shëndetësore. Çdo analizë laboratorike e cila bëhet me qëllim që të merret informacion për aspekte të veçanta të statusit gjenetik të individit, konsiderohet si analizë gjenetike. Nëse dyshohet për një çrregullim gjenetik specifik, me qëllim që të vendoset një diagnozë përfundimtare, mund të propozohet bërja e analizave gjenetike, kur këto të fundit janë të mundshme. Prindërit mund të kenë qëndrime të ndryshme miratuese ose jo ndaj kësaj analize. Kështu që në një rast të tillë çështja mund të përcillet në gjykatë. Analiza gjenetike tek të miturit gjithmonë është trajtuar me shumë kujdes. Zakonisht, fëmijët dhe adoleshentët do të analizohen gjenetikisht vetëm nëse nga rezultati i analizës varen masat urgjente parandaluese ose mjekuese. Në rast se analiza nuk është urgjente (p.sh. sëmundja/çrregullimi fillon vetëm në moshë të rritur dhe nuk mund të fillohet mjekim përpara kësaj kohe) analiza zakonisht shtyhet derisa i mituri të ketë arritur moshën e duhur për të bërë vetë zgjedhjen përkatëse, pasi të jetë informuar paraprakisht.

Duke qenë se çështjet e atësisë janë çështje te rëndësishme dhe që kanë të bëjnë me interesin publik, përfshihet si subjekt prokurori.

Gjykata e Kasacionit e Italisë, Seksioni Civil, në vendimin nr.21014/13.09.2013 nënvizon se babai që kërkon të kundërshtojë atësinë e një fëmije nuk mund të mbështetet në një agjenci investigative për të mbledhur prova të ADN-së dhe mandej të vlerësojë përshtatshmërinë e procedurave ligjore. "Përpunimi i të dhënave gjenetike, në këtë rast synon të ndihmojë në zgjedhjen e mëvonshme të veprimit në drejtim të mohimit të atësisë nga përcaktimi paraprak i lidhjeve të gjakut atë e bir.

Me ligjin nr.10 339/28.10.2010 Shqipëria ka aderuar në Konventën e Këshillit të Europës "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të qenieve njerëzore lidhur me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë". Sipas nenit 12 të kësaj Konvente testet gjenetike parashikuese mund të kryhen vetëm për qëllime shëndetësore ose kërkime shkencore të lidhura me qëllime shëndetësore dhe i nënshtrohen konsulencës së duhur gjenetike.

5. Përgjegjësia prindërore pas zgjidhjes së martesës dhe vështirësitë shumëformëshe në gëzimin të drejtave dhe lirive të ish-bashkëshortëve

Në praktikën gjyqësore, për mënyrën e re të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës, zakonisht përdoret shprehja të tilla si 'lënie në kujdestari', 'fëmija është lënë në kujdestari të nënës' etj. Në këtë mënyrë duket se referimi tek instituti i kujdestarisë sipas dispozitave që gjenden në KF lidhur me këtë institut nuk është korrekt.

Përgjegjësia prindërore është një ndër institutet e rëndësishme të KF. Në nenin 18 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF e OKB) vihet theksi në përgjegjësinë e përbashkët të prindërve për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës dhe në sanksionimin e parimit se ata duhet të udhëhiqen nga parimi bazë i kësaj Konvente, që është interesi më i lartë i fëmijës. Praktika gjyqësore tregon se, modelet e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore gjatë martesës, nga njëri prind, sjellin pakënaqësi tek tjetri dhe e zgjerojnë konfliktin midis tyre deri në zgjidhjen e martesës[130].

Nëna është më së shumti prindi pranë së cilës qëndron fëmija pas zgjidhjes së martesës. Monitorimi i vendimeve gjyqësore të 4 gjykatave të rretheve gjyqësore, Tiranë, Shkodër, Vlorë e Durrës, për një periudhë rreth 1 vit e gjysmë [janar 2011- 31 maj 2012] bërë nga QNLQ tregon se në rreth 90% të rasteve ndodh kështu. Si e tillë, ajo, pra nëna, është ushtruesja kryesore e përgjegjësisë prindërore. Por rritja dhe edukimi i fëmijës, pavarësisht zgjidhjes së martesës, është detyrim i të dy prindërve.

Përmbajtjen e përgjegjësisë prindërore e përbëjnë të gjitha të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit në raport me fëmijët e tyre, detyra, të drejta dhe pra, përgjegjësi, të cilat burojnë nga të qenit nënë ose atë i fëmijës dhe nuk kanë lidhje as me martesën e as me bashkëjetesën e tyre, po kështu as me faktin që prindërit e kanë zgjidhur martesën. Përmbajtjen e përgjegjësisë prindërore e përbëjnë detyrime të tilla si detyrimi për mirërritje, edukim, arsimim, përfaqësim ligjor dhe për administrimin e pasurive të të miturit. Nga kjo mënyrë konceptimi, për shkak të përgjegjësisë prindërore, midis prindërve dhe fëmijëve krijohen marrëdhënie me karakter vetjak, jopasuror dhe marrëdhënie të karakterit pasuror. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbështetjes morale dhe materiale deri sa të arrijnë moshën madhore dhe të gjithë përbërësit e kësaj mbështetjeje përbëjnë përmbajtjen e përgjegjësisë prindërore.

Në planin e prindërimit, pas zgjidhjes së martesës, e për rrjedhojë në ushtrimin e përgjegjësive prindërore, vlen të merret seriozisht parimi i barazisë dhe mos diskriminimit të prindërve. Kjo do të thotë

[130] Kështu, p.sh., sipas Vendimit nr.3038/25.03.2013 të GjRrGj Tiranë kemi: "Me kalimin e kohës midis palëve kanë filluar grindjet dhe mosmarrëveshjet të cilat e kanë tronditur thellë martesën dhe e kanë bërë të pamundur bashkëjetesën mes palëve. Paditësi shpjegoi në seancë gjyqësore se problemet midis tij dhe të paditurës kanë lindur si rrjedhojë e angazhimit të të paditurës në ritet e fesë myslimane si dhe për faktin që ajo mësonte edhe fëmijët me ritet e kësaj feje. Paditësi shpjegoi gjithashtu se vajzat janë ende ne moshe te mitur dhe kur te rriten ato e zgjedhin vetë besimin fetar e jo t'iu imponohet në këtë moshë. Në këto kushte, martesa nuk funksionon dhe si e tille ka mbetur formale. Aktualisht palët nuk bashkëjetojnë me njeri-tjetrin prej rreth gjashtë vitesh."

se qoftë prindërit kundrejt njëri-tjetrit, ashtu edhe cilido autoritet (gjykatat etj.) duhet të respektojë barazinë ndërmjet prindërve dhe asnjë diskriminim nuk mund të bëhet për shkak të gjinisë, etj. Vendosja e parimeve të barazisë edhe në përgjegjësinë prindërore, përkatësinë dhe ushtrimin e saj, midis nënës dhe atit të fëmijës, ka për qëllim të realizojë interesin me të lartë të fëmijës, nga njëra anë dhe të vendosë barriera ndaj diskriminimit të gruas si nënë, nga ana tjetër, duke mundësuar gëzimin e jetës private dhe familjare për të gjithë subjektet. Sipas nenit 220 të KF, rregulli i përgjithshëm është që përgjegjësia prindërore u *përket dhe ushtrohet prej të dy prindërve*.

Përcaktimi i mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, pra, përcaktimi i modaliteteve të marrëdhënieve me fëmijët e prindit që nuk jeton në një strehë me fëmijën ose të besuarit e fëmijës njërit ose tjetrit prind, është një sfidë e vërtetë e gjykatës (shih preambulën e Konventës Evropiane "Për marrëdhëniet me fëmijët"[131], e cila ka zëvendësuar konceptin "e drejta e vizitës" me nocionin "marrëdhëniet me fëmijët"). Në marrjen e një vendimi në interesin më të lartë të fëmijës, ajo duhet të konsultohet me psikologë ose punonjës socialë të cilët duhet të japin një mendim të kualifikuar profesional pas marrjes së një sërë të dhënash për situatën materiale dhe morale të fëmijës, kushtet në të cilat ai jeton dhe ku është më e përshtatshme për të për të jetuar në të ardhmen. Nëse vendimi i përkohshëm i gjykatës vendos për lënien fëmijës një personi të tretë ose një familjeje kujdestare, për këtë gjykata duhet të marrë domosdo' mendimin e sektorit të ndihmës dhe shërbimeve sociale pranë bashkisë së vendit ku zhvillohet gjykimi.

Pas zgjidhjes së martesës, ish-bashkëshortët kanë përpara një jetë të re të cilën duhet ta gëzojnë dhe për këtë iu duhet të ekuilibrojnë përgjegjësitë ndaj fëmijëve me të drejtat dhe liritë e tyre personale. Ndonëse nuk ka formula definitive dhe nuk ka qasje identike e ligji flet për barazi prindërore, prindi "që ka në kujdes fëmijën/ët" ka, në praktikë edhe përgjegjësi, detyra e angazhime më të mëdha kundrejt tyre. E pranojmë këtë sepse, prindi që ka fëmijët në kujdes, dhe siç rezulton ky prind është përgjithësisht nëna, ka përgjegjësi të përditshme dhe has në mënyrë dinamike dhe progresive probleme të reja e të ndryshme që fëmija i paraqet çdo ditë. Edhe prindi tjetër ka përgjegjësitë dhe të drejtat e veta kundrejt fëmijëve për të patur marrëdhënie vetjake dhe të rregullta me ta si dhe të drejtën të ketë takime, të drejtën për të ndjekur apo mbikëqyrur, për t'u informuar e konsultuar për zgjedhjet e rëndësishme që lidhen me jetën e fëmijës[132]. Shpesh herë 'të drejtat' pleksen midis tyre aq sa nuk vendoset

[131] Ligji nr.9359/24.3.2005.

[132] Shih neni 158 të Kodit të Familjes dhe neni 8 e 10 të Ligjit nr. 10 347/4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës". Në nenin 18 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF e OKB) vihet theksi në përgjegjësinë e përbashkët të prindërve për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës dhe në sanksionimin e parimit se ata duhet të udhëhiqen nga parimi bazë i kësaj Konvente, që është interesi më i lartë i fëmijës.

dot ekuilibri midis interesit të fëmijës dhe të drejtave e lirive të prindërve në situatën e krijuar. Çiftet që kalojnë këtë 'krizë' kanë vështirësi të gjejnë "gjuhën e përbashkët" apo mirëkuptimin, ndonjëherë edhe për çështje të rëndomta. Por, referuar ligjit, zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre[133].

Nga statistikat zyrtare, vëmë re se kundrejt çështjeve familjare të regjistruara në gjykata, volumin më të madh e zënë ato të zgjidhjes së martesës[134]. Në statistikat zyrtare nuk ka një diversifikim të të dhënave mbi mosmarrëveshjet e prindërve pas zgjidhjes së martesës lidhur me aspekte të ndryshme të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, por ne, mund abstragojmë mbi një konkluzion të mbështetur se, një përqindje të konsiderueshme [pasi zbresim zgjidhjet e martesës së çifteve pa fëmijë], e zënë çështjet familjare lidhur me pasojat që sjell zgjidhja e martesës mbi fëmijët[135]. Shpesh për këto kërkohet ndërhyrja e gjykatës. Kjo edhe në raste që, parë së jashtmi, duket se janë të mundshme për t'u zgjidhur me mirëkuptim.

Problemet e hasura në praktikë lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore:

Në praktikë konstatohet se zgjidhja e martesës shoqërohet me kufizimin e 'lirisë së zhvendosjes' së fëmijës dhe të prindit që e ka në kujdestari në një shtet tjetër, për shkak të pengesave që vijnë nga prindi tjetër ose të afërmit e tjerë të fëmijës dhe të mosmarrëveshjeve të prindërve. Po kështu, nuk janë të panjohura rastet e mos marrjes së pëlqimit dhe mohimit të të drejtave për marrëdhënie e kontakte me fëmijën.

Nga Vendimin nr. 8471/21. 09.2012 i GjRrGj Tiranë, mësojmë se rimartesa jashtë shtetit, pas mbarimit të martesës për shkak të vdekjes së bashkëshortit, i ka kushtuar nënës së një fëmije për të cilin kujdesen gjyshërit nga ana e atit të tij, heqjen e përgjegjësisë prindërore të fëmijës. Pra, këto janë kosto të lirisë së lëvizjes kundrejt detyrimeve familjare dhe në thelb gëzimit të jetës familjare sipas nenit 8 të KEDNJ. Nga analiza e disa vendimeve, vëmë re se si në vend që kërkesa të paraqitet përmes institutit të pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, aplikohet, në mënyrë të gabuar, instituti i heqjes së përgjegjësisë prindërore.

Veç sa më sipër, vështirësitë vijnë e shtohen kur fëmija përdoret si mjet presioni ndonjëherë duke manipuluar edhe me 'mbrojtjen e interesit të fëmijës' për të penguar apo vështirësuar të drejtën që ka ish-bashkëshorti apo bashkëshortja për jetën e vet private pas zgjidhjes së martesës dhe kombinimin e jetës private me jetën familjare. Në praktikën shqiptare, hakmarrja prindërore shkon deri në 'rrëmbimin

[133] Shih Kodi i Familjes, Neni 154.

[134] Kështu për vitin 2008 numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej në gjykatat e rretheve gjyqësore është **8082.** Nga ky numër **6109** janë zgjidhje martese. **Në vitin 2009** numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **7832**. Nga ky numër **6169** janë zgjidhje martese. **Në vitin 2010** numri i çështjeve familjare të regjistruara gjithsej është **7657**. Nga ky numër **5970** janë zgjidhje martese.

[135] Zgjidhjet e martesës sipas të dhënave të marra nga Vjetari Statistikor të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010.

civil të fëmijës' dhe privimin e fëmijës dhe të prindit tjetër nga kontaktet e marrëdhëniet[136]. Shembulli tipik të cilin duam të sjellim në vëmendje të gjyqtarëve është çështja *Bajrami kundër Shqipërisë* [GjEDNj] ku renditen përpjekjet e dështuara të një ati lidhur me ekzekutimin e vendimit mbi kujdestarinë e fëmijës pas zgjidhjes së martesës. Pas zgjidhjes së martesës, F.M, bashkëshortja e ankuesit udhëtonte shpesh në Greqi, duke e lënë të bijën për një kohë të gjatë me prindërit e saj në Vlorë, ose duke e marrë në Greqi me vete pa pëlqimin e ankuesit. F.M. dhe prindërit e saj e kishin ndaluar ankuesin të takohej me të bijën. Që pas ndarjes me F.M., ankuesi është lejuar të takohet me të bijën vetëm dy herë, në shtator 2000 dhe maj 2003. Ankuesi i kërkoi policisë së rrethit Vlorë të bllokonte pasaportën e së bijës për faktin se bashkëshortja e tij po planifikonte ta merrte atë në Greqi pa pëlqimin e tij. Pavarësisht nga kërkesa e ankuesit drejtuar policisë së rrethit Vlorë, rezulton që e shoqja e mori fëmijën në Greqi më 15 janar 2004, duke përdorur një certifikatë zyrtare, ku e bija e ankuesit ishte regjistruar me emrin I.M. dhe përdorte mbiemrin e F.M.-së, çka nënkupton një ndryshim të plotë të identitetit të fëmijës.

Pa dyshim që ka edhe përvoja të marrëveshjeve prindërore, rasti që citohet në Vendimin 3957/23.04.2012 i GjRrGj Tiranë lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës dhe lëvizjes së prindit kujdestar drejt Kanadasë.

Mbrojtja më e mirë e interesave të fëmijëve dhe të prindërve të tyre në situata të komplikuara dhe me elemente të huaj mbetet ende një sfidë në rritje e gjykatës[137]. Pa dyshim që në çështjet e aksesit prind-fëmijë duket se gjyqtarit i takon të dalë pak nga roli i vet rutinë dhe të luajë shpesh herë edhe rolin e një këshilluesi të mirë jo vetëm dhe thjesht nga një nen i ligjit por nga interesat në konflikt.

Pra, nisur nga sa më sipër, problemet për diskutim në rastin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës shtrohen në dy plane:

---

[136] Shih: GJEDNJ Bajrami kundër Shqipërisë në: http://www.gjykataelarte.gov.al/

[137] Po kështu, së fundmi, kemi edhe një çështje tjetër në fushën e jetës familjare për të cilën është shprehur GJEDNJ. Çështja *Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë*, (vendim i datës 8 Janar 2013 i GJEDNj), ku ankuesi ka pretenduar në bazë të neneve 8 dhe 6 § 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shkelje të së drejtës për të takuar fëmijën e tij, fituar në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë të gjykatës shqiptare, ndërkohë që kujdestaria e fëmijës i ishte njohur tezes së fëmijës nga ana e gjykatës italiane. Shih rastin në http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-115854 në versionin anglisht. Përsa i përket pretendimeve kundër shtetit italian, GJEDNJ vendosi papranueshmërinë e tyre, pasi ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore si rezultat i mosankimimit të vendimit gjyqësor italian që i njihte të drejtën e kujdestarisë tezes së fëmijës. Në lidhje me pretendimet kundër shtetit shqiptar, ndër të tjera GJEDNJ duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, arriti në konkluzionin se neni 8 i Konventës nuk duhet të kuptohet se vendos detyrime ndaj një shteti të paditur që t'i sigurojë një ankuesi që të ketë kontakte me fëmijën e tij, në një kohë kur ky i fundit është zhvendosur në një juridiksion tjetër dhe është jashtë juridiksionit të shtetit të paditur. Si rrjedhojë, Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës kundër shtetit shqiptar.

në atë të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës, në rastet kur duhet të ndryshohen rregullat mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe në atë të respektimit të të drejtave të prindërve mbi fëmijën për të patur marrëdhënie me ta në situatën e re të krijuar.

Nga vetë natyra e dispozitave të Kodit të Familjes, kuptojmë se për shkak të ecurisë dhe zhvillimeve ritmike që imponon jeta familjare, mosha e fëmijës, ndryshimet në jetën social-ekonomike të prindërve, të priturat e të papriturat e jetës, nevojat dhe kërkesat e reja, etj., vendimet gjyqësore lidhur me aspekte të përgjegjësisë prindërore janë të ndryshueshme[138]. Një vendim i ri mund të sjellë ndryshim të plotë ose të pjesshëm të aspekteve të përgjegjësisë prindërore. Çdo vendim, sado i ndryshëm që të jetë nga vendimi/et e mëparshme dhënë për rregullimin e marrëdhënieve midis të njëjtëve prindër e fëmijë, imponuar nga situata e re e prindërve apo nevojat e fëmijëve, në procesin e konsolidimit të vet, duhet të vlerësojë interesin e fëmijëve për të patur marrëdhënie me prindërit dhe të drejtat e prindërve në stadin aktual dhe 'mundësisht' edhe perspektiv të tyre[139]. Gjithsesi, është shumë e rëndësishme që gjykata të bëjë kujdes që të nxisë ndërmjetësimin jashtë gjyqësor ose të nxisë komunikimin e prindërve me qëllim që prindërit të merren vesh dhe të zgjidhin me mirëkuptim çështje që lidhen me përgjegjësitë prindërore, sepse në fund të fundit pa këtë mirëkuptim edhe vendimi nuk ka vlerën e duhur sociale e juridike[140]. Këtu megjithatë duhet vendosur rezerva e ndalimit të përpjekjeve për pajtim në rastet kur kemi dhunë në familje. Ky është standardi i vendosur nga Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës në familje, e njohur ndryshe edhe si Konventa e Stambollit.

---

[138] Sipas neni 159 të Kodit të Familjes: "Vendimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të ndryshohet në çdo çast nga gjykata, me kërkesën e njërit prej ish-bashkëshortëve, një të afërmi ose të prokurorit.

[139] Në çështjen Giszczak kundër Polonisë (nr. 40195/08) e datës 29.11.2011 të GJEDNJ, vuri re dy shkelje të nenit 8 të KEDNJ. Rasti lidhet me refuzimin për liridalje nga burgu që i bëhet një të burgosuri i cili dëshiron të takojë vajzën e vet e cila ishte aksidentuar nga një autobus dhe gjendej në gjendje kome. Pas vdekjes së saj, aplikuesi nuk mundi të ndjekë funeralin sepse nuk ishte e qartë nëse ai mund të shkonte në funeral me rrobat e burgut dhe pranga ose i shoqëruar me skuadrën e policisë. Autoritetet nuk i ishin përgjigjur në kohë kërkesë së aplikuesit për të shkuar në funeral duke i mohuar takimin e fundit me vajzën e tij. Nga ana tjetër edhe mos lejimi për ta vizituar atë ne spital nuk kishte argumente të bazuar dhe nuk ishte në proporcion me të drejtën prindërore.

[140] Është parim i KF që çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe *mirëkuptimi*. Sipas Ligjit nr 10 385/ 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", neni 2 pika 4: Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, **detyrimisht ftojnë palët** për zgjidhjen me ndërmjetësim, **veçanërisht, por pa e kufizuar** vetëm në to, të mosmarrëveshjeve: a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve; b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes;

Neni 48 – Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit

1 Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Kjo do të thotë që, përpjekjet për pajtim të parashikuara nga neni 134 – 136 e 221 i Kodit të Familjes, nuk duhet të aplikohen.

Në raste të tjera, pra kur nuk ka vend për dhunë, gjykata duhet të bëjë përpjekje për të lehtësuar një bashkëpunim e mirëkuptim të tillë, me qëllim që çdo detyrim për të zbatuar detyrimet në çështjet e përgjegjësisë prindërore të kufizohet nga interesat, të drejtat dhe liritë e të gjithë të interesuarve dhe, më në veçanti, interesat më të mira të fëmijës dhe të drejtat e tij/saj.

Çdo fëmijë gëzon të drejtën për të qëndruar me prindërit e vet dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës[141]. Duket se në këto procese ka rëndësi vlerësimi i dëshirës së fëmijës. Nga ana tjetër, nëse fëmija është ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit, ka të drejtë të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij/saj. Asnjë nuk mund të ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me prindin tjetër dhe të afërmit. Këtë e bën vetëm gjykata kur vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

Deri në moshën 18 vjeç, fëmijët janë në përgjegjësinë prindërore. Kjo do të thotë që, si rregull, të gjitha vendimet lidhur me ta merren nga prindërit në interes të fëmijës duke respektuar parimin e së drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar. Ndryshimet e jetës së prindit që ka në kujdestari fëmijën, qoftë për shkaqe ekonomike apo sociale mund të sjellin nevojën që prindi të largohet jashtë shtetit. Shqiptarët gjithnjë e më shumë lëvizin të lirë jashtë shtetit për arsye të ndryshme si pushime, punësim, martesë, etj.

Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve[142]. Kjo lloj zhvendosjeje e fëmijës implikon planet e prindërimit dhe për rrjedhojë rregullat "në fuqi" deri në atë moment të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. Procedurat që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, duke përfshirë zbatimin e vendimit përfundimtar, kërkojnë trajtim urgjent përderisa zgjatja e kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit. Këtë na tregoi rasti Bajrami kundër Shqipërisë. Ati vdiq pa e takuar fëmijën. Por ky nuk është rasti i vetëm. Veç kësaj, në këto vendime, çdo rregullim i ri mbi ushtrimin e përgjegjësisë prindërore duhet parë në

[141] Shih neni 8 i Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"

[142] Neni 10 i Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

nivelin e zbatueshmërisë në kushtet e reja të krijuara. Për këtë, gjykata duhet të hedhë çdo hap me kujdes deri në një vendimmarrje lidhur me përgjegjësinë prindërore. Pra, nëse fëmija i është lënë nënës dhe nëna shkon të jetojë ne Kanada, vendimi nuk mund të parashikojë takime periodike siç janë në rastin kur fëmija jeton në Shqipëri, sikurse vendimi duhet të parashikojë mënyrën e re të realizimit të kontakteve qoftë edhe 'virtuale', periodike e të shpeshta në kushtet e distancës gjeografike. Vëmendja e gjykatës duhet të jetë në argumentet e paraqitura nga palët në proces dhe që e bindin gjykatën se interesi më i lartë i fëmijës është që fëmijës t'i garantohet rritja në një mjedis të shëndetshëm për zhvillimin e tij/saj dhe të mbahen lidhjet me familjen, kuptohet kur kjo nuk përbën rrezik për të.

Në rast të zhvendosjes së fëmijës jashtë shtetit, qoftë edhe për pushime, autoritetet, në rastin konkret policia kufitare, kërkon disa dokumente, ndër të tjera edhe deklaratën me akt noterial të prindit tjetër për lejimin e udhëtimit të fëmijës. Ky dokument nuk ka të bëjë vetëm me situatat e zgjidhjes së martesës por me çdo rast kur fëmija shoqërohet nga njëri prind apo një person i tretë. Në rastin kur çifti ka zgjidhur martesën, dhënia e pëlqimit kërkon ose mund të kërkojë një informacion të plotë lidhur me itinerarin, kohën e kthimit, vendqëndrimin, aktivitetet që do të frekuentohen, mënyrën e komunikimit gjatë udhëtimit, etj. nga ana e prindit që shoqëron fëmijën dhënë prindit tjetër. Këto janë informacione të domosdoshme.

Sipas Ligjit nr.9861/24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror", të miturit i nënshtrohen, si të rriturit, kontrollit të plotë të dokumenteve nga punonjësi i Policisë Kufitare dhe i Migracionit. Ky kontroll bëhet si për fëmijët e shoqëruar edhe të pashoqëruar. Në rast se nga kontrolli i dokumenteve të të miturit, të shoqëruar nga një person madhor, punonjësi i Policisë Kufitare dhe i Migracionit krijon bindjen se i mituri po i largohet kujdesit prindëror apo të kujdestarit të vet ligjor, atëherë bën hetime të menjëhershme për vlefshmërinë e informacionit të paraqitur. Kontrollit të plotë e rigoroz të dokumentacionit u nënshtrohen edhe të miturit, që udhëtojnë të pashoqëruar, në mënyrë që të mos largohen pa dëshirën e prindërve apo të kujdestarit e që mund të bien viktima të trafikimit etj[143]. Prindi ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës, ose çdo person që merr dijeni për humbjen e tij duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës[144].

143 Neni 36 i Ligjit nr.9861/24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror". Shih gjithashtu Ligjin nr.9544/29.5.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktima të trafikimit".

144 Lidhur me autoritetin shtetëror përgjegjës në raste të tilla, veç policisë, shih gjithashtu edhe Ligjin "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", përkatësisht neni 32 e vijues në të cilin renditen si Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës: Mekanizmat në nivel qendror janë: a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës; b) ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Mekanizmat në nivel vendor janë: a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut; b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.

Në rast se prindërit nuk merren vesh me njëri-tjetrin për zhvendosjen e fëmijës, atëherë, kjo realizohet me vendim gjykate[145]. Në një rast të tillë, gjykata vihet në lëvizje me anë të një kërkesë padie. Fëmija, sikurse prindi ka të drejtë për pushime dhe argëtime kulturore e sportive dhe askush nuk mund ta privojë nga kjo e drejtë për sa kohë është në interesin e tij/saj. Nisur nga lista e përkufizimeve të renditura në nenin 3 të Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" vëmë re se konsiderohen si "dhunë psikologjike" veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes kur këto shkaktohen nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën. Është e padiskutueshme rëndësia që ka liria e lëvizjes dhe mbrojtja e kësaj lirie, me qëllim gëzimin e plotë të jetës familjare prej gjithsecilit. Por, nga ana tjetër kërkohet një hetim i plotë gjyqësor mbi interesin e fëmijës në rastin e proceseve të tilla si edhe të të drejtave të prindërve kundrejt tyre. Në procese të tilla është shumë e rëndësishme përfshirja e prindërve në vendimmarrje. Meqë çështje të tilla hyjnë në gamën e atyre të trajtuara sipas nenit 8 të KEDNJ, pikërisht referuar GJEDNJ në çështjen *W kundër Mbretërisë së Bashkuar* vlen të nënvizojmë se "procesi vendimmarrës që çon në masat e ndërhyrjes duhet të jetë i drejtë dhe i tillë që të bëjë respektimin e duhur të interesave që mbrohen ...". Çfarë ... duhet përcaktuar është nëse, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit dhe sidomos natyrën serioze të vendimeve të marra, prindërit përfshihen në procesin e vendimmarrjes në një shkallë të mjaftueshme për t'u siguruar atyre mbrojtjen e duhur të interesave. Nëse kjo nuk është përmbushur, do të ketë një cenim të respektimit të jetës së tyre familjare dhe ndërhyrja që rezulton nga vendimi nuk do të konsiderohet si "e nevojshme" dhe brenda kuptimit të nenit 8"[146].

Shpesh herë problemi ka të bëjë me aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Kjo do të thotë që ka raste që, me miratimin apo pa miratimin e prindit tjetër, fëmija zhvendoset nga njëri prej prindërve dhe nuk kthehet më në vendbanimin e tij/saj të zakonshëm. Rrëmbimi civil i fëmijëve është një problem global që ka nisur të ndihet edhe në praktikën gjyqësore shqiptare pas 'hapjes' së Shqipërisë dhe lehtësirave të lëvizjes jashtë shtetit. Në të shumtën e rasteve, dhënia e miratimit për zhvendosje, justifikuar me pushime, etj., është shfrytëzuar për të bërë 'rrëmbim civil të fëmijës". Kështu që për gjykatën është shumë me vend të reflektojë në mënyrë proaktive jo vetëm pro zhvendosjes së fëmijës, por edhe lidhur me bazën ligjore për të kërkuar moszhvendosjen e fëmijës jashtë shtetit ose për të aplikuar për të ashtuquajturin vendim

[145] Neni 10 i Ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

[146] *W. kundër Mbretërisë së Bashkuar vendimi i 8 korrik 1987, Seria A nr. 121-A], f 28 dhe 29, § § 62 dhe 64.*

për *'ne exeat'*[147], pra ndalimin e zhvendosjes. Kjo vlen kur klienti i tyre ka argumente që tregojnë se zhvendosja është kundër interesit të fëmijës apo zhvendosja paraqet rrezikun e 'rrëmbimit civil ndërkombëtar". Kështu, në çështjen Neulier dhe Shruk kundër Zvicrës, aplikuesja, e frikësuar se mos bashkëshorti i saj do të çonte jashtë shtetit të birin me qëllime të indoktrinimit fetar, në një komunitet të quajtur "Chabad-Lubavitch" aplikoi në gjykatën familjare të Tel Aviv-it për një urdhër ndalimi [*ne exeat* order] për lëvizjen e djalit të saj Noami nga Israeli. Më 20 qershor 2004 gjykata e dha këtë vendim i cili kishte fuqi deri sa fëmija të arrinte moshën madhore. Ndërkohë, aplikuesja i drejtohet përsëri gjykatës më 27 mars 2005 për të anuluar këtë vendim sepse ajo dhe fëmija i saj pengoheshin për shkak të këtij vendimi të lëviznin jashtë shtetit. Në këtë rast, gjykata e Tel Aviv konkludoi se kishte një rrezik serioz që fëmija të mos kthehej më në Izrael sepse nëse nëna do të merrte fëmijën jashtë shtetit, në familjen e saj të origjinës, atëherë, ajo mund të mos kthehej më sepse ajo nuk kishte lidhje me vendin. Po kështu, në çështjen *C. kundër. C.* (të gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit; [1989] 1 WLR 654, 657-658), prindi që kishte kujdestarinë mbi fëmijën e kishte çuar fëmijën në Austri duke shkelur një '*ne exeat* order' i cili ndalonte që fëmija të dilte jashtë një hapësire gjeografike të caktuar. Lëvizja e fëmijës do të bëhej vetëm me miratimin e prindit jo kujdestar. Pra, këto vendimmarrje

---

[147] Lidhur me vendimin për mos zhvendosje [*ne exeat*] shih paragrafët 19; 27; 71;74 të çështjes gjykuar prej Dhomës së Madhe të GJEDNJ më 10 Korrik 2010 në *Neuliger dhe Shruk kundër Zvicrës [Aplikim nr. 41615/07.* Në rastin e njohur *Abbott v Abbott* Gjykata Supreme e SHBA ka vendosur "ne exeat" si një institut që lidhet me institutin e kujdestarisë mbi fëmijën. Rasti ka të bëjë me një fëmijë amerikan i cili është marrë nga nëna e tij amerikane, nga Kili dhe është vendosur në Teksas pa miratimin e të atit. Gjykata e çështjeve familjare të Kilit ka dhënë një vendim që ndalon zhvendosjen e fëmijës nga Kili. Në gjykatën federale të shkallës së parë në Teksas, babai, një shtetas britanik ky, nisi një procedim bazuar në Konventën e Hagës "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës" duke kërkuar kthimin e fëmijës në Kili. Pretendimi i tij nuk u pranua. Pas apelimit të pasuksesshëm, ati aplikoi në Gjykatën Supreme të SHBA. Gjykatës iu desh të vendosë nëse e drejta për 'ne exeat' ka të bëjë me të drejtën e kujdestarisë sipas nenit 3 të Konventës së Hagës. Kjo gjykatë pranoi se klauzola për ndalimin e zhvendosjes "ne exeat" dhënë nga gjykata kiliane i referohet së drejtës së kujdestarisë që ka mbi fëmijën ati, të cilit nuk i është lënë fëmija në kujdestari sipas kuptimit të Konventës së Hagës. Sipas nenit 3 të kësaj Konvente kemi: Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

a. konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë që i janë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm para largimit apo mbajtjes; dhe

b. në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes. Të drejtat e kujdestarisë, të përmendura në nënparagrafin (a) më sipër, mund të lindin veçanërisht nga funksionimi i ligjit ose për shkak të një vendimi gjyqësor apo administrativ, ose për shkak të një marrëveshjeje që ka efekt ligjor sipas ligjit të atij shteti.

janë çështje të rënies në konsensus nga ana e prindërve duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës.

Përvoja e parë 'e denoncuar' ndaj Shqipërisë, deri në nivelin e GjEDNJ është rasti *Bajrami kundër Shqipërisë*, çka e bëri detyrim ratifikimin e Konventës së Hagës "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës"[148]. GJEDNJ, përmes jurisprudencës së saj, ka nënvizuar se *"mosmarrja nga autoritetet shtetërore e masave të përshtatshme dhe të mjaftueshme në përputhje me të drejtën e kërkuesit/es për të kthyer fëmijët pranë tij/saj cenon të drejtën për respektimin e jetës familjare"*[149].

Kështu, në çështjen Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë, kërkuesja, një shtetase franceze kjo, ka zgjidhur martesë dhe me vendim të gjykatës franceze është vendosur që të dy vajzat e saj të qëndronin me të. Në vitin 1990, gjatë pushimeve verore, fëmijët shkuan për të qëndruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me ish-bashkëshortin e saj, i cili mbante një shtetësi të dyfishtë franko-rumune. Në fund të festave, ai refuzoi t'i kthente vajzat te kërkuesja. Pas ndryshimit të adresave disa herë, në mënyrë që t'u shmangej autoriteteve amerikane, rast për të cilin ato i ishin referuar Konventës së Hagës të 25 tetorit 1980 mbi rrëmbimin civil ndërkombëtar të fëmijës, ai arriti të ikte për në Rumani në mars të vitit 1994. Gjykata e Shkallës së Parë e Bukureshtit lëshoi një urdhër që kërkon që fëmijët t'i kthehen kërkueses. Përpjekjet për të zbatuar urdhrin nuk rezultuan të suksesshme. Që nga viti 1990 kërkuesja i pa fëmijët e saj vetëm një herë, në një takim të organizuar nga ana e autoriteteve rumune në janar të vitit 1997. Asnjë takim në mes kërkueses dhe fëmijëve së saj nuk u organizua nga autoritetet, edhe pse kërkuesja kishte udhëtuar për në Rumani në tetë raste me shpresën për t'i parë ato. Kërkuesja pretendoi se autoritetet rumune nuk kanë ndërmarrë hapa të mjaftueshme për të siguruar ekzekutimin e shpejtë të vendimeve gjyqësore dhe për të lehtësuar kthimin e fëmijëve tek ajo. Autoritetet kishin shkelur kështu nenin 8 të Konventës. Përpjekjet e bëra për të ekzekutuar urdhrin e datës 14 dhjetor 1994, kërkuesja i përshkroi si "të shtirura" dhe theksoi se asgjë nuk ishte bërë për të gjetur vajzën e saj, që fshihej nga babai përpara ardhjes së përmbaruesit. Ajo kritikoi gjithashtu autoritetet rumune për pasivitetin total që treguan ndërmjet periudhës dhjetor 1995 dhe janar 1997[150]. Vite të tëra që nëna nuk njeh fëmijët e fëmijët nënën. Në çështjet familjare vonesat marrin një përmasë kohore përtej numrit të viteve. Ka disa etapa të jetës ku çdo ditë ka vlerë të veçantë e sidomos në marrëdhëniet prind fëmijë.

Duke qenë se vendimet lidhur me përgjegjësinë prindërore janë vendime si gjithë të tjerat, avokatët mund të vlerësojnë 'sanksionet' që

[148] Shih Ligji nr.9446/24.11.2005 me të cilin ratifikohet Konventa e sipërpërmendur e Hagës.

[149] Vendim i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë i datës 25.01.2000.

[150] Lidhur me jurisprudencën e GJEDNJ shih: Eriksson kundër Suedisë, 22 qershor 1989, Seria A nr. 156, fq 26-27, § 71; Margareta dhe Roger Andersson kundër Suedisë, 25 shkurt 1992, Seria A. jo 226-A, fq 30, § 91; Olsson kundër Suedisë (nr. 2), 27 nëntor 1992, Seria A nr 250, fq 35-36, § 90;Hokkanen kundër Finlandës, 23 shtator 1994, Seria A nr. 299-A, p. 20, § 55).

vijnë si rezultat i mosrespektimit të vendimit, qoftë këto sanksione me natyrë civile, qoftë penale për sa vihen në rrezik interesat e fëmijës. Nga ana tjetër, në këto procese mbetet i rëndësishëm roli i psikologut.

Ajo çka synon të nënvizojë Konventa e Hagës "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar" e ratifikuar nga vendi ynë, janë interesat e fëmijëve si interesa të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre. Konventa synon mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë nga ana e prindit jo kujdestar ose nga ana e prindit kujdestar i cili pengon prindin tjetër nga e drejta e mbajtjes së kontakteve dhe të marrëdhënieve me fëmijën. Pra, në këtë mënyrë mbrohen këto marrëdhënie prind-fëmijë për të dy prindërit pa diskriminim.

Konventa është një instrument shumë efektiv në krijimin e procedurave që sigurojnë kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në shtetin e vendbanimit të përhershëm të fëmijës, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit. Pra, duke përsëritur, Konventa synon të mbrojë marrëdhëniet prind-fëmijë pas zgjidhjes së martesës. Nëse fëmija është larguar nga prindi që ka kujdestarinë mbi të, atëherë është cenuar e drejta e kontaktit të prindit tjetër. Anasjelltas, nëse fëmija është marrë nga prindi 'jo kujdestar', atëherë është cenuar e drejta e atij që ka kujdestarinë. Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë që i janë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm para largimit apo mbajtjes[151].

Si përfundim, vendi ynë ka një bazë të plotë ligjore, që nga Kushtetuta, konventat e legjislacioni i përmendur në këtë shkrim, në mënyrë jo shteruese, që rregullon ushtrimin 'qetësisht' të përgjegjësisë prindërore nga ana e të dy prindërve që kanë zgjidhur martesë. Shumë mbetet ne dorë të vetë prindërve. Ata kanë të gjitha mundësitë që të nxiten për zgjidhjen me mirëkuptim si dhe për zgjidhjen gjyqësisht të cenimeve që synojnë t'i bëjnë njëri-tjetrit por që shkarkohen tek fëmijët. Nga ana tjetër çdo rast zhvendosjeje me keqbesim, me qëllim rrëmbimin si dhe çdo pengesë tjetër për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore kërkon një bashkërendim të autoriteteve, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës. Referimi në rastet e GjEDNJ dhe njohja e mirë e tyre, do t'u japin avokatëve dhe gjyqtarëve argumente dhe mjete për ballafaqimin e këtyre standardeve me realitetin ligjor e faktik shqiptar.

---

[151] Për më shumë lidhur me jurisprudencën e GJEDNJ dhe referimin e Konventës së Hagës "Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës" shih: Francine Bonnaud dhe Patricia Lecoq kundër Francës (nr. 6190/11); Iglesias Gil dhe A.U.I. kundër Spanjës (nr. 56673/00) vendim i datës 29.04.2003; Maumousseau dhe Washington kundër Francës; Bianchi kundër Zvicrës (nr. 7548/04) 22.06.2006; Monory kundër Rumanisë dhe Hungarisë (nr 71099/01) 05.04.2005; Carlson kundër Zvicrës (nr. 49492/06) 06.11.2008; Karrer kundër Rumanisë (nr. 16965/10) 21.02.2012; etj. Shih gjithashtu përmbledhjen në: http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/1E5FE626-F299-445D-B396-9CC428A5FF39/0/FS_Parental_ENG.pdf

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Disa aspekte lidhur me përmirësimin e gjendjes faktike dhe juridike në familjen shqiptare, kanë qenë pjesë edhe e studimeve të mëparshme. Kështu, si të tillë veçojmë analizën ligjore të bërë në kuadrin e UNDP ku grupi i ekspertëve ka dalë me sugjerime konkrete lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor.

Bërja e një përmbledhjeje të tyre dhe vendosja në një listë prioritare e rekomandimeve të papërmbushura, mund të ishte një sugjerim i këtij studimi me qëllim që gjetjet dhe rekomandimet të mos përsërisin njëra-tjetrën.

Rekomandimet në vijim synojnë që të rrisin aksesin e anëtarëve të familjes në çështje që lidhen me barazinë gjinore si dhe të nxisin autoritetet në ndërmarrjen e masave pozitive për këtë qëllim

1. Lidhur me kuadrin ligjor dhe jurisprudencën e GJEDNJ

Studimi evidentoi se reforma ligjore në aspektet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e martesore ka qenë një proces dinamik. Kështu, dispozitat e KF e pasqyrojnë këtë. Po kështu, instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara përcaktojnë detyrime ligjore dhe jurisprudenca e GjEDNj mbetet një udhërrëfyese e sigurtë.

Ndërkohë, sa kohë që rezultatet do të tregojnë një pabarazi të theksuar, kjo duhet marrë si nxitje për reforma ligjore e politikash në vijimësi. Shpesh herë në ligjet neutrale duket se fshihen pasoja diskriminuese nga këndvështrimi gjinor.

Në këtë drejtim mund të veçojmë aspektet ligjore lidhur me:

❒ Rregullimin ligjor të institutit të bashkëjetesës si një domosdoshmë-ri në kushtet që kjo formë e jetës familjare ka marrë përmasa të konsiderueshme në vend. Pavarësisht nëse bashkëjetesa konsiderohet ose jo si një fazë paraprake për lidhjen e martesës, është koha për të bërë adresime ligjore adekuate për këtë institut;

❒ Çështja e mbiemrit të fëmijës në rast mosmarrëveshjeje midis bashkëshortëve. Duke eliminuar klauzolën diskriminuese që fëmija të marrë në këto raste automatikisht mbiemrin e atit dhe duke gjetur zgjidhje të balancuara;

❒ Të saktësohet çështja e legjitimimit aktiv në rastet e kërkesës së lidhjes së martesës nën moshë, për shkak se praktika ka ecur në drejtime të ndryshme duke legjitimuar herë vetëm prindërit e herë vetëm të miturit;

❒ Mbrojtja e të dhënave personale në vendimet gjyqësore kryesisht ku pasqyrohet identiteti i fëmijës, mund të kërkojnë përgatitjen e një udhëzimi

uniform për të gjitha gjykatat në vend, me qëllim që kjo të referojë në një sistem kriptometrik të deshifrueshëm vetëm sipas rregullimeve ligjore;

❒ Mundësia e rregullimeve konform rekomandimit të Këshillit të Evropës lidhur me masat urgjente duke parashikuar një lloj diskrecioni të gjykatës për analogji me ligjin e dhunës në familje;

❒ Ndërhyrjet ligjore duhet të mbajnë në konsideratë ndikimet e së drejtës zakonore me qëllim eliminimin e tyre.

Ratifikimi i një numri të madh konventash nuk e ezauron plotësisht problemin, sepse ende zbatueshmëria e Konventave nuk është e duhura, kjo edhe për efekt të njohurive të kufizuara lidhur me to, por edhe sepse vetëzbatueshmëria e tyre nuk është e mundur, për shkak se kërkohet dalja e një ligji të veçantë.

Një harmonizim i brendshëm i kuadrit ligjor mbetet me rëndësi.

2. Lidhur me zbatimin më të mirë të ligjit nga ana e gjyqësorit (por jo vetëm)

❒ Të njihen dhe zbatohen instrumentet ndërkombëtarë dhe të referohen në vendimet gjyqësore. Kujdes ndaj standardeve të:

o Konventës CEDAW dhe rekomandimeve të Komitetit CEDAW si dhe vërejtjeve përmbyllëse për Shqipërinë;

o Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje". Të mbahet në vëmendje mosaplikimi i procedurës së pajtimit në rastet kur zgjidhja e martesës është pasojë e dhunës në familje;

❒ Të azhurnohen në mënyrë dinamike aktorët e sistemit të drejtësisë me të dhënat e portalit të GJEDNJ lidhur me çështje që implikojnë nenin 14 [mbrojtja nga diskriminimi], 8 [jeta private dhe familjare] dhe 12 [e drejta për martesë] të KEDNj

❒ Të azhurnohen në mënyrë dinamike aktorët e sistemit të drejtësisë me rastet e CEDAW;

❒ Të aplikohet instituti i pavlefshmërisë së martesës në rastet e martesave pa pëlqimin e lirë dhe martesave me detyrim/shtrëngim;

❒ Aktorët e sistemit të drejtësisë të luajnë një rol aktiv edhe gjatë seancave/proceseve gjyqësore në eliminimin e ndikimit të instituteve të së drejtës zakonore;

❒ Të bëhet lidhja me realitetin përmes njohjes së studimeve dhe statistikave, përgatitur nga aktorë të ndryshëm lidhur me fenomenin e diskriminimit dhe aspektet që cenohen nga pabarazia

❒ Të bëhet një analizë e gjerë e rasteve të lejimit të martesës nën moshë duke u mbështetur edhe në sugjerimet e këtij studimi;

❒ Të mbahen në vëmendje rreziqet që mund të vijnë për të miturit në shëndet, edukim, siguri, etj. në rastet e lejimit të martesës nën moshë;

❒ T'i kushtohet vëmendje e duhur kuptimit dhe zbatimit të masave

urgjente, duke u mbështetur edhe në Rekomandimin e Këshillit të Europës

3. Lidhur me ndërgjegjësimin

Sa kohë të drejtat gjenden në letër, por gratë nuk i zotërojnë ato, atëherë është njëlloj sikur të mos kishte ligje.

P.sh., fejesa nuk është institut juridik dhe nuk mbart asnjë detyrim për lidhjen e martesës. Çdo grua është e lirë t'i japë fund një lidhjeje të tillë në mënyrë autonome e jo të përfundojë në një martesë pa pëlqimin e lirë. Ndikimi i së drejtës zakonore duhet të eliminohet në çështjet e lidhjes së martesës, duke nxitur zbatimin e kushteve të njohura nga KF.

Puna me gratë për të njohur të drejtat e tyre duhet të jetë e vazhdueshme jo vetëm përmes aktiviteteve të OJF-ve por edhe këshillimit prej institucioneve, siç janë: noterët, avokatët, zyrtarët e institucioneve, etj. OJF-të, duke qenë se janë në ndërveprim dhe kanë njohje të drejtpërdrejtë me problemet sipas diversiteteve lokale, duhet të shpërndajnë informacion mbi të drejtat e grave dhe rreziqet e cenimit të tyre.

Paralelisht, nuk duhet neglizhuar ndërgjegjësimi i meshkujve me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në çështjet familjare.

Përdorimi i medias dhe mjeteve të tjera të informacionit; përgatitja e emisioneve televizive do të ishte efektive.

4. Nevoja e trajnimeve të aktorëve të sistemit të drejtësisë

Përkatësisht, Shkolla e Magjistraturës dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të kujdesen në vazhdimësi për azhurnimin e aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë me standardet e barazisë gjinore dhe kujdesin në zbatimin e tyre në proceset gjyqësore dhe jashtëgjyqësore. Kështu, nëse çështjet mund të zgjidhen me ndërmjetësim, është shumë e rëndësishme që një marrëveshje e arritur të mos cenojë këto parime bazë.

Rritja e vëmendjes ndaj rolit të prokurorit në çështjet familjare, një pjesë e të cilave janë adresuar si problematike në këtë studim, siç është rasti i martesave pa shpallje, etj.

Mungesa e sigurisë në të drejtat dhe moszbatimi i ligjit mbetet një çështje me rëndësi që shkakton destabilizim social dhe ekonomik. Rritja e vetëdijes mbi të drejtat e anëtarëve të familjes mbetet një sfidë e profesionistëve sa herë hartojnë, miratojnë, zbatojnë e japin vendime si dhe mbrojnë këto të drejta.

Është e rëndësishme që trajnimet të ndërtohen duke qasur standardet me problemet konkrete që hasin gratë dhe familja në Shqipëri, me qëllim që t'u jepet zgjidhje problemeve të dala në terren.

Institute të tilla, si regjimet pasurore martesore, kontributi kompensues, kuptimi i jetës familjare, detyrimi për ushqim, përgjegjësia prindërore, amësia dhe atësia, raporti midis jetës familjare dhe jetës

private pas zgjidhjes së martesës, etj. mbeten me rëndësi prioritare. Njohja e avokatëve me mjetet juridike që mund të përdoren kundër bashkëshortit që shkel detyrimet që burojnë nga martesa mbetet një rekomandim që kërkon ndërhyrje sa më të shpejtë, sepse këto dispozita janë thuajse të pazbatuara në praktikë.

5. Aksesi në informacion dhe shërbime, përfshirë ndihmën dhe këshillimin ligjor

Të gjithë jetojnë në familje. Edukimi me të drejtat dhe përgjegjësitë brenda strukturës familjare mbetet një çështje me rëndësi.

Krijimi i qendrave të këshillimit paramartesor në formatin e një konsulence *ad hoc* pranë zyrave të gjendjes civile, e mandej në mënyrë permanente, do të ndikojë tek brezi i ri në përzgjedhjen e regjimit adekuat dhe në kuptimin e të drejtave dhe detyrimeve gjatë martesës.

6. Statistikat/bazat e të dhënave

Është e patolerueshme që t'u referohesh të dhënave të vjetra dhe të mos marrësh masa për të kontrolluar ndryshimin që ka sjellë çdo aksion ligjor e politikash pozitive. Prandaj, të dhënat duhet të jenë zyrtare dhe të azhurnuara. INSTAT- i, Ministria e Drejtësisë, gjykatat e të tjera agjenci që merren me çështjet e të dhënave duhet të bashkëpunojnë në këtë drejtim dhe të krijojnë statistika jo të izoluara por gjithëpërfshirëse dhe të integruara me aspektet gjinore.

7. Studime e monitorime

Hulumtimet e kryera në funksion të këtij studimi vunë në dukje edhe aspekte të tjera që kërkojnë më shumë kërkim, analizë dhe shtjellim. Kështu studiuesit dhe politikëbërësit mund të gjejnë interes në ndërmarrjen e këtyre studimeve:

❒ Studime mbi impaktin gjinor të pasojave personale e pasurore që vijnë nga zgjidhja e martesës, duke marrë së paku një kampion 10-vjeçar do të ishte efikas për ndërmarrjen e masave adekuate pozitive

❒ Çështje të ligjit, politikave dhe gjendjes faktike të strehimit të grave.

❒ Impakti i standardeve të reja ligjore dhe nënligjore lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

❒ Përgatitja e një komentari për nëpunësit e gjendjes civile me qëllim këshillimin paramartesor mbi të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve dhe regjimin pasuror martesor efektiv.

❒ Përgatitja e një manuali për noterët lidhur me çështje të regjimeve pasurore martesore dhe kujdesin ndaj standardeve të barazisë gjinore në

rastet e regjimeve me kontratë.

❒ Përgatitja e një udhëzuesi me indikatorë të ndryshëm me qëllim përllogaritjen e punës së papaguar si kontribut për familjen.

❒ Përgatitja e një harte me të gjitha rekomandimet e bëra nga studime të mëparshme dhe aktorë kombëtarë e ndërkombëtarë kundrejt statusit të realizimit të tyre në çështjet e barazisë gjinore

Monitorimet e praktikës gjyqësore lidhur me:

❒ Efektin që kanë pasur ligje të ndryshme në dukje neutrale, në cenimin e të drejtave të grave.

❒ Monitorimi i vendimeve gjyqësore me qëllim evidentimin gjithëpërfshirës të akteve e veprimeve noteriale që kanë sjellë cenime të të drejtave pronësore dhe hartimi mbi këtë bazë i programeve trajnuese në bashkëpunim me DHKN.

8. Njohja dhe nxitja e praktikave pozitive

Eliminimi i zakoneve patriarkale dhe diskriminuese është një problem gjithëpërfshirës global. Në këtë drejtim, evidentimi i modeleve pozitive që japin rezultat e që mund të adoptohen në një vend si Shqipëria mund të jetë një veprim i duhur.

9. Në fushën e arsimit

Të shihet mundësia e përfshirjes në kurrikulën e shkollës 9-vjeçare e të mesme njohja, sipas grupmoshës, me standardet e barazisë në familje e në martesë.

BIBLIOGRAFIA

Legjislacion

1. Kushtetuta e R.Sh
2. KEDNJ - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
3. Konventën për të Drejtat e Fëmijës
4. Ligji nr, 7767/9.11.1993 "Për aderimin e RSh në Konventën "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave" CEDAW
5. Kodi i Familjes
6. Ligji nr.8737, datë 12.2.2001 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (Ndryshuar me ligjin nr.9102, datë 10.7.2003) (Ndryshuar me ligjin nr.10 051, date 29.12.2008), neni 2/1 me të njëjtën përmbajtje si kushtetuta.
7. Ligji nr.10173/22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë". (Ndryshuar me ligjin nr. Nr.10 461, datë 13.9.2011)
8. Kodi Etik i Prokurorit
9. Kodi Penal i RSH
10. Rezolutë e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr.(72)29,
11. LGJC [2009, ndryshuar]
12. ligji nr. 8876/4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues".
13. KPrC
14. Ligji nr.9861/24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror".
15. Ligjin nr.9544/29.5.2006 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për mbrojtjen dhe asistencën
16. e fëmijëve, viktima të trafikimit".
17. Konventa e Hagës "Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës"
18. Ligji Nr.10 347/4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".
19. "Strategjia e Shërbimeve Sociale"
20. "Strategjia e Sektorit të Mbrojtjes Sociale"
21. Këshilli i Europës, Rezoluta 1468 (2005) Mbi martesat me detyrim dhe martesat e fëmijëve [anglisht: Forced Marriages and Child Marriages], 5 Tetor 2005, 1468 (2005).

LITERATURË

1. Arta Mandro, E Drejta Familjare, SHB Emal, Tiranë, 2009
2. Anastasi.A, Mandro.A, Shkurti.E, Bozo.A "Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi"
3. A.Mandro "Pa certifikatë lindjeje. Probleme praktike dhe ligjore që lidhen me regjistrimin e lindjeve të fëmijëve. Botuar në revistën juridike "Justitia" Nr.1, botim i Fakulteti jopublik Justicia. ShB Toena. Prill 2008. (Faqe 29-40).
4. Analiza gjenetike për qëllime mjekësore, përgatitur nga Këshilli i Europës.
5. "Forced marriages in Council of Europe member states. A comparative study of legislation and political initiatives". Përgatitur nga Edwige Rude-Antoine Doctor of Law, Research Officer CERSES/CNRS. Directorate General of Human Rights Strasbourg, 2005.
6. Hamit Beqja & Lekë Sokoli: "Divorci. Vrojtime e refleksione". ShB "Dudaj" & "Rinia 2000".
7. Asylum Aid, Women's Asylum News: Issue No. 120, November/ December 2013, December 2013, Issue 120,
8. HIGH SEX RATIO AT BIRTH IN SOUTHEAST EUROPE. A research note prepared by CZ Guilmoto, October 2010
9. Christophe Z. Guilmoto "Sex Imbalances at Birth. Current trends, consequences and policy implications." 2012, botuar nga UNFPA Asia and Pacific Regional Office.
10. "Raporti i paekuilibruar midis sekseve ne lindje në Shqipëri", studim i prezantuar nga Ministria e Shëndetësisë, me mbështetjen e organizatave UNFPA dhe World Vision.
11. Kanuni i Lekë Dukagjinit
12. Protecting the right to respect for private and family life under the European Convention on Human Rights. Council of Europe human rights handbook.
13. Komenti i Përgjithshëm nr. 16 (2005) të Komitetit të OKB për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore lidhur me nenin 3 mbi të drejtat e barabarta të burrit dhe gruas dhe lidhjen me nenin 10 dhe 16 të Konventës.
14. Përmbledhje akteve në fushën e të drejtës familjare dhe mbrojtjes së fëmijëve në kuadrin e Këshillit të Europës
15. Raportet periodike të Shqipërisë në kuadrin e CEDAW
16. Raporti i Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në zbatim të projektit: "Përgatitja e kërkesë padive strategjike me qëllim forcimin e të drejtave të grave dhe rritjen e aksesit të tyre në mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë". Projekti është zbatuar nga QNL, përmes monitorimit të vendimeve gjyqësore për periudhën janar 2011- 1 qershor 2012. mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD.
17. Harry.D Krause. Family Law "In a nut shell". Botimi i tretë. West

Publishing CO. 1995.
18. Council of Europe: European Court of Human Rights, The role of public prosecutor outside the criminal law field in the case-law of the European Court of Human Rights, March 2011
19. Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW për Shqipërinë, korrik 2010
20. Vjetari Statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010

VENDIME TË GJEDNJ

1. Bajrami kundër Shqipërisë
2. Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë
3. Mizzi v. Malta
4. Giszczak kundër Polonisë
5. W. kundër Mbretërisë së Bashkuar
6. Neuliger dhe Shruk kundër Zvicrës
7. Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë
8. Eriksson kundër Suedisë
9. Margareta dhe Roger Andersson kundër Suedisë
10. Olsson kundër Suedisë
11. Hokkanen kundër Finlandës
12. Francine Bonnaud dhe Patricia Lecoq kundër Francës
13. Iglesias Gil dhe A.U.I. kundër Spanjës
14. Maumousseau dhe Washington kundër Francës;
15. Bianchi kundër Zvicrës
16. Monory kundër Rumanisë dhe Hungarisë
17. Carlson kundër Zvicrës
18. Karrer kundër Rumanisë
19. A.A. and Others v. Sweden
20. Chepelev kundër Rusisë
21. Airey kundër Irlandës
22. ČECHOVÁ v. SLOVAKIA
23. Biondic v Kroacia,
24. Cusan and Fazzo v. Italy
25. V.K kundër Kroacisë
26. Lashin kundër Rusisë
27. H kundër Finlandës
28. O'DONOGHUE dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar
29. Ferreira Alves v. Portugal
30. Moldovan and Others v. Romania
31. M. AND OTHERS v. ITALY AND BULGARIA
32. A kundër Kroacisë

VENDIME TË GJL

Vendimi KCGJL, Nr.21001-00864-00-2008 i Regj. Themeltar. Nr.00-2012-448 i Vendimit (68).

Vendimi nr 51/22.02.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

Vendimi i Kolegjit Penal të GJL nr.99/10.02.2010.

Nr.52804-00870-00-2008 i Regj.Themeltar; Nr.00-2010-194 i Vendimi (99).

Vendimi i Kolegjit Penal të GJL. Nr.52102-01216-00-2010 i Regj. Themeltar Nr.00-2011-216 i Vendimit (42).

Vendimi i KPGJL: Nr.52907-00592-00-2008 i Regj.Themeltar Nr.00-2010-795 i Vendimit (538).

Faqe ne web:

http://www.coe.int/

http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N10/485/20/PDF/N1048520.pdf?OpenElement

http://mfa.gov.al

http://www.unhchr.ch/udhr/lang/aln.htm

http://hudoc.echr.coe.int

http://gjykatatirana.gov.al/